



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



RAPORTI
I PERFORMANCËS
2023

Përmbajtja

	Faqe
Mesazhi i Kryetarit	
1 Misioni, Vizioni dhe Objektivat	7
2 Aktiviteti Auditues	8
2.1 Përmbledhje e aktivitetit auditues 2023	9
2.2 Gjetjet kryesore sipas fushave të auditimit	12
2.3 Rezultatet sipas llojeve të auditimit	25
2.4 Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e mëparshme	86
3 Menaxhimi Institucional Dhe Zhvillimi Strategjik	88
3.1 Korniza e Indikatorëve të Matjes së Performancës të KLSH	88
3.2 Implementimi i Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2023-2027 dhe Objektivat 2024	89
3.3 Organizimi institucional dhe zhvillimi e menaxhimi i burimeve njerëzore	94
4 Komunikimi Dhe Bashkëpunimi Me Palët E Interesit	99
4.1 KLSH dhe Kuvendi	99
4.2 Bashkëpunimi Ndërinstitucional	104
4.3 KLSH dhe Media	112
4.4 Programi i Transparencës dhe e Drejta e Informimit	112
5 Vlerësime Nga Institucione Ndërkombëtare	113
6 Treguesit Buxhetorë E Financiarë Të Klsh Dhe Konkluzioni I Auditit Të Brendshëm	115
6.1 Treguesit buxhetorë dhe financiarë të KLSH për vitin 2023	115
6.2 Konkluzioni i Auditit të Brendshëm	117
7 Anekse	119

Mesazhi i Kryetarit

Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor të veprimtarisë së tij për vitin 2023, bazuar në përcaktimet e nenit 164 të Kushtetutës, kërkesave të nenit 31 të ligjit 154/2014 “Për organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si institucion kushtetues i pavarur, i ngritur për t’i shërbyer qytetarëve shqiptarë, Kuvendit dhe palëve të tjera të interesit duke i informuar ata vazhdimisht, në mënyrë të plotë dhe të paanëshme mbi përgjegjësitë që qeveria dhe organet publike ushtrojnë gjatë përdorimit të fondeve publike të taksapaguesit shqiptarë, duke dhënë kështu kontribut në përmirësimin e qeverisjes dhe luftën kundër korrupsionit.



Ky raport ofron një pasqyrë të përmbledhur se si burimet publike që u janë besuar për menaxhim institucioneve publike janë përdorur për të arritur rezultatet dhe objektivat e vendosura në programet dhe politikat qeverisëse me synim mirëqenien e qytetarëve shqiptar, duke i shërbyer kështu Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me informacione të rëndësishme për të siguruar dhe nxitur llogaridhënien, përgjegjshmërinë dhe transparencën e njëjstive të qeverisjes qendrore dhe vendore si dhe përkushtimin e tyre për menaxhimin sa më të mirë dhe efikas të burimeve publike.

Bazuar në këto detyrime, nëpërmjet Raportit vjetor të Performancës paraqitet puna audituese e 160 misioneve të auditimit të kryera në 195 subjekte, në zbatim të Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit, Manualeve të auditimit të aplikuara në KLSH, si dhe në vlerësimin material dhe cilësor të gjetjeve të auditimit, duke konkluduar me dhënien e 185 Opinioneve të Auditimit mbi pasqyrat financiare të subjektit të audituar dhe mbi përputhshmërinë e aktivitetit.

Këto misione auditimi kanë përfshirë njësi të qeverisjes së përgjithshme (njësitë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, të krijuara me Kushtetutë, si dhe ato të krijuara me ligj ose vendim të Këshillit të Ministrave, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, shoqëritë publike etj.); Fondet speciale etj., me synim që nëpërmjet tyre të ndihmojë në përmirësimin e performancës dhe të sigurojë përgjegjshmërinë e qeverisjes duke rekomanduar përmirësime dhe ndryshime ligjore, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike apo shërbimet e tjera, dhe të promovojë menaxhim më të mirë nga Institucionet.

Ky synim i Kontrollit të Lartë të Shtetit është ngushtësisht i lidhur me shkallën e zbatimit të rekomandimeve dhe masave të adresuara institucioneve publike.

Shkalla mesatare e zbatimit të plotë të këtyre rekomandimeve, ndonëse në pjesën më të madhe të pranuar, tregon për nevojën në rritje të angazhimit të institucioneve publike në vlerësimin, hartimin dhe zbatimin e masave për problematikën e evidentuara gjatë auditimeve të KLSH-së. Një angazhim më i madh i Qeverisë dhe i Kuvendit në rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve tona do të nxisë mirëqeverisjen e institucioneve publike, si dhe nëpërmjet rritjes së bashkëveprimit do të nxisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë audituese, duke sjellë vlerë dhe krijuar impakt pozitiv në përmirësimin e jetesës së qytetarëve.

Në këtë kuadër, shfrytëzoj rastin për të sjellë në vëmendjen e titullarëve të institucioneve publike të ndërmarrin veprime konkrete në zbatimin e plotë të rekomandimeve tona, me qëllim reflektimin dhe ofrimin e sigurisë së nevojshme, që fondet publike shpenzohen dhe pasuria publike administrohet e menaxhohet në përputhje me kuadrin ligjor dhe objektivat përkatës të zhvillimit të vendit.

Raporti i performancës për vitin 2023 është përgatitur në përputhje me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr.134/2018, datë 20.12.2018, dhe Manualin e Monitorimit Vjetor, sipas të cilit çështjet që duhet të

përfshihen në përmbajtjen e raportit vjetor, në funksion të shqyrtimit të veprimtarisë nga Kuvendi, i referohen ligjit mbi të cilat mbështetet veprimtaria e institucionit; rekomandimeve të Progres-raportit të BE-së për Shqipërinë dhe shkallës së përmbushjes së këtyre rekomandimeve nga KLSH; informacionit të detajuar për nivelin e zbatimit të rezolutës së Kuvendit; ndryshimeve që i janë bërë kuadrin rregullator; aktivitetit auditues si detyrim kushtetues institucional, shoqëruar me krahasime statistikore me vitin e mëparshëm; statusit të zbatimit të rekomandimeve që KLSH ka dhënë për subjektet e audituara; organizimit të brendshëm të institucionit; të dhënave për të ardhurat dhe shpenzimet, përfshirë fondet e përfituara nga donatorë, si dhe marrëdhëniet dhe komunikimi me institucionet ligj zbatuese.

Raporti Vjetor i Kontrollit të Lartë të Shtetit përmban një analizë të veprimtarisë institucionale gjatë një viti, duke evidentuar punën dhe arritjet për përmbushjen e detyrimeve kushtetuese dhe të zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit 2023-2027. Raporti paraqet një analizë të veprimtarisë audituese vjetore, si dhe të zhvillimit dhe bashkëpunimit institucional. Pjesë përbërëse e Raportit Vjetor janë edhe treguesit buxhetorë dhe financiarë të KLSH-së për vitin 2023, së bashku me konkluzionin e auditit të brendshëm.

KLSH, gjatë vitit 2023 ka përmbushur përgjegjësitë e veta kushtetuese, ligjore dhe misionin institucional, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të auditimit, me qëllim forcimin e përgjegjshmërisë, rritjen e transparencës dhe parandalimin e rasteve të keqpërdorimit të fondeve publike, duke rritur në vazhdimësi profesionalizmin dhe ruajtur integritetin, paanshmërinë dhe pavarësinë si vlera themelore të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në linjë me rekomandimet e progres raportit të KE-së (Kapitullit 32 auditimi i jashtëm), si dhe mbështetjen në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të), të cilët përshijnë një objektiv të veçantë (objektivi 16) për *"nxitjen e shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimin e qasjes në drejtësi për të gjithë, dhe ngritjen e institucioneve efikase, llogaridhënëse dhe përfshirëse"* është i fokusuar që puna e tij të paraqesë një nivel të lartë të cilësisë së veprimtarisë audituese në përgjigje të pritshmërive që Kuvendi, taksapaguesit dhe çdo palë interesi presin nga KLSH, në dobi të mirëqeverisjes dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve, pa veçuar detyrimin ndaj partnerëve ndërkombëtarë të cilët janë mbështetësit tanë kryesor në përmbushjen e reformave për integrimin e vendit në BE.

KLSH, si institucioni më i lartë i auditimit ekonomiko-financiar, objektivitetin dhe pavarësinë institucionale e siguron përmes ushtrimit të mandatit të përcaktuar me Kushtetutë dhe ligj dhe në pajtueshmëri me standardet profesionale të auditimit, kodin e etikës dhe normat e sjelljes profesionale, për të siguruar rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në përdorimin e parasë publike nga institucionet e qeverisjes qendrore dhe lokale, duke qenë një mbikëqyrës i financave publike, *rekomandon* për profesionalizëm dhe përgjegjshmëri të lartë të administratës shtetërore.

Sa më sipër, jam i bindur se eksperiencia dhe përkushtimi i stafit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, janë një garanci më shumë për përmbushjen e detyrave tona dhe objektivave të zhvillimit të vendit.

Ju faleminderit!

Arben Shehu

1. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT

Misioni	Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucion i pavarur, kushtetues, i cili nëpërmjet ekspertizës dhe auditimeve cilësore, mbështet Kuvendin dhe informon publikun dhe palët e interesit në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në menaxhimin e parasë së taksapaguesve, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike.
Vizioni	KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përmirësimin e shërbimeve publike, nëpërmjet auditimeve cilësore dhe luftës kundër korrupsionit, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni.
Objektivat	<p>Përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2023-2027, objektivat e KLSH-së edhe për vitin 2023 ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> · Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH-së si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike. · Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve. · Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.

Në linjë me INTOSAI P-12 “Vlerat dhe përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit – Një ndryshim në jetën e qytetarëve”, KLSH ka adoptuar parimet që përcaktojnë mënyrën se si institucioni duhet të përmbushë mandatin për të forcuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin e qeverisë dhe njësisë të sektorit publik, duke ruajtur vlerat që lidhen me: Forcimin e llogaridhënies, transparencës dhe integritetit të qeverisë në njësitë e sektorit publik; demonstrimin e rëndësisë dhe konsideratës së duhur ndaj qytetarëve, Parlamentit dhe grupeve të tjera të interesit; dhe shndërrimin në një organizatë model, duke udhëhequr nëpërmjet shembullit.

2. AKTIVITETI AUDITUES

AKTIVITETI I KLSH PËRMES SHIFRAVE




* Në 2 auditime nuk janë dhënë opinione mbi pasqyrat financiare

2.1 PËRMBLEDHJE E AKTIVITETIT AUDITUES 2023

Kontrulli i Lartë i Shtetit, në cilësinë e institucionit më të lartë të auditimit të jashtëm publik, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, **për vitin 2023, ka realizuar veprimtarinë audituese duke kryer dhe evaduar 160 misione auditimi nga 154 të programuar.** Në përputhje me mandatin ligjor dhe objektivat strategjike institucionale, KLSH ka zhvilluar auditime financiare, auditime të përputhshmërisë, auditime performance, auditime të sistemeve të teknologjisë dhe informacionit, si dhe auditime të kombinuara (financiare dhe përputhshmërie). Gjithashtu, KLSH, krahas përmbushjes së detyrimit ligjor për auditimin dhe raportimin mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, ka kryer dhe disa auditime përputhshmërie (tematike) për çështje të veçanta me interes publik, të bëra prezent nga palë të ndryshme interesi.

Në referencë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, Manualeve të Auditimit, si dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, **në përfundim të çdo auditimi është konkluduar:** me opinion në auditimet financiare; me opinion ose konkluzion në rastin e disa auditimeve të përputhshmërisë dhe në auditimet IT; si dhe me mesazh në rastin e auditimeve të performancës¹.

Diagrama nr.1 Opinione/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit



Përgatiti: KLSH

Në përfundim të 160 misioneve të auditimit, bazuar në evidencën e auditimit dhe gjykimin profesional të audituesve, është konkluduar me dhënien e 185 opinioneve të auditimit mbi pasqyrat financiare të subjektit të audituar dhe mbi përputhshmërinë e aktivitetit. Bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Manuallet e auditimeve të aplikuara në KLSH, dhe, në vlerësimin material dhe cilësor të gjetjeve të auditimit, janë dhënë 28 opinione të pamodifikuara, 148 të modifikuara, 4 të kundërt, 1 refuzim opinioni dhe 4 konkluzione.

Gjatë vitit 2023, **auditimet janë kryer në 195 subjekte**². Ato kanë përfshirë njësi të qeverisjes qendrore (njësitë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, të krijuara me Kushtetutë, si dhe ato të krijuara me ligj ose vendim të Këshillit të Ministrave, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes qendrore); Fondet speciale, që shërbejnë për financimin e funksioneve shoqërore dhe shëndetësore (ISSH dhe FSDKSH); Njësi të qeverisjes vendore (njësitë e

¹ 1 auditim nuk ka konkluduar në mesazh auditimi

² Auditimet e performancës dhe IT mund të përfshijnë subjekte në të cilat është kryer gjithashtu edhe auditim financiar dhe/ose auditim përputhshmërie.

niveleve të ndryshme vendore, të krijuara me ligj, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes vendore, brenda një territori të caktuar); shoqëritë tregtare, ku kapitali shtetëror është mbi 50 për qind, si dhe projektet me financim të huaj kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.

Tabela nr.1: Subjektet e audituara

Emërtimi	Numër
Institucione të qeverisjes qendrore dhe të vartësisë	30
Njësi të vetëqeverisjes vendore dhe ente të tjera në nivel vendor	68
Shoqëritë publike dhe projektet me financim të huaj	17
Institucionet e administrimit të aseteve dhe agjenci të mbrojtjes së mjedisit	8
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet IT	8
Subjekte në të cilat janë kryer auditimet e performancës	64
Totali i subjekteve të audituara	195


Burimi: KLSH

Duhet theksuar se, në vitin 2023 ka një rritje të numrit mesatar të subjekteve të audituara për çdo auditim në krahasim me një vit më parë mbi 5 %, fakt që i referohet rritjes së auditimeve të sistemeve, kryesisht në auditimet e performancës, por dhe të përputhshmërisë.

Objektivat e misioneve audituese të vitit 2023 janë fokusuar në shqyrtimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së subjekteve të audituara në drejtim të menaxhimit dhe administrimit të fondeve dhe pasurisë publike, si dhe raportimin e tyre, përfshirë dhe çështjet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në bazë të klasifikimit si: gjetje të karakterit të nevojës për përmirësim ligjor, organizativ, të masave për shpërbllimin e dëmit ekonomik dhe si parregullsi/paligjshmëri me efekte negative financiare në përdorimin e fondeve dhe në financat publike, gjetje të karakterit administrativ, për të cilat janë dhënë respektivisht edhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, dhe vijuar më tej me rekomandime për masa disiplinore dhe sipas rastit edhe të karakterit penal.

Kontrulli i Lartë i Shtetit në përfundim të veprimtarisë audituese, në përmbushje të standardeve të auditimit dhe detyrimeve ligjore, **në raportet e tij ka dhënë rekomandime për të marrë masa korigjuese të përshtatshme nga subjektet e audituara.**

Diagrama nr. 2: Masat e rekomanduara nga KLSH, sipas llojit, viti 2023



Përgatiti: KLSH

Në institucionet e audituara gjatë periudhës janar - dhjetor 2023, KLSH ka adresuar gjithsej 5759 rekomandime, nga të cilat: 42 propozime për përmirësime ligjore; 3293 masa organizative; 1468 masa disiplinore dhe administrative, 267 masa për shpërblim dëmi, 641 masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e fondeve dhe 48 masa në fushën e tatimeve dhe doganave për mbledhjen e të ardhurave në buxhet.

Në vitin 2023 janë rekomanduar 339 masa më shumë krahasuar me vitin 2022, kryesisht në drejtimit të përmirësimeve organizative dhe të masave disiplinore, me qëllim ndëshkimin e zyrtarëve publik të cilësuar përgjegjës të parregullsive dhe mangësive të evidentuara, në funksion të mirëqeverisjes dhe luftës kundër klimës së pandëshkueshmërisë.

Nga rezultatet e auditimeve, **gjatë vitit 2023, gjetjet e konstatuara në lëmin financiar** i referohen:

- Parregullsive dhe mangësive në zbatimin e disiplinës buxhetore në programimin dhe realizimin e shpenzimeve publike, likuidimin e shpenzimeve përfshirë dhe ato për investime, krijimin e detyrimeve të prapambetura etj.;
- Përdorimit të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë kryesisht në fushën e prokurimit publik, për shkak të mangësive në realizimin e procedurave të cilat në shumë raste rezultojnë se nuk kryhen në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Tabela nr. 2: Masat për shpërblim dëmi³ dhe për efekte negative⁴ në buxhet, sipas fushave

Në mijë lekë

Emërtimi	Masa për shpërblim dëmi	Masa për efekte negative për shkak të parregullsive
A. Në fushën e të ardhura		
<i>Në fushën e zbatimit të legjislacionit tatimor në Vetëqeverisjen Vendore</i>	7,052	4,605,498
<i>Në administrimin e pasurisë shtetërore dhe marrëdhëniet kontraktuale me palët e treta</i>	1,545	1,344,647
<i>Në koncesione dhe PPP</i>	49,999	3,835
<i>Në administrimin urban</i>	689	400,117
<i>Detyrime të koncesionarëve ndaj Albpetrol dhe të tjera</i>		12,385,432
Totali	59,285	18,739,529
B. Në fushën e shpenzimeve		
<i>Në fushën e pagave, sigurime dhe shpërblime</i>	181,800	1,440,279
<i>Në fushën e shpenzimeve operative</i>	1,388,536	185,334
<i>Në fushën e prokurimeve</i>	386,624	4,373,529
<i>Në koncesione dhe PPP</i>		33,020
<i>Dëmshpërblime për vendime gjyqësore, detyrime të prapambetura dhe të tjera</i>	3,154,244	40,120,939
Totali	5,111,204	46,153,101
Totali (A+B)	5,170,489	64,892,630

Burimi: KLSH

³ Dëmi ekonomik referohet detyrimit të shpërblimit monetar të një individi ose subjekti që i shkaktohet entit shtetëror të audituar në lidhje me veprime ose mosveprime në cenim të disiplinës financiare dhe kuadrin rregullator përkatës.

⁴ Efekti negativ në performancën e subjekteve nën auditim i referohet efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Gjithashtu, KLSH gjatë auditimeve të kryera në institucionet e administratës fiskale (tatime dhe dogana), ka konstatuar parregullsi dhe mangësi në grumbullimin e të ardhurave tatimore dhe doganore, të cilat janë vlerësuar dhe konsideruar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Tabela nr. 3: Mangësi në aktivitetin tatimor dhe doganor me ndikim negativ në të ardhurat buxhetore

Në mijë lekë

Emërtimi	Detyrime tatimore të vlerësuara	Penalitete të vlerësuara	Vlera totale
<i>Nga aktiviteti tatimor</i>	1,488,645	669,408	2,158,053
<i>Nga aktiviteti doganor</i>	141,200	24,234	165,434
Totali	1,629,845	693,642	2,323,487

Burimi: KLSH

Duhet theksuar se, struktura dhe vlera e masave të rekomanduara për shpërblim dëmi dhe atyre të efekteve negative, varen në masë të konsiderueshme nga struktura e subjekteve të audituara, struktura e auditimeve të ushtruara, numri i subjekteve të përfshira në auditim, periudha e aktivitetit të audituar, madhësia e aktivitetit etj., shtu këtu dhe rënien e nivelit të investimeve në vitin 2022. Krahas kësaj, duhet parë dhe si një lloj reagimi i administratës publike në drejtim të përmirësimit të administrimit dhe menaxhimit të fondeve dhe të pasurisë publike, si edhe në kuadër të forcimit të luftës kundër korrupsionit të zyrtarëve publik nga reformimi i sistemit të drejtësisë.

Duhet theksuar se të dhënat e mësipërme të aktivitetit auditues të KLSH-së përfshijnë edhe periudha auditimi më të hershme se viti kalendarik 2023.

Veç sa më sipër, KLSH në kuadër të bashkëpunimit me institucionet ligj-zbatuese, ka adresuar 67 materiale për auditime të ndryshme në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në kuadër të veprimeve hetimore që po kryhen nga ky i fundit, si dhe ka kallëzuar penalisht 10 zyrtarë të administratës shtetërore për veprën penale shpërdorim i detyrës të parashikuar nga neni 248 i Kodit penal, si dhe shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal të kryera në bashkëpunim më shumë se njëherë.

Gjithashtu, 24 materiale auditimi janë adresuar Prokurorive pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në kuadër të nisjes apo vijimit të veprimeve hetimore që kryhen nga ana e këtij organi në kuadër të procedimeve penale.

2.2 GJETJET KRYESORE SIPAS FUSHAVE TË AUDITIMIT

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në cilësinë e institucionit më të lartë të kontrollit ekonomik e financiar në vend, kryen veprimtarinë e auditimit, i cili përfshin auditimin e përputhshmërisë, auditimin financiar, auditimin e performancës, auditimin e IT- së, si dhe auditimin e kombinuar të tyre, me qëllim përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut, nëpërmjet publikimit të raporteve të auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në veprimtarinë audituese është orientuar drejt rritjes më tej të cilësisë së auditimeve, duke iu përgjigjur në mënyrë të vazhdueshme zhvillimeve të fushës, si dhe rregulloreve të auditimit sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI-ve), duke përditësuar metodologjitë, si dhe duke përmirësuar strukturën dhe përmbajtjen e tyre, për të qenë sa më efikas dhe në koherencë me zhvillimet ekonomike dhe sociale të vendit, në funksion të mirëqeverisjes dhe rritjes së nivelit të mirëqenies së qytetarëve.

Auditimi si pjesë jetike e një sistemi rregullator, ka për qëllim rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, si dhe parandalimin e shkeljeve në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve publike, por edhe të të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë

financiar, për të bërë të mundur : rikuperimin e dëmeve të shkaktuara dhe ndërmarrjen e veprimeve korigjuese sipas rastit.

Në mënyrë të përmbledhur, disa nga parregullsitë dhe mangësitë e evidentuara sipas llojit të auditimit të kryer janë:

A. Në auditimet e përputhshmërisë:

A.1 Në auditimet e kryera në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe institucionet qendrore kanë rezultuar mangësi në drejtimit e mëposhtme:

Në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e administrimit të pasurisë shtetërore, të prokurimeve me fondet publike, të zbatimit të projekteve të financuara nga buxheti, të shpërblimit të punës dhe pagave të punonjësve, zbatimin e kontratave të mallrave dhe mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, kontrollit të brendshëm financiar publik etj.

Në fushën e shpenzimeve buxhetore, kryesisht për shkak të pasaktësisë, dublimit të zërave të punimeve apo diferencave në volumet e punimeve të ndërtimit të situacionuara, por të pa kryera dhe të kaluara për pagesë; nuk janë aplikuar penaltetet për shkelje dhe mosrespektim të grafikut të lëvrimit/punimeve/furnizimit; të amendimit të kontratave të hartuara e miratuara në kundërshtim me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të prokurimit, duke tjetërsuar llojin dhe tipin e kontratës; moszbatimi i kërkesave të administrimit të aktiveve; parregullsi në dokumentimin dhe kryerjen e pagesave për punë, shpërblime jashtë kohës normale; dobësi në argumentimin e shumave të paguara nga projektet me financim të brendshëm e të huaj etj.

Në disa subjekte, regjistrat e parashikimit të prokurimeve me fondet publike nuk janë përgatitur sipas afatit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore, kurse regjistrat e realizimit nuk përmbajnë të dhënat për të gjithë procedurat e realizuara gjatë vitit; nga strukturat përgjegjëse nuk është realizuar arkivimi i dosjeve të prokurimit në sistem, të cilat nuk janë pasqyruar as në regjistrat e prokurimeve si të realizuara; në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk është argumentuar për çdo rast vendosja e çdo kriteri për kualifikim (teknikisht dhe ligjërisht) dhe operatorët ekonomik fitues në dosjet e vlerësuara nuk kanë paraqitur dokumente, që të vërtetojnë se plotësojnë kriteret e përcaktuara në DST.

Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhënave për totalin e detyrimit të mbetur/faktik dhe kontigjent për vendimet e Tribunalit të Arbitrazhit dhe GJEDNJ-së, shumat e raportuara nga MFE të vlerave të detyrimeve faktike dhe kontigjente, nuk përputhen me të dhënat e raportuara nga Avokatura e Shtetit, pasi nuk janë përfshirë penaltetet dhe kamatëvonesat të parashikuara në dispozitivin e këtyre vendimeve.

Në fushën e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të financave publike: në subjektet e audituara mungojnë programet specifike për trajnimin e punonjësve të administratës; ka institucionet që nuk kanë hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut, si dhe nuk është përgatitur dhe dërguar tek Nëpunësi Autorizues (NA) nga drejtoritë përkatëse. Në disa institucione qendrore e të pavarura nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), si dhe Strukturat e Auditimit të Brendshëm nuk janë eficiente pasi nuk kanë funksionuar me kapacitet të plotë. Po ashtu, Komitetet e Auditimit të Brendshëm ose nuk janë ngritur, ose nuk e kanë përmbushur rolin e tyre. Nuk janë përgatitur dhe dërguar nga të gjitha njësitë shpenzuese në MFE dokumente të tilla si Pyetësorët e Vetëvlerësimit, Deklaratat dhe Raportet për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Plan Veprimi për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK). Gjithashtu, detyrimi për hartimin e regjistratit të riskut për gjithë hallkat dhe drejtoritë e subjekteve publike të audituara nuk janë përmbushur sipas legjislacionit; mungojnë gjurmët e miratuara të auditimit dhe hartat e proceseve të punës në mjaftë institucione e njësi shpenzuese, në kundërshtim me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Në misionet e auditimit për vitin 2023, KLSH ka vlerësuar se niveli i riskut nga mungesa e kuadrit rregullativ dhe/ose e harmonizimit të legjislacionit është i lartë, për të cilat janë adresuar propozimet për përmirësime apo ndryshime ligjore në institucionet përgjegjëse, Kuvendin, Qeverinë, ministrinë etj. Gjatë vitit 2023 janë propozuar 42 masa për përmirësim të legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi dhe si rrjedhojë dhe sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike.

Këto përmirësime janë adresuar në fusha të tilla si:

Domosdoshmëria e hartimit të ligjit për kontabilitetin e institucioneve buxhetore të qeverisjes së përgjithshme të sektorit publik, si dhe e përmirësimit të akteve nënligjore në fushën e menaxhimit të sistemit buxhetor.

Propozimet për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimeve publike, koncesioneve, ankandit etj., ku ka rezultuar një mungesë koherence dhe harmonizimi të kuadrit ligjor dhe atij nënligjor në fuqi.

Në fushën e institucioneve rezidenciale për të moshuarit, KLSH ka kërkuar që MSHMS dhe MFE, në bashkëpunim me SHSSH, të marrin masa të menjëhershme për miratimin e ndryshimeve të nivelit të kuotës ushqimore, mbi përcaktimin e kriterëve për përfituesit e shpenzimeve personale të shërbimeve dhe pagesat e tarifave shërbimeve që ofrohen nga kontributet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Në auditimin mbi procedurat e Shërbimit të Jashtëm të RSH-së: nuk janë iniciuar amendime në Ligjin nr.23/2015 "Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë" dhe aktet e dala në zbatim të tij, si dhe është konstatuar mungesë e harmonizimit dhe plotësimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi shërbimin e jashtëm.

Në lidhje me fushën e përgjegjësisë shtetërore dhe të kompetencave të MSHMS-së, ka elementë të mbivendosjes së tyre me ato të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, institucion i krijuar nga Ligji "Për bashkëqeverisjen" etj.

Sa i takon auditimit të institucioneve arsimore, është konstatuar se, në Universitetin e Mjekësisë Tiranë ka munguar një metodologji për caktimin e tarifave universitare; nuk janë implementuar siç duhet kërkesat e ligjit për menaxhimin e financiar dhe kontrollin.

A.2 Nga auditimet e kryera në Ministrinë e Financave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe drejtori rajonale tatimore e në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave e degët doganore për çështjen e të ardhurave, si dhe në fondet speciale (Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor e drejtori rajonale të tyre), ka rezultuar:

Në procesin e planifikimit buxhetor nuk respektohen afatet në përgatitjen dhe nxjerrjen e akteve nënligjore lidhur me kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, me tavanet përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) për fazën strategjike, si dhe me tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA; për dokumentin e rishikuar të PBA-së; gjatë hartimit të PBA-së nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë paraqitur kërkesa buxhetore në tejkallim të tavanit të miratuar me VKM dhe jashtë afateve të përcaktuara në udhëzimin përkatës; ka rishikime të prioritetëve buxhetore gjatë vitit; evidentohen ndryshime në buxhetin e planifikuar të ministrive në krahasim me PBA, ku në vitin 2022 janë konstatuar 29 raste ku projektet e investimit 2-3 vjeçare të miratuara për PBA-në 2021-2023, nuk reflektohen në PBA 2022-2024, ose reflektohen me vlera konsiderueshëm më të ulëta me qëllim ruajtjen e tavanëve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja, si dhe 16 raste ku projektet e investimit miratohen fillimisht në PBA 2021-2023 si projekte të reja me vlerë të ulët, duke ruajtur tavanet e miratuara dhe më pas rriten në PBA 2022-2024 me vlerë të konsiderueshme.

Paketa fiskale 2022 është miratuar në nëntor 2021 në kundërshtim me Ligjin organik të buxhetit i cili përcakton afatin jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal.

Buxheti është ndryshuar me Akte Normative para muajit korrik, në mungesë të dokumentacionit bazë dhe atij shoqëruar, i cili kërkohet nga Ligji organik i buxhetit si në rastin e projektbuxhetit vjetor, si dhe pa respektuar afatet përkatëse.

Gjatë zbatimit, raportimit dhe monitorimit të buxhetit: janë konstatuar problematika sa i takon kryerje së shpenzimeve korrente sipas kodeve të produkteve buxhetore, ndryshime midis objektivave të produkteve të buxhetit dhe alokimit/ekzekutimit të tyre sipas pagesave të kryera;

Investimet me burim të brendshëm financimi, e kanë realizimin e përqendruar kryesisht në muajt nëntor dhe dhjetor, duke ndikuar krahas të tjerave dhe në performancën e tyre, si dhe në një vlerë të konsiderueshme (rreth 7 %) përfaqësojnë pagesa të detyrimeve të prapambetura; në vitin 2022 janë raportuar si investim i realizuar nga Autoritetit Rrugor Shqiptar me përshkrim “Vendime gjyqësore në proces” me vlerë 180 milion lekë, për të cilin duhet të ishin përdorur llogaritë e shpenzimeve operative, si dhe në këtë shumë vlera prej 32,085 mijë lekë, përfaqëson detyrime të prapambetura të periudhave të mëparshme duke filluar nga viti 2016; janë konstatuar problematika që detajimin e projekteve të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA 2022-2024, detajimin e fondeve të investimeve për vetëm vlerën e 20% të kostos së projektit pa buxhet në vitet pasardhëse buxhetore, detajimin e planit buxhetor në 3 vite për investime që përfshijnë periudhë faturimi për kontrata që parashikojnë faturim më të vogël se një vit, shkurtimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin e këtyre fondeve drejt projekteve të tjera të investimit publik me detyrime të prapambetura apo në proces nga vitet e kaluara; mos regjistrimin e kontratave dhe rrjedhimisht mos regjistrimin e obligimit në SIFQ duke lejuar ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Konstatohen projekte investimi me përshkrimin “Fond i ngrirë”, detajim i fondeve pa projekt specifik në çeljen fillestare.

Vitet e fundit ka prirje të ulet vlera e investimeve kapitale të kryera me burim të huaj financimi duke nxjerrë në pah mungesën e një roli aktiv të Ministrisë së Financave dhe të institucioneve publike përfituese të këtyre financimeve, si dhe mungesën e një analize më të thellë për zbatimin e projekteve, për të përcaktuar se ku dhe nëse mund të bëhen përmirësime, veçanërisht në lidhje me zbatimin e monitorimin e tyre.

Për vitin 2022, kanë rezultuar 8 nga 11 ministri me diferenca midis të dhënave të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisjes (SIFQ) dhe të dhënave të paraqitura në raportet e monitorimit, si dhe për këto të fundit mungon analiza dhe vlerësimi i performancës për zbatimin e buxhetit bazuar në rishpërndarjet e tij, me qëllim evidentimin e impaktit të mundshëm në performancën e objektivave lidhur me to; në vitin 2022 janë realizuar 45 projekte (grant) në vlerën 519,754 mijë pa plan buxhetor apo në tejkalim të planit buxhetor, tregues i një planifikimi të dobët, i cili mund të sjellë si pasojë ndryshimin e prioriteteve qeverisëse, si dhe kalim të tavanit përkatës buxhetor.

Referuar vendimeve të Këshillit të Ministrave të dala deri në fund të vitit 2022 për rindërtimin, rezulton se fondet e shpërndara janë mbi vlerën e përcaktuara në ligjin e buxhetit për këtë fond, është përcaktuar si burim financimi edhe ngurtësimi i fondeve nga projekte të tjera të rindërtimit, të cilat paraqiten me ecuri të ngadaltë; kosto totale e projekteve nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së planifikuar më ligjin e buxhetin për fondet e rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore, duke qenë se plani vijon të paraqitet në shumën 0 lekë, duke sjellë mungesë bashkërendimi të kostove totale të projekteve me planifikimin e vlerave përkatëse në ligjin e buxhetin për vitet pasardhëse buxhetore.

Me efekt për buxhetin e vitit 2022 konstatohen 2956 rishikime, të cilat kanë sjellë ndryshime për 25508 transaksione, të cilat konstatohen kryesisht në muajin dhjetor me 6731 raste ose rreth 26.4% të rasteve në total; regjistrimi i rialokimeve të fondeve buxhetore me data kontabile efektive më të hershme (retrospektive).

Janë konstatuar 102 raste të urdhër prokurimeve të regjistruara në sistem në vitin buxhetor 2022 të cilat lidhen me një kontratë të nënshkruar në vitet e mëparshme buxhetore (2011-2021); 52 raste në të cilat urdhër prokurimet rezultojnë të jenë regjistruar deri në 10 ditë diferencë nga data e kontratës; nuk është respektuar afati 3-ditor për regjistrimin e kontratave nga data e nënshkrimit të tyre në 10602 raste; mosregjistrim në SIFQ i planit të pagesave të kontratës e kushtëzuar nga mos detajimi i planit buxhetor për projekte të investimeve sipas parashikimeve të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit; janë

konstatuar 27311 fatura në total të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor nga data e furnitorit; janë të paktën 20 raste në rreth 2,700 milionë lekë të regjistrimit dhe pagesave pjesore më të vogla të faturave, të lidhura me përputhjen e fondeve buxhetore disponibël, me efektin e detyrimeve të prapambetura në kushtëzimin e procesimit të transaksioneve të pjesshme në sistem; konstatohen gjithsej 9349 transaksione pagesash në vitin 2022 në shumën totale 16,8 miliardë lekë të cilat i përkasin faturave me datë të viteve buxhetore të mëparshme; u konstatuan ekzekutime të pagesave të faturave të regjistruara në data të mëvonshme, përpara urdhër shpenzimeve të regjistruara në data më të hershme.

Vlera e detyrimit të mbetur për ish të përndjekurit politik deri në fund të viti 2022 është 29,882,175 mijë lekë dhe nëse buxheti dhe çelja e fondit për ish të përndjekurit do të vazhdojë me këtë ritëm apo më të ulët, ky detyrim do të mund të shlyhet mesatarisht pas rreth 30 vitesh;

Shpenzimet për fondet speciale (sigurime shoqërore dhe kujdes shëndetësor) përbëjnë mesatarisht 33 % të shpenzimeve publike gjithsej; rritja e shpenzimeve për sigurime shoqërore shoqërohet me rritjen e financimit nga buxheti i shtetit, pra qëndrueshmëria sociale dhe financiare e sistemit të pensioneve mbetet e pambrojtur, pasi vijon të vuajë nga një deficit i lartë që e bën atë financiarisht të kushtueshme për buxhetin e shtetit. Për më tepër që, vlerësimet për projeksionet e popullsisë për të ardhmen tregojnë se numri i njerëzve në moshë madhore do të rritet gjithnjë e më shumë krahasuar me një rënie më të madhe të numrit të atyre në moshë të re, çka do të thotë më pak burime financiare nga kontributet në skemë, dhe nga ana tjetër më shumë përfitues të pensionit, pa marrë në konsideratë nevojën dhe domosdoshmërinë e rritjes së përfitimeve aktuale nga skema e sigurimeve shoqërore në vendin tonë; Nga auditimi në FSDKSH për vitin 2022 është konstatuar rritje e shpenzimeve për koncesionin e sterilizimit për shkak edhe të ndryshimit të strukturës së setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë me rritje 17 % të kompleksitetit të lartë, 3% i mesëm dhe 16% kompleksiteti i ulët; rritje të shpenzimeve për koncesionin e dializës, përfshirë faturime për shërbime të pakryera për 8854 raste në shumën 99 milionë lekë pa TVSH; janë kryer pagesa për shërbim të pakryer për Koncesionin e Kontrollit Mjekësor Bazë (Check-up) për 20172 raste, me një kosto në shumën 31,004 mijë lekë pa TVSH; në zbatimin e Kontratës Koncesionare “Për ofrimin e hemodializës” janë kryer pagesat për 8854 raste, nga të cilat 6918 raste nën projeksion dhe 1936 raste mbi projeksion, në shumën 99,191 mijë lekë, që përfaqëson pagesë për shërbim të pa kryer; mungesa e barnave alternativë e parë dhe vetme në vitin 2022 ka sjellë për pasojë ulje të numrit të recetave, duke ndikuar tek një numër i konsiderueshëm pacientësh; kufizimet buxhetore për financimin e shërbimit të analizave laboratorike të lidhura me tavanin buxhetor, të sanksionuar në kontratën koncesionare të laboratorëve, kanë rrezikuar ofrimin e analizave laboratorike, në masën e duhur, sipas nevojave spitalore dhe duke sjellë për pasojë drejtimin e pacientëve në marrjen e këtij shërbimi tek subjektet private, me kosto për qytetarët, si dhe përkeqësim të shëndetit nga moskryerja në kohë e analizave përkatëse.

Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave tatimore, konstatohet se raportohen si të ardhura të realizuara për efekt të planit, gjoha të sistemit tatimor, të ardhurat nga gjohat e vendosura nga kontrollat e realizuara në tatimpagues; në raportimin e të ardhurave nga kontributet shoqërore dhe shëndetësore konstatohet se janë përfshirë edhe depozitimet e përkohshme dhe kamatëvonesat e gjohat për listë-pagesat të cila nuk lidhen vetëm me kontributet, por edhe me tatimin mbi të ardhurat personale; ka prirje të rritjes së detyrimeve tatimore nga viti në vit, si dhe vështirësi në vjeljen e këtyre detyrimeve për shkak se në vitin 2022 vetëm 37 % e subjekteve debitorë janë me status aktiv, detyrimet mbi 5 vite zënë 49 % të detyrimit tatimor të papaguar, si dhe Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DPT nuk ka kryer asnjë inspektim në asnjë drejtori rajonale tatimore; administrata doganore ka dështuar në rikuperimin e stokut të borxhit të krijuar gjatë viteve pasi ai rezulton gjithnjë në rritje.

Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave në vitin 2022 ka tejkaluar kufirin e përcaktuar në ligjin organik të buxhetit; konstatohen mangësi në plotësimin e dokumentacionit në vendimet për përdorimin e këtij fondi; evidentohet përdorim i fondit rezervë si “shtesë buxheti”, kur në fakt këto shpenzime duhet të

parashikoheshin në përputhje me procedurat dhe kriteret ligjore të planifikimit të buxhetit, dhe të miratoheshin me ligjin vjetor të tij, apo dhe të cilësoheshin si “emergjencë”, duke sjellë për pasojë devijim nga parimi i përgjithshëm i qëllimit të këtyre fondeve për amortizimin e ngjarjeve të papritura si fatkeqësi natyrore etj., si dhe denatyrimit të përdorimit të fondit rezervë. Për vitin 2022, Fondi Rezervë në 5 raste, në vlerën 1,491 milionë lekë, është përdorur në kundërshtim me Ligjin Organik të Buxhetit dhe Udhëzimin për zbatimin e tij.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk janë hartuar dhe paraqitur në Kuvend pasqyrat financiare të konsoliduara të shtetit, si dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik vijon të rregullohet me një akt nënligjor (Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar) i paplotë dhe me probleme nga pikëpamja konceptuale.

KLSH ka konsideruar risqe fiskale që cenojnë qëndrueshmërinë e financave publike, risqet nga koncesione/PPP me mbështetje buxhetore, risqet nga dobësitë e ndërmarrjeve të sektorit energjetik, ndërmarrjet e sektorit ujësjellës kanalizime, detyrimet e prapambetura të qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, detyrimet të tjera kontigjente si: detyrimet nga vendimet e GJEDNJ-së dhe nga vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar.

Rritja e shpenzimeve për kontratat koncesionare/PPP nga viti në vit përbën një risk fiskal për buxhetin, për më tepër që në mungesë të treguesve të matshëm të performancës së tyre bën të diskutueshme dhe arritjen në kohë të objektivave të tyre me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet.

Detyrimet e ndërsjella në sektorin e energjisë elektrike kanë prirje të rriten nga viti në vit, duke u ekspozuar gjithnjë e më shumë ndaj kërkesës për financime buxhetore. E njëjta situatë vërehet dhe në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, duke sjellë për pasojë dështimin e bashkëpunimit të MFE-së dhe MIE-së në zbatimin e dy urdhrave të përbashkët të viteve 2020 dhe 2021 “Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”. Po ashtu, nuk kanë qenë rezultative as intensifikimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimi me institucionet dhe aktorët kryesorë të fushës: ndërmarrjet Ujësjellës –Kanalizimeve me MIE, si dhe me ndërmarrjet e sektorit të energjisë.

Akumulimi i detyrimeve të prapambetura të njërive të qeverisjes qendrore dhe vendore përbën një problematikë për sistemin buxhetor, për më tepër që në detyrimet e prapambetura nuk përlllogariten dhe nuk përfshihen si vlerë në raportet dhe statistikën e borxhit publik, duke e nënvlerësuar këtë të fundit.

Veprimet dhe mosveprimet e MFE-së për mos-ekzekutimet e vendimeve të GJEDNJ-së krijojnë risk të lartë për efekte shtesë në dëm të buxhetit të shtetit, si rrjedhojë e kamatë vonesave të kërkueshme për moszbatim në afat të vendimeve. Detyrimet e prapambetura dhe detyrimet nga vendimet e GJEDNJ-së/Arbitrazhit vijnë të jenë të larta dhe përbëjnë një risk të shtuar për treguesit buxhetor. Nga auditimi konstatohet se mungon një analizë mbi shkaqet, nivelin dhe shtimit të tyre. Kjo analizë do të mundësonte nxjerrjen e konkluzioneve të sakta dhe dhënien e rekomandimeve sa më të përshtatshme dhe në nevojë të situatës së krijuar. Si rrjedhojë detyrimet e prapambetura paraqesin një risk fiskal, jo vetëm për treguesit buxhetor të institucioneve përgjegjëse, por edhe në nivel makroekonomik për financat publike, pasi pavarësisht se këto detyrime nuk llogariten dhe nuk regjistrohen në treguesit e borxhit publik, e implikojnë dhe e nënvlerësojnë këtë të fundit, pasi janë detyrime që do të shlyhen në të ardhmen.

Deficiti buxhetor në vitin 2022 ka rezultuar i realizuar në masën 93.3%, me tendencë ulje krahasuar me një vit më parë, por që indirekt ka ndikuar dhe në mosrealizimin e shpenzimeve buxhetore gjithsej (të cilat janë realizuar 97.58%), kryesisht atyre kapitale (të cilat janë realizuar 93.39%).

Borxhi publik për vitin 2022 sipas MFE-së ka rezultuar 64.6%, tregues i cili është në rënie në krahasim me një vit më parë për shkak të dy faktorëve: nga rritja e PBB-së (278,292 milion lekë më shumë në 2022), si dhe nga rënia e nivelit të stokut të borxhit në vlera nominale (4,317 milionë lekë më pak në 2022).

KLSH ka konstatuar krijim të detyrimeve të reja në shumën 3,404 milionë lekë të subjekteve nën-huamarrëse në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë përgjatë vitit 2022, si pasojë e mos-shlyerjes së detyrimeve përkatëse.

Gjendja e detyrimeve në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit është me një rritje vjetore prej 2,239 milionë lekë, duke shfaqur një risk të shtuar në drejtim të administrimit të tyre.

Në Raportin e paraqitur në Kuvend “Mbi Zbatimin të Buxhetit të Vitit 2022”, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar Qeverisë, midis të tjerave, orientimin drejt konsolidimit fiskal, të mbështetur në reformën për rritjen e të ardhurave dhe minimizimin e shpenzimeve jo efektive, si dhe vijimin e reduktimit të borxhit publik, si çështje thelbësore për zbutjen e efekteve të risqeve, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike.

A.3 Në auditimet e kryera në shoqëritë publike kanë rezultuar problematika si:

Mos-arkëtim i të ardhurave si në rastin e Albpetrol sh.a., ku nuk ka marrë masat e nevojshme e të mjaftueshme për vjeljen e detyrimeve të koncesionarëve ndaj saj, përfshirë këtu detyrimet për konsumin e energjisë elektrike të cilat vijojnë të paguhen nga Albpetrol sh.a. në bazë të marrëveshjeve që ky i fundit ka lidhur me FSHU, me pasoja në vlerësimin real të gjendjes së llogarisë së pagueshme tregtare të furnitorëve.

Në shoqëritë e audituara, vijon të konstatohen raste të pagesave të konsiderueshme për shkak të humbjeve të proceseve gjyqësore si rrjedhojë e largimeve të padrejta nga puna, konkretisht në të paktën 5 subjekte: Albpetrol sh.a., OSHEE sh.a., KESH sh.a., Posta Shqiptare sh.a., UKT sh.a. etj.

Pavarësisht rekomandimeve të herëpashershme të dhëna nga KLSH, shoqëritë publike vijojnë me dhënien e shpërblimeve në kundërshtim me kuadrin ligjor e rregullator, konkretisht pa miratimin e tyre në organet eprore dhe/ose në kushtet kur vetë shoqëria ka qenë me rezultat financiar negativ.

Shoqëritë publike kanë shfaqur mangësi edhe në drejtim të realizimit të procedurave të prokurimit në të gjitha fazat, si në përlllogaritjen e fondit limit, kriteret e vlerësimit, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, si dhe nuk kanë munguar as ato në drejtim të zbatimit të kontratave.

Gjithashtu, në Posta Shqiptare sh.a. ka investime që nuk janë vënë në përdorim duke sjellë për pasojë mungesë efektiviteti, efience dhe ekonomikiteti në përdorimin e fondeve publike.

Në shoqëritë e sektorit energjetik kanë rezultuar mangësi edhe në drejtim të shit-bërjes së energjisë duke bërë që të krijohen efekte financiare negative për shoqëritë prej mosrespektimit të marrëveshjeve përkatëse.

A.4 Në lidhje me projektet me financime të huaja, konkretisht në Projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate, në Autoritetin Rrugor Shqiptar”, kanë rezultuar mos përmbushje e objektivave të projektit; vonesa në tërheqjen e fondeve të kredisë me pasojë rritjen e komisioneve të angazhimit mbi vlerat e parashikuara në projekt, pra rritje të kostos së projektit; largime të padrejta të stafit të projektit me pasojë likuidimin e detyrimeve për paga pas shqyrtimit të praktikave në gjykata etj.

A.5 Në auditimet e kryera në fushën e mjedisit kanë rezultuar mangësi në zbatimin me korrektësi të procedurave për ruajtjen e mjedisit si: në lidhje me kryerjen e procedurave për pajisjen e subjekteve me leje mjedisore dhe të vlerësimit me ndikim në mjedis; mos realizimit të dëgjësive me publikun; mos kryerja e inspektimeve, monitorimeve, kontrolleve mbi ndërtimet pa leje në zonat e mbrojtura, si dhe në menaxhimin e fondeve në dispozicion etj.

Në këto subjekte, janë kryer auditime në drejtim të zbatimit të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për menaxhimin ruajtjen e zonave të mbrojtura mjedisore, menaxhimin e kujdesshëm të burimeve të tokës, përfshirë ajrin, ujin, florën dhe faunën, si dhe në integrimin e politikave të mbrojtjes së mjedisit në ato të zhvillimit ekonomik, ndërgjegjësimin e popullatës, ndalimin e gjuetisë së paligjshme, monitorimin e kontrollin etj.

A.6 Në auditimet e kryera në fushën e administrimit dhe regjistrimit të pronës, në DVASHK Sarandë, Kamëz-Vorë, Tirana Jug, Tirana Veri dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave në mënyrë të përmbledhur janë konstatuar problematikat si vijon:

Janë regjistruar toka bujqësore me AMTP, ku rezulton se poseduesit e këtyre akteve, kanë përfituar sipërfaqe më tepër sesa përcakton titulli i pronësisë.

Janë miratuar vendime për legalizimin e objekteve që janë ndërtuar jashtë afatit ligjor, në tejkallim të 3-fishit të parcelës ndërtimore, si dhe në cenim të infrastrukturës publike si kanale, rrugë etj.

Nga Sektori i Kompensimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronave rezulton se vetëm 4,5 % të vendimeve janë ekzekutuar. Po ashtu, është konstatuar se janë marrë vendime nga ATP-ja për kompensimin fizik me fondin e tokës duke mos zbatuar kriterin e përzgjedhjes së pronës gjeografikisht më pranë pronës të njohur për kompensim fizik, por është kompensuar në një qark tjetër më larg se prona e njohur për kompensim.

B. Në auditimet financiare dhe të përputhshmërisë të njërive të vetëqeverisjes vendore:

Janë konstatuar mangësi në *planifikimin dhe zbatimin e buxhetit*, pasi angazhimet buxhetore nuk mbështeten në planifikime realiste të të ardhurave të veta, me pasojë korrigjimin gjatë vitit; nuk kryhen analiza të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor, me qëllim nevojën për rishikime, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi; nuk analizohen rastet e vendimeve gjyqësore që zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes; ka raste ku janë lidhur kontrata pa pasur në dispozicion minimalisht 20% të vlerës së kontratës në vitin e parë të financimit; nuk likuidohen në kohë të gjitha detyrimet ndaj të tretëve, duke mos paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 60 ditor nga momenti i prerjes së faturës; nuk ka planifikim të likuidimit të detyrimeve të prapambetura; nga auditimi në 49 bashki ka rezultuar se vlera e stokut progresiv të detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022 është në vlerën 4,533,281 mijë lekë, ose 11% e totalit të shpenzimeve të planifikuara vjetore, si dhe ka mangësi në raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta etj.

Në administrimin e asetëve, kanë rezultuar mangësi nga strukturat përkatëse, pasi megjithëse planifikohet të mblidhen të ardhura të cilat janë parashikuar në paketën fiskale dhe buxhetin vjetor, si të ardhura të tjera që vijnë nga qiraja e asetëve të njërive vendore, apo gjoha të aplikuara nga inspektorati i mbrojtjes së territorit, por nuk ezaurojnë të gjitha masat përkatëse shtrënguese për vjeljen e këtyre detyrimeve, me gjithë insistimin nga KLSH nëpërmjet rekomandimeve për zbatimin e dispozitave ligjore në këtë drejtim.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore vijojnë të kenë mangësi në *administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor për regjistrimin e pronave*, si dhe *evidentohet moszbatimi i kriterëve ligjore në procedurat e legalizimit të tyre*.

Sa i takon *Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*, rezultojnë raste ku nuk janë pasqyruar saktë volumet sipas projekteve të ndërtimit, me qëllim përcaktimin e saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe respektimin e kriterëve sipas pasaportës së njërive strukturore; nuk janë respektuar distancat ndërmjet pronave kufitare, pronave nga kufiri i rrugës, si dhe lartësitë e objekteve; nuk janë shqyrtuar të dhënat teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit/infrastrukturore, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit; nuk janë mbajtur akt kontrole me subjektin zhvillues; mbikëqyrësin e punimeve dhe firmën zbatuese të punimeve të ndërtimit në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Në fushën e prokurimit publik kanë rezultuar mangësi në fazën e prokurimit, si: mungesë argumenti në kryerjen e investimit, zhvillim procedure në mungesë të fondeve në dispozicion; mangësi në formimin profesional të zyrtarëve të përfshirë në procedurat e prokurimit publik; mungesë argumentimi në vendosjen e kriterëve për kualifikim; mangësi në vlerësimin e ofertave etj.

Nga auditimi i kontratave të punimeve civile dhe furnizimit të mallrave, në 39 subjekte të audituara ka rezultuar mos zbatim i rregullave në fushën e ndërtimit, kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të punimeve të ndërtimit, devijime nga volumet e situacionuara, shmangie të penaliteteve etj., me pasoja të dëm ekonomik.

Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm, pasi: në 7 njësi vendore specialistët nuk janë të gjithë të kualifikuar/certifikuar/trajnuar; në 9 njësi vendore në dosjet e auditimit ka mungesa të dokumenteve që vërtetojnë kryerjen e të gjitha fazave të auditimit; në 14 bashki njësitë e Auditit të Brendshëm nuk kanë numrin e duhur të punonjësve; në 9 subjekte nuk është realizuar plotësisht plani vjetor i auditimeve; nuk janë kryer auditime me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm etj.

C. Në auditimet financiare:

C.1 Në njësitë e qeverisjes qendrore:

KLSH ka konstatuar mangësi në hartimin e kuadrit ligjor e rregullator në fuqi në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar në sektorin publik; parregullsi në zbatimin e procedurave dhe afateve të përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, dobësi e neglizhenca në arkëtimin e debitorëve dhe të drejtave për arkëtim, si dhe shlyerjen në afat të detyrimeve të prapambetura, mungesë funksionimi e harmonizimi të komponentëve të kontrollit të brendshëm etj. Më konkretisht, strukturat përgjegjëse në MFE nuk kanë hartuar Pasqyrat Financiare Përmbledhëse Vjetore për vitin 2021 dhe 2022. Edhe pasqyrat financiare individuale vjetore të kësaj ministrie dhe ministrive e institucioneve të tjera qendrore kanë ekspozuar parregullsi, mangësi e mospërputhje, ndaj nuk është e mundur që të ofrohet siguri e plotë mbi saktësinë dhe cilësinë e informacionit të përmbledhur në nivel grupi (ministrie). Evidentohet një nivel i lartë i detyrimeve të subjekteve debitorë dhe klientëve dhe rezulton një trend në rritje për to për periudhën e audituar. Nuk janë kryer procedurat për kontabilizimin e plotë, të saktë, të rregullt dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, në përputhje me udhëzimet e MFE duke mos koordinuar sistemet e kontrollit mbi kontabilizimin e detyrimeve. Është evidentuar mangësi e parregullsi në lidhje me monitorimin e detyrimeve të kontratave të qirasë së tokave bujqësore nën administrim të MBZHR-së, si dhe nuk janë kryer regjistrimet në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare për periudhën 2021-2022, të tokave bujqësore që kjo ministri administron, duke cenuar transparencën dhe pasqyrimin e plotë të të dhënave pasurore shtetërore në administrim të institucioneve të bujqësisë.

Nuk janë realizuar deri në datën e kryerjes së auditimit, ndryshimet e nevojshme ligjore për të mundësuar heqjen e pengesave për fillimin e zbatimit të metodologjisë së re kontabël dhe përgatitjen e pasqyrave financiare bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik. Në një numër rastesh, nuk sigurohet krahasueshmëria e të dhënave të Pasqyrave Financiare të Konsoliduara dhe raporteve financiare të përgatitura nga ana e organeve shtetërore për ushtrimin e mëparshëm dhe bilancin e çeljes për vitin ushtrimor; gjë që tregon për moskryerjen e kontrolleve sistematike të informacioneve që dërgojnë institucionet shtetërore në ministrinë e linjës, në shkelje të parimeve dhe normave kontabël. Nuk ka gjetur zbatim regjistrimi i inventarit të plotë të aktiveve publike dhe procesi i migrimit të të dhënave nga institucionet buxhetore me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ. Në Ministrinë përgjegjëse për pronat shtetërore mungon regjistri i konsoliduar i aktiveve dhe pasurive shtetërore në nivel qendror dhe për gjithë institucionet e qeverisjes së përgjithshme, si dhe ky dokument nuk mund të gjenerohet nga SIFQ. Nuk është zbatuar vlerësimi dhe inventarizimi i aseteve në të gjithë njësitë e qeverisjes qendrore sipas metodologjisë së aprovuar.

Dobësi janë evidentuar në kryerjen e procesit të inventarizimit vjetor të aseteve dhe mungesa e vlerësimit të pasurive të institucioneve buxhetore e ekstra-buxhetore me qëllim pasqyrimin në kontabilitet të aktiveve, me vlerën e tyre të drejtë. Në disa njësi shpenzuese, llogaritja e amortizimit për kategorinë e aktiveve aplikohet në kundërshtim me udhëzimet e Ministrisë së Financave.

Llogaritë kryesore inventariale të pasurisë, (sintetike dhe analitike), rezultojnë me pasaktësi për shumë institucione buxhetore e njësi shpenzuese të testuara, pasi mungojnë analizat e tyre. Praktika të njëjta të mos regjistrimit në kontabilitet të vlerës së “Ndërtesave” dhe mos evidentimit të gjendjeve të llogarisë “Toka, troje e terrene” konstatohen gjerësisht, si në auditimet e institucioneve në nivelin qendror, duke vazhduar edhe me ato në nivel vendor, në kundërshtim me UMFE nr.8, datë 09.03.2018“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”; i ndryshuar.

C.2 Në auditimet financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore:

Nga auditimet e kryera në 49 njësi të vetëqeverisjes vendore ka rezultuar se në vështirësi financiare janë 7 bashki: Dimal, Rrogozhinë, Peqin, Belsh, Vorë, Dibër dhe Kavajë, në të cilat raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj planit të shpenzimeve të miratuara është respektivisht nga 27% në 62 %. Gjithashtu, janë dhe 6 bashki të tjera: Poliçan, Tropojë, Pogradec, Libohovë, Delvinë dhe Cërrik, në të cilat ky tregues është nga 17% në 25%, duke sjellë për pasojë që të shfaqin probleme financiare dhe që rrezikojnë të rrëshqasin drejt atyre me vështirësi financiare.

Janë konstatuar problematika si në vijim: pasqyrimi i ngjarjeve ekonomike në kontabilitet nuk kryhet në mënyrë të drejtë, pasi ka llogari të pa justifikuar nga ana dokumentare ose raste ku nuk janë përfshirë në inventarizim llogari të ndryshme; ka mangësi në rakordimet me Thesarin; mungesa e një regjistri kontabël; mangësi kontabilizimi gjatë vitit me mungesë rakordimi në pasqyrat financiare; aktive të paregjistruara në ASHK, raste të keq- llogaritjes së amortizimit; fatura që nuk paraqiten me vlerën reale; mungesa e dokumenteve të pronësisë për objektet e trashëguara nga njësitë vendore; mungesa të inventarit fizik dhe të regjistrimit të aktiveve etj.

Gjithashtu, rezultojnë se, nuk është bërë pasqyrimi në inventar dhe kontabilitet i pronave të kaluara me VKM në Njësitë Administrative; nuk janë marrë masa për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe ligjor të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP-së (ASHK), si dhe nuk ka rakordim midis tyre, përfshirë këtu dhe të dhënat për objektet e privatizuara; mungon evidenca e pronarëve që nuk kanë shlyer detyrimet për trojet etj.

Sa i takon vlerësimin të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në njësitë e vetëqeverisjes vendore është konstatuar se, aspekte të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm përgjithësisht funksionojnë me mangësi pasi:

Për “Mjedisin e Kontrollit” ka:

- (i) mungesa të procedurave të sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive;
- (ii) mungesa e programeve të trajnimit për integritetin dhe sjelljen;
- (iii) mungesa e raporteve periodike të monitorimit të planit të veprimit të kontrollit të brendshëm etj.;

Për “Menaxhimin e Riskut” ka:

- (i) mangësi në hartimin e regjistrave të risku, si dhe mungojnë plan-veprimet vjetore operationale të miratuara, për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme;
- (ii) nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve, si dhe
- (iii) nuk ka një plan menaxhimi të riskut të TI për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish;

Për “Informimin dhe komunikimin” ka:

- (i) nuk ofrohet informacion i plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj;
- (ii) mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut;

- (iii) nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave;

Për “Monitorimin” mungojnë:

- (i) raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti;
- (ii) mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit etj.

D. Në auditimet e performancës:

Fokusi i auditimeve të performancës, gjatë vitit 2023 ka përfshirë disa fusha me ndjeshmëri të lartë publike, si:

Fusha e shëndetësisë dhe mirëqenies, ku janë kryer auditimet me temë “Trajtimi i sëmundjeve tumorale”, dhe “Shërbimi në Terapinë Renale Zëvendësuese (hemodializa, dializë peritoneale, transplant)”.

Fusha e mjedisit: “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”, dhe “Performanca në sistemit e shfrytëzimit minerar të mermerëve”.

Fusha e bujqësisë: “Efektiviteti i procesit të certifikimit të materialit mbjellës bimor (fara e fidanë), i përdorur nga fermerët”.

Fusha sociale dhe barazisë gjinore: “Fuqizimi ekonomik i gruas në vendin tonë”, “Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus, gratë e dhunuara”, dhe “Kujdesi ndaj të moshuarve”.

Fusha e drejtësisë, zvogëlimit pabarazisë dhe ndërtimit të institucioneve të forta: “Shërbimi i policisë në përgjigje të qytetarëve”, “Ndihma juridike falas për personat në nevojë”, “Shërbimi përmbartimor shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore”, “Performanca e shërbimit të paraburgimit”.

Fusha e ekonomisë dhe sigurisë: “Rezervat e shtetit në shërbim të qytetarit”.

Fusha e teknologjisë dhe inovacionit: “Performanca e ofrimit të shërbimeve “online” për qytetarët”.

Fusha e kulturës: “Garantimin i të drejtës së autorit”.

Çështjet/problematikat kryesore të konstatuara në auditimet e performancës, gjatë vitit 2023 konsistojnë:

Në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies ku: (i) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe institucionet e varësisë së saj nuk kanë mundur të përmirësimin e shërbimit të trajtimit të sëmundjeve tumorale; shërbimet radiologjike, radioterapi e disa kimioterapi, ofrohen vetëm në Spitalin Onkologjik, për rrjedhojë centralizimi i shumicës së shërbimeve shëndetësore, rrit kostot ekonomike për pacientët dhe familjarëve të tyre; (ii) institucionet përgjegjëse të sistemit shëndetësor nuk ka qenë plotësisht efektive në forcimin e më tejshëm të politikave të parandalimit, të depistimit, të trajtimit në kohë të kancerit, për uljen e mortalitetit të popullsisë së prekur nga sëmundjet tumorale në vend; (iii) MSHMS në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik, nuk kanë hartuar raporte monitorimit dhe vlerësimit për përfundimin e Programit të Kancerit në Shqipëri 2011-2020 si dhe të publikojnë raporte vlerësimi për ecurinë e kancerit në Shqipëri duke pasuruar Regjistrin Kombëtar të Kancerit; (iv) MSHMS dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor: nuk kanë planifikuar auditimin e strukturave të monitorimit të zbatimit të kontratave të shërbimit të hemodializës; (v) nuk i kanë studiuar dhe analizuar, kapacitetet profesionale, teknike dhe infrastrukturore, të institucioneve shëndetësore publike dhe jopublike të çdo qyteti që shërbimi i dializës të jepet sa më afër pacientëve që banojnë në këto qytete; (vi) nuk kanë zhvilluar programe trajnimit për rrjetin e nefrologëve dhe të infermierëve për aksesin vaskular si dhe përpunimi e miratimi me akte nënligjore të vendosjes së aksesit vaskular Av-fistula ose Graftit para fillimit të hemodializës; (vii) nuk kanë studiuar për të mundur rishikimin dhe përmirësimin e ligjit për “Transplantimin e

Indeve, të Qelizave dhe të Organeve në Republikën e Shqipërisë” sipas praktikave më të mira evropiane e botërore për transplantin e kryqëzuar të veshkave.

Në fushën e mjedisit: (i) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave nuk kanë bashkëpunuar sa duhet me njëra tjetrën për të siguruar financime për promovimin e shkarkimeve zero nga mjetet rrugore, shkarkime të ulëta, automjete me karburant të pastër, alternativ, etj.; (ii) në vendin tonë evidentohet një rritje të numrit të mjeteve rrugore me naftë dhe moshës mesatare të mjeteve; (iii) Shqipëria ka raportin më të ulët të mjeteve rrugore elektrike; (iv) Strategjia Minerare është e mangët; (v) Ligji mineral dhe Ligji për Taksat Kombëtare nuk janë të harmonizuar me njëri-tjetrin; (vi) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) nuk ka marrë masa për të unifikuar pagesën e rentës minerare bazuar në emërtimin e mineralit; (vii) AKBN nuk ka marrë masat e nevojshme për të kryer dy herë në vit monitorimin e veprimtarisë minerare të çdo subjekti.

Në fushën e bujqësisë: (i) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) nuk ka pasur struktura të dedikuara për monitorimin e farave, fidanëve e materialin mbjellës dhe shumëzues bimor; (ii) Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve nuk evidenton gjithë procesin që kalon testimi dhe regjistrimi i varieteteve; (iii) MBZHR në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve nuk kanë të përditësuar të dhënat mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar dhe eksportuar; (iv) MBZHR dhe institucionet e varësisë të nuk koordinojnë të dhënat në kohë reale me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për importet dhe eksportet e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;

Në fushën sociale dhe barazisë gjinore: (i) Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk kanë qenë plotësisht efektive në realizimin e objektivave mbi Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor; (ii) Në programet ekzistuese të ministrive planifikimi i Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor nuk ka tregues me ndarje gjinore; (iii) Nuk është realizuar monitorimi, gjurmueshmëria si dhe vlerësimi e matja e ndikimeve të shpenzimeve buxhetore; (iv) legjislacioni për dhunën në familje ka mangësi në evidentimin e përgjegjësive të personave që janë pjesë e sistemit; (v) për dhunën në familje ka munguar bashkëpunimi ndër institucional i MSHMS me Ministrinë e Brendshme dhe/ose Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për të evidentuar dhe marrë masat e nevojshme sensibilizuese të cilat kanë impakt të lartë social; (vi) në strukturat e policisë dhe bashkive specialistët e krimeve dhe koordinatori vendor i dhunës nuk janë të dedikuar për të mbuluar vetëm rastet e dhunës në familje; (vii) në Institucionet Rezidenciale Publike për të moshuarit nuk kanë kapacitete të mjaftueshme, staf të punësuar për të moshuarit, kushte për të moshuarit dhe nuk plotësojnë nevojat e tyre sipas standardeve; (viii) për të moshuarit nuk është zbatuar asnjë program, i cili parashikon ekzaminimin dhe kryerjen e vizitave apo konsultave periodike nga mjekë specialistë sipas nevojave të të moshuarve si dhe vizita dentare; (ix) sistemi i shërbimit social shtetëror nuk ofron qendra rezidenciale për persona jo-autosuficientë, kjo kategori të moshuarish akomodohet në të njëjtat ambiente me të moshuarit e tjerë dhe për trajtimin e tyre nuk është angazhuar asnjë mjek psikiatër;

Në fushën e drejtësisë, zvogëlimit pabarazisë dhe ndërtimit të institucioneve të forta: (i) Policia e Shtetit nuk ka të përditësuar procedurat standarde për trajtimin e ankesave anonime ndaj punonjësve të policisë së shtetit; (ii) sistemi i numrit 112 funksionon si sistem teknologjik për administrimin e thirrjeve emergjente vetëm në Tiranë dhe niveli i realizimit të angazhimeve financiare për ngritjen dhe vendosjen në funksion të numrit unik 112 është 54%; (iii) nuk është kryer analizë, për përcaktimin e kriterit të pamjaftueshmërisë financiare dhe përfitimit të ndihmës juridike falas; (iv) Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit nuk ka një Strategji Institucionale dhe përditësuar Rregulloren e Brendshme; (v) Shërbimi Përmbarrimor Shtetëror haset në vështirësi në rastet e vendosjes së urdhër sekuestros nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor; (vi) Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk ka analizë dhe shpërndarje proporcionale të paraburgosurve, sipas kapaciteteve dhe IEVP-ve; (vii) kushtet që ju ofrohen

personave të paraburgosur në IEVP-të nuk përmbushin standardet kombëtare e ndërkombëtare, në respektim të dinjitetit njerëzor;

Në fushën e ekonomisë dhe sigurisë; (i) Ministria e Mbrojtjes nuk ka përfshirë në dokumentet politikë (strategji kombëtare/sectoriale), direktivat e ministrisë për mbrojtjen civile etj., rezervën materiale të shtetit; (ii) kuadri ligjor dhe rregullator i rezervës materiale të shtetit është i pa përditësuar; (iii) struktura aktuale e rezervës materiale të shtetit është jo e plotë dhe e pamjaftueshme për të përmbushur qëllimin për të cilin është krijuar;

Në fushën e teknologjisë dhe inovacionit: (i) Në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) u konstatua mangësi në procesin e hartimit të planeve të monitorimit për realizimin e Programit Kombëtar TIK 2018-2021; (ii) institucionet shtetërore nuk janë përcjellë kërkesa në AKSHI për nevojat e tyre; (iii) AKSHI dhe 75 institucione të administratës shtetërore nuk kanë bashkëvepruar për transferimin e aseteve;

Në fushën e kulturës: (i) Kuadri rregullator për të drejtën e autorit nuk është përafëruar plotësisht me direktivat e BE-së; (ii) paqartësia e kompetencave institucionale ndërmjet subjekteve: Drejtoria për të Drejtën e Autorit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoritetit të Mediave Audiovizuale, të ngarkuara me mbrojtjen dhe garantimin e së të drejtës së autorit, kanë sjellë koordinim të pamjaftueshëm të veprimeve të tyre, për respektimin e kësaj të drejte.

E. Në auditimet e Teknologjisë së Informacionit (auditimet IT):

Në fushën e funksionimit të Qeverisjes TIK, është konstatuar: mungesa e strategjisë institucionale dhe strategjisë në drejtim të teknologjisë së informacionit, e cila ka mbartur riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së institucioneve të audituara; mungesa e kontroleve dhe mekanizmave të duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT dhe mungesa e akteve rregullatorë të përditësuar në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit, të cilat kanë ndikuar në një zhvillim të pa monitoruar të aktivitetit të institucioneve dhe pa deleguar përgjegjësitë individuale për veprimet e kryera etj.

Në fushën e Sigurisë së Informacionit, ka rezultuar: identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimeve kundrejt qytetareve dhe bizneseve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave, si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit pa ndërprerje nëpërmjet teknologjisë së informacionit, që rezultoi i pamjaftueshëm; ndërveprimi i të dhënave që këto sisteme ruajnë dhe përpunojnë, i cili rezultoi të mos jetë i konsoliduar etj.

Në fushën e zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit, ku përmendim: investimet në sistemet e informacionit, të cilat nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit si dhe sigurimin e vazhdueshmërisë së biznesit dhe nevoja që zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës të mbështetet në praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare etj.

Në fushën e Auditimit të Sistemeve, ka raste ku pjesa më e madhe e infrastrukturës software dhe hardware të institucioneve është lënë nën administrimin e AKSHI-t dhe ofertuesve të shërbimeve, si dhe performanca e funksionimit të sistemeve është jo e kënaqshme.

2.3 REZULTATET SIPAS LLOJEVE TË AUDITIMIT

A. Auditime të përputhshmërisë

1. Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë: Në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj për periudhën e aktivitetit të vitit 2022, janë evidentuar problematika dhe mangësi në të gjitha fazat e planifikimit, miratimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit të buxhetit, për të cilat është dhënë *opinion i modifikuar/kualifikuar*⁵ bazuar në sa vijon:

Janë konstatuar vonesa në hartimin e dokumenteve të Programit Buxhetor nga institucionet buxhetore: kalendari i menaxhimit të shpenzimeve publike si dhe udhëzimi për përgatitjen e PBA-së, janë miratuar në tejkallim të afatit të përcaktuar në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB). Rishikim i prioriteteve buxhetore pa kaluar më parë në PBA, pagesa të detyrime të prapambetura për investime kapitale me financim të brendshëm në vlerën 6,169 milionë lekë, ose rreth 6.8% të totalit, duke deformuar vëllimin e investimeve të realizuar për vitin fiskal 2022; janë nënshkruar 1,319 kontrata pas datës 15 Tetor me vlerë të kontraktuar 10,045 milionë lekë; janë raportuar investime kapitale me financim të brendshëm të realizuara nga të ardhurat dytësore në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar në vlerën për 1,352 milionë lekë.

Nga auditimi në MFE është konstatuar se: FSHZH në 17 raste për 9 projekte investimi në vlerën 398,792 mijë lekë ka kryer parapagimin e kontratave, të cilat janë përfshirë në investime të realizuara; në FSHZH raportohet si investim i realizuar kosto lokale e menaxhimit të projekteve të investimit në shumën 883,200 mijë lekë, ndërkohë që këto fonde përdoren për aktivitetin e shpenzimeve korrente të institucionit; janë çelur 6 projekte investimi me përshkrimin “Fond i ngrirë”, me vlerë fillestare 4,300 mijë lekë, në 12 programe të ndryshme buxhetore, në kundërshtim me përcaktimet ligjore për përkufizimin e projektit të investimit publik. Nga ARRSH raportohet si investim projekti me përshkrim “Vendime gjyqësore në proces” me vlerë për 180,000 mijë lekë, ndërkohë që për planifikimin dhe realizimin e këtyre shpenzimeve duhet të ishin përdorur llogaritë e shpenzimeve operative; Nga AZHBR konstatohet se janë raportuar investime kapitale me kod projekt 18AL301 “Përfitues nga Programi IPARD II nga masa 1” në shumën 591,600 mijë lekë, kapitulli 3 “kosto lokale”, duke mbivlerësuar treguesit e investimeve publike.

Janë konstatuar disa raste ku rishpërndarja buxhetore është ekzaktësisht e barabartë me vlerën e faturave të prapambetura në vlerën 3,8 miliardë lekë; gjithashtu për 202 projekte investimesh të procesuara për pagesë në vlerën 2,168 milionë lekë, pagesat nga buxheti i shtetit për shlyerjen e faturave kryhen në të njëjtën ditë ose deri në 10 ditë diferencë nga data e regjistrimit të kontratës (data e krijimit të kontratës) në sistemin informatik financiar të qeverisë; raste të projekteve për të cilat ka angazhim në vitin aktual në vlerë të përcaktuar, angazhim 0 lekë për vitet 1 dhe 2 dhe në vijim angazhim në vitin e tretë dhe të katërt në vlerë, përfundim i formuar në bazë të raportit më të fundit për vitin buxhetor, atë të muajit dhjetor të vitit 2022; për 28 projekte investimi janë marrë angazhime pa pasur fonde në dispozicion në vlerën 5,617 milionë lekë.

Për investimet e huaja, 26 projekte, me kredi dhe grant, në vlerën 2,200 milionë lekë janë realizuara pa pasur plan buxhetor dhe 53 projekte në vlerën 1,506 milionë lekë janë realizuar në tejkallim të planit të buxhetit të miratuar; ndërsa 95 projekte në vlerën 3,273 milionë lekë, janë keq klasifikuar në llogarinë 231 “Investime për rritjen e aktiveve afatgjata materiale” pasi përfaqësojnë natyrë tjetër shpenzimi.

⁵ Sipas Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë: Opinioni i modifikuar/i kualifikuar në auditimin e përputhshmërisë jepet bazuar në treguesit evidencave të mjaftueshme dhe të përshtatshme, në të cilat parregullsitë/anomalitë janë materiale por jo të përhapura.

Vlera e fondeve të rindërtimit e shpërndarë me VKM përgjatë viteve, është mbi vlerën e përcaktuar në ligjet e buxhetit të viteve 2020, 2021 dhe 2022, për shumën 44,736 milionë lekë, pasi shpërndarja e fondeve me VKM nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së fondit të rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore sipas tabelës 4 të ligjit të buxhetit vjetor. Gjithashtu, për financimin e një pjese të projekteve të rindërtimit, në VKM është përcaktuar burim financimi ngurtësimi i fondeve, në vlerën rreth 2,763 milionë lekë, gjë e cila nuk është në përputhje me ligjin organik të buxhetit dhe ligjin vjetor të buxhetit.

Nga buxheti i shtetit është financuar Korporata Shqiptare e Investimeve sh.a., në shumën 2 miliardë lekë, pa kërkesë të shoqërisë dhe pa asnjë projekt të saj, në një kohë që shoqëria rezultoi pa aktivitet dhe me humbje. Ortaku i vetëm i kësaj shoqërie në të njëjtën ditë ka marrë 4 vendime për zmadhim dhe zvogëlim kapitali me efekt neto në rritje kapitali në vlerën 2.1 miliardë lekë, pa ndonjë argument dhe pa vendimmarrje të organeve drejtuese.

Janë konstatuar 27311 fatura me vlerë 52,579 milionë lekë të dorëzuara në thesar jashtë afatit 30-ditor, ku 4033 në vlerën 34,203 milionë mijë lekë i përkasin investimeve. Gjithashtu për 20 raste, në vlerën 2,700 milionë lekë janë konstatuar regjistrime dhe pagesa pjesore të faturave, të cilat janë më të vogla se sa vlera e detyrimit të lindur sipas faturës së furnitorit, kjo me qëllim përputhjen e fondeve buxhetore disponibël.

Pjesa më e madhe e ekzekutimit të shpenzimeve përqendrohet në muajin dhjetor, ku janë procesuar për pagesë edhe fatura të viteve të mëparshme apo të muajve të mëparshëm të vitit 2022. Nga 65,890 milionë lekë fatura të kaluara me datë libri të madh në dhjetor, janë konstatuar rreth 20,800 milionë lekë të pagesa të faturave që i përkasin muajve janar-nëntor.

Detyrimet e prapambetura me vlerë 12,753 milionë lekë nuk janë përfshirë në treguesit fiskal të konsoliduar.

Rezultojnë pagesa të ekzekutuara jo sipas parimit hyrje e parë - dalje e parë në sistem (FIFO), si dhe ekzekutime të pagesave të faturave të regjistruara në data të mëvonshme, përpara urdhër shpenzimeve të regjistruara në data më të hershme.

Në tre procedura të prokurimit nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjërishit kriteret e vendosur dhe dokumentuar në procesverbal, ndërsa në dy raste është vepruar me dy standarde në vendosjen e kriterëve, në kundërshtim me kërkesat e LPP. Është kryer rikonstruksioni për një objekt ku zhvillon aktivitetin shkollë profesionale shtetërore, por në pronësi të Fondacionit SOS Fshatrat e Fëmijëve në vlerën 32 milionë lekë etj. Aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ka likuiduar 13.6 milionë lekë vendime gjyqësore për largime nga puna.

2. Në Bankën e Shqipërisë për periudhën e aktivitetit nga data 01.09.2021 deri më datën 31.12.2022, është ushtruar auditimi, për të cilat është dhënë *opinion i pa kualifikuar*⁶.

Rezultati financiar negativ për vitin 2022, sipas pasqyrave financiare është në vlerën 17,650 milionë lekë, tregues i cili jep efekt në uljen e vlerës totale të kapitalit dhe korrigohet për efektet nga kurset e këmbimit, duke rezultuar në një humbje bruto në vlerën - 3,084 milionë lekë, si rrjedhojë e luhatjeve të kurseve të këmbimit, si dhe situatës në tregjet financiare.

Banka e Shqipërisë ka pranuar bono privatizimi nga subjekte të pa autorizuara, në vlerën totale 2,497 milionë lekë, nga të cilat 2,430 milionë lekë bono privatizimi nga Banka Credins dhe 67.5 milionë lekë bono privatizimi Banka Raiffeisen.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë asgjëson vetëm bonot e privatizimit që sillen nga bankat e nivelit të dytë, për të cilat nuk ka siguri nëse përfaqësojnë të gjitha bonot e përdorura apo vetëm një pjesë të tyre,

⁶ Sipas Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë: Opinioni i pa modifikuar/i pa kualifikuar në auditimin e përputhshmërisë jepet bazuar në treguesit evidencave të mjaftueshme dhe të përshtatshme, në të cilat parregullsitë/anomalitë nuk janë materiale dhe nuk janë të përhapura.

duke mbartur risk që pjesa e pa dorëzuar në Bankën e Shqipërisë, të vijojë të mbahet nga bankat e nivelit të dytë jashtë monitorimit dhe mbikëqyrjes.

Ka rezultuar mos konfirmimi sipas periodicitetit të parashikuar në rolin e agjentit fiskal sipas parashikimeve të marrëveshjes për ofrimin e shërbimeve financiare; parregullsi në vendosjen e kritereve kualifikuese për kandidatët gjatë procedurave të prokurimit, si dhe parregullsi në zbatimin e kontratave të lidhura; zhvillimi i procedurave të rekrutimit të testuara nëpërmjet procedurës së pranimit pa konkurrim dhe pagesa të shpërblimeve për punonjës me leje lindje etj.

3. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor” (FSDKSH), për periudhën e aktivitetit të vitit 2022, është dhënë *opinion i modifikuar/kualifikuar*.

Të ardhurat e realizuara nga fondet speciale, janë raportuar me diferencë për 102,000 mijë lekë më shumë nga FSDKSH, kundrejt raportimit në treguesit fiskalë nga MFE. Janë konstatuar mangësi në mënyrën e përzgjedhjes së subjekteve për ushtrim kontrolli në subjektet farmaceutike, apo dhe subjektet që kanë kontratë me FSDKSH, si rrjedhojë e mos përcaktimit të procedurave dhe hapave që duhet të ndiqen për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit; përcaktimin e kritereve të riskut; afateve në zbatimin e procedurave të kontrollit, të cilat në disa raste, nuk janë të përcaktuara në rregulloren përkatëse, duke krijuar kushte për favorizim dhe shmangie të kontrolleve ndaj tyre. Nga verifikimi i disponibilitetit të barnave në treg, alternativë e parë dhe e vetme, rezultoi mungesë e tyre e reflektuar kjo në uljen e ndjeshme të recetave, ku kanë ndikuar dhe rastet e pezullimit të kontratave me importuesit farmaceutikë bazuar në vendimet gjyqësore, për të cilat nga Fondi nuk janë marrë për të zgjidhur çështjen e mungesës së disponibilitetit të barnave, alternativë e parë dhe e vetme e LBR-së. Janë kryer pagesa në shumën 2,361 mijë lekë, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet e padrejta nga puna, si dhe janë paguar shpenzime të pa nevojshme përmbartimore në vlerën 145 mijë lekë, të cilat përbëjnë efekte financiare negative për buxhetin e institucionit.

Për koncesionin e kontrollit mjekësor bazë (Check-up) janë kryer pagesa për shërbim të pakryer për 20172 raste, me një kosto në shumën 31,004 mijë lekë pa TVSH. Për koncesionin e hemodializës, pagesat e koncesionarit nuk kryhen për shërbim të kryer, por për shërbim të faturuar, i cili përfshin likuidimin e rasteve të pakryera ose shprehur ndryshe nën projeksion vjetor, si dhe të rasteve të realizuara mbi projeksion mujor, të secilës qendër dialize, në total 8854 raste, nga të cilat 6918 raste nën projeksion dhe 1936 raste mbi projeksion, në shumën 99,191 mijë lekë, që përfaqëson pagesë për shërbim të pa kryer. Për koncesionin e sterilizimit të pajisjeve mjekësore, rezulton se në 15339 raste në Spitalet Universitare, në 8708 raste në Spitalet Rajonale dhe në 55 raste në Spitalet Bashkiake janë përdorur sete të ndryshme për të njëjtën tipologji kirurgjikale.

Për koncesionin e shërbimit laboratorik, kufizimet janë të lidhura me tavanin buxhetor të secilit spital, të sanksionuar në kontratën koncesionare të laboratorëve, duke rrezikuar ofrimin e analizave laboratorike, në masën e duhur, sipas nevojave spitalore dhe duke sjellë për pasojë drejtimin e pacientëve në marrjen e këtij shërbimi tek subjektet private, me kosto shtesë për qytetarët, si dhe përkeqësim të shëndetit nga moskryerja në kohë e analizave përkatëse.

4. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Tiranë, për periudhën e aktivitetit të vitit 2022, është konkluduar në *opinion të pa kualifikuar/me theksim çështjeje*⁷.

⁷ Sipas Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë: Opinioni i pa modifikuar/ i pa kualifikuar me theksim të çështjes, në auditimin e përputhshmërisë jepet bazuar në treguesit evidencave të mjaftueshme dhe të përshtatshme, në të cilat parregullsitë/anomalitë janë jo materiale dhe nuk janë të

Është konstatuar se, numri i pensioneve përgjatë vitit 2022 ka pësuar një rritje me 1.9% krahasuar me një vit më parë.

Masa mesatare e pensioneve të reja është rritur me 3.2% krahasuar me 2021, kjo si rezultat i rritjes së periudhës kontributive në lidhje me këtë kategori dhe kontributeve të derdhura që sjellin një bazë të vlerësuar më të lartë, por dhe pensionet ekzistuese janë rritur si rezultat i indeksimit situatë e cila ka sjellë shpenzime totale për përfitime më të larta në masën 4.5%, krahasuar me një vit më parë. Norma e varësisë së sistemit (numër mesatar i kontribuesve/numër mesatar i pensioneve) është rritur me 1.7% krahasuar me vitin 2021, çka përbën një tregues negativ për sistemin e sigurimeve shoqërore. Në 2022 për një pension kanë kontribuar 1.17 kontribues, nga 1.15 që ishte më parë, kjo për shkak se rritja e numrit të përfituesve në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 është 1.9% dhe rritja e numrit të kontribuesve në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 është 1.3%.

Në nivel sistemi, ISSH përgjatë vitit 2022 ka realizuar të ardhura nga kontributet në masën 105,657 milionë lekë, ose 11% më shumë se viti 2021, të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit ka qenë 62,872 milionë lekë ose 9% më shumë se viti 2021, shpenzimet totale të ISSH, që përfshijnë shpenzime për përfitime, për paga dhe të tjera administrative të ISSH-së kanë rezultuar në masën 163,037 milionë lekë ose 10% më shumë se viti 2021, ndërsa rezultati fiskal i vitit 2022 ka rezultuar 5,492 milionë lekë ose 18% më shumë se një vit më parë, në terma të treguesve financiarë situata e sigurimeve shoqërore paraqitet pozitive.

Nga krahasimi i të ardhurave të realizuara nga ISSH (kontributet/të ardhura tatimore) dhe të dhënave të Tabelës së Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, Kapitulli II.3 “Të ardhurat nga fondet speciale”, rezulton se të ardhurave faktike nuk përputhen për shumën 16 milionë lekë dhe plani i shpenzimeve, ka mospërputhje në shumën 11,946 milionë lekë.

Nga auditimi i 148 dosjeve të pensionit, në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, kanë rezultuar me mangësi në përlllogaritjen e masës së pensionit 56 dosje, ose 37.8% e tyre, kjo për shkak përlllogaritjes së pasaktë të elementëve përbërës të pensionit, si pensioni bazë dhe shtesa e pensionit nga inspektorëve përpunues të dosjeve, si dhe nga auditimi mbi respektimin e afatit 42-ditor në përpunimin e një dosje pensioni, nga auditimi i 148 dosjeve, në 38 raste, ose në masën 25% kundrejt totalit të dosjeve të audituara ka rezultuar se nuk është respektuar afati i përpunimit të dosjes.

ISSH ka funksionuar mbi bazën e Rregullores për Organizimin e Funksionimit të saj, e cila nuk përshtatet me strukturën organizative aktuale.

5. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD, pjesa I-rë), për periudhën e aktivitetit të vitit 2022, është dhënë *opinion i modifikuar/kualifikuar*, për sa më poshtë:

DPD në fund të vitit 2022 rezulton me një nivel borxhi doganor në shumën 46,691 milionë lekë, përfaqësuar nga 4,858 raste. Borxhi doganor i trashëguar përgjatë viteve rezulton gjithmonë në rritje, ku për vitin 2022 rritja paraqitet në vlerën 979 milionë lekë, ose me 2,14%. U konstatuan të ardhura doganore të munguara në buxhetin e shtetit, të shkaktuara si pasojë e problematikave të identifikuara në zbatimin e kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator në strukturën përgjegjëse të hetimit, antikontabandës, akcizës në total prej 19,300 mijë lekë.

Janë evidentuar problematika në procedurat e prokurimit dhe monitorimit të kontratave; në veprimtarinë e sektorit juridik; në procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave doganore; administrimin e burimeve njerëzore; mos finalizimi i procesit të ristrukturimit të institucionit, duke sjellë një numër të konsiderueshëm të vendeve të paplotësuara dhe transferimeve në administratën doganore. Pavarësisht se reduktimi në numër i punonjësve të institucionit sipas strukturës së re

përhapura, por ekziston një çështje që duhet evidentuar dhe mund të ketë ndikim në të ardhmen, ndaj duhet sjellë në vëmendje të përdoruesve të synuar.

organizative miratuar me VKM nuk ka pasur efekte financiare, kjo situatë ka kontribuar për shtimin e mangësive në garantimin e performancës optimale në punë.

Efekte financiare negative në përdorimin e fondeve publike si pasojë e likuidimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ish-punonjësit e larguar nga puna, llogariten në vlerën totale prej 8,210 mijë lekë, nga të cilat vlera prej 416 mijë lekë i korrespondon pagesës së kryer si tarifë përmbartimore.

6. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), për periudhën e aktivitetit të vitit 2022, është dhënë *opinion i modifikuar/kualifikuar*.

Gjendja e detyrimeve të papaguara në fund të vitit 2022, është 147,767 milionë lekë, ku stoku i detyrimeve tatimore ka pësuar një rritje neto prej 11,800 milionë lekë krahasuar me një vit më parë; Nuk është respektuar plani i rimbursimit të TVSH-së i përcaktuar në ligjin vjetor të buxhetit të vitit 2022”, i cili është tejkaluar në shumën 4,000 milionë lekë. Në mbyllje të periudhës ushtrimore, rezultojnë 32 kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuar, por të pa miratuara në vlerën totale prej 1,800 milionë lekë, në tejkalim të afatit ligjor 60-ditor.

Të ardhurat tatimore neto paraqiten me mosrealizim për vlerën 13,000 milionë lekë, ku ndikim ka dhënë mosrealizimi i të ardhurave nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, nga Taksat Kombëtare dhe Taksa e Qarkullimit Rrugor.

Mangësi në trajtim të të ardhurave faktike të vitit ushtrimor të strukturuar sipas natyrës dhe llojit, pasi janë përfshirë edhe të hyrat e kontabilizuara në llogarinë 466 “Mjete në ruajtje”, e cila përfaqëson arkëtimet e pidentifikuara deri në sistemin e tyre, si dhe raportimi i gjobave dhe kamatëvonesave; Në realizimin e të ardhurave në raportim janë përfshirë edhe arkëtimet prej 5,600 milionë lekë për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme me normë të reduktuar tatimore, të cilat paraqiten pa plan të ardhurash, pasi janë realizuar në formën e të ardhurave jo tatimore;

DPT ka kryer likuidime për vendime gjyqësore të formës së prerë për ish-punonjës të larguar nga puna në vlerën totale 77,700 mijë lekë, vlerë e cila ka efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit;

Mangësi në zbatimin e buxhetit institucional për shpenzimet operative dhe investimet publike, që përfshijnë rishikime të shpeshta të projekteve të investimeve publike në vlerë, kontraktimi i fondeve buxhetore përtej afateve të përcaktuara në ligjin organik të buxhetit; Mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, ku megjithëse përzgjedhja e subjekteve për kontroll është automatike, detajimi i subjekteve për secilën drejtori kryhet manualisht. Sistemi nuk merr në konsideratë subjektet e planifikuara për kontroll në planet e mëparshme të kontrollit të cilat nuk janë realizuar brenda afateve të përcaktuara, janë në proces kontrolli apo janë hequr nga lista e subjekteve të planifikuara, të cilat eliminohen manualisht nga punonjësit e kësaj drejtorie në bazë të informacionit të marrë nga Drejtoritë Rajonale; Mangësi në aktivitetin e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, të cilat konstatohen në monitorimin periodik të punës së Drejtorive Rajonale Tatimore lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor, në përfundimin e kontrolleve dhe arkëtimin e detyrimeve, e në mos përfundimin e kontrolleve për disa vite etj.

7. Në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2022, është dhënë *opinion i modifikuar*.

Spektori i Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin e qarkullimit sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratat e Tatim Fitimit të Thjeshtuar dhe Tatim Fitimit për tatimpaguesit, nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për 325 tatimpagues, në kundërshtim me përcaktimet ligjore e rregullat procedurale, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Nga auditimi me përzgjedhje i 40 raporteve të kontrollit tatimor, është konstatuar se nga ana e inspektorëve të kontrollit nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur procedurat e kontrollit, mbi analizimin e situatës financiare dhe deklarimeve të subjektit, ku janë konstatuar paraprakisht mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në vlerësimin e inventarit fizik ku përfshihen shitje mallrash nën kosto, në identifikimin e shpenzimeve të panjohura në përputhje me legjislacionin tatimor nga ana e

inspektorëve të kontrollit, si dhe në identifikimin e kriterëve ligjore për përfitimin e rimbursimit të TVSH-së nga ana e subjekteve tatimore, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

8. Në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM), për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2022, është dhënë *opinion i modifikuar/kualifikuar*, për sa më poshtë:

Janë konstatuar efekte negative në grumbullimin e të ardhurave buxhetore gjatë auditimit të raporteve të kontrolleve tatimore, duke shkaktuar mungesën e evidentimit dhe të kërkimit për arkëtim të shumë prej 2,024,711 mijë lekë, si pasojë e faturimeve të situacioneve të punimeve ndërtimore poshtë nivelit të përcaktuar në EKB, mangësive në inventar, shitjeve pa faturë tatimore, kreditim i gabuar i TVSH-së së karburantit, zbatimit të gabuar të koeficientit të rregullimit të TVSH-së, shitjeve të objekteve ndërtimore poshtë çmimit të referencës të përcaktuar me VKM nr. 168, datë 27.03.2019; si dhe uljen e humbjes në vlerën 230,296 mijë lekë. Në raportet e kontrollit në vend kanë rezultuar pasaktësi në transaksionet me ortakun, të kryera në kundërshtim me parimet dhe kushtet e tregut, duke mos aplikuar norma interesi, dhe me mos njohjen si të ardhur të parapagimeve për shitjet e njësisve të banimit, të cilat janë të pajisura me certifikatë shfrytëzimi, por pa kalim titulli të pronësisë.

Nga shitja e mallit naftë bruto e kryer nga një kompani me destinacion jashtë territorit të Shqipërisë, rezultuan diferenca të pagesës së rentës minerare, ku sipas çmimit të bursës brend të rivlerësuar në procedurë eksporti në shumën totale 1,315,285 mijë lekë, si dhe rillogaritje të pagesës së rentës minerare me një detyrim tatimor të taksës kombëtare të rentës minerare në shumën 131,528 mijë lekë, bazuar në nenin 5 të ligjit nr. 153/2020 për “Regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur renta minerare”. Problematika të tjera lidhen me masat e ndërmarra për vjeljen e detyrimeve të papaguara, mangësitë në procesin e monitorimit të të ardhurave tatimore, dobësi në procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e subjekteve objekt kontrolli në vend, mos realizim i propozimeve për kontroll nga DTM në masën 50%, mangësitë në sistemet e aplikuara duke rezultuar me diferenca në deklarimin e TVSH-së në dogana krahasimisht me deklarimin në sistemin C@TS në tatime.

9. Nga auditimi i kryer mbi vlerësimin e sistemit të licencimit, shfrytëzimit dhe mbikëqyrjes e monitorimit të subjekteve me veprimtari në fushën minerare në institucionet përgjegjëse, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM) si dhe në 3 shoqëri tregtare në likuidim dhe sipër që veprojnë në këtë sektor, për periudhën 2018 – 2022, është arritur në konkluzion se ky sistem është pjesërisht funksional dhe pjesërisht efikas⁸.

Nga auditimi i ushtruar, ka rezultuar se, këto institucione shtetërore janë të ekspozuara ndaj risqeve ligjore, ekonomike, financiare, mjedisore, etj., si kanë mangësi domethënëse të ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësisve të tyre zyrtare, me ndikim të mundshëm në shfrytëzimin e zonave minerare, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre pasurive publike dhe kryerjen e këtyre veprimtarive me interes publik. Këto mangësi dhe parregullsi, mund të konsiderohen dhe klasifikohen si devijime nga kriteret, probleme thelbësore dhe sistematike, të cilat janë të përsëritura nga viti në vit.

Nga MIE, nuk janë respektuar rregullat dhe procedurat e licencimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare, për shpalljen e zonave dhe zhvillimin e procedurave konkurruese operatorëve ekonomikë, procedurat e shqyrtimit të ankesave nga njësia e ankimimit, ushtrimin e përgjegjësisve ligjore mbi revokimet dhe pezullimet e lejeve minerare të shfrytëzimit, heqjen nga fondi pyjor e kullësor të sipërfaqeve të dhëna në shfrytëzim për subjektet private të

⁸ Sipas Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë: Konkluzioni i auditimit, pasi audituesi ka shqyrtuar në mënyrë sistematike të gjithë informacionin përfaqësues, duke përdorur për këtë qëllim përzgjedhjen e elementëve nga kampionet dhe testimin e tyre, nisur gjithnjë nga rëndësia apo materialiteti i informacionit, shprehë në se objekti i angazhimit është /ose nuk është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e zbatueshme.

licencuara në këtë sektor; mos respektim i kushteve dhe administrimin e dokumentacionit që duhet të plotësojnë aplikuesit për një leje minerare, për vlerësimin e përmbushjes së kushteve të përcaktuara në aktet ligjore. MIE si ministria e linjës administrative, nuk ka siguruar koordinimin dhe bashkërendimin e roleve dhe funksioneve me strukturat përgjegjëse respektive në ministritë e linjës, me qëllim ushtrimin nga ana e këtij institucioni të të gjitha kompetencave dhe mekanizmave ligjor për zgjidhjen e të gjitha çështjeve me institucionet e varësisë (AKBN) si dhe me ministritë e linjës (MTM), për të shmangur procedurat e ri aplikimit për pajisje me leje minerare. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për rastet e moskryerjes së inspektimeve dhe mbikëqyrjeve nga AKBN sipas ligjit, nuk ka marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive apo rishikimin e kapaciteteve njerëzore dhe fondeve në dispozicion të kësaj strukture, etj.

Nga ana e **AKBN**-së nuk është përmbushur detyrimi ligjor i kryerjes së inspektimeve së paku dy herë në vit, i të gjitha subjekteve-zotërues të lejes minerare të shfrytëzimit; nuk ka miratim të programit vjetor për ushtrimin e kontroleve në çdo veprimtari minerare, raportet e mbikëqyrjes dhe monitorimit të këtyre subjekteve nuk japin informacion të plotë dhe të rakorduar. Neglizhencë dhe mosveprime për marrjen e masave në përputhje me ligjin minerar për mos-shlyerjen në afat të garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit apo realizimit të investimit; dobësi në kryerjen e procedurave të monitorimit post-minerar të objekteve minerare. Nuk është hartuar dhe miratuar një udhëzues i detajuar (në plotësim të kuadrit ligjor dhe rregullator bazë), lidhur mbi procedurat e kryerjes së monitorimit, sistemin e detyrueshëm, e të domosdoshëm të çështjeve që do të mbikëqyren dhe monitorohen, me qëllim lehtësimin e veprimtarisë monitoruese dhe inspektuese të strukturave përgjegjëse, si dhe aspekte të tjera të aktivitetit të AKBN për sa i përket shqyrtimit dhe miratimit të planeve vjetore, aplikimin e sanksioneve dhe masave ndëshkimore për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit teknik dhe financiar, si dhe mos kryerjen e raportimin e monitorimeve në përputhje me kriteret e aprovuara; zbatimin e komponentëve të strategjisë minerare, etj.

Nga ana e MIE-së dhe AKBN-së nuk janë ndërmarrë iniciativa për përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe hartimin e akteve nënligjore, me qëllim përcaktimin e procedurave administrative dhe afatet ligjore për çështje të parregulluara deri në mbajtjen e raportit të auditimit, kjo në funksion të disiplinimit dhe standardizimit përfundimisht të proceseve dhe procedurave të sektorit minerar. Mangësi në zbatimin e plotë të rregullave për zhvillimin e veprimtarive minerare e postminerare; nuk janë ndjekur detyrimet e zotëruesit pas revokimit të lejes për të vjelë dëmshpërblimin përkatës për dëmet shkaktuar shtetit nga shkeljet e zotëruesit të lejes minerare; mungesë e përditësimit dhe azhurnimit të regjistrit minerar duke përfshirë të gjitha të dhënat për regjimin juridik të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje, respektimin e projektit dhe kryerjen e operacioneve minerare, vlerësimin e investimeve të raportuara nga zotëruesit e lejeve minerare, mos sigurim i punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë, sipas rregullave të sigurimit, etj.

AKSEM nuk ka inspektuar të gjitha subjektet e planifikuara dhe në raportet vjetore të aktivitetit nuk janë paraqitur arsyet për mosrealizimin e këtyre inspektimeve, si dhe nga analiza statistikore e treguesve të inspektimit të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe atyre të paraqitur nga AKSEM në Raportet Vjetore të Veprimtarisë ka mospërputhje të theksuara lidhur me numrin e punëmarrësve të aksidentuar dhe të aksidentuar me vdekje në miniera.

Shoqëritë anonime në likuidim e sipër në sektorin minerar kanë mungesë pothuajse totale të dokumentacionit ekonomik-financiar dhe teknik, si për objektet ndërtimore sipërfaqësore dhe për punimet minerare të 34 ish-minierave në juridiksionin e shoqërisë “Albminiera” duke krijuar probleme të vazhdueshme në administrimin e aseteve të shoqërisë, por edhe në përcaktimin e saktë të zonave minerare të rrezikshme në territoret e juridiksionit të kësaj shoqërie. Nuk ka bilance ekonomike të sakta të ish-minierave, për periudhën që ato kanë funksionuar si subjekte më vete; llogaritë inventariale të tyre kanë qenë të paargumentuara, rezultojnë 613 pasuri të miratuara për privatizim ndër vite, për të cilat procesi i vlerësimit nuk ka vijuar për arsye të ndryshme, etj.

Referuar auditimit të kryer në MIE dhe AKBN janë konstatuar detyrime të papaguara për garanci rehabilitimi sipas lejes në vlerën 21,999 mijë lekë, shtatë (7) masave administrative të shfuqizuara në vlerën 800 mijë lekë në mungesë të shqyrtimit të plotë të provave, si dhe 85% e gjobave të zotëruesve të lejeve minerare për periudhën e audituar e vlerësuar në vlerën prej 27,200 mijë lekë, nuk ka nisur procedura e vjeljes së detyrimi, duke ulur ndjeshëm efektet e masave të ndëshkimit me gjobë të zotëruesve të lejeve minerare në drejtim të disiplinimit të veprimtarisë së sektorit minerar, që ka rezultuar në vlerën totale 49,999 mijë lekë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit. Gjithashtu, kanë rezultuar mangësi në zbatimin e plotë të rregullave për zhvillimin e veprimtarisë minerare dhe postminerare duke sjellë për pasojë uljen e efektivitetit të fondeve publike dhe përdorim pa efikasitet efektivitet dhe ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën gjithsej 33,020 mijë lekë, në të cilat, 6,820 mijë lekë rezultojnë të jenë shpenzim pa ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit ku shoqëritë minerare në likuidim kanë kryer pagesa për ekspertë kontabël për shërbimet e ekspertizës së pasqyrave financiare dhe për shërbimet e auditimit të pasqyrave financiare vjetore, si dhe procesi ligjor i likuidimit të këtyre shoqërive është vonuar dhe tej zgjatur. Procesi ligjor i likuidimit të këtyre shoqërive është vonuar dhe nuk ka përfunduar në kohë deri në shkriren dhe çregjistrimin përfundimtar të këtyre shoqërive, si rrjedhojë shpenzimet që i ngarkohen buxhetit të shtetit për kostot e stafit administrativ të minierave me status “sh.a. në likuidim e sipër” janë të konsiderueshme dhe përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit. Investimet për raportet e monitorimit janë konstatuar mangësi që kanë sjellë uljen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike në vlerën 26,200 mijë lekë pasi raportet nuk ezaurojnë plotësisht çështjet e monitorimit, nuk disponojnë informacion mbi statusin aktual të lejeve, si dhe raportet nuk kanë informacion të plotë për zbatimin e planit të rehabilitimit.

10. Në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), për periudhën e veprimtarisë 01.10.2017-31.12.2022, është dhënë *opinion i kualifikuar*.

Në raportimet e AAPSK-së rezultojnë se janë përfshirë në zërin “të ardhurat e veta” edhe të ardhurat e marra nga buxheti i shtetit, për të mbuluar shpenzimet, duke mbivlerësuar në këtë mënyrë raportimin e të ardhurave, konkretisht: për periudhën objekt auditimi të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara rezultojnë 177,358 mijë lekë ndërsa shpenzimet në vlerën 298,044 mijë lekë, ku diferenca prej 120,686 mijë lekë rezultojnë kosto për buxhetin e shtetit. Për vitin 2022 të ardhurat rezultojnë në vlerën prej 82,134 mijë lekë ndërsa shpenzimet 83,460 mijë lekë. Diferenca prej 1,326 mijë lekë rezultojnë kosto për buxhetin e shtetit për vitin 2022.

Konstatohet se buxheti të shtetit i është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 11,207 mijë lekë, nga të cilat: 7,567 mijë lekë si rezultat i mos mbajtjes së shpenzimeve të administrimit për 7 pasuri dhe 3,640 mijë lekë, si rezultat i financimit të dy projekteve nga Fondi i Posaçëm, pa mbështetje me dokumentacion të plotë justifikues.

Rezultojnë se sistemi elektronik për mbajtjen dhe azhurnimin e regjistrit elektronik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, nuk aksesohet nga administratorët për të gjeneruar të dhënat e pasurive që kanë në administrim, duke sjellë për pasojë mungesën e një baze të dhënash për të gjitha pronat e sekuestruara e të konfiskuara, mangësi në monitorimin e tyre dhe shpenzime pa efektivitet të fondeve të buxhetit të shtetit.

Në dy raste, për një periudhë kohë mbi 1 vit, nuk është kryer asnjë veprim për administrimin e pasurive të paluajtshme. Nga auditimi i 23 praktikave rezultojnë se nuk janë marrë masa për sigurimin e pasurisë për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë, ndërsa në lidhje me veprimet e “bllokimit” të pasurive pranë ASHK-së është vepruar me vonesë të konsiderueshme. Konstatohet se nuk është shitur asnjë pasuri e luajtshme e sekuestruar, të cilave jo vetëm i janë faturuar shpenzime pagat e administratorëve të pasurive, por edhe u ka rënë vlera nga amortizim.

AAPSK nuk ka kryer inventarizimin fizik të pronave dhe llogarive në administrim, duke rritur riskun e humbjes apo tjetërsimit të tyre, nisur dhe nga fakti që janë konstatuar 24 automjete të cilat nuk janë dorëzuar nga administratorët në ambientet magazinuese të AAPSK-së.

11. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD- Pjesa II), për periudhën e aktivitetit të vitit 2022, është konkluduar me dhënien e një *opinionit të modifikuar/kualifikuar*, për shkak të çështjeve kryesore si më poshtë:

Nga auditimi janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat doganore të vlerësimit doganor të mallrave dhe shpenzimeve të transportit gjatë procedurave doganore në import; klasifikime tarifore jo në përputhje me përcaktimet e Nomenklaturës së Mallrave në Republikën e Shqipërisë (RSH); deklarime doganore me pasojë mos pagesën e detyrimeve të akcizës.

Janë konstatuar raste ku për disa subjekte vlerat e artikujve të importuar është trajtuar me transaksion edhe pse dokumentacioni bashkëlidhur nuk i plotëson kushtet për t'u trajtuar si i tillë; i njëjti subjekt për të njëjtin artikull të importuar në shumë raste është rivlerësuar dhe për raste të tjera jo; deklarime të çmimeve të produkteve të gatshme nën çmimin e lëndës së parë; trajtimi i mallrave të përdorur me transaksion nën çmimin e lëndës së parë; si dhe për mallra të importuar nga vende jashtë Komunitetit Evropian trajtimi i tyre është bërë me transaksion në momentin e hedhjes për qarkullim të lirë, veprime jo në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor duke rezultuar me të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në shumën 146,119 mijë lekë, nga të cilat rreth 135,179 mijë lekë detyrime dhe 10,940 mijë lekë penalitet.

Sektori i Përpunimit të Dhënave dhe Analizës së Riskut, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër dhe Drejtoria e Kontroleve të Pas Zhdoganimit për vitin 2022 nuk kanë bërë asnjë propozim për përditësim të vlerave referuese të mallrave të deklaruar si dhe përditësime të vlerave të shpenzimeve të transportit nisur nga deklaratimet e pranuar pranë sistemit Asycuda World të cilat rezultojnë dukshëm në rritje për kategori të ndryshme mallrash për artikuj specifik, megjithëse ka një rritje në bursat botërore të materialeve parësore që janë pjesë e lëndëve të para në procesin e prodhimit, këto ndryshime nuk janë reflektuar në përditësimet e të dhënave të Dosjes së të Dhënave të Disponueshme.

Gjatë auditimit të deklarimeve doganore të mallrave të kapitullit 25 të Kodit Doganor, u konstatua se dokumentacioni tregtar bashkëlidhur praktikave doganore për artikullin “Asfalt i ftohtë bituminoz” në sasinë totale 1,100 ton nuk jep detaje në lidhje me përqindjen e bitumit të deklaruar. Dokumentacioni tregtar nuk është i plotë, pasi nuk paraqet të dhëna cilësore të kartës teknologjike të produktit, përmbajtjes së tij dhe nuk ka prova në lidhje me sasinë e bitumit të përdorur në këtë artikull, në funksion të arkëtimit të pagesës së taksës së akcizës në shumën 5 lekë/kg, bazuar në shtojcën e ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në RSH”.

Subjekte të veçantë kanë importuar mallra të natyrës kafshë të gjalla për majmëri të klasifikuara në kapitullin 1, bazuar në kriteret dhe përcaktimet e Udhëzimit nr.2 date 03.04.2017 “Mbi procedurat e trajtimit të kafshëve të gjalla për majmëri”, por konstatohet se bazuar në pikën III “Mbikëqyrja dhe shkëmbimi i informacionit” nuk dokumentohet veprimtaria e Degës Doganore Mbikëqyrëse mbi detyrat specifike të përcaktuara si dhe nuk rezulton kryerja e veprimeve verifikuese pranë Doganave Homologe lëvruese të mallrave për faktorët thelbësorë ekonomike që kane sjellë kushtin e deklaratimit sipas kushtit KPM (përfashtim nga tarifa dhe TVSH-ja).

12. Në Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe në Agjencinë Kombëtare të Rinisë (AKR), për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri në 31.08.2022, është dhënë *opinion i pakualifikuar*. Nga AKR, për 12 projektet për organizatat të financuara, nuk janë respektuar afatet e vendosura në kontratë për disbursimin e kësteve; dokumentacioni i dosjes së aplikimit është i fotokopjuar; nga përfituesit është kërkuar shtyrje e afatit të kontratës, disa ditë para mbarimit të afatit të kontratës. Për të gjitha procedurat e projekteve për Rininë nuk ka asnjë plan monitorimi periodik me objektiva të qarta, e cila ka çuar në mungesën e një analize të hollësishme në ecurinë e projekteve të investimeve.

Nga 4 projektet e fituara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, 3 prej tyre në përfundim të afatit të kontratave nuk kishin filluar implementimin e projekteve në kundërshtim me kontratat e lidhura.

Agjencia Kombëtare e Rinisë: funksiononte mbi bazën e rregullores së brendshme e pa përditësuar; Nuk ishin lidhur kontratat individuale të punës me punonjësit e institucionit, si dhe mungonte një kontratë tip, ku të përcaktohen të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punës, si dhe mangësi dokumentacioni në dosjet e personelit.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët rezultoi se: Nuk ka ndërmarrë hapa për zhvillimin e kompetencave të rëndësishme për hartimin dhe publikimin e raporteve të vlerësimit mbi situatën e të rinjve, zbatimin e politikave, si dhe të veprimtarive rinore; nuk janë monitoruar standardet për ndërtimin e hapësirave rinore të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjtë, të parashikuara në Ligjin nr.75/2019 “Për Rininë”.

13. Në Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2017 deri më 30.06.2022, është dhënë *opinion i pakualifikuar*.

Nuk është bërë shpallja e thirrjes së parë të mbështetjes me grant sipas një prioriteti specifik. Rregullorja e grantit nuk është e emërtuar si një rregullore specifike për thirrjen e parë megjithëse në afatet e thirrjes rezulton të përfshijë vetëm vitin 2022. Rregullorja nuk përmban afate të standardizuara e gjithëpërfshirëse, të vlefshme për të gjitha thirrjet e mundshme për grant.

Procesverbalet e Komisionit me vendimet e fituesve dhe jo fituesve nuk janë shoqëruar me një relacion shpjegues si është kryer vlerësimi i fituesve mbi 80 pikë. Gjithashtu në rregulloren e grantit nuk ka një parashikim mbi një përqindje apo shumë kundrejt totalit të parashikuar për tu shpërndarë në këtë thirrje midis dy kategorive startup apo lehtësues, megjithëse konstatohet se më shumë se 50%, (konkretisht 56%) të shumës së fondit të miratuar për tu shpërndarë i përket pikërisht kategorisë së lehtësuesve (dhe vetëm 44% i përket kategorisë së startup-eve).

Nga auditimi i dokumentacionit shoqëruar së çdo aplikimi konstatohet se, në shpenzimet e kërkuara dhe të miratuara nga komisioni janë përfshirë kosto për të cilat nuk ka një preventiv, ofertë apo shpenzime të mëparshme si dokumente justifikuese mbi të cilat ato janë mbështetur. Komisioni është mjaftuar vetëm me një renditje në formë tabelare të *startup-eve* dhe lehtësuesve të skualifikuar, krahas numrit përkatës identifikues dhe pikëve të caktuara për çdo aplikant.

Gjatë auditimit të regjistrimit të startup-eve dhe krahasimit të të dhënave me pasaportën e startup-it u konstatua se janë dhënë 967 pasaporta startup-i, ku 48 prej të cilave rezultojnë të kenë ose të njëjtin emër tregtar, ose të njëjtin numër regjistrimi (NUIS) në regjistrin tregtar ndërkohë që 1 prej tyre është i pajisur me pasaportë lehtësuesi. Kështu, u konstatuan se janë pajisur me nga 2 pasaporta të ndryshme 22 startup-e duke pasur të njëjtin emër tregtar, si dhe 15 startup-e me të njëjtin numër në regjistrin tregtar. Nga auditimi i regjistrimit të lehtësuesve të startup-eve konstatohet se nga 238 lehtësues, janë pajisur me pasaporta të ndryshme lehtësuesi, 5 aplikantë me të njëjtin numër identifikimi në regjistrin tregtar. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e sipërmarrjes nuk përdor aktualisht një manual të brendshëm për organizimin dhe funksionimin e këtij regjistri. Nga auditimi i regjistrimit të startup-eve dhe lehtësuesve konstatohet se ky dokument është mbajtur vetëm në mënyrë elektronike; nuk i përmban të gjitha të dhënat parësore; nuk i përmban kryesisht të gjitha të dhënat dytësore.

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e sipërmarrjes është njëkohësisht dhe Kryetar i Këshillit të startup-eve dhe Kryetar i Komisionit të vlerësimit të dhënies së granteve për mbështetjen e startup-eve. Përmbushja e detyrës së vlerësimit të fituesve apo jo fituesve pas një procesi konkurrues nga Ministri cenon linjën e raportimit të procesit të vlerësimit të projekteve inovative.

Ministria ka funksionuar pa një rregullore të brendshme të miratuar. Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurma auditimit për proceset kryesore. Nuk është hartuar dhe depozituar tek nëpunësi i parë autorizues në MFE sipas afateve ligjore në fuqi, Pyetësori i Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti Vjetor përkatës mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të kësaj njësie publike të qeverisjes qendrore. Nuk janë hartuar plane veprimi dhe raporte performance (6-mujore e

vjetore) mbi ecurinë e zbatimit të “Strategjisë për ndërveprim mes sipërmarrjes dhe institucioneve publike”.

14. Në Institutin e Gjeoshkencave, (IGJEO) për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri në 31.12.2022, është dhënë *opinion i pa kualifikuar*.

IGJEO nuk disponon laborator për kryerjen e analizave të ndryshme, në kundërshtim me përcaktimet e rregullores së Departamentit të Gjeologjisë të vitit 2022. Në strukturën e IGJEO-së mungonte një njësi e specializuar vetëm për vlerësimin e riskut dhe rreziqeve natyrore brenda fushës së veprimtarisë së Institucionit, si një nga fushat prioritare të veprimtarisë së Institutit të Gjeoshkencave. Nga verifikimi në terren rezultoi se në stacionin sizmik të Shkodrës, godina në të cilën ndodhen pajisjet është në kushte të papërshtatshme dhe mungon infrastruktura e nevojshme, e cila sjell riskun për dëmtimit të tyre, duke cenuar aktivitetin e monitorimit sizmik në vend.

Nga auditimi u evidentua se mungon një dokumentacion / regjistër mbi kontributin e dhënë nga Institucioni për doktorantët e rinj, si gjurmë mbi zbatimin e një prej drejtimeve kryesore në misionin e Institucionit. Dosjet e personelit dhe disa nga kontratat e rinovuara nuk administrohen nga IGJEO, në kundërshtim me rregullores së brendshme të Institutit.

Gjatë periudhës objekt auditimi puna studimore mbi vlerësimin i Biomassës ka qenë mjaft e reduktuar nga ana e Departamentit të Hidrologjisë, studimi i së cilës është ndër objektivat e institucionit. Mungojnë të dhëna mbi zhvillimin e modeleve gjeo-informatike, e cila është një nga detyrat e Institutit referuar kuadrin rregullues në fuqi. Nuk janë kryer procedurat e inventarizimit fizik të pasurisë për stacionet sizmike, hidrologjike dhe meteorologjike, pronësi e IGJEO-së.

15. Nga auditimi i institucioneve rezidenciale Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shtëpia e të Moshuarve Shkodër për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2022, është dhënë *opinion i kualifikuar*.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit, nga auditimi ka rezultuar: Në asnjë nga kontratat e lidhura për furnizimin me ushqim të të moshuarve nuk është respektuar neni 6 i kontratës “*Grafiku i lëvrimit të mallit*”. Nga dokumentacioni i dosjes se prokurimit nuk rezultoi të jenë hartuar Raport Përmbledhës për rregullshmërinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problematika të hasura gjatë zbatimit të saj.

Nga auditimi i vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm: Në urdhër shpenzimet e likuiduara për OE që kanë furnizuar me ushqim mungonin dokumentimi i rregullt (*proces verbalet*) mujore të furnizimeve me ushqim në sasi dhe vlerë të firmosur nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallit. Lidhur me zbatimin e kontratave për *blerje ushqimesh* rezultoi se komisionet e pranimit të mallit nuk kanë evidentuar cilësinë e mallrave të furnizuara, mungojnë fletë analizat dhe të dhënat e certifikuara të cilësisë së mallrave, etiketat e produktit me të dhëna mbi datën e prodhimit, peshën bruto/ neto, origjinën e prodhimit, datën e skadencës, etj. Hartimi i menues së ushqyerjes së moshuarve në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë dhe Shkodër, nuk i referohet një menuje specifike sipas normës së ushqyerjes mbështetur në kartelat mjekësore të të moshuarve duke i ndarë në grupe, në përputhje me kërkesat dietike të vendosura nga Drejtoria e Shëndetit Publik

16. Në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për periudhën e aktivitetit nga data 01.04.2021 deri më 31.12.2022, është dhënë *opinion i kualifikuar*.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit, ka rezultuar: Në furnizimin për 6 artikuj në vlerën 25,605 mijë lekë me TVSH, nuk janë zbatuar specifikimet teknike, si dhe mobiliet janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat. Nga verifikimi fizik i kryer në Spitalin A2 (Urgjenca), u konstatua se 130 shtretër pacienti me kontroll manual për vlerën 12,480 mijë lekë me TVSH, nuk janë pajisje të reja, por të përdorura. Pajisjet/shtretërit janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test raportin e fabrikës).

Për *Furnizim vendosje të pajisjes mjekësore për Spitalin e Ri “Kabineti i Endoskopisë”*, viti 2022: Pjesët përbërëse të pajisjes të paraqitura në ofertën teknike kanë ardhur në Republikën e Shqipërisë dhe regjistruar në QKBPM, secila më vete në kohë të ndryshme gjatë periudhës 2021-2022, me prodhues të ndryshëm dhe operatorë të ndryshëm, çka dëshmon se pajisja është asambluar në vend. Procesimi/mbledhja (asamblimi) në një pajisje është bërë nga një shoqëri e cila nuk e ka tagrin ligjor/teknik për ta kryer këtë asamblim.

Në prokurimin e kryer sipas kërkesë me propozim për *“F.v. kokë goditëse për pajisjen mjekësore ESWL, prodhuesi storz medical /ekuivalent”*, viti 2021, kontraktuar dhe likuiduar për vlerën 6,886 mijë lekë shkaktonte mbivendosje, rezultoi se është pagesë e dubluar, në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 5,636 mijë lekë me TVSH, kurse për procedurën e prokurimit kërkesë me propozim me objekt *“F. v kokë goditëse për pajisjen mjekësore ESWL, prodhuesi storz medical /ekuivalent”*, viti 2022, kontraktuar dhe likuiduar për vlerën 3,443 mijë lekë shkaktonte mbivendosje, (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e mirëmbajtjes në vlerën 3,074 mijë lekë me TVSH.

Investimi i godinës së Pediatriës Infektive në vlerën 26,638 mijë lekë, nuk ka arritur zgjidhjen e qëndrueshmërisë së godinës me risk të lartë mbi qëndrueshmërinë dhe integritetin strukturor në rast tërmeti. Zhvillimi i procedurës e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me objekt *“Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore për përbalimin e nevojave ekstreme, deri në lidhjen e kontratës bazë të procedurave konkurruese me të drejtë shkëputje pa pasoja për autoritetin kontraktor me fond limit në vlerën 61,002 mijë lekë pa TVSH, ka ardhur si pasojë e mos kushtimit të vëmendjes së duhur institucionale.*

Në të gjitha procedurat e prokurimit për periudhën objekt auditimi, për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, blerjen e pajisjeve mjekësore dhe barnave, është vendosur kriteri favorizues i kualifikimit: autorizim nga prodhuesi.

Për *mirëmbajtje full-risk të pajisjeve mjekësore*, AK, para shpalljes së procedurave nuk ka hartuar planin e mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore për çdo vit, plan i cili duhet miratuar nga komiteti mjekësor, për faktin se numri i pajisjeve për nevoja mirëmbajtje është i madh dhe nuk mbulohen nga fondet e QSUNT-së.

17. Në Avokaturën e Shtetit për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2022, është dhënë *opinion i pamodifikuar.*

Për proceset gjyqësore të përfunduara në GJEDNJ dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar, nga të cilat kanë rezultuar detyrime e pagesa të fondeve të buxhetit të shtetit, si dhe penalitete për mos likuidimin e detyrimeve në afatet e parashikuara, mungon një analizë e çështjeve gjyqësore të humbura nga ana e institucioneve shtetërore pjesë e këtyre proceseve dhe nga Avokatura e Shtetit;

Në lidhje me çështjet në proces gjyqësor në Arbitrazhin Ndërkombëtar, efektet potenciale të tyre rezultojnë të jenë, tre raste me dëm të mundshëm për buxhetin e shtetit në vlerën 160,224 mijë Euro, dhe 2,788 mijë lekë, si dhe një me të ardhura të mundshme potenciale të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 2,405 mijë Euro dhe 14,630,050 mijë lekë;

Në lidhje me dy çështjet e përfunduara në *Arbitrazhin Ndërkombëtar me vendim*, ku kanë lindur detyrime dhe të drejta për institucionet e shtetit shqiptar, por nuk kanë vijuar kërkesat për njohje vendimi në Gjykatën e Apelit Vendas, rezultoi përkatësisht: në një rast me efektin e dëmit të mundshëm për buxhetin e shtetit (ku palë e paditur është *“Autoriteti Rrugor Shqiptar”* me një detyrim të shtetit shqiptar sipas Tribunalit të Arbitrazhit në vlerën 44,263 mijë USD dhe 573 mijë Euro, si dhe në një rast me efektin e të ardhurave të munguara për buxhetin e shtetit (ku palë e paditur është *“Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”* me një detyrim të palëve të treta sipas Tribunalit të Arbitrazhit kundrejt Republikës së Shqipërisë në vlerën 2,407 mijë Euro, 428 mijë USD dhe 107 mijë £.

Vendimet e pazbatuara të GJEDNJ datojnë që prej vitit 2015 deri në vitin 2021, ku dy prej tyre përbëjnë dhe peshën kryesore të vlerës financiare për tu përbaluar nga buxheti i shtetit, përkatësisht: Peshën më

të lartë e mban çështja “Sh... k. Shqipërisë”, mbartur prej vitit 2018, (me 75% të totalit të vlerës), e cila vijon të jetë në proces për shkak të mungesës së fondeve të buxhetit të shtetit, ku vetëm vlera e shpërblimit të drejtë të akorduar rezulton të jetë 13,447 mijë Euro, vlerë e cila pritet të shtohet për shkak të interesave; Çështja “D... k. Shqipërisë” mbartur prej vitit 2015, vijon në proces pritje të miratimit të VKM-së ku vetëm vlera e shpërblimit të drejtë të akorduar rezulton të jetë 16 mijë Euro, vlerë e cila pritet të shtohet për shkak të interesave.

Në lidhje me çështjen e iniciuar në vitin 2017, me nr.22676/ GR “GBC Oil” dhe palë të paditur MIE, AKBN dhe Albpetrol sh.a., vendimi i arbitrazhit është lëshuar më datë 06.07.2020. Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.49 datë 04.05.2021 në dispozitivin e tij urdhëron që MIE dhe AKBN duhet ti paguajë paditësit 12,557 mijë USD si dëmshpërblim për shkeljen e detyrimeve, po ashtu urdhëron që të paditurit të paguajnë shumat prej 292 mijë USD dhe 14 mijë EURO, me interes me normën 5% që nga data e këtij vendimi deri sa të bëhet pagesa e plotë. Totali i interesave të pagueshme deri në 31.12.2022 sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit rezulton të jenë 1,042 mijë USD; 24 mijë USD; 2 mijë Euro, që i shtohen vlerës së principalit të vendosur në vendimin e arbitrazhit.

Nga auditimi u konstatua se, pranë GJEDNJ-së janë edhe 30 çështje me statusin “Kërkesa në shqyrtim, por pa vendim”, ku praktika më e hershme daton prej vitit 2011, për të cilat Gjykata nuk është shprehur ende. Vlera ekonomike sipas pretendimit të palëve paditëse rezulton të jetë rreth 151,915 mijë Euro dhe 115,300 mijë ALL, por këto vlera mund të jenë të ndryshueshme në varësi të ecurisë së çështjes në gjykim, rast pas rasti.

Nga auditimi i praktikave lidhur me ato çështje ku në vendimet e formës së prerë të nxjerrë nga GJEDNJ është akorduar shpërblim i drejtë me vlerë principali *mbi vlerën 10,000 Euro*, e rrjedhimisht pagesa e të cilave ekzekutohet përmes nxjerrjes së një VKM përkatëse pas njoftimit nga ana e Avokaturës së Shtetit, rezultoi se, *për 5 nga 6 çështjet e trajtuara, këto ekzekutime janë kryer me vonesë dhe me impakt financiar në trajtën e interesave të shkaktuara nga vonesat e likuidimeve.*

Nga auditimi i ekzekutimit dhe shlyerjes së detyrimeve që rrjedhin nga Arbitrazhi Ndërkombëtar rezulton se, sipas Raportit Vjetor për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2022, të hartuar nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë:

Qeveria ka regjistruar totalin e detyrimit fillestar më 1.1.2022 për 12 institucione shpenzuese, në vlerën 192.6 milionë Euro; detyrimet e faturuara janë për 62,6 milionë Euro; Likuiduar gjithsej 18,2 milionë Euro, *(nga e cila, pjesa e likuiduar gjatë vitit 2022 është vetëm 7,9 milionë Euro)*; detyrimi i mbetur 63 milionë Euro; detyrimet kontigjente janë vendosur për 111 milionë Euro, duke arritur në totalin e detyrimit të mbetur dhe kontigjent *(së bashku)* për 174 milionë Euro, gjë që tregon për një nivel shumë të lartë të këtyre detyrimeve me impakt ndaj buxhetit të shtetit.

Nga ana e MFE-së në këtë raport është vendosur shënimi se, *“informacioni bazohet në të dhënat më të fundit maj 2023, të raportuara nga Avokatura e Shtetit dhe Ministrinë e Linjës/ institucionet buxhetore. Për pasojë, vlerësimet tona janë të sakta për aq sa informacion disponojmë. Tagrin për validimin e tyre e ka vetëm Avokatura e Shtetit”.*

Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhënave për totalin e detyrimit të mbetur/faktik dhe kontigjent për vendimet e Tribunalit të Arbitrazhit, sipas Raportit të Mesvitet të Buxhetit, ato evidentohen për 161,938 mijë Euro, ndërsa më datën 31.12.2022 për 173,914 mijë Euro, ose me një rritje prej 11.976 mijë Euro.

Në vlerësimin e grupit të auditimit të KLSH-së, në përlllogaritjen e kontigjencave nuk janë përfshirë interesat e pagueshme në vlera të konsiderueshme pas njohjes së vendimit nga Gjykata e Apelit, por që rezultojnë të jenë pjesë e stokut të detyrimeve të papaguara në ngarkim të buxhetit të shtetit.

b. Nga auditimi u konstatua se, mes të dhënave të vendosura në dispozicion nga Avokatura e Shtetit dhe atyre të pasqyruara në raportin vjetor mbi zbatimin e buxhetit të shtetit, publikuar nga MFE për vitin 2022 rezultojnë mospërputhje në totalin e vlerës së detyrimit faktik më 31.12.2022 nga vendimet e GJEDNJ-së (për 31 mijë Euro). Më konkretisht:

“Detyrimet faktike nga vendimet e GJEDNJ-së (në Euro)” sipas ASH rezultojnë për 17,912 mijë Euro, ndërkohë në raportin e MFE-së (*raporti zbatimit të buxhetit të shtetit 2022, fq. 59*), janë evidentuar për 17,880 mijë Euro, me një diferencë prej 32 mijë Euro, (si rrjedhojë e mos pasqyrimin në raportin e MFE-së të dy vendimeve, konkretisht “Prizreni k. Shqipërisë” me vlerë 14 mijë Euro dhe “Strazimiri k. Shqipërisë” me vlerë 18 mijë Euro, të cilat janë likuiduar më datën 26.1.2023 dhe nga MFE janë konsideruara të likuiduara gjatë vitit 2022).

Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhënave për totalin e detyrimit të mbetur/faktik dhe kontigjent për vendimet e GJEDNJ, sipas Raportit të Mesviti të Buxhetit të MFE, ato evidentohen për 21,796 mijë Euro, ndërsa me 31.12.2022 për 21,717 mijë EURO, ose me një pakësim prej vetëm 79 mijë Euro.

Procesi i arbitrazhit, i regjistruar me nr. “ICSID ARB/14/26” ka përfunduar me Vendimin e Tribunalit të datës 3 mars 2020, i cili i ka dhënë të drejtë pretendimeve të RSH dhe ka rrëzuar të gjitha kërkesat e paditësve. Kjo çështje ka përfunduar në Arbitrazh Ndërkombëtar me vendim, por nuk ka ende asnjë kërkesë për njohje vendimi në Gjykatën e Apelit Vendas. Detyrimi i vendosur nga Tribunali i Arbitrazhit është në vlerën e 2,407 mijë Euro; 427 mijë USD dhe 107 mijë £. Si pasojë e mosveprimit në kohë nga autoritetet shtetërore si palë të interesuara, për njohje të vendimit nga Gjykata e Apelit, nuk janë arkëtuar për llogari të buxhetit të shtetit shumat prej 2,407 mijë Euro; 427 mijë USD dhe 107 mijë £.

18. Në Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ), për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 30.09.2023, është dhënë *opinion i pakualifikuar*.

Struktura organike e KLGJ-së nuk është plotësuar sipas planit vjetor të pranimit. Në 13 raste, Këshillat e Gjykatave kanë miratuar strukturat jo sipas përcaktimeve me ligjin Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” si dhe VKM Nr. 893, datë 17.12.2014, pasi janë krijuar sektorë nën minimumin e punonjësve të parashikuar nga ligji.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit, grupi i auditimit ka konstatuar se: Në prokurimet e zhvilluara, në hartimin e dokumenteve të tenderit AK/KLGJ nuk ka argumentuar në mënyrë të qartë vendosjen e kriterëve të veçanta, lidhur me kapacitetin teknik. Mungon dokumentacioni mbi analizën e planifikimit të nevojave si pjesë e dosjes së tenderit si dhe gjurma e botimit nga APP/ Gazeta Zyrtare të Bashkimit Evropian, për tenderat mbi kufirin e lartë monetar. Nga AK nuk janë shqyrtuar sugjerimet e koordinimit APP-së në lidhje me DT dhe nuk ka gjurmë të dokumentacionit në dosje, pasi AK nuk është shprehur nëse janë marrë në konsideratë ato duke bërë rregullimet e nevojshme në DT si dhe publikimin e tyre.

Mungon dokumentacioni mbi analizën e shkaqeve të anulimit të procedurës nga AK. Nga ana Drejtorisë së IT/KLGJ, nuk është bërë mbikëqyrja për përdorimin e sistemeve IT në të gjitha gjykatat, por vetën në ato raste kur ka patur problematika kjo me kërkesë nga gjykatat, pasi nga QTI nuk është miratuar akoma udhëzuesi mbi procesin e kryerjes së mbikëqyrjes në gjykata.

19. Në Ministrinë e Kulturës, në lidhje me auditimin e projektit “Parku i Artit” për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2022, nga auditimi i përputhshmërisë me drejtim të veçantë, është arritur në *konkluzionin* se:

Projekti “Parku i Artit”, nuk ka respektuar parashikimet ligjore të rregullave Europiane të PRAG (*In line with EU public procurement regulations*), kontratat për punë publike, duke tjetërsuar llojin e kontratës dhe tipin e kontratës, nga Lump-Sum (*çelësa në dorë*) në kontratë me çmim njësie, duke realizuar një përfitim shtesë të kontraktorit në vlerën 51,480 Euro me TVSH, të pa argumentuar dhe të pa mbështetur ligjërisht.

Në procedurën e prokurimit faza II, nuk është respektuar ligji nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” dhe VKM nr. 425, datë 27.05.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, i ndryshuar, duke vendosur kriterë kualifikues të cilët nuk janë në përputhje me natyrën, vlerën dhe përmasën e kontratës.

20. Në Albpetrol sh.a. për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2022, ka rezultuar me dhënien e *opinionit të modifikuar*.

Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm ka mangësi të theksuara në të gjithë elementët e tij kryesorë.

Detyrimet e koncesionarëve ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a. për energjinë e shitur/faturuar me dhe pa kontrata janë në shumën 1,429,616 mijë lekë, nga e cila kamatëvonesë për mos pagim në afat për vlerë 1,583,865 mijë lekë. Nga ana e saj, ka vijuar me pagesat sipas akt-marrëveshjes për pagesë me 24 këste të detyrimeve, duke paguar në mënyrë të padrejtë dhe për detyrimet e koncesionarëve.

Gjithashtu, shoqëria nuk ka marrë masa shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve të energjisë elektrike të konsumuar nga shoqëritë koncesionare. Ky veprim përben risk të lartë për shoqërinë me efekt financiar në shumën 3,013,481 mijë lekë së bashku me kamatëvonesat, pasi në rast falimentimi ose largimi të ndonjë prej shoqërive koncesionare detyrimet për energjinë i mbeten për likuidim kësaj shoqërie, gjë e cila bëhet akoma dhe më e vështirë për ato shoqëri koncesionare që nuk kanë kontratë shitje energjie për të kërkuar në gjykatë detyrimet, duke rënduar situatën financiare të shoqërisë Albpetrol sh.a..

U konstatuan shpenzime të cilat kanë sjellë efekte negative financiare në buxhetin e shoqërisë në vlerën 118,939 mijë lekë, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e vendime gjyqësore për largime nga puna të punonjësve në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, për shpërblime dietash me vlerë më të madhe se kufijtë e lejuar ligjorë, si dhe persona të punësuar mbi strukturën e aprovuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Kryerja e shpenzimeve për shpërblim e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në shumën 6,371 mijë lekë, në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit.

Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a., nuk janë marrë masat për një vlerësim real të gjendjes së *“Llogari të pagueshme tregtare” (Furnitorët)* në vlerën 10,043,406 mijë lekë në të cilat janë të përfshira dhe llogari kreditore të subjekteve të cilët kanë kaluar afatin më shumë se 10 vite. Aktualisht prej disa viteve ka kaluar afati i parashkrimit të detyrimeve, nuk ekziston asnjë kërkesë e subjekteve kreditore për shlyerje detyrimi dhe njëkohësisht është parashkruar afati për tu kërkuar në rrugë gjyqësore. Për më tepër qendrat nuk zotërojnë dokumentacionin provë për detyrimin e lindur, si dhe nuk janë vlerësuar risqet për pagesat e kreditorëve në afat për të shmangur kamatëvonesat apo penalitet të cilat rëndojnë rezultatin e shoqërisë

Mos kryerja e veprimeve nga ana e shoqërisë për realizimin e procedurës së nxjerrjes së jashtë përdorimit të makineri e pajisje, mjete transporti dhe pajisje zyre dhe informatike të 2214 copë makineri e pajisje, mjete transporti dhe pajisje zyre dhe informatike me vlerë të mbetur 96,264 mijë lekë.

Kryerja e pagesave për kompensimin ushqimor në kundërshtim me VKM nr. 68, datë 7.2.2018 *“Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfutur në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”*, me efekt negativ në buxhetin e shoqërisë për vlerën 170,093 mijë lekë.

Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a., nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e *“Llogarive të arkëtueshme tregtare”* në vlerën 13,174,589 mijë lekë.

Është kërkuar kamatëvonesa për pagesat e Bankers Petroleum Albania LTD në vlerën 175,458 mijë lekë, kur detyrimi që Albpetrol ka ndaj FSHU sha, për kontratat përkatëse për kamatëvonesa është 1,356,346 mijë lekë. Vlera 1,180,888 mijë lekë përbën shpenzime jo të pa justifikuar nga Albpetrol sh.a..

Kontraktori “Bankers Petroleum Albania” LTD. ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Albpetrol ka kryer auditet vjetore dhe rezultatet e tyre në vite janë kontestuar nga Bankers dhe janë çuar për gjykim në Gjykatën e Arbitrazhit. Albpetrol ka

kryer auditin në vitin 2021 dhe ka rezultuar se *vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperushme për vitin 2020 për Bankers Petroleum Albania LTD është 2,913,868 USD.*

Kontraktori “Anio Oil & Gas” sh.a. ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen, e cila sipas auditit vjetor në 2021 ka rezultuar në *vlerën totale të kostove që nuk njihen si të rikuperueshme për vitin 2020 në shumën prej 71,306.21 USD.*

Delvina Gas Company LTD ka detyrim ndaj Albpetrol sh.a., për gaz natyror për llogari të Prodhimit Para Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën nga data efektive deri më 31 Dhjetor 2022, për vendburimin Delvinë Gaz në vlerën 1,443,000 USD, e cila përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.

Detyrimi që shoqëria “Bankers Petroleum Albania” Ltd ka ndaj Albpetrol sh.a. në naftë bruto për llogari të PPE dhe PPA për periudhën nga data efektive deri me 31.12.2022 është 78,915.002 ton naftë bruto, me vlerë 39,247,000 USD. Këto veprime kanë sjellë ulje të të ardhurave nga kompania Albpetrol për sasinë e naftës bruto e cila nuk është tërhequr për pamundësi depozitimi.

Detyrimi që shoqëria “Anio Oil & Gas” sh.a. ka ndaj Albpetrol sh.a. në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjendje në vendburim, për periudhën nga 02.05.2018 deri më 31.12.2022 është 29,103.96 ton naftë bruto, sasi e cila në se do të shitej më 31.12.2022, do të përfitohej shuma 14,476,000 USD, e cila përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.

Nuk është kryer inventarizimi i plotë i aktiveve afatgjata dhe detyrimeve për periudha 2021 e 2022, duke mos kryer verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre.

Nga auditimi u konstatua se shoqëria në regjistrat e saj ka materiale të cilat janë stok ose me qarkullim të ngadalshëm për shkak të ndryshimit të teknologjisë apo kalimit të afatit të skadencës në vlerën 1,306,029 mijë lekë për të cilat shoqëria ka njohur zhvlerësime vetëm për vlerën 137,487 mijë lekë në periudha të mëparshme, pra sipas SNK 2 “Inventarët”, duhet të njihen dhe të pasqyrohen në kontabilitet për vlerën më të vogël.

Janë konstatuar mangësi në emërimet e punonjësve, lëvizje paralele dhe largime të tyre pa procedurë të rregullt.

Janë konstatuar shpenzime për karburant në vlerën 3,320,276 leke për të cilat mungon dokumentacioni justifikues, si dhe shpenzime të tjera për këtë zë në vlerën 2,126,154 lekë për drejtoritë e administratës qendrore, për të cilin edhe pse ka një miratim për kuotën e shpenzuar, dokumentacioni justifikues i shpenzimit nuk është i plotë.

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë nuk ka krijuar komitetin për përcaktimin e standardeve për emërimin e Administratorit nga Asambleja e Përgjithshme, për përcaktimin e skemës së shpërblimit individual të administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, si dhe për kontrollin financiar. Për periudhën e audituar janë emëruar katër administratorë, por në asnjë rast nuk është nënshkruar kontratë pune midis Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit të shoqërisë.

Janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP-së, gjithsej 13 procedura me fond limit 968,140 mijë lekë ose 82.7% e procedurave të audituara, shkelje të cilat kanë konsistuar në:

Në aplikimin e kritereve jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën, veprime të cilat kanë çuar në mospjesëmarrjen e OE në garë dhe mos përdorimin me efektivitet të fondeve të prokuruar, evidentuar kjo në 10 procedura.

Në shpalljen fitues të OE me kritere të paplotësuara sipas kërkesave të DST-së, evidentuar kjo në 12 procedura me fond limit 318,476 mijë lekë, nga e cila me efekt financiar 3 procedura me vlerë 10,365 mijë lekë.

Në mos llogaritje të saktë të fondit limit në përputhje me aktet ligjore, evidentuar kjo në 1 procedura, veprime me efekt negativ në buxhet për vlerën 521 mijë lekë.

Në mos zbatimin e kushteve të kontratës, evidentuar kjo në 5 procedura, veprime me efekt financiar me dëm ekonomik në shumën 13,651 mijë lekë.

21. Në ARRSH, për periudhën e aktivitetit nga data 01.10.2020 deri më 31.12.2022, është konkluduar me dhënien e *opinionit modifikuar*.

Vendosja e metodës së vlerësimit e cila nuk është në përputhje me nevojat e investimit nuk ka rritur eficiencën dhe efikasitetin e procedurave, nuk ka arritur të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale, nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë si dhe nuk ka nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë për të gjitha procedurat e prokurara;

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi, duke ju referuar vendimeve të Gjykatave, ARRSH rezulton të jetë palë debitorë në 18 raste me subjekte të ndryshme në vlerën 373,116 mijë lekë. Në dy nga këto raste, nga ana e debitorëve është vendosur urdhër sekuestro në llogaritë e Thesarit me vlerën 41,943 mijë lekë. Sa më sipër, situata e krijuar lidhur me detyrimet ndaj palëve të treta dhe urdhër sekuestrot e llogarive të Thesarit, rrezikojnë performancën e ARRSH-së, përmbushjen e funksioneve primare, pagesën e punonjësve e të detyrimeve të tjera, në kushtet e bllokimeve të vazhdueshme të llogarive të saj, gjë e cila mund të rezultojë në pezullim të detyrimeve operacionale.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezultoi se janë përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet fonde në shumën prej 104,130 mijë lekë pa TVSH si dhe janë përfutur tepër nga ana e sipërmarrësve të kontratave si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shumën totale prej 12,132 mijë lekë pa TVSH.

22. Në OSHEE sh.a., për periudhën e aktivitetit nga data 01.07.2020 deri më 31.12.2022, është dhënë *opinion i modifikuar*.

Janë konstatuar mangësi në vendimmarrjen e Këshillit Mbikëqyrës dhe të strukturave drejtuese të shoqërisë, me efekte negative financiare për shoqërinë, gjithsej në shumën 1,033,051 mijë lekë, konkretisht:

Nga auditimi mbi zbatimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore për blerjen e energjisë elektrike është konstatuar se, nga 10 subjektet e Prodhimit me Përparësi të Energjisë (PPE) të cilët prodhojnë energji elektrike të rinovueshme nga centralet fotovoltaike, bazuar në kapacitetin 2MW, miratuar në kushtet kontraktore me Autoritetin Kontraktor (dokumentacionit financiar nga shoqëria OSHEE GROUP sh.a.(FTL sh.a.) dhe sipas treguesve të programit PVGIS, duke ju referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihen këto centrale e prodhimit të operatorëve ekonomike, rezulton se këta subjekte kanë prodhuar me tepër energji se sa është kapaciteti i tyre prej 2MW, përcaktuar në kushtet kontraktore, gjithsej në sasinë 23,568,327 kWh, me efekte financiare për shoqërinë në shumën 2,356,730 Euro.

Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën e audituar rezultoi se, punonjësit e OSHEE Group sh.a. trajtohen me dietë ushqimore jo sipas përcaktimeve ligjore. Nga përlllogaritjet e bëra sipas listë-pagesave të periudhës korrik 2020 – dhjetor 2022 rezulton se, janë përfutur gjithsej nga punonjësit shuma 1,878,988 mijë lekë, nga vlera 1,127,393 mijë lekë që duhej të ishte, pra është paguar më tepër shuma prej 751,595 mijë lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.

Nga auditimi konstatohet se në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën 18,797 mijë lekë, si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Për periudhën objekt auditimi, janë humbur dhe janë në proces gjykimi 56 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë, në vlerën 63,843 mijë lekë, si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Në total, për periudhën objekt auditimi është paguar si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera 82,640 mijë lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.

Janë dhënë shpërblime për punonjësit e OSHEE-së, bazuar në vendimet e asamblesë së përgjithshme edhe se shoqëria ka rezultuar me rezultat financiar negativ (pra me humbje), dhe shpërblimi për një kategori punonjësish është dhënë dy herë brenda një viti, për rrjedhojë vlera prej 189,166 mijë lekë konsiderohet efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.

Në procedurën e prokurimit: “*Rikonstruktion i linjës 35kV Korçë - Bilisht*” është konstatuar pasaktësi në përlllogaritjen e fondit limit dhe mangësi në përzgjedhjen e llojit të kontratës. Përlllogaritja e fondit limit është bërë e përgjithshme për punimet që do të realizohen, por në dokumentet e tenderit preventivi është konceptuar me çelësa në dorë. Të gjitha projektet dhe detajet do të jenë *subjekt i aprovimit nga Investitorit*. Investitori ka të drejtën t’i kërkojë kontraktorit, pa kosto shtesë, për çdo ndryshim në projekt dhe detaje, të nevojshme për ta realizuar objektin konform kushteve të kontratës. Ofertuesi duhet të ofrojë sasi të në përputhje me formularin e çmimeve. Këto sasi janë vlerësuar për qëllime tenderimi, të bazuara në projekt idenë paraprake. Verifikimi i sasive nga Drejtoria e Tensionit të Lartë do të bëhet gjatë fazës së projektimit të detajuar dhe janë subjekt i miratimit nga Investitorit. Kontraktori duhet të vendosë sasi të nevojshme bazuar në projektin e tij final të miratuar. Referuar sa më sipër, konstatohet se nga AK është hartuar një projekt ide, duke mos përcaktuar saktë fondin limit të kontratës. Parashikimi i projektimit për realizim nga kontraktori, si dhe përcaktimi kontratë me çelësa në dorë ndërkohë që projektimi duhet të prokurohet nga autoriteti kontraktor, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, neni 26, pika 1.b. Në preventivin e punimeve është përfshirë pagesë për realizimin e projektit të zbatimit. Nga ana e Kontraktorit është parashikuar për projektimin vlera 9,650 mijë lekë, e cila nuk disponon analizë bazuar VKM 354 datë 11.05.2016 “*Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*”. Projektit të detajuar inxhinierik në vlerën 9,650 mijë lekë pa TVSH vlerësohet si efekt negativ ekonomik dhe në kundërshtim me parimet e efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit, pasi nga OSSH sha, për projektin mund të shfrytëzoheshin kapacitetet inxhinierike e profesionale të specialistëve të “*Sektorit të Projekteve*”, të cilët kanë detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara konform rregullores së brendshme të institucionit, ku deri më periudhën aktuale projektet hartoheshin nga specialistët e zyrës së projektimit.

Mos respektim të detyrime kontraktore në zbatimin punimeve të ndërtimit, duke shkaktuar dëm ekonomik për shoqërinë në shumën 9,832 mijë lekë;

Mangësi në mbajtjen e evidencës kontable dhe auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë, si dhe mangësi në administrimin e aseteve.

23. Në KESH sh.a., për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2022, është konkluduar me dhënien e *opinionit të modifikuar*.

Janë konstatuar: Në procedurat e shkëmbimit të energjisë elektrike shoqëruar me efekt negativ financiar me vlerë 2.774.536 Euro. Në lidhje me procesin e realizimit të shërbimit të automjeteve shpenzime pa ekonomicitet me vlerë 156,545 mijë lekë. Në pagesat për trajtim ushqimor konsideruar me shpenzime pa efektivitet me vlerë 68,008 mijë lekë. Në zërin shpërblime konsideruar shpenzime pa efektivitet me vlerë 64,702 mijë lekë. Në lidhje me krijimin e fondit për pension profesional, me efekt negativ financiar me vlerë 21,159 mijë lekë.

Procese gjyqësore të humbura për largime nga puna pa shkaqe të përligjura shpenzime pa efektivitet me vlerë 4,186 mijë lekë.

Mangësi në përlllogaritjen e fondit limit në procedurat e prokurimit shoqëruar me shpenzime pa ekonomicitet me vlerë 3,870 mijë lekë si dhe mangësi në zbatimin e kontratave shoqëruar me dëm ekonomik me vlerë 21,981 mijë lekë.

Mangësi në mbajtjen e evidencës kontabël dhe auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë, si dhe mangësi në administrimin e aseteve.

24. Në Posta Shqiptare sh.a., për periudhën e aktivitetit nga data 01.06.2019 deri më 31.12.2022, është dhënë *opinion i modifikuar*.

Janë konstatuar: Dëm ekonomik në shumën prej 12,975 mijë lekë pa TVSH nga të cilat: 11,990 mijë lekë pa TVSH prej mangësive në drejtim të vlerësimit të ofertave; 984 mijë lekë pa TVSH prej punimeve të pakryera në fakt.

Përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet i fondeve në shumën prej 262,505 mijë lekë pa TVSH nga të cilat: 154,938 mijë lekë pa TVSH prej mangësive në drejtim të leverdishmërisë për investime; 47,500 mijë lekë pa TVSH prej mos vënies në përdorim të investimit; 44,572 mijë lekë pa TVSH prej mangësive në drejtim të përcaktimit të vlerës së fondit limit; 1,988 mijë lekë pa TVSH prej mangësive në drejtim të zbatimit të kontratave për punime civile; 10,302 mijë lekë prej punimeve largimeve të padrejta nga puna; 846 mijë lekë prej penaltiteteve të pa aplikuar për dorëzimet me vonesë të produkteve objekt kontrate; 9,579 euro (ose 1,197 mijë lekë) prej shpenzimeve të kryera pa dokumentacion justifikues; 1,161 mijë lekë pa TVSH prej mangësive në drejtim të administrimit të karburantit;

Posta Shqiptare nuk ka marrë në konsideratë burimet e veta njerëzore për mirëmbajtjen e pjesëve hardware dhe sistemeve të IT-së, ka zhvilluar procedura të reja për modifikimin e moduleve ekzistuese si dhe nuk ka të justifikuar për nga ana e leverdishmërisë ekonomike vënien në jetë të investimeve të reja siç është ai i për blerje bojërash teknologjike dhe lëndë pastrimi teknologjike për Hibrid Mail. Gjithashtu, nga shoqëria nuk janë marrë masa për vënien në eficiencë të investimeve për objektin “*Blerje Kuti Postare me çelës për paketa për klientë*”, për të cilën AK ka lidhur kontratën përkatëse me vlerë 47,500 mijë lekë pa TVSH dhe po njësojë për kontratën me objekt “*Blerje kuti postare restante dhe kuti postare për klientë*”, për të cilën AK ka lidhur kontratën përkatëse me vlerë 7,572 mijë lekë pa TVSH.

25. Në Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a. për periudhën e aktivitetit nga data 01.09.2018 deri më 31.10.2022, është konkluduar me dhënien e *opinionit modifikuar*.

Janë konstatuar: Këshilli i Administrimit nuk ka analizuar raportin për ecurinë e shoqërisë, raport që administratori duhet ta paraqesë një herë në muaj në këshill, si dhe nuk ka kryer verifikim dhe kontroll të llogarive vjetore të shoqërisë brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar.

Në strukturën e pagave vendosja e nivelit të pagës për secilin pozicion nuk është vlerësuar bazuar në kriteret e mirë përcaktuar si arsimimi, kualifikimi, përgjegjësia etj.

Nga Organet Drejtuese të Shoqërisë, nuk janë marr masa për të rinvegociuar kontratën/marrëveshjen me Qiradhënësin për të bërë amendimet përkatëse me qëllimin e rikuperimit të vlerës 28,330 mijë lekë për investimet e kryera por të pa kthyeshme.

Në kontratën nr. 10728 prot., datë 12.06.2019 me objekt “Marrja me qira e tokës mbi të cilën është ndërtuar depo uji me vend-ndodhje në fshatin Surrel, u konstatua një diferencë 109.5 m² duke përfituar padrejtësisht vlerën 1,545 mijë lekë.

Në procedurën e prokurimit “Zhbllokim pusetash”, viti 2022, për vlerën 19,994 mijë lekë, është përfituar padrejtësisht nga Shoqëria vlera 952 mijë lekë.

Në procedurën e prokurimit “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, viti 2019, për vlerën 99,903 mijë lekë, në preventiv nuk është pasqyruar pajisja hardware e komunikimit DCU që mundësojnë transmetimin në kohë reale në Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të të dhënave, pajisje e cila është në projekt.

Shoqëria “UKT” sh.a. për periudhën 2021, ka instaluar 4776 matës inteligjentë të ujit të pijshëm. Instalim i matësve inteligjent është realizuar pa kryer më parë, vlerësim ekonomik.

Për periudhën objekt auditimi mbetjet të tipit inerte (dhe, shtufë, materiale hidraulike, tubacione, saraçineska etj.) të cilat krijohen për shkak të ndërhyrjeve dhe punimeve në infrastrukturë të projekteve të ndryshme, depozitohen në Landfill-in e Sharrës, për të cilat nuk ka kontratë të lidhur dhe faturimi

është bërë me çmimi 800 lekë/tonë inerte (mbetje nga ndërtimet dhe prishjet) dhe 246.7 lekë/tonë për dhera dhe shtuf.

Shoqëria “UKT Tiranë” sh.a. është penalizuar në vlerën 34,992 mijë lekë nga mos zbatimi i procedurave gjyqësore po në të njëjtën vlerë, për mos respektim të afatit të ankimit në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i matjeve të enteve private që përdorin ujin si lëndë të parë”, viti 2021, në vlerën 99,903 mijë lekë, nuk është siguruar kontrata për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta, si dhe Autoriteti Kontraktor, nuk ka zgjatur periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit dhe të zbrësë koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

Nga auditimi i zbatimit të 6 kontratave për realizim dhe mirëmbajtje sistemesh, është evidentuar dëm ekonomik në vlerën 15,942 mijë lekë dhe efekt negativ financiar në vlerën 5,434 mijë lekë.

26. Projekti: Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate, në Autoritetin Rrugor Shqiptar
Në ARRSH kanë rezultuar të meta dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë që lidhen me menaxhimin e projektit:

Objektivat e përcaktuara në marrëveshjen e ratifikuar nuk janë realizuar plotësisht.

Pagesa të komisionit të angazhimit në vlerën 189,875.77 Euro mbi ato të parashikuara në marrëveshje si rezultat i vonesave në realizimin e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të projektit, me pasoja në rritjen e koston së projektit.

Në 11 raste janë konstatuar vonesa në likuidimin e situacioneve të kontratave, të cilat rrezikojnë që nga ana e kontraktorit të kërkohen interesa për vonesat referuar kushteve të kontratës. Në kontratën e konsulencës evidentohet një rritje prej 38% të vlerës së kontratës e cila ka ardhur si rezultat i shtimit të kontributeve të stafit nga mosrealizimi i punimeve rehabilituese dhe përmirësuese në vitin e pare, duke sjellë shpenzime pa efektivitet në vlerën 594,000 Euro pa TVSH.

Largime nga puna të stafit pa kryer vlerësimin e performancën së tyre duke ndjekur rrugën ligjore për largimin e tyre me kosto 92,400 Euro deri në këtë fazë të procesit të gjyqimit.

Gjithashtu është konstatuar se nga realizimi i testeve nga ana e konsulentit është përfituar më tepër vlerën prej 33,360 Euro pa TVSH.

27. Në Universitetin e Mjekësisë Tiranë nuk ka hartuar një metodologji për tarifën e programeve të studimit, ka pasur dhe vazhdon të ketë mungesë të theksuar të stafit akademik.

Është konstatuar se mungon një analizë për planifikimin e nevojave buxhetore, ekziston risku i parashikimeve të pabazuara nga ana e departamentit të menaxhimit të programeve, pasi figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në disa raste.

Rezultoni se nuk janë përdorur të ardhurat vjetore të realizuara, pasi në vitin 2020 janë trashëguar të ardhura në shumën 711,593 mijë lekë, në vitin 2021 në shumën 704,162 mijë lekë dhe në vitin 2022 në shumën 802,514 mijë lekë, e cila nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015.

Në FSHMT, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në shumicën e rasteve nuk ka dokumentacion të plotë justifikues lidhur me evidentimin e shpenzimeve të karburantit.

Nga ana e UMT-së, nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme, si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast.

Gjatë periudhës objekt auditimi rezultoni se ka 24 anulime procedurash të cilat shkojnë deri në tre herë anulim, në vlerën 216,010 mijë lekë, duke sjellë mospërdorim të fondeve si nga buxheti ashtu dhe nga të ardhurat e veta, me ndikim në realizimin e misionit të tij.

Nga auditimi i sistemeve të MFK-së në UMT, rezultoi se, nuk janë implementuar si duhet kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe veprimtaria e NJAB nuk ka qenë në përputhje të plotë me kuadrin rregullator në fuqi

28. Në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, është konstatuar se: regjistohen leje me format të vjetër, apo VNM pa raportuar asnjëherë; në 13 raste për të njëjtin instalim nga i njëjti subjekt ka dy apo më shumë leje mjedisore; në 14 raste nga komisioni i verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për miratimit të lejeve mjedisore janë miratuar kërkesa në mungesë të dokumentacionit të kërkuar ligjor; në 4 raste ka miratime të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në shkelje të procedurave ligjore; në 15 raste në kryerjen e inspektimeve ka parregullsi në konstatimin e shkeljeve dhe aplikimin e sanksioneve administrative.

29. Në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër dhe Kukës, është konstatuar se: nuk ka hartuar/plotësuar regjistrin e aktiveve; Sektori i Ujërave ka ushtruar inspektime në 57 subjekte, vetëm për pusët pa përfshirë veprimtarinë e subjektit lidhur me ujërat; Sektori i Inspektimit të Mjedisit, nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të listuar sipas ndikimeve që subjektet kanë në mjedis; për 20 subjekte të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e monitorimit/vetë monitorimit mjedisor, si dhe dokumentacion ligjor, nuk është aplikuar masa administrative në vlerën totale prej 920 mijë lekë.

30. Në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit (AKB), është konstatuar se: nuk ka korrespondencë zyrtare drejtuar Policisë Bashkiake dhe inspektoreve të taksave pranë NJQV-ve, për marrjen e masave për pezullimin e aktivitetit të pa ligjshëm dhe lirimin e hapësirave publike nga subjektet; AKB ka vendosur gjithsej 105 gjoba, në vlerë totale 13,080 mijë lekë, nga të cilat kanë likuiduar 11 subjekte me vlerë 1,660 mijë lekë dhe janë pa arkëtuar në vlerën 87,440 mijë lekë; në 5 raste, aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë për stacione plazhi janë miratuar pa certifikatat e kualifikimit të vrojtuesve; në 6 raste është shmangur kryerja e procedurave normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit.

31. Në Njësitë Administrative Dajt, Farkë dhe Zall-Herr, Bashkia Tiranë për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2019 deri në datë 30.08.2022, është dhënë *opinion i kualifikuar*:

Në 3 raste pasuritë e përfituar me anë të AMTP-së bie mbi pasuri “pyll”, që do të thotë se është pranuar kërkesa, për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, (AMTP-së) pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Dajt hartën e shkallës 1:5000 dhe librin e ngastrës para vitit 1991.

Në 10 raste, nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshat janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore për normë për frymë më shumë se sa është përcaktuar norma për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.08.1991 dhe datë 01.10.1992.

Në 5 raste, përfituesi i AMTP-së nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë bujqësore sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore, bazuar në certifikatën e gjendjes familjare të administruar në dosje.

Në 6 raste, plani i rilevimit i hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, nuk përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012.

Në 4 raste, nga ana e Njesisë Administrative nuk është verifikuar pasuria në terren por është referuar plan-rilevimit i përgatitur nga topografi me licencë, ku ky i fundit nuk ka saktësuar pasurinë sipas terrenit, por është referuar hartës kadastrale të DV ASHK Rurale.

Në 1 rast, është plotësuar AMTP “Dublikatë” nga Njësia Administrative Dajt dhe e dërguar direkt për regjistrim pa u miratuar më parë nga Sektori i AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.

Në të gjitha rastet, në dosje mungon e administruar vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.

B. Auditime financiare dhe të përputhshmërisë:

1. Në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave mbi “Kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit” për periudhën

nga identifikimi/propozimi i projektit deri në zbatimin e tij në 31.12.2022, disa prej çështjeve kryesore të konkluduara me problematika paraqiten si më poshtë:

Oferta e kërkuar për dhënie me koncesion të këtij shërbimi nuk rezulton të jetë mbështetur në prioritetet strategjike të qeverisë për periudhën në fjalë dhe nuk rezulton nëse në momentin e propozimit për dhënie me koncesion të këtij shërbimi, të jetë kryer një studim, për të parashikuar kostot respektive të mbështetjes buxhetore, apo për të identifikuar nëse ky projekt ka qenë i përballeshëm për buxhetin e shtetit, pasi nuk janë përfshirë analiza të tilla si: *kostoja e shpronësimeve; kostoja e investimit; kostot e mirëmbajtjes; kostot operative për skanimet e kryera; burimet e financimit të koncesionarit; norma e brendshme të kthimit (IRR) dhe vlera aktuale neto (NPV); argumentimi i çmimit etj.*

Vlerësimi i kryer paraqet vetëm konkluzionet, duke mos dokumentuar analizat e kryera krahas vendimmarrjes së tyre për pikëzimin e kryer; vlerësimin e skemës financiare dhe vlerës; shtuar këtu edhe afatin e tejkuluar nga data e propozimit të pa kërkuar.

Në dokumentacionin e administruar dhe shqyrtuar nga grupi i auditimit, u konstatua se mungojnë analizat nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) dhe Njesisë së Hartimit të Dokumenteve (NJHD) për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit të ofertës. Nuk rezulton të jetë analizuar sipërmarrja e koncesionarit në fazën e propozimit për kryerjen 100% skanim në fazën e vlerësimit të propozimit, apo KVO-së, për të vlerësuar lidhur me realizueshmërinë e këtij procesi.

Pavarësisht pretendimeve të ngritura fillimisht nga përfaqësuesit e ATRAKO-s se tarifimi nuk duhet të bëhet për çdo deklaratë pa marrë shërbimin, me argumentimin që nuk mund të paguhet për një shërbim që nuk merret, pasi çmimi i shërbimit është pjesë e aktivitetit sipërmarrës që do të kryejë koncesionari dhe nuk mund të jetë detyrim monetar, por të paguhet sipas deklaratave që do të skanohen; në mbledhjet e ardhshme përfaqësuesit kanë pranuar skanimin 100% të deklaratave dhe tarifimi të bëhet për çdo deklaratë.

Projekti koncesionar ka parashikuar në fazën e propozimit dhe DST-ve përpara ndryshimit, se pagesa për skanimin do të kryhet në bazë të njësive transportuese të mallit (pra për çdo mjet transporti), ndërkohë që në kontratën e nënshkruar është përcaktuar se pagesa për skanim do të kryhet në bazë të deklaratave doganore.

Kontrata e nënshkruar paraqet ndryshime të theksuara nga faza e propozimit të ofertës, deri në finalizimin e saj, të cilat kanë konsistuar në ndryshime të treguesve të paraqitur fillimisht gjatë propozimit të ofertës së pa kërkuar, apo termave të referencës të saktësuara nga ana e MFE në vijim të kërkesave për sqarim të paraqitura nga Operatorët Ekonomikë (OE).

Kontrata nuk ka parashikuar specifikisht operatorët objekt skanimi; nuk ka parashikuar formatet tip të raportimit; nuk ka përfshirë penalitete apo masa që do të ndërmerren për mos realizimin e detyrimeve të koncesionarit në lidhje me investimet, trajnimet apo angazhimet e tjera kontraktuale.

Nuk është përshtetur saktë përdorimi i konceptit të pronësisë intelektuale dhe teknologjisë sekrete, duke përbërë kështu një risk të shtuar në përfundimin e kontratës.

Mbas miratimit të ligjit nr. 123, datë 25.04.2013, kontestimeve të shumta dhe refuzimeve të bizneseve për të zbatuar këtë kontratë referuar tarifave shumë të larta të shërbimeve, është evidentuar nevoja për ndryshimin e marrëveshjes së koncesionit. Referuar skemës së financimit të kësaj kontrate me ndryshimet në ligj, koncesioni nga një ofertë e pa kërkuar pa mbështetje buxhetore, është kthyer në një kontratë koncesionare me mbështetje buxhetore, që konsiston në diferencën mes të ardhurave të gjeneruara nga pagesat e kryera për çdo tarifë skanimi në deklaratat doganore, dhe pagesës fikse të detyrimit kontraktual ndaj koncesionarit, sipas dakortësimit në kontratë.

Për këtë kontratë mbështetja buxhetore nga viti në vit referuar diferencës mes të ardhurave të gjeneruara nga aplikimi i tarifës së skanimit për çdo deklaratë, krahasuar me pagesat për çdo vend

skanimi ka rezultuar në kosto financiare shtesë për buxhetin e shtetit që variojnë në mbi 400 milionë lekë për çdo vit.

Pas miratimit të kontratës me ligjin nr. 123/2013, deri në rishikimin e saj me ligjin nr. 74/2015 dhe Ligjin nr. 118/2015, shoqëria koncesionare nuk ka vijuar punën në zbatimin e kontratës.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë kufizuar me emërimin e vetëm një menaxheri projekti, përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarisë së shoqërisë koncesionare pa përcaktuar mënyrën dhe njësinë përgjegjëse përgjatë zbatimit të kontratës.

Nga auditimi konstatohet se, nuk është kryer në asnjë rast një vlerësim se sa janë rritur të ardhurat e buxhetit të shtetit nga ky shërbim apo sa është ulur trafiku i mallrave të paligjshme, i cili ka qenë edhe objektivi fillestar i dhënies me koncesion të këtij shërbimi.

DPD në cilësinë e përfaqësuesit ekzekutiv të autoritetit në kontratë dhe autoritetit përgjegjës për aktivitetin në doganat e RSH-së, dhe MFE-së në cilësinë e autoritetit kontraktor nuk kanë realizuar mbikëqyrjen e përshtatshme për zbatimin e kësaj kontrate duke mos identifikuar problematikat e konstatuara nga auditimi:

Konkretisht, nga auditimi i realizimit të detyrimeve të shoqërisë koncesionare sipas kontratës u konstatua:

Investimi paraprak i shoqërisë sipas Planit të Biznesit të paraqitur në propozim, ishte parashikuar në vlerën 21.7 milionë Euro, i cili nuk dokumentohet të jetë realizuar në këtë vlerë dhe për më tepër nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë nga Autoriteti Kontraktor për përmbushjen e këtij detyrimi.

Zëvendësimi i detyrueshëm periodik i pajisjeve çdo 6 muaj, përkthyer në investime në vlerën rreth 7.8 milionë Euro, të parashikuar në Planin e Biznesit nga shoqëria koncesionare, nuk rezulton të jetë kryer.

Nga MFE nuk dokumentohet analiza e miratimit të përzgjedhjes së “I” sh.p.k. për shitjen e 49% të kuotave të koncesionit, duke përfshirë këtu shqyrtimin e eksperiencës së shoqërisë në fushën e ndërtimit; mirëmbajtjes së objekteve; personelit të punësuar etj, dhe se si ky partneritet do të sillte përfitime apo vlerë të shtuar për kontratën koncesionare.

Përcaktimi i vend-ndodhjes fizike të skanerit në Portin e Durrësit ka paraqitur probleme të shumta të cilat lidhen ngushtësisht me efektivitetin e shërbimit të skanerit, deri edhe me çënimin e sigurisë kombëtare pasi edhe procedurat e iniciuara nga DPD për prokurimin e shërbimit të zhvendosjes së skanerit në një vendndodhje të re të përmirësuar me fond limit 62,378 mijë lekë pa TVSH, janë në kundërshtim me pikën 5 të nenit 3 të marrëveshjes nr. 14980 prot., datë 06.09.2013 “*Për dhënie në përdorim të vendit ku do të instalohet skaneri në Degën Doganore Durrës*”.

Nuk është realizuar detyrimi për lidhjen me serverin ose switch-in lokal më të afërt të vendit të Autoritetit (me sistemin Asycuda) me qëllim transferimin e imazheve dhe analizimin e të dhënave të tyre.

Nuk u paraqit dokumentacion vërtetues mbi kryerjen e analizave me bazë fluksi dhe risku për përcaktimin e 5 pikave doganore me skaner dhe nuk janë rivlerësuar gjatë zbatimit të kontratës këto pika për të vlerësuar prioritetet ku shërbimi i skanimit do të ishte më efektiv.

Nga ana e autoritetit kontraktor në momentin e lidhjes së kontratës nuk është kryer asnjë analizë lidhur me numrin maksimal të mjeteve që mund të skanohen nga koncesionari sipas pikave doganore, krahasimisht me numrin e mjeteve që kanë qenë për skanim sipas ditëve.

Gjatë skanimit rezultati është kufizuar në përfshirjen e elementit të ngjyrës së verdhë (*dyshime të bazuara për parregullsi*), ndërkohë që në kontratë është parashikuar se rezultati i skanimit do të kufizohet në identifikimin (*ngjyra e kuqe*) ose jo të parregullsive (*pa ngjyrë*).

Raportet e shoqërisë koncesionare dhe DPD nuk paraqesin informacion mbi “*gjetjet e skanerit*”.

Nuk janë kryer raporte përmbledhëse nga degët doganore të pajisura me skaner për vlerësimin e efektshmërisë së vazhdueshme të funksionit të analizës së imazheve të R-së, përfshirë numrin e

skanimeve të kryera për çdo vendndodhje skaneri; origjinën e kërkesës referuese, p.sh: profili i riskut në Asycuda, përzgjedhje vendore, institucion tjetër; numrin e anomalive të evidentuara (me kodin e kuq dhe të verdhë); rezultatin e kontrolleve të kryera.

Përditësimet e software të përcaktuara në kontratë janë vetëdeklaruar të realizuara nga koncesionari, por autoriteti nuk ka kryer asnjë analizë të tyre, dhe Menaxheri i Projektit pranë DPD-së nuk disponon njohuritë e duhura teknike për vlerësimin e tyre.

Referuar procedurave aktuale nuk ekziston asnjë mundësi që të identifikohen gabime të skanerit, në kushtet kur nuk kryhet një verifikim i saktësisë/vërtetësisë së tij, pasi kontrolle fizike nga AD kryhen vetëm në skanimet e dyshuara për pasaktësi.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, apo DPD nuk kanë mundësuar krijimin e një sistemi që monitoron nivelet e kënaqësisë/ankesat e konsumatorëve, me qëllim mbrojtjen e interesit të konsumatorëve lidhur me sasinë, cilësinë dhe nivelin e tarifës të aplikuar për këtë shërbim.

2. Në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2022, është dhënë *opinion i kualifikuar*⁹, si për pasqyrat financiare ashtu dhe për përputhshmërinë e aktivitetit.

Detyrimet dhe vendimet gjyqësore nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por janë njohur në momentin e likuidimit. Në llogarinë 230 “*Investime në proces*” nuk janë paraqitur 8 projekte në shumën 17,373 mijë në Pasqyrat Financiare të vitit 2021. Llogaria 466 “*Kreditorë për mjete nën ruajtje*” për 7 objekte në vlerën prej 20,730 mijë lekë, evidenton shumën e fondeve që gjenden të ngurtësuara nga viti 2014, për të cilat është tejkaluar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhblllokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive.

MTM nuk ka përditësuar regjistrin elektronik për aktivet afatgjata me vlerën aktuale të aktiveve që institucioni ka në pronësi. Nga auditimi i Vendimeve gjyqësore, të formës së prerë është konstatuar se, për vitin 2022 është paguar shuma prej 8,146 mijë lekë, për ekzekutimin dhe pagesën e 9 (nëntë) vendimeve gjyqësore me detyrimin për “*Pagesë page deri në kthim në punë*” për ish punonjës të larguar padrejtësisht nga puna, për të cilët vijon pagesa.

Kriteret e vendosura dhe të kërkuara nga AK nuk janë të argumentuar dhe kanë mbivendosje. KVO ka kualifikuar OE, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT. Komisionet e marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve kanë hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim, por plotësimi i tyre është kryer duke iu referuar faturës dhe kontratës, pa një përshkrim të hollësishëm të zërave/analizave të mallrave/shërbimeve të marra në dorëzim.

Për kontratën “*Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)*” rezultuan disa pasaktësi për punime të pakryera, por të likuiduara dhe mbivendosje të zërave të punimeve në vlerën 264 mijë lekë pa TVSH.

Gjithashtu, nga verifikimi në vend-depozitimin e Bashkisë Kukës mbetjet urbane nuk depozitoheshin në të dhe nga AK nuk ka një monitorim të situatës se ku depozitohen mbetjet urbane të kësaj bashkie, pasi objekti është në periudhën e garancisë dhe nuk ka kaluar si investim kapital përfituesit. Ndërtimi i vend-depozitimit është kryer si rezultat i situatës emergjente të mbetjeve në bashkinë Kukës. Për sa më sipër vlera e investimit prej 27,921 mijë lekë pa TVSH, të kryer në vend-depozitimin në Bashkinë Kukës konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet i fondeve publike deri në këtë fazë të menaxhimit të landfillit.

⁹ Sipas Manualit të Auditimit Financiar: *Opinion i Kualifikuar/Modifikuar*, jepet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

MTM nuk ka zhvilluar proces studimi dhe planifikimi, sipas prioriteteve që ministria duhet të ketë çdo vit, Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në procesverbalet e mbajtura ndër vite nuk ka dhënë argumente në lidhje me projektet e përzgjedhura dhe të kualifikuara si fitues, nëse ato kanë impakt në planin e zhvillimit turizmit. MTM nuk ka asnjë plan monitorimi periodik me objektiva të qarta mbi këto projekte të finalizuar, e cila ka çuar në mungesën e një analize mbi impaktin që kanë pasur dhe kanë këto projekte në zhvillimin e turizmit.

Mungojnë programet specifike për trajnimin e punonjësve të administratës. Institucioni nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut, nuk janë përgatitur dhe dërguar te NA, regjistri i riskut nga drejtoritë përkatëse. Nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS, i cili duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Struktura e Auditimit të Brendshëm nuk ka funksionuar me kapacitet të plotë, pasi 2 pozicione kanë qenë të paplotësuara. Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm nga MTM, në kundërshtim me ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.

3. Në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për periudhën e aktivitetit nga data 01.04.2021 deri më 31.12.2022, është konkluduar me dhënien e *opinionit të kualifikuar*.

Nga auditimi i pasqyrave financiare, kanë rezultuar shkelje dhe parregullsi, si: Nga auditimi i llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime” rezultoi se shpenzimet prej 3,981 mijë lekë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime në momentin e ndodhjes së tyre, por janë njohur në një periudhë të më vonshme, të cilës nuk i përkasin. Shuma e raportuar e detyrimeve të prapambetura për vitin 2022 ndaj të tretëve nuk është e saktë, pasi MSHMS nuk ka njohur në kontabilitet detyrimet e vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë.

Nga auditimi analitik i Llogarisë 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”, u konstatua se në këtë llogari është kontabilizuar “Regjistri elektronik i ndihmës ekonomike” me kosto historike në shumën prej 71,400 mijë lekë, vlerë e pasqyruar gabim në këtë llogari kontabël, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të aktiveve në pasqyrat financiare të institucionit.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit, ka rezultuar se: Regjistrat e parashikimit nuk janë përgatitur, sipas afatit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore, kurse regjistrat e realizimit nuk janë të plotësuara me të dhënat për të gjithë procedurat e realizuara gjatë vitit 2022. Nga njësia përgjegjëse për SPE nuk është realizuar arkivimi i dosjeve të prokurimit në sistem, të cilat nuk janë pasqyruar as në regjistër si të realizuara. Në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim (teknikisht dhe ligjorisht). Operatorët ekonomik fitues në dosjet e vlerësuara nuk kanë paraqitur dokumente, që vërtetojnë se plotësojnë kriteret e përcaktuara në DST. Në dosjen e prokurimeve (por dhe në SPE) nuk janë administruar kërkesat e KVO-së për ofertën anomalisht të ulët/ korrigjimin e gabimeve aritmetike siç parashikohet në VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave u konstatuan pasaktësi dhe pagesa për punime të pakryera, por të likuiduara dhe mbivendosje të zërave të punimeve në vlerën 1,032 mijë lekë. Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si dhe ka mungesë në raportet të monitorimit periodik për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të saj.

4. Në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik (DSHTD), për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2022, është dhënë *opinion i kualifikuar*.

Nga auditimi i pasqyrave financiare, kanë rezultuar shkelje dhe parregullsi, si:

DSHTD nuk ka kryer inventarizimin fizik të godinave në administrim të saj dhe nuk ka përditësuar vlerat e tyre në pasqyrat financiare vjetore. Nga ana e institucionit nuk janë zbatuar normat e amortizimit për kategorinë e aktiveve në përputhje me normat e përcaktuara nga MFE.

DSHTD ka aplikuar derdhjen e 30% të të ardhurave të krijuar nga qiraja vetëm nga “*subjektet vendase*”, kur një përcaktim të tillë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhet të shtetit vlerën prej 113,694 mijë lekë.

Në kundërshtim me nenin 4, pika 1 dhe 3 të Kontratave tip me subjektet vendase nga DSHTD, për periudhën në auditim nuk janë aplikuar kamatëvonesat përkatëse për vonesa në likuidimin e qirave. Në një rast tarifa e qerasë e vendosur është më e ulët se sa nivelet e miratuara me VKD, duke sjellë të ardhura të munguara në vlerën prej 2,796 Euro dhe 48 mijë lekë etj.

5. Në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), për periudhën e aktivitetit nga data 01.04.2021 deri më 31.12.2022, është dhënë *opinion i kualifikuar*.

Nuk janë kryer procedurat për kontabilizimin e plotë, të saktë, të rregullt dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, në përputhje me udhëzimet e MFE duke mos koordinuar sistemet e kontrollit mbi kontabilizimin e detyrimeve që rrjedhin nga monitorimi i kontratave të qirasë së tokave bujqësore në administrim të MBZHR. Mungon regjistrimi në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare për periudhën 2021-2022, të tokave bujqësore që MBZHR administron, (në sipërfaqe totale 19,034 ha), duke cenuar transparencën dhe pasqyrimin e plotë të të dhënave pasurore në administrim të MBZHR. Nga 51 kontrata për tokat bujqësore të lidhura në MBZHR, deri në dhjetor 2022, 38 prej tyre ose 75% kanë detyrime nga mos pagimi i qirasë në shumën totale 64,680 mijë lekë. Për mungesë të realizimit të planit të investimit nga subjektet qiramarrës, MBZHR deri më 31.12.2022 ka vendosur penalitete në përputhje me detyrimet kontraktuale në shumën 427,045 mijë lekë. Pra shuma prej 491,725 mijë lekë përfaqëson detyrime të subjekteve palë të kontratave të tokave bujqësore në përdorim, (e përbërë nga shumatat për mos pagim qiraje dhe penalitet për vonesën në pagim në vlerën 64,680 mijë lekë deri më datë 31.12.2022 si dhe penalitete të mos realizimit të investimit në shumën totale 427,045 mijë lekë), të cilat nuk janë të kontabilizuara në pasqyrat financiare të aparatit të MBZHR.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit, u konstatua vendosja e kriterëve të pastuduara e përjashtuese nga AK, të cilat kanë sjellë pasojë përdorimin pa eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 30,247 mijë lekë pa TVSh e fondit të prokuruar.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave rezultoi: Për objektin “Rikonstruktion i godinës së QTTB Fushë Krujë dhe ndërtim godine”, nga verifikimi në terren i zbatimit të kontratës në lidhje me punimet e ndërtimit rezultoi se në 5 mujorin e parë të vitit 2023 investimi prej 67,633 mijë lekë me TVSH është krejtësisht jo efektiv dhe i pa vënë në përdorim nga ana e Ministrisë dhe QTTB Fushë Krujë, duke mos përmbushur objektivin për të cilin është ndërtuar dhe duke sjellë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondit të shpenzuar për këtë objekt. Në lidhje me zbatimin e kontratës të procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstrukcioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë”, rezultoi se nga krahasimi i zërave të situacionuar me ato të pasqyruara në librezën e masave janë përdorur pa efektivitet eficiencë dhe ekonomikitet fondet në shumën prej 745 mijë lekë pa TVSH nga buxheti i shtetit.

Dëm ekonomik në vlerën 7,591 mijë lekë pa TVSH, për 3 procedurat e prokurimit, pasi nga verifikimi në terren i zbatimit të kontratave rezultoi se, është përfituar më tepër nga ana e sipërmarrësve si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt për disa zëra punimesh.

Mungesa e një plani vjetor për monitorimin e kontratave dhe një regjistri të miratuar për kontratat e qirasë. Detyrimet vjetore të qirave të tokave bujqësore në administrim të MBZHR, të pa arkëtuara nga kontraktorët, përlllogaritur në vlerën 64,680 mijë lekë për periudhën në auditim (për 51 kontratat e lidhura).

Të ardhura të munguara nga mos arkëtimi në kohë i qirave vjetore për tokat bujqësore në vlerën totale 55,830 mijë lekë, nga strukturat përgjegjëse në MBZHR.

Nga ana e 12 subjekteve qiramarrëse të përzgjedhura për auditim në zbatimin e detyrimeve kontraktuale nga të dy palët (MBZHR dhe qiramarrës) evidentohet mos realizim i investimeve të parashikuara në plan biznes, e cila ka gjeneruar gjyba në vlera të konsiderueshme dhe pa shpresë

arkëtimi në shumën 426,029 mijë lekë, nga të cilat 82.7% e vlerës u përket vetëm 3 subjekteve kontraktues.

Nga auditimi i vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të financave publike u konstatua se: Mungonte përditësimi, inventarizimi, dhe regjistrimi i gjithë fondit të tokës bujqësore që ka në administrim MBZHR, duke bashkëpunuar dhe koordinuar punën me Drejtoritë Rajonale të Administrimit të Tokave në Qarqe dhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Në lidhje me monitorimin e kontratave nga Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të kontratave, për vitin 2022, janë monitoruar: 14 kontrata nga 51 gjithsej, ose 27 % e tyre. MBZHR nuk disponon një plan vjetor për monitorimin e kontratave, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve, nuk u gjendën raporte për çdo vit për monitorimin e kontratave.

Megjithëse janë mbajtur procesverbalet e dorëzimit, janë hasur probleme ndër vite me zaptimin e tyre nga palë të tretë pa tagra pronësie dhe për pasojë nuk ka një shfrytëzim të plotë të ngastrave të tokës të dhënë me qira. Nuk janë dorëzuar garancitë e kontratave nga ana e subjekteve, kjo në kundërshtim me detyrimet kontraktuale.

6. Në Autoritetin e Mediave Audiovizive, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2019 deri në 30.06.2022, është konkluduar me dhënien e *opinionit të kualifikuar*.

Nga auditimi i pasqyrave financiare, kanë rezultuar shkelje dhe parregullsi, si: Nuk është evidentuar vlera e ndërtesave në kontabilitet, por vetëm vlera e shpenzimeve për rikonstruksionin e tyre. Mos pasqyrim në kontabilitet i vlerës së drejtë së llogarisë 210 “*Toka troje e terrene*”, e evidentuar 0 lekë, kur vlera paraprake e përlllogaritur është 343,524 mijë lekë.

Niveli i lartë detyrimeve debitorëve të subjekteve dhe ish-subjekteve të licencuara/ autorizuara dhe subjekteve të pa licencuara/autorizuara nga AMA, dhe klientëve me trend në rritje për periudhën e audituar, përkatësisht në shumën prej 442,000 mijë lekë në vitin 2019, 450 milionë lekë në vitin 2020 janë 446,000 mijë lekë në vitin 2021 dhe 487,000 mijë lekë në fund të 6-mujorit të parë 2022.

Vendime gjyqësore të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e AMA-së, si shpenzim që nuk janë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, në vlerën prej 4,181 mijë lekë.

Nuk janë përmbushur detyrimet ligjore nga OSHMA mbi depozitimin e Pasqyrave Financiare Vjetore për vitet 2018-2021 në 36 raste gjithsej, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nuk janë aplikuar sanksionet ligjore ndaj tyre.

Nga auditimi i vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të financave publike u konstatua se:

Nuk është hartuar plani i përdorimit të frekuencave, në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave si dhe mangësi e parregullsi në zbatimin e procedurave të prokurimit me fondet publike; Mungesa e propozimeve për masa administrative, në rastet e shkeljes së detyrimeve të nenit 33, të ligjit të AMA-s nga ana e OSHMA dhe vendimmarrje në tejkalim të kompetencave ligjore të Këshillit të Ankesave;

Nuk janë marrë masat për përgatitjen dhe dërgimin në MFE të Pyetësorëve të Vetëvlerësimit, Deklaratat dhe Raportet për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Plan Veprimi për MFK. Nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk kanë gjetur zbatim detyrimet mbi hartimin e regjistrit të riskut për gjithë hallkat dhe drejtoritë e këtij institucioni publik dhe përgjegjësitë për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Riskut;

Bordi i AMA-s, në 10 (dhjetë) raste ka shfuqizuar sanksionet administrative të dënimit me gjobë, të vendosura nga grupet e inspektimit, në shumën prej 12,240 mijë lekë, që përfaqëson rreth 20 % të numrit dhe vlerës së gjobave të vendosura gjatë asaj periudhe nga grupet e inspektimit, të cilat kanë qenë të bazuara në kuadrin ligjor, rregullator të fushës, në fuqi.

Vlera prej 1.360 mijë lekë si efekt negativ financiar për fondet publike, që rrjedh prej masave administrative të marra për 4 (katër) OMSh.a., në raport me mungesën e njoftimeve në lidhje me ndryshimet e pronësisë, të cilat më pas janë shfuqizuar nga AMA, pas ankimeve të paraqitura etj

7. Në Ministrinë e Drejtësisë (MD), për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri në 31.12.2022, është dhënë *opinion i pakualifikuar*¹⁰.

Nga auditimi rezultoi se MD disponon certifikatë pronësie vetëm për godinën e Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa për godinën e Gjykatës Administrative të Apelit dhe godinën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të MD-së, kanë filluar procedurat për hartimin e planit të rievimit dhe planimetrive të zyrave, por aktualisht nuk disponohet certifikata e pronësisë. Llogaritja e amortizimit për kategorinë e aktiveve “Inventar ekonomik” është zbatuar në kundërshtim me udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”; i ndryshuar.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave rezultoi: Dëm ekonomik në vlerën 849 mijë lekë me TVSH, për një procedurë prokurimi, pasi nga verifikimi në terren i zbatimit të kontratave rezultoi se është përfituar më tepër nga ana e sipërmarrësve si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt për disa zëra punimesh.

Nga auditimi i vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të financave publike u konstatua se: mungojnë takimet e dokumentuara të veprimtarisë së GMS.

8. Në Gjykatën e Lartë, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri në 30.09.2022 është konkluduar me dhënien e *opinionit të pakualifikuar*.

Rezultoi se, raportimi i detyrimeve të prapambetura është raportuar në vlerën zero, pasi nuk janë njohur në kontabilitet detyrimet për t'u shlyer që janë në vlerën prej 1,044 mijë lekë.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit, evidentohet se: regjistrat e parashikimit nuk janë përgatitur sipas afatit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore dhe nga AK nuk janë pasqyruar në regjistrin e realizimit të gjitha kategoritë e mallrave dhe shërbimeve sipas rregullave të prokurimit publik.

9. Në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri më 30.09.2022, është dhënë *opinion i kualifikuar*.

Nga auditimi i pasqyrave financiare:

Rezultoi se nuk janë kryer procedurat e inventarizimit të plotë të aktiveve të MEPJ si dhe inventarizimi i përgjithshëm i aseteve të përfaqësive diplomatike e konsullore të Shqipërisë jashtë vendit, fenomen ky i evidentuar edhe më parë nga KLSH.

U konstatua se, nuk kryej rakordimi i të ardhurave konsullore mes MEPJ dhe Drejtorisë së Tatimeve, në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve të Jashtme nr.37, datë 31/12/2014.

Nga ana e përfaqësive diplomatike dhe konsullore, për periudhën objekt auditimi, nuk janë hartuar pasqyrat financiare individuale sipas përcaktimeve të kuadrit nënligjor mbi kontabilitetin dhe raportimin në sektorin publik. Konsolidimi i PF-së është kryer pa verifikuar zërat dhe llogaritë kontabile, por vetëm duke përmbledhur të dhënat e njësive shpenzuese të varësisë.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit:

Parregullsi në përcaktimin e kriterëve kualifikuese në procedurat e prokurimit publik si dhe në vlerësimin e ofertave në procedurat e prokurimit publik. Dosjet e procedurave të prokurimeve, për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, nuk rezultuan të arkivuara pranë sektorit të arkiv-prokollit;

Nga auditimi i vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të financave:

¹⁰ Sipas Manualit të Auditimit Financiar: *Opinion i pamodifikuar/i pakualifikuar*, audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar për besueshmërinë e llogarive kur arrijnë në përfundimin se llogaritë vjetore janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Ky opinion mund të jetë pa rezervë ose me theksim çështjeje.

Nuk është hartuar një strategji institucionale ku të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre; nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS. Nga MEPJ nuk është përditësuar dokumenti i rregullores së brendshme dhe institucioni funksionon në bazë të rregullores së miratuar me 08.06.2010.

Nga ana e strukturës nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut, regjistri i riskut si dhe nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, nuk janë plotësuar pyetësorët e vetëvlerësimit në mënyrë që të identifikohen problematikat e kontrollit të brendshëm.

Mungon dokumentimi i raportimit nga ana e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

10. Në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2017 deri më 31.12.2021, është dhënë *opinion i kualifikuar*.

Nga auditimi i pasqyrave financiare, kanë rezultuar shkelje dhe parregullsi, si:

Vlera e paraqitur në Formatin nr. 7/a të PF-së për Llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje*”, nuk përputhet me vlerën e konstatuar nga “Komisioni i Inventarizimit”, e cila rezulton 4,584,431 mijë lekë me një diferencë bruto prej 72,721 mijë lekë *më pak se vlera e paraqitur në pasqyrën financiare.*

Në Formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” nga sektori i financës, pakësimi është pasqyruar në vlerën 552,881 mijë lekë me një vlerë më shumë prej 137,725 mijë lekë, për të cilën nuk ka asnjë koment dhe dokumentacion shoqërues.

Llogaria 24 “*Aktive afatgjata të dëmtuara*” paraqitet në vlerën neto prej 36,372 mijë lekë dhe mbartet nga viti paraardhës, kurse nga inventarizimi kjo vlerë është dalë në shumën prej 30,696 mijë lekë, me një diferencë prej 5,676 mijë lekë më pak se sa është paraqitur në Formatin nr.7/a “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike).*”

Nga auditimi i procedurave të prokurimit:

Në procedurat e mirëmbajtjes AK në asnjë rast nuk ka argumentuar mënyrën e zgjedhur për përlllogaritjen e vlerës limit.

Në të gjitha rastet e audituara janë vendosur specifikime teknike të cilat nuk përshkruajnë saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke mos krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve ofertues; në një rast është bërë copëtimi i fondeve të prokuruar për vlerën prej 24,621 mijë lekë; mangësi dhe shkelje në planifikimin e fondit limit dhe veprime në kundërshtim me kriteret e vlerësimit (*në 3 procedura*); përdorim pa efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike në shumën 161,517 mijë lekë (*4 procedura*);

Nga auditimi i zbatimit të kontratave:

Dëm ekonomik në vlerën 18,441 mijë lekë, nga zbatimi i 3 kontratave për realizim dhe mirëmbajtje sistemesh. Nga auditimi i realizimit të sistemit “*Ngritja e regjistrit elektronik të ekspertëve*” me vlerë 136,000 mijë lekë me TVSH, u konstatua se: “Moduli i vlerësimit të aplikimit” nuk është si modul më vete, por pjesë e funksionaliteteve të “*Modulit të çështjeve gjyqësore*”, në kundërshtim me pikën 13.1 të TORS; Sistemi nuk ka modulet: “*Moduli i përditësimit të të dhënave dhe korrigjimit të gabimeve*” dhe “*Moduli i çaktivizimit/pezullimit/heqjes së ekspertit nga regjistri*”, në kundërshtim me pikën 13.1 të TORS; Në sistem nuk janë implementuar fushat “*gjinia*” dhe “*vendlindja*”, kjo bën që të mos gjenerohet raport mbi këto fusha, sipas kërkesave të pikës 13.1/a të TORS mbi raportet e detyrueshme të sistemit; Raportet gjenerohen vetëm në formatin PDF, në kundërshtim me pikën 13.1/a të TORS. Sa më sipër, operatori ekonomik nuk e ka realizuar kontratën sipas parashikimeve, duke mos i përfunduar të gjitha modulet dhe kërkesat. Vlera e moduleve të cilat nuk janë realizuar është 17,498 mijë lekë me TVSH dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Nga auditimi i vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të financave publike:

Institucioni ka funksionuar me rregullore të brendshme të pa azhurnuar duke qenë se struktura dhe organika e institucionit ka pësuar ndryshime; nuk ka hartuar Kodin Etik; nuk është ngritur grupi i

menaxhimit strategjik dhe nuk ka kryer takimet periodike; nuk janë hartuar gjurmët e auditimit si dhe nuk janë hartuar raportet e monitorimit periodik të buxhetit të AKSHI-t.

11. Në Bashkinë Mirditë për periudhën e auditimit financiar për vitin 2022 dhe për auditimin e përputhshmërisë nga data 01.10.2018 deri në datë 31.12.2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare është dhënë *opinion i pamodifikuar*. Referuar analizës së gjendjes së aktiveve me vlerën e tyre bruto prej 2,506,661 mijë lekë të llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksiione”, u konstatuan aktive jashtë funksionit, të cilat duhet të kalojnë në llog. 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, për vlerën 13,008 mijë lekë që i përkasin 10 zërave të aktiveve të konstatuara të dëmtuara. Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë rezultoi se, parregullsitë janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një *opinionit të modifikuar*. Kështu, nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2018-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 11 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim dhe në 9 raste, kualifikimi i OE-së të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST.

12. Në Bashkinë Roskovec për periudhën e aktivitetit të vitit 2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare është konkluduar me *opinion të modifikuar*. Në gjendjen e llogarisë. 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë përfshirë detyrimet që rrjedhin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 21,845 mijë lekë për 758 persona, si dhe nuk janë përfshirë gjobat e vendosura nga IMT –ja dhe Policia Bashkiake në vlerën 1,043 mijë lekë të akumuluar në fund të vitit ushtrimor 2022, vlerë e cila nuk është kontabilizuar.

Nga analiza e llogarisë 202- *Studime dhe kërkime*, rezulton se për 21 projekte Drejtoria e Financës nuk ka bërë përpjekje për sistemin e veprimit kontabël të llogarisë, duke ia bashkëngjitur vlerës së projektit çka ka sjell një mbivlerësim të llogarisë në vlerë neto 10,868 mijë lekë.

Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së kësaj bashkie ka rezultuar se, parregullsitë janë materiale por jo të përhapura dhe justifikohet dhënien e një *opinionit të modifikuar*. Bashkia Roskovec nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Nuk janë marrë masa të plota për uljen e detyrimeve të prapambetura. edhe pse janë likuiduar gjatë vitit buxhetor detyrime të prapambetura, nga ana tjetër edhe gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura, duke çuar në 31.12.2022 vlerën e tyre, me burim financimi të ardhurat e veta në 49,880 mijë lekë.

Janë konstatuar anomali në hartimin e kriterëve të veçanta të DST në procedurat e prokurimit publik, pasi janë vendosur kriterë të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën dhe madhësinë e kontratës.

13. Në Bashkinë Vlorë me për periudhën e aktivitetit nga data 01.07.2021 deri në datë 31.12.2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2022 është dhënë *opinion i modifikuar*.

Për 52 projekt-studime për investime të kryera gjatë viteve për vlerën 115,857 mijë lekë, nuk është bërë shpërndarja sipas llojit të aktiveve materiale. Gjithashtu vlera prej 9,812 mijë lekë e emërtuar “Të tjera”, nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.

Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksiione” konstatohet se janë kontabilizuar gabim 21 aktive materiale në vlerën 139,985 mijë lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 83,080 mijë lekë, llog. 210 “Toka, troje, terrene” në vlerën 56,904 mijë lekë.

Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, konstatohet se janë kontabilizuar gabim 31 artikuj aktive materiale në vlerën 76,464 mijë lekë, që nuk i përkasin

klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 202 “*Studime e kërkime*” në vlerën 887 mijë lekë, llog. 210 “*Toka, troje, terrene*” në vlerën 42,144 mijë lekë, llog. 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” në vlerën 22,735 mijë lekë, llog. 214 “*Instalime teknike makineri e pajisje*” në vlerën 10,696 mijë lekë. Gjithashtu vlera prej 37,387 mijë lekë e emërtuar “*Të tjera*”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.

Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Bashkisë Vlorë, anomalitë dhe parregullsitë janë materiale dhe të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një *opinionit të kundërt*.¹¹

Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.07.2021 – 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), kanë rezultuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, si në aplikimin e kriterëve të paargumentuara me tipologjinë e procedurës, po ashtu dhe në shpalljen fitues të OE/BOE të cilët nuk janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST-së të miratuara nga AK.

Nga mos menaxhimi i mirë të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, si në planifikim dhe arkëtim, duke evidentuar të ardhura të munguara. Gjithashtu në dhënien e lejeve të ndërtimit janë konstatuar shkelje në lidhje me respektimin e distancave, dokumentacionin teknik/ligjor, etj., si dhe nuk janë marrë masa për regjistrimin e pronave të Bashkisë kaluar me VKM në pronësi të saj.

14. Në Bashkinë Vorë, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2022 deri në datë 31.12.2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2022 është dhënë *opinion i modifikuar*.

Llogaria nr. 202 “*Studime dhe kërkime*”, është pasqyruar më pak për vlerën 101,503 mijë lekë;

Llogaria nr. 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*”, është pasqyruar më shumë për vlerën 56,077 mijë lekë;

Llogaria nr. 212 “*Ndërtesa dhe konstruksione*”, është pasqyruar më pak për vlerën 547,392 mijë lekë;

Llogaria nr. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, është pasqyruar më pak për vlerën 3,658,587 mijë lekë;

Nga ana e Bashkisë Vorë është bërë pakësimi i aktiveve pa u bërë procedurat e asgjësimit të tyre.

Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Bashkisë Vorë janë evidentuar parregullsi dhe anomalitë materiale dhe të përhapura, të cilat justifikojnë dhënien e një *opinionit të kundërt*.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për punë publike, mallra dhe shërbime, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.

Në 5 raste, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. Konstatohet se në të gjitha procedurat e prokurimit të audituara, u konstatuan probleme në lidhje me protokollimin e procesverbaleve.

Nga auditimi i lejeve të ndërtimit, u konstatuan shkelje dhe mangësi të ndryshme konkretisht:

Në planvendosjen e miratuar dhe në rilevimin topografik nuk pasqyrohen numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet objekti që do të zhvillohet;

Nuk janë respektuar distancat minimale ndërmjet objekteve;

Nuk janë respektuar distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës;

Lartësia e përgjithshme e ndërtimit e tejkalon lartësinë e lejuar;

Mungon marrëveshja ndërmjet palëve për kontributin e krijimit të fondit publik të banesave sociale;

Nuk janë marrë miratimet nga institucionet përkatëse.

¹¹ Sipas Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë: Nëse audituesit konstatojnë se aspektet e mospërputhjeve (rastet e anomalive) janë materiale dhe të përhapura, në bazë të evidencës së mjaftueshme e të përshtatshme të auditimit, shprehin opinionin të kundërt.

15. Në Bashkinë Kukës, për auditimin financiar nga data 01.01.2022 deri në datë 31.12.2022 dhe për auditimin e përputhshmërisë nga data 01.01.2021 deri në datë 31.12.2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare është dhënë *opinion i modifikuar*:

Llogaria 520 “Disponibiliteti në thesar” është në vlerën 250,479 mijë lekë, ndërkohë që duhet të jetë 172,836 mijë lekë pra është mbivlerësuar për vlerën 77,642 mijë lekë. Llogaritë e klasës 5, nuk kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Drejtoria e financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” më 31.12.2022 e cila paraqitet në vlerën 23,392 mijë lekë.

Nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022.

Nga auditimi i përputhshmërisë kanë rezultuar parregullsi të cilat janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një *opinionit të modifikuar*.

Bashkia Kukës nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët.

Në 5 raste në procedurat e prokurimit janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë. Janë konstatuar anomali në fushën e lejeve të ndërtimit dhe zbatimit të tyre në terren.

Në 2 raste plan vendosja e paraqitur nuk është në përputhje me projektin e miratuar.

Në 2 raste nuk janë respektuar distancat minimale ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Në 1 rast dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e-leje, paraqitet me deviacione të sipërfaqes ekzistuese të truallit para miratimit të shtesës për leje.

Në 2 raste realizimi i punimeve të ndërtimit nuk është në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.

Në 1 rast u konstatua se çertifikata e përdorimit është miratuar përpara përfundimit të punimeve të ndërtimit.

16. Në Bashkinë Elbasan për periudhën e aktivitetit të vitit 2022.

Nga auditimi financiar për vitin ushtrimor 2022 kanë rezultuar parregullsi dhe shkelje që janë materiale por jo të përhapura që justifikojnë dhënien e *opinionit të modifikuar*.

Pasqyrimi i gabuar i llogarisë analitike 468 “Debitor ndryshëm” për 1,056,298 mijë lekë me llogarinë analitike në pasiv 467 “Debitorë ndryshëm” për 1,064,539 mijë lekë

Mos regjistrimi në kontabilitet i 22 pronave të paluajtshme, të pajisur me certifikate pronësie në vitin 2022.

Nga auditimi i përputhshmërisë kanë rezultuar parregullsi materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një *opinionit të modifikuar*.

Nuk janë marrë masa të plota për uljen e detyrimeve të prapambetura, pasi edhe gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura, duke çuar në 31.12.2022 vlerën e tyre, me burim financimi të ardhurat e veta në 67 milionë lekë.

Janë konstatuar anomali në hartimin e kriterëve të veçanta të DST në procedurat e prokurimit publik, pasi janë vendosur kritere të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën dhe madhësinë e kontratës.

Në 3 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit.

Në auditimi i kontratave të zbatimit rezultuan diferenca në volumet e punimeve.

Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve së taksapaguesve familjarë dhe privat.

17. Në Bashkinë Selenicë për periudhën e aktivitetit të vitit 2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare është konkluduar me *opinion të modifikuar*:

Llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)”, e pasqyruar në bilanc për vlerën 70,005 mijë lekë, është e pa analizuar.

Llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, është paraqitur më pak për vlerën 17,987 mijë lekë, pasi nuk janë pasqyruar debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, për shumën 6,459 mijë lekë.

Gjendja e llogarisë 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*”, paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 75,928 mijë lekë, e cila nuk kuadron me Llogarinë 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” pasi paraqitet në shumën 0 lekë.

Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë, ka rezultuar se shkeljet dhe parregullsitë janë materiale dhe të përhapura dhe justifikojnë dhënien e *një opinionit të kundërt*.

auditimi i 11 procedurave me fond limit 374,648 mijë lekë (*ose 94% e fondit të prokuruar*), kanë rezultuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, si në aplikimin e kriterëve të paargumentuara me tipologjinë e procedurës (*në 9 procedura*), po ashtu dhe në shpalljen fitues të OE/BOE të cilët nuk kanë plotësuar të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, evidentuar kjo në 7 procedura me fond limit 193,855 mijë lekë *ose 51.7% e vlerës së fondit limit të audituar*, të procedurave të audituara *ose 45.7% e fondit limit të prokuruar*.

Në kryerjen e shpenzimeve jo me efektivitet dhe efikasitet në vlerën 4,839 mijë lekë.

Në mos zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore në vlerën 455,655 mijë lekë.

Në mos zbatimin e akteve ligjore në arkëtimin e taksës së hidrokarbureve për vlerën 4,600 mijë lekë.

Në mangësitë e konstatuara në menaxhimin e kontratave të qirave për kullota, toka bujqësore, prona për vlerën 61,810 mijë lekë.

Në mos marrjen e masave për regjistrimin e pronave të bashkisë kaluar me VKM në pronësi të saj.

18. Në Bashkinë Tropojë, për auditimin financiar nga data 01.01.2022 deri në datë 31.12.2022 dhe për auditimin e përputhshmërisë nga data 01.01.2021 deri në datë 31.12.2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2022 është konkluduar me *opinion të modifikuar*:

Nga auditimi i pasqyrave financiare se, për llogaritë: 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota, plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, kanë respektivisht vlerat: 22,460 mijë lekë, 10,017 mijë lekë, 1,057,967 mijë lekë dhe 1,676,415 mijë lekë, por vlerat e këtyre llogarive nuk japin siguri se janë të sakta, pasi janë të pa mbështetura me listën analitike të aktiveve.

Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Bashkisë Tropojë kanë rezultuar anomali dhe parregullsi të cilat janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e *një opinionit të modifikuar/kualifikuar*.

Janë konstatuar mangësi në evidentimin dhe vlerësimin e nivelit të detyrimeve debitore, kontabilizimet dhe procedurat e ndjekjes së borxhit tatimor për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Tropojë.

Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit publik në 4 prej tyre janë konstatuar anomali në hartimin e kriterëve të veçanta të DT-së, pasi janë vendosur kriterë të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën dhe madhësinë e kontratës:

në 5 raste në procedurat e prokurimit publik në vlerën totale 88,342 mijë lekë, janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik; janë konstatuar mangësi në menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve/Liçencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, Bashkia Tropojë;

janë konstatuar shkelje afatesh në realizimin e kontratave për punë publike, si dhe amendime kontratash të pa argumentuara, lidhur me shtyrjen e afateve të zbatimit;
Niveli i ulët i arkëtimit të gjobave të vendosura nga IMTV për shkeljet e konstatuara.

19. Në **Bashkinë Pogradec** për periudhën e aktivitetit të vitit 2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare vjetore për vitin ushtrimor 2022, është dhënë *opinion i modifikuar*: Është hartuar regjistri i aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimit të tyre.

Për vitin 2022 nga Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit Pogradec nuk është realizuar procesi i inventarizimit të aktiveve të institucionit.

Nga Qendra Arsimore Pogradec janë dhuruar aktive në vlerën 580 mijë lekë të vlerësuara për jashtë përdorimit nga procesi i inventarizimit drejt subjekteve private pa procedurë ankandi.

Nga Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike Pogradec janë nxjerrë aktive në vlerën 5,424 mijë lekë jashtë përdorimit për të cilat nuk disponohet asnjë dokumentacion për asgjësimin e tyre. Me VKM përkatëse janë transferuar në total 3,403 pasuri si ndërtesa, pyje, kullota, terrene, toka, terrene etj., nga të cilat vetëm për 174 prej tyre Bashkia Pogradec disponon certifikatë pronësie.

Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Pogradec dhe Njësive Administrative Buçimas, Udenisht, Çërravë, Velçan, Dardhas, Trebinjë, Propisht nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentet e pronësisë.

Nga auditimi i përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Pogradec ka rezultuar se anomalitë janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një *opinionit të modifikuar*.

Bashkia Pogradec nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, të kenë vlerën 275,701 mijë lekë.

Në 15 raste janë vendosur kriteret të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

Në 13 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe më pas lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale 2,264,536 mijë lekë.

Në 2 raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë distancat urbane nga trupi i rrugës së propozuar, midis ndërtimeve, ndërtesë-kufi prone, lartësia minimale e lejuar për katin përdhe, si dhe mosrespektim i vijave të ndërtimit.

Në 1 rast DPKZHT dhe Bashkia Pogradec nuk kanë kërkuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

Në 6 raste projekti ndërtimor nuk është i plotë si dhe janë konstatuar mangësi në plotësimin me dokumentacionin shoqërues përkatës.

Në 2 raste, DPKZHT dhe IMTV nuk kanë plotësuar detyrat e tyre funksionale, të parashikuara në ligj dhe rregullore, në lidhje me inspektimin e objekteve përpara miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit.

20. Në **Bashkinë Bulqizë** për periudhën e aktivitetit të vitit 2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare vjetore është dhënë *opinion i modifikuar*:

Ilogaritë inventariale janë pasqyruar për vlerën kontabël pa u krahasuar me inventarin fizik;

Ilogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” është nënvlerësuar për vlerën 51,290 mijë lekë, pasi në fund të vitit nuk janë kontabilizuar detyrimet e papaguara për qira Pyje/Kullota dhe detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit;

Ilogaria 202 “*Studime dhe projektme*”, në vlerën prej 3,116 mijë lekë është e pa analizuar dhe nuk ka informacion nëse këto projekte janë vënë në zbatim;

Ilogaria 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*”, nuk është pakësuar për vlerën e 35 artikujve për ujësjellës e kanalizime në shumën 926,427 mijë lekë të transferuara tek Ujësjellës Kanalizime Bulqizë.

Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Bashkisë Bulqizë ka rezultuar se parregullsitë janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një *opinionit të modifikuar*:

Në të gjitha procedurat e audituara, u konstatua se kriteret e vlerësimit janë vendosur në kundërshtim me LPP-së dhe Rregullat e prokurimit publik, duke shkelur qëllimin dhe parimet kryesore të LPP-së, siç është nxitja e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së shoqërive të vogla e të mesme, trajtimi i barabartë, mos diskriminimi etj;

Në të gjitha procedurat e audituara, u konstatua se Raporti Përmbledhës i procedurës së auditimit nuk i përmban të gjithë elementët e kërkuar në LPP;

Nga 20 procedura të audituara, në 17 prej tyre me vlerën 388,974 mijë lekë pa TVSh, u konstatuan se OE të shpallur fitues nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Në administrimin e të ardhurave vendore nga subjektet fizike/juridike dhe abonentët familjare, si dhe personat që kanë kontratë qiraje, leje legalizimi për ndërtim pa leje, nuk janë ndjekur procedurat e plota për arkëtimin e debitorëve në vlerën 130,153 mijë lekë.

Në zbatimin e kontratave të punimeve u konstatuan dëme për vlerën 1,730 mijë lekë.

Në llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë u konstatuan llogaritje të gabuara në vlerën 689 mijë lekë.

21. Në **Bashkinë Klos** për periudhën e aktivitetit të vitit 2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare vjetore për vitin ushtrimor 2022 është dhënë *opinion i modifikuar*: Nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit rezulton se nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit vlerat e trojeve të kësaj bashkie, sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione.

Llog. 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, nuk paraqet gjendjen reale për pasqyrat financiare të vitin 2022 pasi nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Klos, të transferuara me VKM përkatëse.

Në auditimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së Bashkisë Klos janë evidentuar parregullsi materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një *opinionit të modifikuar*.

Nga auditimi i 3 procedurave të prokurimit publik, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi gjithsej 2 procedura prokuruar në vitin 2022, shkelje të cilat kanë konsistuar në këto mangësi: Nuk janë vendosur kriteret e veçanta për kualifikim si bilancet dhe xhiro vjetore për tre vitet e fundit. Janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, duke sjellë lidhjen e dy kontratave në vlerën totale 35,457 mijë lekë me TVSH, me OE të shpallur fitues në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi për prokurimin publik.

Nuk është kryer inventarizimi i aseteve (pronave) të bashkisë dhe nuk janë marrë masa për regjistrimin e tyre në ASHK. Nuk ka regjistër kontabël për këto pasuri, si dhe për të gjitha aktivet e tjera të njësisë vendore.

Nuk është hartuar regjistri i taksapaguesve familjarë dhe privat për taksën mbi tokën bujqësore, duke mos evidentuar në mënyrë të saktë të ardhurat reale dhe detyrimet për këtë taksë.

Në territorin e Bashkisë Klos zhvillojnë aktivitet pa licencë 4 subjekte që tregtojnë karburant për konsumatorët fundorë, por nuk janë marrë masa të plota për licencimin e tyre ose mbylljen e aktivitetit.

Në asnjë procedurë prokurimi nuk është përpiluar një kërkesë për nevojat e sektorëve përkatës për mallrat apo shërbimet e prokuruar nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël.

22. Në Bashkinë Lushnjë për periudhën e aktivitetit të vitit 2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2022 është dhënë *opinion i modifikuar*:

Në inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në fund të vitit 2022 në llogaritë: 210 “Toka, troje, terrene” është në vlerën 15,786 mijë lekë; 211 “Pyje, plantacione” në vlerën 249 mijë lekë, 212 “Ndërtesa konstruksione” në vlerën 411,698 mijë lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 3,569,343 mijë lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 23,109 mijë lekë, janë azhornuar vlerat bruto për të gjithë investimet e kryera sipas llojit të aktivitetit dhe emërtesave të projekteve të investimeve, por pa kryer inventar fizik për të verifikuar statusin e tyre, nëse ekzistojnë apo jo dhe marrjen e masave për ndjekjen e procedurave ligjore për sistemimin e tyre.

Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Bashkisë Lushnjë kanë rezultuar parregullsi materiale por jo të përhapura që justifikojnë dhënien e një *opinionit të modifikuar*.

Bashkisë Lushnje dhe 8 NJA i janë transferuar në pronësi /përdorim 6462 prona, nga të cilat janë hipotekuar 57 prona, janë në proces hipotekimi 54 prona dhe për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë inventarizimi dhe përditësimi i të dhënave. Nuk janë kryer procedurat për miratimin e listave përfundimtare të pronave dhe transferimin e tyre në Bashkinë Lushnje për 4 NJA Ballagat, Karbunarë, Hysgjokaj dhe Fiershegan.

Kontratat shumëvjeçare për dhënien me qira të parcelave pyjore të tokave të pandara nuk janë të noterizuara si dhe nuk ka të dhëna nëse janë regjistruar në ASHK Drejtoria Lushnjë si edhe nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e marrjes në dorëzim të parcelës. Në asnjë rast të kontratave të qiradhënies së pronave nuk janë parashikuar në kontratë ndryshimet ligjore në lidhje me tarifën e qirasë, si dhe nuk është kryer monitorimi i tyre. Në fund të vitit 2022 janë 7 subjekte debitoare në vlerën 6,676 mijë lekë.

Në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit mungon struktura (drejtori/sectorë/njësi) e dedikuar për Informacionin Gjeohapësinor (GIS), duke mos kryer proceset e grumbullimit, përpunimit dhe përditësimit të informacionit. Plani i detajuar vendor, nuk figuron i azhornuar në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit në sistemin GIS.

Struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nuk është plotësuar me punonjës sipas kërkesave ligjore, pasi K/Inspektori nuk është me profesion inxhinier ndërtimi.

Nga auditimi është konstatuar se në 5 procedurat e prokurimit si në DST ashtu dhe në Kontratat e lidhura me operatorët fitues, referuar grafikut të pagesës, nuk kanë qenë në dispozicion fondet e plota të nevojshme për realizimin e punëve, edhe pse kontratat kanë kohëzgjatje disa mujore brenda vitit buxhetor.

24. Në Bashkinë Poliçan për periudhën e aktivitetit të vitit 2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare vjetore për vitin ushtrimor 2022 është dhënë *opinion i modifikuar*.

Nuk ka analiza për llogarinë nr.202 “Studime dhe kërkime” në vlerën 2,704 mijë lekë.

Llogaria nr. 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, përbëhet nga vlera e garancisë së punimeve prej 5% e vlerës së kontratës për 37 objekte, ku për 17 prej këtyre në shumën 4,728 mijë lekë afati i garancisë sipas kontratës ka përfunduar në vitin 2020.

Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Bashkisë Poliçan kanë rezultuar parregullsi materiale por jo të përhapura që justifikojnë dhënien e një *opinionit të modifikuar/kualifikuar*.

Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, të kenë vlerën 74,697 mijë lekë.

Tre procedura prokurimi me vlera të larta të zhvilluara gjithsej dhe të audituara, dy prej tyre u konstatuan me shkelje në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, ndërsa dy në kualifikimin dhe shpalljen e fituesit.

Janë konstatuar anomali në fushën e inspektimit të mbrojtjes së territorit, pasi në 2 raste kundërvajtje për ndërtime pa leje, nuk është marrë asnjë masë tjetër në vazhdim, si dhe struktura e IMTV-së nuk ka funksionuar për vitin 2022.

Nuk ka ngritur një strukturë efektive të auditit të brendshëm, nuk ka hartuar dhe miratuar Kartën e Auditit të Brendshëm, nuk ka hartuar planin vjetor dhe strategjik të auditimeve.

25. Në **Bashkinë Devoll** për periudhën e aktivitetit të vitit 2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2022 është konkluduar në *opinion të modifikuar*.

Llogaria nr. 520 “Disponibilitet në thesar” paraqitet më datën 01.01.2022, në vlerën 135,072 mijë lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 79,935 mijë lekë. Kjo llogari nuk kuadron me totalin e llogarisë nr. 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 79,935 mijë lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 20,627 mijë lekë. Llogaria nr. 520 “Disponibilitet në thesar” është nënvlerësuar në vlerën 20,627 mijë lekë. Në llogarinë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë përfshirë debitorët nga taksat dhe tarifat vendore.

Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Bashkisë Devoll janë konstatuar parregullsi materiale por jo të përhapura që justifikojnë dhënien e një *opinion të modifikuar/kualifikuar*.

Nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Në total në pronësi të saj janë 3,036 pasuri të transferuara sipas VKM-ve përkatëse nga të cilat vetëm për 64 prej tyre janë të pajisura me Certifikatë pronësie.

Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Devoll dhe Njësite Administrative Qendër Bilisht, Hoçisht, Progër dhe Miras nuk janë marrë masa për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie.

Janë konstatuar anomali në fushën e lejeve të ndërtimit dhe zbatimit të tyre në teren: në 2 raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj; në 3 raste projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore; në 1 rast Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) nuk është përlllogaritur e saktë; në 2 raste nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, si dhe në 1 rast nuk janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ushtrimin e kontrolleve dhe inspektimeve të nevojshme për ato raste që aplikojnë për leje ndërtimi, si dhe për inspektimin që këto struktura duhet të ushtrojnë mbi objektet e pajisura me leje ndërtimi.

26. Në **Bashkinë Kurbin** për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri në datë 31.12.2022.

Për vitin ushtrimor 2022 në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare është shprehur *opinion i pa modifikuar me theksim të çështjes*, si vijon:

Nga auditimi i llogarisë nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, u konstatua se për këtë llogari është bërë kontabilizimi i aksioneve për 3 shoqëritë në të cilat Bashkia Kurbin është aksionere sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit, por nuk u konstatua kryerja e pagesës së pjesëmarrjes.

Nga auditimi i llogarive 210 “toke, troje e terrene” dhe llogarisë nr. 211 “Pyje, kullota e plantacione” u konstatua se në këto llogari pasqyrohet vlera e tyre e pandryshuar në vijimësi duke mos pasqyruar: - Vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, kopshteve,

pallati i kulturës dhe ndërtesat e njësisve administrative. Gjithashtu, nuk ekziston një regjistër kontabël i mirëfilltë i përditësuar.

Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Bashkisë Kurbin kanë rezultuar parregullsi materiale por jo të përhapura që justifikojnë dhënien e një *opinion* të modifikuar.

Nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, në kenë vlerën 294,901 mijë lekë, ku vetëm për vitin 2022 janë evidentuar 30,891 mijë lekë.

Në 8 raste në procedurat e prokurimit janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

Janë konstatuar anomali në fushën e lejeve të ndërtimit dhe zbatimit të tyre në terren: në 3 raste nuk janë respektuar kondicionet urbane; në 3 raste konstatohet se shqyrtimi i aplikimeve me afate më të gjata se ato të parashikuara në ligj; në 6 raste konstatohet se ka mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqëruar të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi ose përdorimi; në 2 raste rezultojnë mangësi në dokumentat e pronësisë mbi të cilat zhvillohet objekti; në 4 raste u konstatua se Bashkia Kurbin dhe DPKZHT nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit; në 3 raste konstatohen ndryshime midis projektit të miratuar dhe objektit të ndërtuar, si dhe mangësi lidhur me inspektimin përpara miratimit të lejes së ndërtimit dhe gjatë ndërtimit.

27. Në **Bashkinë Malësi e Madhe** për periudhën e aktivitetit të vitit 2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2022 është dhënë një *opinion* i modifikuar:

Ilogaria nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”, është pasqyruar më pak për vlerën 53,117 mijë lekë;

Ilogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është pasqyruar më shumë për vlerën 7,246 mijë lekë;

Ilogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, është pasqyruar më pak për vlerën 171,273 mijë lekë;

Ilogaria nr. 202 “Studime dhe kërkime” është pasqyruar më shumë për vlerën 1,743 mijë lekë;

Ilogaria nr. 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”, është pasqyruar më shumë për vlerën 129,420 mijë lekë.

Nga auditimi përputhshmërinë së veprimtarisë së Bashkisë Malësi e Madhe janë konstatuar parregullsi materiale por jo të përhapura që justifikojnë dhënien e një *opinion* të modifikuar.

Në 7 procedura prokurimi të audituara me fond limit 128,546 mijë lekë pa TVSH, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kriterëve në kundërshtim të akteve ligjore/nënligjore të PP-së.

Në 7 procedura prokurimi të audituara me fond limit 130,352 mijë lekë pa TVSH, OE të kualifikuar nuk plotësojnë kriteret e vendosura.

Bashkia Malësi e Madhe në rolin e autoritetit vendor të planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit, në 5 raste nuk ka zbatuar plotësisht kuadrin rregullator të fushës dhe atë sektorial, në miratimin e aplikimeve për leje ndërtimi.

Moszbatimin plotësisht të kuadrit rregullator të fushës për arkëtimin e të drejtave të konstatuara (taksa, tarifa dhe qira) ndaj palëve të treta, në vlerën 108,271 mijë lekë.

28. Në **Bashkinë Pukë** për periudhën e aktivitetit të vitit 2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2022 është konkluduar me *opinion* të modifikuar:

Nga krahasimi i Pasqyrave Financiare të Bashkisë, me Pasqyrat Financiare të sistemit të Thesarit, konstatohet se pasqyrat financiare të sistemit të thesarit nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë, konkretisht: në totalin e Aktivit, konstatohet një diferencë prej 111,559 mijë lekë më shumë në PF të Bashkisë, në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra konstatohet, diferencë prej 302,553 mijë lekë më shumë

në PF të Bashkisë dhe llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”, ka vlerën 59,178 mijë lekë, ndërsa në PF në sistemin e Thesarit ka vlerën 0 (zero).

Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Bashkisë Pukë kanë rezultuar parregullsi materiale por jo të përhapura që justifikojnë dhënien e një *opinionit të modifikuar*.

Në 3 procedura prokurimi të audituara me fond limit 8,294 mijë lekë, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kriterëve në kundërshtim të përcaktimeve të akteve ligjore/nënligjore të PP.

Në 2 procedura prokurimi të audituara me fond limit 4,116 mijë lekë, OE i kualifikuar nuk plotëson kriteret e vendosura.

Mos zbatim i plotë i kuadrit rregullator të fushës për arkëtimin e të drejtave të konstatuara (taksa, tarifa dhe qira) ndaj palëve të treta, në vlerën 26,854 mijë lekë.

29. Në Bashkinë Fushë Arrëz me objekt “Auditim financiar dhe përputhshmërie”, për periudhën e aktivitetit të vitit 2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2022 është dhënë një *opinion i modifikuar*:

Llogaria.468 “Debitorë të ndryshëm” është pasqyruar më pak për vlerën 3,671 mijë lekë;

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është pasqyruar më shumë për vlerën 9,250 mijë lekë.

Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Bashkisë Fushë Arrëz janë konstatuar parregullsi materiale por jo të përhapura që justifikojnë dhënien e një *opinionit të modifikuar*.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se është konstatuar përdorim i fondeve publike në kundërshtim me parimet e efektivitetit, efencës dhe ekonomicitetit, për:

1 rast në procedurat e prokurimit publik në vlerën 540 mijë lekë;

3,572 mijë lekë të ardhura të munguara nga marrëdhëniet kontraktore me subjektet që kanë shfrytëzuar fondin pyjor/kullosor.

Nuk kanë likuaduar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore 131 subjekte në vlerën 1,109 mijë lekë, si dhe nuk janë paguar detyrimet nga 4 subjekte në shumën 4,000 mijë lekë.

30. Në Bashkinë Dibër për periudhën e aktivitetit për vitin 2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2022 është konkluduar me *opinion të modifikuar*:

llogaria nr.214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*” përmban zëra, që nuk klasifikohen si të tillë dhe klasifikimi i pasaktë ka ndikuar në llogaritjen e amortizimit vjetor, ku për llogaritjen e tij është përdorur norma 5% dhe jo 20%, për pasojë ky grup aktivesh është mbivlerësuar me 2,593 mijë lekë në pasqyrën e pozicionit financiar;

llogaria nr.215 “*Mjete transporti*” paraqitet e mbivlerësuar me 6,022 mijë lekë;

llogaria nr.218 “*Inventar ekonomik*”, paraqitet e mbivlerësuar në shumën 18,590 mijë lekë llogaria nr.231 “*Investime për Aktive Afatgjata materiale*” paraqitet e mbivlerësuar në shumën 196,290 mijë lekë;

shënimet shpjeguese dhe pasqyrat statistikore nuk janë paraqitur të plota dhe nuk është kryer inventarizimi fizik për aktivet e qëndrueshme.

Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Bashkisë Dibër kanë rezultuar parregullsi materiale materiale por jo të përhapura që justifikojnë dhënien e një *opinionit të modifikuar*:

në 19 procedura prokurimi të audituara, në 17 raste me fond limit 401,806 mijë lekë, janë konstatuar shkelje në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, pasi nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

në 19 procedura prokurimi të audituara, ose 100% e kampionit të zgjedhur me vlerë kontrate 291,815 mijë lekë, OE/BOE e kualifikuar nuk përmbushin kriteret e vendosura.

Në 3 procedura prokurimi të zhvilluara, me vlerë kontrate 75,771 mijë lekë, OE/BOE e kualifikuar nuk përmbushin kriteret e vendosura, ndërkohë që janë skualifikuar ofertat më të ulëta ose më të

favorshme në mënyrë të padrejtë, duke shkaktuar shpenzime pa ekonomikitet për buxhetin e Bashkisë në vlerën 8,291 mijë lekë.

në 10 procedura prokurimi të audituara, rezulton se KVO ka kryer vlerësimin përtej afatit ligjor të përcaktuar në rregullat e LPP-së.

në auditimin për lejet e ndërtimit, në 5 raste taksa e ndikimit në infrastrukturë është përlogaritur gabim, me pasojë të ardhura të munguara në vlerën 5,735 mijë lekë.

31. Në Bashkinë Divjakë për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2022 deri në datë 30.06.2023.

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2022 është konkluduar me *opinion të modifikuar*.

Nga ana Bashkisë janë shitur aktive afatgjata materiale që i përkasin llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione” në vlerën historike 13,208,886 lekë, për të cilat nuk janë kryer veprimet rregulluese për zbritjen e tyre nga kontabiliteti.

Aktualisht ka në pronësi dhe përdorim 1657 prona (në të cilën përfshihen edhe njësitë administrative) nga të cilat 1210 prona janë në pronësi dhe 447 prona janë në përdorim. Deri më datën 31.12.2022, me certifikatë pronësie janë 58 prona nga të cilat 21 prona i përkasin Bashkisë Divjakë, 4 prona Njësisë Administrative Tërbuf, 8 prona Njësisë Administrative Gradishtë dhe 25 prona Njësisë Administrative Remas.

Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Divjakë nga 134 prona të pasqyruara në kontabilitet vetëm për 3 prej tyre disponon titull pronësie.

Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Divjakë dhe Njësisë Administrative Tërbuf, Grabjan, Gradisht dhe Remas nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave, duke mos kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik, më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie.

Nga auditimi i përputhshmërinë së veprimtarisë së Bashkisë Divjakë kanë rezultuar parregullsi materiale por jo të përhapura që justifikojnë dhënien e një *opinion të modifikuar*:

Në 7 procedura të prokurimit publik me vlerë totale të fondit limit 125,472 mijë lekë, është konstatuar vendosje e kriteret të veçanta të dokumenteve të tenderit, të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Në 6 procedura është lidhur kontratë me operatorët ekonomik të kualifikuar dhe shpallur fitues në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vecanta të DT. Vendosja jo e drejtë e kriterëve për kualifikim ka sjellë mungesë konkurrence me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 76,610 mijë lekë.

32. Në Bashkinë Mat për auditimin financiar nga data 01.01.2022 deri në datë 31.12.2022 dhe për auditimin e përputhshmërisë nga data 01.01.2019 deri në datë 31.12.2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2022 është konkluduar me dhënien e një *opinion të pamodifikuar*.

Nga auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Bashkisë Mat, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat janë materiale dhe të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një *opinion të kundërt*.

Nga auditimi i 23 procedurave me fond limit 2,311,628 mijë lekë pa TVSH, u konstatuan shkelje të LPP-së, legjislacionit të fushës sipas natyrës së objekteve të prokuruar dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

Për aktivitetin e vitit 2019, nga auditimi i 7 procedurave me fond limit 28,760 mijë lekë pa TVSH, u konstatuan me shkelje të LPP-së dhe akteve nënligjore, si më poshtë: në 4 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me hartimin e fondit limit, për vlerën totale të kontraktuar 15,620 mijë lekë pa TVSH;

në 6 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 25,734 mijë lekë pa TVSH; në 6 procedura, OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DT të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 26,226 mijë lekë pa TVSH.

Për aktivitetin e vitit 2020, nga auditimi i 4 procedurave, me fond limit 1,952,635 mijë lekë pa TVSH, u konstatuan me shkelje të LPP-së dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

në 4 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE-së, për vlerën totale të kontraktuar 1,944,781 mijë lekë pa TVSH;

në 4 procedura, OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 1,944,781 mijë lekë pa TVSH;

Për aktivitetin e vitit 2021, nga auditimi i 6 procedurave, me fond limit 74,420 mijë lekë pa TVSH, u konstatuan me shkelje të LPP-së dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

në 2 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 31,481 mijë lekë pa TVSH;

në 4 procedura, OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 57,761 mijë lekë pa TVSH.

Për aktivitetin e vitit 2022, nga auditimi i 6 procedurave, me fond limit 255,813 mijë lekë pa TVSH, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

Në 5 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE-së, për vlerën totale të kontraktuar 247,628 mijë lekë pa TVSH;

Në 4 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 238,711 mijë lekë pa TVSH;

Në 1 procedurë, u konstatuan probleme në lidhje me marrjen e mallit në dorëzim, i cili kishte mospërputhje me ST të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, për vlerën totale të kontraktuar 4,698 mijë lekë pa TVSH.

C. Auditime financiare:

1. Në **institucionet MFE dhe MIE**, mbi auditimin e Sistemit të Përgjithshëm të Raportimit Financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2022, u konstatuan devijime materiale nga kuadri e raportimit financiar në fuqi për të cilin justifikojnë nga KLSH dhënien e *opinionit të kualifikuar* për subjektin MIE dhe me *konkluzion* për subjektin MFE.

Sistemi i përgjithshëm i raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme (në MIE), rezultoi se:

Strukturat përgjegjëse në MIE kanë hartuar Pasqyrat Financiare Përmbledhëse Vjetore për v. 2022, por ato përmbajnë parregullsi, mangësi e mospërputhje, ndaj nuk është e mundur që të ofrohet siguri e plotë mbi saktësinë dhe cilësinë e informacionit të përmbledhur në nivel grupi (ministrie);

Konstatohen shkelje të afateve në lidhje me ngarkimin në SIFQ të pasqyrave individuale dhe dorëzimin e pasqyrave fizike individuale, nga institucionet buxhetore dhe ekstra-buxhetore.

Teprica debitoare e llog.486 “Shpenzimet e periudhave te ardhshme”, sipas PFK të MIE për vitin 2022 teprica e kësaj llogarie është 542,573 mijë lekë. Pra, nuk rezulton të jenë kryer veprimet sistemuese dhe mbyllëse të llogarisë 486 në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr 5, datë 21.2.2022;

Pasaktësi në evidentimin në kontabilitet të vlerës së ndërtesave dhe rikonstruksioneve kundrejt listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, miratuar nga VKM dhe kaluar në përgjegjësi administrimi të ministrisë dhe subjekteve të varësisë direkte; nga auditimi i llogarisë 230 konstatohet se për vlerën prej 34,145 mijë lekë nuk ka ndonjë të dhënë përveç vlerës së saj (gjendje nga vitet e kaluara ish Ministria e Energjetikës), mungon analiza inventariale për këtë vlerë dhe MIE nuk disponon dokumentacion për këtë aktiv. Gjithashtu nga auditimi i llogarisë 231 konstatohet se për 2 (dy) aktive në vlerë 2,804,029 mijë lekë mungon analiza e tyre dhe MIE nuk disponon dokumentacion për këto aktive, pasi për aktivin në vlerën prej 269,377 mijë lekë është vendosur shënimi “Gjendje nga vitet e kaluara, ish-Ministria e Transportit” dhe për aktivin në vlerë 2,534,652 mijë lekë është vendosur shënimi “Gjendje nga vitet e kaluara, ish-Ministria e Energjisë”;

Evidentohet një nivel i lartë i detyrimeve të subjekteve debitoare dhe klientëve dhe rezulton një trend në rritje për to për periudhën e audituar. Llogaria “Debitorë të ndryshëm” (llog. 468) pasqyrohet në shumën prej 4,694 milionë lekë në fund të v. 2022. Evidentohet se, janë shtuar të drejtat e tjera për arkëtim, për zëra të tilla si “Divident i A.P” për 2,155,452 mijë lekë, (nga kjo shumë janë arkëtuar vetëm 1 milionë lekë); masa e dëmit sipas urdhrit nr.313. datë 23.12.2020 “Për përfundimet e inspektimit financiar publik” për 7 zyrtarë të institucionit, me nga 126 mijë lekë/secili. Për vitin ushtrimor 2022 janë shtuar detyrimet debitoare në kuadër të Llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, për OSHEE Grup sh.a., për detyrimet e tarifës koncesionare, sipas kontratës koncesionare nr.5535/5, datë 24.10.2016 në shumën 1,495,990 mijë lekë. Përfshirja e detyrimeve të OSHEE Grup sha, për sa llogaritur tarifa koncesionare e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et të dhëna me koncesion për periudhën 2016-2021, i përket një periudhe 5 vjeçare, veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në kontabilitet;

Ekzistojnë mospërputhje midis të dhënave të bilancit të konsoliduar të MIE, i mbyllur më datën 31.12.2022, (sa pasqyruar në formatin 7/b, krahasuar me të dhënat e regjistruara në Formatin nr. 1 “Pozicioni financiar”, grupi “Aktivi i Bilancit Kontabël për AAM) që paraqesin diferencën ose nuk rakordojnë prej 7,723 mijë lekë. Mos rakordim i të dhënave dhe vlerave të bilancit të konsoliduar të MIE në rubrikën “ushtrimi i mbyllur” (të datës 31.12.2021) evidentuar 391,217,674 mijë lekë, me të dhënat e rubrikës “ushtrimi paraardhës”, (të bilancit të datës 31.12.2022) pasqyruar 391,212,997 mijë lekë, për diferencën prej 4,676 mijë lekë, në kundërshtim me paragrafin 31, pika 3.1, “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018, i ndryshuar.

Sistemi i përgjithshëm i raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme (në MFE) rezultoi se:

Kuadri rregullator dhe politikat e miratuara nga MFE, të zbatueshme për njësitë shpenzuese të sektorit publik, bazohen në disa udhëzues të karakterit administrativ që adresojnë procedurën e hartimit, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare të sektorit publik. Sa më sipër, mungon një kuadër i plotë ligjor mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare që ti shërbejë rritjes e llogaridhënies dhe ushtrimit të autoritetit të MFE nëpërmjet sanksioneve në rast të mos zbatimit të këtyre dispozitave. Nuk janë hartuar e miratuar aktet e detyrueshme që synojnë të vendosin në zbatim SNKSP-të / IPSAS mbi kontabilitetin me bazë të drejtat e detyrimeve të konstatuara, që është korniza rregullatore për çdo nivel qeveritar dhe është vonuar procesi i vënies në zbatim i këtyre standardeve.

Strukturat përgjegjëse në MFE nuk kanë hartuar pasqyrat financiare përmbledhëse, të konsoliduara për sektorin publik, për periudhën objekt auditimi 1.1.2022-31.12.2022. Nga auditimi i kryer nga KLSH, në lidhje me zbatimin e standardeve të raportimit financiar dhe sistemin e kontabilitetit të sektorit publik, ka rezultuar se, nga ana e MFE-së nuk janë hartuar e dorëzuar në Qeveri dhe Kuvend, Pasqyrat

Financiare Përmbledhëse, të Konsoliduara as në nivel grupi (ministrie), as në nivelin e përgjithshëm për Njësitë e Sektorit Publik për vitin 2022.

Nuk ofrohet siguri mbi saktësinë dhe cilësinë e informacionit kontabël, të përmbledhur në nivel grupi (ministrie, bashkie etj.), pasi në shumë raste kanë shfaqur pasaktësi dhe mospërputhje. Si rrjedhim, për vitin 2022, pasqyrat financiare të sektorit publik, nuk janë përfshirë në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit të shtetit, të përgatitur nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Janë evidentuar mangësi në zbatimin e procedurave dhe respektimin e afateve të përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave të llogaridhënies vjetore/ bilanceve vjetore individuale nga institucionet buxhetore dhe hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara, gjë që tregon për dobësi në zbatimin e ligjit të buxhetit dhe akteve nënligjore mbi kontabilitetin e sektorit publik.

Mungesa e rakordimit dhe e shpjegimeve në lidhje me mospërputhjet/mosrakordimet e informacioneve dhe të dhënave të gjeneruara nga SIFQ, me të dhënat e pasqyrave financiare të dorëzuara fizikisht nga ana e njërive të qeverisjes së përgjithshme.

Në një numër rastesh, nuk sigurohet krahasueshmëria e të dhënave të Pasqyrave Financiare të Konsoliduara dhe raporteve financiare të përgatitura nga ana e organeve shtetërore për ushtrimin e mëparshëm dhe bilancin e çeljes për vitin ushtrimor; gjë që tregon për moskryerjen e kontrolleve sistematike të informacioneve që dërgojnë institucionet shtetërore në ministrinë e linjës, në shkelje të parimeve dhe normave kontabël.

Mungon regjistri i aktiveve dhe pasurive shtetërore në nivel qendror dhe për gjithë institucionet e qeverisjes së përgjithshme. Dobësi janë evidentuar në kryerjen e procesit të inventarizimit vjetor të aseteve dhe mungesa e vlerësimit të pasurive të institucioneve buxhetore e ekstra-buxhetore me qëllim pasqyrimin në kontabilitet të aktiveve, me vlerën e tyre të drejtë.

Llogaritë kryesore inventariale të pasurisë, (sintetike dhe analitike), rezultojnë me pasaktësi për shumë institucione buxhetore e njësi shpenzuese të testuara, pasi mungojnë analizat e tyre. Praktika të njëjta të mos regjistrimit në kontabilitet të vlerës së “Ndërtesave” dhe mos evidentimit të gjendjeve të llogarisë “Toka, troje e terrene” konstatohen gjerësisht, si në auditimet e institucioneve në nivelin qendror, duke vazhduar edhe me ato në nivel vendor.

Rritje të vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme dhe të detyrimeve të pagueshme, shtim i stokut të detyrimeve të shtetit nga vendimet e Gjykatave të Arbitrazhit dhe GJEDNJ, nivel i lartë i shpenzimeve buxhetore nga vendimet gjyqësore / përmbartimore, me ndikim në rritjen e shpenzimeve shtesë etj.

D. Auditime të performancës

1. Në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies: Në përputhje edhe me Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm numër 3 "Shëndeti i Mirë dhe Mirëqenia", i cili synon të sigurojë akses universal në kujdesin shëndetësor cilësor dhe të promovojë mirëqenien për të gjithë në nivel global deri në vitin 2030, është audituar me dy tema të auditimit si vijon:

“*Trajtimi i sëmundjeve tumorale*” për vlerësimin e politikave shtetërore e institucioneve përgjegjëse në lidhje me parandalimin, diagnostikimin, trajtimin e sëmundjeve tumorale dhe kujdesin paliativ të pacientëve.

Auditimi u ushtrua, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe institucionet e varësisë së saj, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (Spitali Onkologjik), në Spitalet Rajonale Durrës, Vlorë, Fier, Elbasan, Korçë, Shkodër, Berat dhe Lezhë.

Në Shqipëri, identifikohen 6 mijë raste të reja me sëmundje tumorale çdo vit. Sëmundja tumorale është një diagnozë individuale që ka ndikime të rëndësishme shëndetësore tek pacientët, por gjithashtu ndikon rëndë dhe në jetën e familjeve të tyre. Sëmundjet tumorale mbeten shkak i dytë i fataliteteve, duke shkaktuar rreth 16% të vdekjeve çdo vit.

Shqipëria ka vetëm një "spital onkologjik" pranë QSUNT-së në Tiranë, ku të gjithë pacientët e dyshuar dhe më pas të diagnostikuar me sëmundje tumorale nga spitalet rajonale të vendit, vijnë për përcaktimin

e saktë të diagnozës dhe më pas ndjekjen e ecurisë dhe protokollit të mjekimit. Shërbimet radiologjike, radioterapi e disa kimioterapi, nuk ofrohen pranë Spitaleve rajonale të vendit, por vetëm në Spitalin Onkologjik, për rrjedhojë centralizimi i shumicës së shërbimeve shëndetësore, rrit kostot ekonomike për pacientët dhe familjarëve të tyre. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka propozuar politika qeveritare për trajtimin e sëmundjeve tumorale, konkretisht Programi Kombëtar i Kontrollit të Kancerit (PKKK) për vitet 2011-2020 dhe për vitet 2021-2031, duke e strukturuar në katër fush.a.(1) parandalimi parësor; (2) zbulimi i hershëm; (3) diagnoza dhe trajtimi; dhe (4) kujdesi paliativ.

Me gjithë punën e bërë nga institucionet përgjegjëse janë konstatuar, disa të meta e mangësi ku më kryesoret janë:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka: hartuar raporte monitorimi e vlerësimi; Regjistër Kombëtar të Kancerit me të dhëna në kohë reale; ndryshuar dhe miratuar protokollin klinike të cilat janë prej vitit 2014;
- në Spitalin Onkologjik, është konstatuar se: ka mungesa të stafit me burime njerëzore; numri i poltronëve “shtrat virtual” është i ulët; nuk është funksionale pajisja mjekësore e Brakiterapi (Kyriterapi);
- në Spitalin Rajonal të Lezhës nuk funksionon njësia e kimioterapisë;
- në Spitalet Rajonale Lezhë, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Korçë, Berat, konstatohet se nuk kanë: kapacitete spitalore të plota; burime njerëzore mjekë onkologë; pajisje dhe materiale mjekësore; shtretër të dedikuar; mungojnë sistemet e informatizuara; nuk u rakordojnë të dhënat me Spitali Onkologjik në Tiranë etj.

*Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për përmirësimin e sistemit të trajtimit të sëmundjeve tumorale në institucionet spitalore të shëndetit publik, sigurimit të infrastrukturës së nevojshme, për stafin mjekësor, medikamente, për aparatura mjekësore, ambiente për njësitë e kimio terapisë dhe shërbimit paliativ, monitorimin dhe vlerësimin periodikisht të cilësisë shërbimit të trajtimit të sëmundjeve tumorale, realizimit të aktiviteteve sensibilizuese me qëllim të uljes së e numrit të sëmundjeve tumorale etj., si dhe në përfundim të auditimit doli me mesazhin e auditimit: *Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet shëndetësore, për shkak edhe të numrit në rritje të pacientëve me sëmundje tumorale, krahas punës së vazhdueshme në promovimin e stilit të jetës së shëndetshme, të nxisin, politikat e parandalimit, depistimit, trajtimit në kohë të kancerit dhe uljes së mortalitetit të popullsisë në vend. Arritja e parandalimit të sëmundjeve tumorale në fazën e hershme të tyre nëpërmjet bashkërendimit të politikave shëndetësore, rritjes së buxheteve financiare, sigurimit të pajisjeve mjekësore, shtimit të ambienteve spitalore, plotësimin me medikamente si dhe përmirësimin të strukturave të dedikuara me personel mjekësor të mirë kualifikuar të jetë një sfidë e vazhdueshme për institucionet shëndetësore.**

“Shërbimi në Terapinë Renale Zëvendësuese” (hemodializë, dializë peritoneale, transplant)” për vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve shëndetësore në menaxhimin dhe parandalimin e sëmundjeve të veshkave në Shqipëri si dhe sigurimin e cilësisë së shërbimit të hemodializës. Gjithashtu mbi nivelin e politikave të hartuara dhe efektivitetin e zbatimit të tyre për sa i përket fazës së identifikimit të pacientëve me sëmundje renale kronike, parandalimit të dializës, marrjes së shërbimit (që ofrohet për pacientët në dializë) sipas projeksioneve, monitorimit të shërbimit të dhënë nëpërmjet qendrave shëndetësore publike etj.

Auditimi u ushtrua në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësorë dhe institucionet e varësisë, Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” si dhe Spitalet Rajonale; Elbasan, Durrës, Lezhë, Shkodër, Korçë, Berat, Fier, Vlorë, në të cilat ofrohet ky shërbim.

Një sërë studimesh kanë vënë në dukje se menaxhimi i hershëm i pacientëve me SKV jo vetëm që pakëson frekuencën e hospitalizimit dhe mortalitetin por, është në gjendje të influencojë edhe në

sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë e pacienteve pas fillimit të dializës. Në Shqipëri trajtohen rreth 1300 pacientë me hemodializë ndërsa vetëm në QSUNT trajtohen rreth 140 pacientë me Hemodializë çdo muaj dhe 45 pacientë të tjerë në Dializë peritoneale.

Në sajë të politikave shëndetësore këta pacientë duhet të marrin shërbim dinjitoz duke ndikuar në cilësinë e jetës dhe jetëgjatësinë e tyre. Procesi i dializës është jetik për pacientët të cilët vuajnë nga sëmundjet renale kronike, për këtë arsye dhe marrja e këtij shërbimi nëpërmjet institucioneve shëndetësore duhet të kushtëzohet nga ndjekja me rigorozitet e protokolleve shëndetësore të miratuara, kushteve të shërbimit, profesionalizmit të stafit shëndetësor dhe sigurisë në marrjen e shërbimit, duke siguruar kushte sa më ideale për këtë kategori të shoqërisë.

Me gjithë punën e bërë nga institucionet përgjegjëse janë konstatuar, disa të meta e mangësi ku më kryesoret janë :

- Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor nuk ka: planifikuar auditimin e strukturave të monitorimit të zbatimit të kontratave të shërbimit të hemodializës; unifikuar metodologjinë në përputhje me Protokollin e Dializës; rishikuar kontrata të papërfunduara me spitaleve etj;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk ka marrë masa për monitorimin periodik të kontratës koncensionare dhe hartuar një raport të përgjithshëm mbi nivelin e investimeve e zëvendësimit e pajisjeve mjekësore (makineritë e dializës) nga koncensionari;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor nuk ka studiuar mundësinë e rishikimit dhe përmirësimit të ligjit për "*Transplantimin e Indeve, të Qelizave dhe të Organeve në Republikën e Shqipërisë*" për transplantin e kryqëzuar të veshkave sipas praktikave më të mira evropiane e botërore.

Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për të garantuar një sistem shëndetësor mirë-funksional në shërbimin e terapisë renale zëvendësuese dhe plotësimin të nevojave të pacientëve me dializë, në parandalimin, përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, monitorim i shërbimit të hemodializës nga institucionet përgjegjëse, koordinimit ndërmjet institucioneve për Planifikimin dhe Menaxhimin e Kujdesit Renal dhe Shërbimin e dializës etj, si dhe në përfundim të auditimit doli me mesazhin e auditimit:

Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet spitalore, Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të rrisin vëmendjen për përmirësimin e politikave të kujdesit shëndetësor në nivel kombëtar dhe rajonal, për depistimin dhe parandalimin e sëmundjeve kronike të veshkave, përmirësimin në shërbimin e Terapisë Renale Zëvendësuese (hemodializa, dializë peritoneale, transplant), monitorimin periodik të ofrimit të shërbimit dhe të protokolleve të shërbimit si dhe trajnimin dhe kualifikimin e stafit mjekësor në mënyrë të vazhdueshme dhe në përshtatje me zhvillimet më të fundit shkencore, duke ndikuar në cilësinë e jetës dhe jetëgjatësinë e pacientëve të prekur me sëmundjet kronike të veshkave.

2. Në fushën e mjedisit: Objektivat në fushën e mjedisit është të sigurohet që planeti ynë të jetë i qëndrueshëm dhe i mbrojtur për të ardhmen tonë dhe për brezat e ardhshëm. Kjo përfshin mbrojtjen e biodiversitetit, zvogëlimin e ndikimit negativ të njeriut në mjedis, përdorimin e burimeve natyrore në një mënyrë që të jetë e qëndrueshme në afat të gjatë dhe të sigurojë një cilësi jetese të qëndrueshme për të gjithë banorët e planetit dhe në këtë kontekst nëpërmjet dy prej temave të auditimit të performancës të fokusuar në mjedis është konstatuar se:

“Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”, për vlerësimin dhe analizimin e masave të marra nga institucionet përgjegjëse me qëllim përmirësimin e flotës së mjeteve të transportit rrugor dhe impaktin e tyre në cilësinë e ajrit. Gjithashtu mbi nismat dhe iniciativat të cilat institucionet përgjegjëse kanë marrë për të përmirësuar gjendjen e flotës së mjeteve të transportit rrugor dhe rrjedhimisht cilësisë së ajrit.

Auditimi u ushtrua në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Ndotja e ajrit është një çështje shumë e rëndësishme sociale dhe mjedisore dhe në të njëjtën kohë është një problem kompleks i cili parashtron sfida të shumta në aspektin e menaxhimit dhe reduktimit të substancave ndotëse. Elementët ndotës kanë ndikim të madh në mjedis, shëndet, klimë etj.

Një nga arsyet kryesore të realizimit të këtij auditimi është sepse sektori i transportit në vendin tonë është kontributori më i madh, për sa u përket shkarkimeve të përgjithshme në ajër. Politikat e transportit kanë një ndikim shumë të rëndësishëm në kostot sociale të ndotjes së ajrit. Nëpërmjet planifikimit, organizimit dhe përcaktimit të mënyrave të ndryshme të transportit, qeveria mund të influencojë në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Me gjithë punën e bërë nga institucionet përgjegjëse janë konstatuar, disa të meta e mangësi ku më kryesoret janë:

- rritje e numrit të mjeteve rrugore me naftë dhe moshë mbi 20 vjet vjetërsi;
- raport i ulët i mjeteve rrugore elektrike kundrejt totalit me 0.11 % si dhe nuk ka të dhëna të përditësuara mbi numrin e stacioneve të karikimit e politika për ngritjen e tyre;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka siguruar me mbulim kohor të mjaftueshëm monitorimin e cilësisë së ajrit;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk kanë përditësuar dokumentet e tyre strategjike sa i përket reduktimit të shkarkimeve nga automjetet dhe shtimit të mjeteve rrugore me karburant alternativ.

*Në këtë auditim janë dhënë rekomandime nëse kanë rezultuar të mjaftueshme masat e marra nga institucionet përgjegjëse me qëllim përmirësimin e transportit rrugor dhe cilësisë së ajrit, përmirësimin të politikave për ndryshimin e raporteve të llojeve të mjeteve, vlerësimin të e gjendjes së cilësisë së ajrit në të gjithë vendin dhe të ndarë me zona problematike, hartimit dhe zbatimit të politikave të përshtatshme në sektorin e transportit rrugor për të përmirësuar cilësinë e ajrit duke stimuluar përdorimin e mjeteve sa më pak ndotëse, rritjen e bashkëpunimit të institucionet përgjegjëse për marrjen e masave sa i përket ndikimit të transportit rrugor në cilësinë e ajrit, etj., si dhe në përfundim të auditimit doli me mesazhin e auditimit: *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës së bashku me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të nxisin rinovimin e flotës së mjeteve rrugore, vënie në zbatim të stimujve financiare për të shtuar numrin e mjeteve rrugore me emetim të ulët, plotësimin e legjislacionit në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare si dhe forcimin e mëtejshëm të sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit.**

“Performanca e sistemit të shfrytëzimit minerar të mermerëve”, për vlerësimin dhe analizimin e masave të marra nga institucionet përgjegjëse mbi shfrytëzimin e mineralit të mermerit si dhe impaktin që ato kanë në ekonomi, komunitet dhe mjedis. Gjithashtu përlllogaritjes së rentës minerare dhe ecurisë së saj ndër vite, çështjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e fondit pyjor, rehabilitimin e mjedisit, sigurimin e punonjësve, monitorimin dhe kontrollin etj.

Auditimi u ushtrua në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Aktiviteti i shfrytëzimit minerar ka ndikime pozitive në ekonomi e shoqëri dhe negative në mjedis. Ai mund të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, krijimin e infrastrukturës dhe rritjen e zhvillimin e komuniteteve, por mund të rezultojë në ndikime të rënda negative mjedisore gjatë gjithë ciklit jetësor të minierës. Pikërisht ndikimi i aktivitetit minerar të mermerit në ekonomi, komunitet dhe mjedis është një nga arsyet kryesore të realizimit të këtij auditimi. Kompanitë minerare neglizhojnë kostot e kompensimit për dëmet mjedisore, të cilat ndonjëherë mund të çojnë deri në mbylljen e plotë të aktivitetit minerar. Për të vlerësuar me saktësi fizibilitetin ekonomik të një aktiviteti minerar, është thelbësore të përfshihen kostot mjedisore në studimet e fizibilitetit. Megjithatë, përcaktimi sasior i kostove mjedisore për ton të mineraleve ende mbetet një sfidë shumë e madhe.

Me gjithë punën e bërë nga institucionet përgjegjëse janë konstatuar, disa të meta e mangësi ku më kryesoret janë:

- Ligji minerar dhe Ligji për Taksat Kombëtare nuk janë të harmonizuar me njëri-tjetrin;
- evidentohet numër i ulët i punonjësve me sigurim jete që punojnë direkt në procesin e shfrytëzimit të mermerit;
- subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit nuk janë të pajisur me aktin për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të shfrytëzuar;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, nuk ka marrë masa për të unifikuar pagesën e rentës minerare dhe kryer monitorime e inspektive;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit nuk ka vlerësuar sipërfaqet e prekura nga aktiviteti i shfrytëzimit minerar të mermerit për të siguruar që subjektet të kryejnë rehabilitimin progresiv/përfundimtar të sipërfaqeve të shfrytëzuara.

Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrin institucionet përgjegjëse mbi përmirësimin e shfrytëzimit të mermerëve, përmirësimin të ndikimeve në ekonomi dhe mjedis, mbikëqyrjes së plotë të procesit të shfrytëzimit të mermerëve, si dhe në përfundim të auditimit doli me mesazhin e auditimit: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të nxisin një qasje të përgjegjshme ndaj menaxhimit të burimeve minerare dhe mbrojtjes së mjedisit, duke kërkuar një harmonizim të ligjit, përdorimit e teknologjisë dhe praktikave të mira për të siguruar një përdorim efektiv dhe të qëndrueshëm të këtyre burimeve. Përdorimi i instrumenteve të nevojshëm është detyrë parësore e tyre me qëllim maksimizimin e vjeljes së rentës minerare, sinkronizimin e legjislacionit minerar me atë të taksave kombëtare, marrjen e masave të nevojshme për miratimin e heqjes nga fondi pyjor të sipërfaqeve pyjore të dhëna për shfrytëzim si dhe kryerjen e rehabilitimit progresiv mjedisor aty ku është e mundur.

3. Në fushën e bujqësisë: Nëpërmjet një teme auditimi të performancës me objektiv në fushën e bujqësisë dhe fara fidanë kemi synuar të identifikojmë dhe të mundësojmë arritjen e realizimit të objektivave që kanë të bëjnë me sigurimin e një prodhimi të qëndrueshëm dhe efikas të kulturave bujqësore dhe fidanëve, të cilat çojnë në përmirësimin e cilësisë së prodhimit, rritjes së sigurisë ushqimore, zhvillimin ekonomik etj., si një përpjekje e përbashkët, nga ku konstatohet se:

“Efektiviteti i procesit të certifikimit të materialit mbjellës bimor (fara e fidanë), i përdorur nga fermerët” për vlerësimin dhe analizimin e masave të marra nga institucionet përgjegjëse për kushtet e prodhimit, përgatitjes tregtimit, përfshirë importin e materialit mbjellës dhe shumëzues. Gjithashtu në përmirësimin e kontrollit dhe monitorimit permanent të materialit mbjellës shumëzues bimor i cili ndikon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë prodhimit bujqësor dhe sigurisë ushqimore.

Auditimi u ushtrua në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e varësisë Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe Qendrat e Teknologjisë dhe Transformimit Bujqësor.

Sipërfaqja totale bujqësore e shfrytëzuar e Shqipërisë është 1,174,081 hektarë. Zhvillimi bujqësor është shumë i rëndësishëm për sa i përket përmirësimin të standardit të jetesës dhe zbutjes së varfërisë. Prandaj menaxhimi i procesit të prodhimit të materialit mbjellës bimor i cili përdoret nga fermerët është sfidë e kohës për t'u ardhur në ndihmë fermerëve si dhe me qëllim garantimin e sigurisë ushqimore. Një farë me cilësi e parametra të larta në fuqinë e mbirjes, dhe fidanë të shëndetshëm shndërrohen në të korra me rendiment të lartë dhe cilësor, siguri ushqimore, rritje të eksporteve etj.

Me gjithë punën e bërë nga institucionet përgjegjëse janë konstatuar, disa të meta e mangësi ku më kryesoret janë:

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka informacion në lidhje me sasinë e stokut të materialit mbjellës si dhe nuk ka struktura të dedikuara për monitorimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me Entin Shtetëror të Farërave nuk kanë realizuar miratimi i plotë i paketës nënligjore në zbatim të ligjit për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor;
- Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve nuk evidenton gjithë procesin që kalon testimi dhe regjistrimi i varieteteve;
- konstatohet rënie e numrit të regjistrimeve të varieteteve të reja në Katalogun Kombëtar;
- nuk rezulton asnjë fidan i certifikuar me bimë medicinale në vitin 2022 ndërkohë që janë mbjellë 7,098 hektarë;
- për vitet 2020-2022 nuk është certifikuar asnjë material mbjellës dhe shumëzues bimor i luleshtrydhes fasules, duhanit, lulediellit sojës dhe panxhar sheqerit, si dhe nuk është realizuar një analizë të detajuar në lidhje me sipërfaqet e mbjella me material mbjellës dhe shumëzues bimor të këtyre kulturave;
- nuk ka të dhëna të përditësuar mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar dhe eksportuar;
- nuk ka një listë të unifikuar dhe publikuar të subjekteve importues, tregtues dhe prodhues të materialit mbjellës shumëzues e bimor.

*Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrin institucionet përgjegjëse mbi përmirësimin e shërbimit ndaj fermerëve dhe cilësisë së prodhimit bujqësor, përditësimit të kuadrit ligjor, garantuar të mbikëqyrjes së plotë të furnizuesve dhe përdoruesve të materialit mbjellës shumëzues bimor, plotësimin me logjistikën e nevojshme dhe burimet njerëzore të mjaftueshme, etj., si dhe në përfundim të auditimit doli me mesazhin e auditimit: *Në kushtet e zhvillimit dhe modernizimit të bujqësisë, është parësore sigurimi i cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në mbështetje të prodhimit bujqësor, mbrojtjes së mjedisit dhe të konsumatorit, nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional, kontrollit dhe inspektimit të furnizuesve, rritjes së burimeve njerëzore e logjistike të institucioneve përgjegjëse, për një menaxhim sa më efektiv në procesin e certifikimit dhe testimit të farave dhe fidanëve.**

Masat e marra nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e varësisë kanë qenë pjesërisht efektive në drejtim të procesit të testimit të varieteteve dhe certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor. Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve ka bërë hapa pozitivë në përmirësimin e situatës, por evidentohen mangësi në përditësimin e akteve ligjore e nënligjore në përputhje me Ligjin nr.10416 datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” i ndryshuar. Raportet Vjetore të monitorimit, certifikimit dhe testimit të varieteteve të reja nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk kanë dhënë garanci për sigurinë e tregut ushqimor. Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve nuk ka arritur të maksimizojë mbledhjen e të ardhurave të veta, gjithashtu nuk ka finalizuar procesin e regjistrimit në Katalogun Kombëtar të Varieteteve duke mos koordinuar në kohë me institucionet e tjera për kryerjen e certifikimit të disa llojeve të materialit mbjellës shumëzues bimor.

4. Në fushën sociale dhe barazisë gjinore. Nëpërmjet 3 temave të auditimit të performancës në fushën sociale dhe të barazisë gjinore kemi synuar të përfshijmë të gjithë aktorët, për të përmirësuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, promovuar barazinë në të gjitha aspektet e jetës e krijuar mjedis të barabartë për të gjithë, nga ku konstatohet se:

“Fuqizimi Ekonomik i gruas në vendin tonë” për vlerësimin dhe analizimin e masave të marra nga institucionet përgjegjëse në angazhimin për fuqizimin ekonomik të gruas, duke nisur nga përmirësimi i ligjit për barazinë gjinore, zbatimin e strategjive si dhe buxhetimi i përgjigjshëm gjinor kryesisht në fushën e punësimit dhe zhvillimit bujqësor rural

Shqipëria ka ngritur ndër vite një kuadër ligjor, institucional dhe politikash për të garantuar fuqizimin ekonomik të gruas në vendin tonë. Mbështetur në Agjendën 2030 të Kombeve të Bashkuara, OZHQ

nr. 5 “*Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave*”, janë hartuar dhe miratuar dy strategji për barazinë gjinore për periudhën 2016 – 2020 dhe 2021 – 2030. Pavarësisht këtyre iniciativave, statistikave të INSTAT - it tregojë se, ende ka hapësirë për përmirësime të qenësishme. Një nga politikat e miratuara për të zbutur diferencat gjinore është Buxheti i Përgjigjshëm Gjinor (BPGJ), i cili ka filluar të zbatohet pjesërisht në nivelin kombëtar, por ende me nivele të ulëta zbatueshmërie në nivel vendor. Në nivel kombëtar, në vitin 2016, barazia gjinore u përfshi si një nga parimet themelore të Sistemit Buxhetor të Republikës së Shqipërisë, për të siguruar qasjen e barabartë të grave dhe burrave në Shqipëri ndaj të drejtave dhe mundësive dhe u bë pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015 - 2020).

Sigurimi i integritetit të grave dhe vajzave, nxitja e të drejtave të tyre social ekonomike, mbështetja e grupeve të pa favorizuara, si dhe angazhimi i burrave dhe djemve në të gjitha veprimtaritë që synojnë fuqizimin e grave dhe dhënien e mundësive të barabarta duhet të jenë në qendër të politikave gjinore dhe të ndikojnë në përmirësimin e barazisë gjinore, zhdukjen e varfërisë dhe progresin e vazhdueshëm të shoqërisë sonë.

Me gjithë punën e bërë nga institucionet përgjegjëse janë konstatuar, disa të meta e mangësi ku më kryesoret janë:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk kanë qenë plotësisht efektive në realizimin e objektivave mbi numrin e programeve të integritetit të buxhetimit gjinor ;
- në programet ekzistuese të ministrive planifikimi i Buxheti i Përgjigjshëm Gjinor nuk ka tregues me ndarje gjinore;
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive nuk ka qenë plotësisht efektive në aktivitetin e saj për punësimin e grave;
- konstatohen mungesa të nëpunësit gjinor lokal;
- MBZHR nuk ka një statistikë zyrtare mbi numrin e fermerëve burra, gra dhe pasiv;
- nuk janë hartuar udhëzime për të mundësuar konsolidimin e figurës së nëpunësit gjinor dhe shmangien e mbivendosjes së detyrave funksionale.

*Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrin institucionet përgjegjëse në drejtim të hartimit të planeve të veprimit për integrimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, monitorimit të buxhetimit të përgjithshëm gjinor në të gjitha nivelet e qeverisjes, përfshirjes në udhëzimin vjetor të buxhetit raportimin mbi Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor, mundësimin të konsolidimit të figurës së nëpunësit gjinor, etj., si dhe në përfundim të auditimit doli me mesazhin e auditimit: *Vendosja e parimit të barazisë gjinore si një parim thelbësor i ciklit buxhetor është e vetmja rrugë e duhur për të rrënjësuar kulturën e barazisë gjinore në vendin tonë. Për këtë qëllim institucionet duhet të angazhohen maksimalisht në drejtim të: rritjes së impaktit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor; promovimit dhe vendosjes treguesve të matshëm sasior e cilësor gjinor në buxhetet e institucioneve; koordinimit midis institucioneve për zbatimin e strategjive të barazisë gjinore dhe integrimin e tyre me strategjitë sektoriale; monitorimit të saktë të këtyre politikave për të konkretizuar angazhimin e grave në të gjitha fushat e ekonomisë të vendit tonë që sigurojnë fuqizimin e tyre.**

“Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus, gratë e dhunuara”, për vlerësimin dhe analizimin e masave të marra nga institucionet përgjegjëse, për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus gratë e dhunuara, bashkëpunimit midis aktorëve qendrorë dhe njësie të vetëqeverisjes vendore, respektimin e kërkesave ligjore për masat që duhen marrë dhe jo vetëm.

Auditimi u ushtrua në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucione në varësi të saj, Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me disa njësi varësie, Këshillin e Qarkut Tiranë si dhe Bashkitë Durrës, Gjirokastër dhe Kukës.

Dhuna ndaj grave, masat për parandalimin e saj dhe rehabilitimi i viktimave nga dhuna është një problem i qenësishëm në shoqërinë e vendit tonë. Politikat e miratuara kanë për qëllim kryesor të sigurojnë ndryshim afatgjatë të sjelljes dhe kulturës së shoqërisë ndaj këtij fenomeni dhe ofrimin e të gjitha shërbimeve të nevojshme ndaj viktimave të dhunës. Në bazë të Vrojtimeve më të fundit kombëtar të zhvilluar nga INSTAT¹² në vitin 2019, 1 në 2, apo 52,9% e grave të moshës 18-74 vjeç, kanë përjetuar “ndonjëherë” një apo më shumë nga pesë llojet e ndryshme të dhunës¹³ gjatë jetës së tyre. Ndërkohë që, dhuna në familje mbetet forma më e përhapur. Gjatë tre viteve të fundit pranë institucionit të Policisë së Shtetit regjistrohen çdo vit rreth 5,000 raste dhunës në familje, kjo me një tendencë të qëndrueshme.

Institucionet kanë një rol aktiv të dyfishtë: mbrojtës dhe parandalues si mënyra e vetme e komunikimit institucional në funksion të parandalimit të dhunës në familje dhe mbrojtjes së pjesëtarëve të familjes nga ky fenomen shkatërrimtar që ndodh në atë që është qeliza bazë e shoqërisë dhe që rrezikon të sjellë impakt negativ të veçantë në formimin dhe edukimin e brezit të ri nëse, nuk merren masat e duhura dhe në kohë.

Me gjithë punën e bërë nga institucionet përgjegjëse janë konstatuar, disa të meta e mangësi ku më kryesoret janë:

- Legjislacioni që trajton dhunën në familje ka mangësi në evidentimin e përgjegjësive;
- për referimin e rasteve të dhunës midis anëtarëve të Ekipit Teknik Ndërdisciplinor dhe Koordinatorëve Vendor në bashki ka munguar ndërveprimi dhe komunikimi;
- ndihmës specialistët/specialistët e krimeve në strukturat vendore të Policisë së Shtetit nuk janë të dedikuara të kryejnë vetëm menaxhimin fillestar të rasteve të dhunës në familje;
- në 37 bashki të vendit koordinatori vendor i dhunës nuk është i dedikuara për të mbuluar vetëm rastet e dhunës në familje;
- Sistemi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqërorë nuk përditësohet me të gjitha rastet e dhunës në familje;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe strukturat e saj të varësisë nuk disponojnë ende një vlerësim të kapaciteteve akomoduese në rang kombëtar;
- bonusi i qirasë për viktimat e dhunës në familje është në nivele minimale;
- Ministria e Drejtësisë nuk disponon ende një strukturë të posaçme e cila të koordinojë veprimtaritë e dhunës në familje.

*Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrin institucionet përgjegjëse për të ndikuar pozitivisht me masa parandaluese për dhunën ndaj grave, përmirësimi i mënyrës së menaxhimit të rasteve të dhunës ndaj grave në marrëdhëniet familjare nga institucionet e përfshira, mënyrës së raportimit, monitorimit të procesit, përmirësimi të kapaciteteve njerëzore dhe financiare etj, në mbështetje të sistemit, si dhe në përfundim të auditimit doli me mesazhin e auditimit: *Institucionet shtetërore të angazhuara kundër dhunës në familje është e nevojshme të bëjnë hapa përpara për promovimin e barazisë gjinore, për të siguruar shoqëri më të drejtë dhe të barabartë për të gjithë, pavarësisht nga gjinia.**

Dhuna në familje si një nga problematikat më të ndjeshme me të cilën po përballlet shoqëria shqiptare sot, paraqitet me një numër të lartë të rasteve të denoncuara në institucionet e shtetit. Kjo tregon një ndërgjegjësim gjithnjë e më të lartë shoqëror por gjithashtu rrit përgjegjësitë që shteti duhet të mbarti nëpërmjet mekanizmave të tij për të garantuar jetën dhe shëndetin e grave dhe vajzave, viktimat të dhunës në marrëdhëniet familjare.

¹²<https://www.instat.gov.al/statistikat-n%C3%AB-shkolla/dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/>

¹³ - dhuna në familje e ushtruar nga partneri, dhuna gjatë marrëdhënieve dashurore, dhuna nga jo-partneri, ngacmimi seksual dhe përndjekja.

Mekanizmi i ngritur në nivel kombëtar për dhunën në familje nuk ka arritur t'i përgjigjet në mënyrë të përshtatshme rasteve të paraqitura, çka paraqet nevojën për një vlerësim të qartë dhe objektiv të situatës nga të gjithë aktorët e përfshirë, përmirësim të proceseve ekzistuese si dhe marrjen e masave të përshtatshme, për përgjigjen në mënyrë të denjë qytetarëve në nevojë, dhe për t'i mbështetur në tejkalimin e problematikave të tyre sociale.

“Kujdesi ndaj të moshuarve”, për vlerësimin e rolit dhe përgjegjësi të institucioneve, për një angazhim më të madh dhe një bashkëpunim më të mirë ndër-institucional, i cili do të mundësonte një mjedis të sigurt, përkujdesje cilësore, dhe jetesë aktive, në përputhje me kërkesat dhe nevojat specifike të të moshuarve, duke përmirësuar cilësinë e jetës, nxitur integrimin social në jetën shoqërore dhe respektuar të drejtat e të moshuarve.

Auditim u ushtrua në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimin Social Shtetëror dhe Institucionet Rezidenciale për të moshuar në Tiranë, Shkodër si dhe në Institucionet Rezidenciale për të moshuar nën administrim të bashkive Fier, Gjirokastrë, Kavajë dhe Poliçan. Kujdesi për të moshuarit është një detyrim sa familjar e shoqëror aq edhe shtetëror. Në vitet 90 moshë mbi 65 vjeç përbënte rreth 3.5% të popullsisë, ndërkohë që sot ka arritur në 13% e saj.¹⁴

Për këtë arsye, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se vendi jonë nuk trashëgon nga e kaluara një sistem tradicional e të integruar të kujdesit shëndetësor e social për të moshuarit, në fund të vitit 2019 qeveria hartoi një “Plan Kombëtar Moshimit 2020-2024”, i cili synon harmonizimin e politikave, koordinimin e përpjekjeve dhe rritjen e efektivitetit të burimeve ekzistuese në kuadër të kujdesit dhe integritit social të moshuarve.

Shërbimit Social Shtetëror ka si mision kryesor të tyre ofrimin e përkujdesit mbi bazën e Standardeve të miratuara për të moshuarit, duke përmirësuar cilësinë e jetës, nxitur integrimin social, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Duke marrë në konsideratë faktin se zbutja e problemeve sociale e shëndetësore që përjetojnë të moshuarit është faktor i rëndësishëm për të garantuar rritjen e cilësisë së shërbimit në institucionet rezidenciale specifike që trajtojnë të moshuarit, modernizimin dhe ndryshimin e kushteve të jetës, përmirësimin e cilësisë së standardeve të shërbimit, trajtimin e tyre në kushte sa më optimale, etj., auditimi merr një rëndësi të veçantë dhe specifike, me qëllim evidentimin objektiv të situatës aktuale dhe përmirësimin e shërbimeve të ofruara në vijimësi.

Me gjithë punën e bërë nga institucionet përgjegjëse janë konstatuar, disa të meta e mangësi ku më kryesoret janë:

Në Institucionet Rezidenciale Publike për të moshuarit:

- nuk kanë kapacitete të mjaftueshme njerëzore, të domosdoshme për të ofruar shërbimet sipas standardeve të përkujdesit shoqëror;
- nuk kanë kushte infrastrukturore sipas standardeve dhe nuk i janë alokuar fonde për kryerjen e investimeve në ndërtesa të reja, përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese, pajisjeve, orendive etj.;
- nuk parashikohet ekzaminimi, kryerja e konsultave dhe vizitave periodike nga mjekë specialistë apo dhe vizita dentare sipas nevojave të tyre;
- nuk kanë në dispozicion një automjet për transportimin në rast emergjence;
- Sistemi i shërbimit social shtetëror nuk ofron qendra rezidenciale të veçanta për persona jo-autosuficientë dhe mjek psikiatër;
- Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk kanë hartuar një metodologji për procesin e planifikimit dhe përcaktimit të listës së medikamenteve

14 https://www.instat.gov.al/media/1734/mplakja_e_popullsis_situata_e_te_moshuarve_ne_shqip_ri.pdf;

sipas nevojave që mund të mbulohen me buxhetin e institucioneve rezidenciale dhe mbahen në infermierinë e tyre.

Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrin institucionet përgjegjëse për përmirësimin e sistemit të kujdesit ndaj të moshuarve, kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukture, në garantimin nga institucionet rezidenciale për të moshuar, nxitjes dhe ruajtjes së shëndetit të moshuarve etj., në mbështetje të sistemit, si dhe në përfundim të auditimit doli me mesazhin e auditimit: “Shërbimi Social Shtetëror, qeverisja vendore dhe Institucionet Rezidenciale për të moshuar duhet të respektojnë standardet e kujdesit shoqëror për të moshuarit. Për këtë qëllim kërkohet një angazhim më i madh dhe një bashkëpunim më i mirë ndërinstytucional, i cili do të mundësonte një mjedis të sigurt, përkujdesje cilësore, dhe jetesë aktive, në përputhje me kërkesat dhe nevojat specifike të të moshuarve”.

5. Në fushën e drejtësisë, zvogëlimit pabarazisë dhe ndërtimit të institucioneve të forta. Nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta me institucionet shtetërore për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe siguruar zbatimin e ligjit në mënyrë të drejtë dhe efikase kemi mundësuar me 3 auditime të performancës në fushën e drejtësisë, zvogëlimit të pabarazisë dhe ndërtimit të institucioneve, nga ku konstatohet se:

“*Shërbimi i Policisë në Përgjigje të Qytetarëve*”, për vlerësimin e performancës së veprimtarisë strukturave përgjegjëse policore në përgjigje të qytetarëve të cilët raportojnë, denoncojnë apo përcjellin ankesat e tyre për trajtim në Policinë e Shtetit nëpërmjet kanaleve të komunikimit të saj, me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor në mbrojtje dhe respektim të drejtave të njeriut, si objektiva të rëndësishme në ndërtimin e një shoqërie të sigurt dhe të drejtë për të gjithë qytetarët.

Auditim u ushtrua në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtoritë Vendore të Policisë Tiranë, Durrës dhe Shkodër.

Policia e Shtetit pas vitit 1999, i është nënshtruar një procesi të vazhdueshëm reformimi, i cili synon ta shndërrojë atë në një shërbim publik. Sipas Progres raportit të BE-së për vendin tonë, aktualisht Policia e Shtetit nuk garanton numër të mjaftueshëm oficerësh policie për 100.000 banorë, gjë kjo ndikon në kapacitetin e këtij institucioni për të mbuluar me shërbime të gjithë territorin e vendit sipas problematikave specifike që mund të ekzistojnë. Evidentohet gjithashtu edhe rotacion i shpeshtë i stafit si një çështje që ndikon në kapacitetin operacional të këtij institucioni.¹⁵ Gjithashtu në këtë raport tërhiqet vëmendja mbi nismën kombëtare për shtrirjen e numrit unik të emergjencave 112 në të gjithë territorin e Shqipërisë, i cili ende nuk është konkretizuar duke nisur nga fakti se ky numër është i aksesueshëm për qytetarët vetëm për qytetin e Tiranës dhe pjesërisht në zonat jashtë tij. Gjithashtu në median vizive dhe të shkruar vazhdojnë të raportohen problematika lidhur me aftësinë e Policisë së Shtetit për tu përgjigjur qytetarëve.

Me gjithë punën e bërë nga institucionet përgjegjëse janë konstatuar, disa të meta e mangësi ku më kryesoret janë:

- Policia e Shtetit nuk ka përditësuar procedurat standarde për trajtimin e ankesave anonime ndaj punonjësve të policisë së shtetit, nuk ka përmirësuar raportin midis forcave të policisë dhe numrit të popullsisë si dhe konstatohet rotacion i lartë i stafit të punonjësve të policisë;
- sistemi i numrit 112 funksionon si sistem teknologjik për administrimin e thirrjeve emergjente vetëm në Tiranë si dhe niveli i realizimit të angazhimeve financiare për ngritjen dhe vendosjen në funksion të tij është 54%;
- operatorët e sallës së komandimit në DVP Tiranë nuk arrijnë të plotësojnë gjithmonë me të dhënat e telefonatës sistemin e regjistrimit;

¹⁵ Albania Progress Report 2022, page 39.

- ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Sigurisë në Komunitet nuk është realizuar sipas planifikimeve të kryera nga Policia e Shtetit.

Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrin institucionet përgjegjëse të Policisë së Shtetit për përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe komunitetit, në përditësimin e bazë ligjore dhe rregullatorë, planifikim më të mirë të aktiviteteve dhe burimet të nevojshme, të funksionimit në mënyrë të plotë të kanaleve e komunikimit midis qytetarëve dhe strukturave policore, etj., si dhe në përfundim të auditimit doli me mesazhin e auditimit: “Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit dhe strukturat e varësisë të nxisin një angazhim të vazhdueshëm e qëndrueshëm në përmirësimin e ofrimit të shërbimit sa më cilësor ndaj qytetarëve, duke kërkuar: procedura e rregulla të qarta dhe të njohura nga të gjithë punonjësit e policisë e qytetarët; ndërtimin e një sistemi efikas për të pranuar dhe trajtuar ankesat e qytetarëve; shtrirjen, përdorimin dhe përgjigjen në kohën më të shkurtër të telefonatave nëpërmjet numrit të unifikuar të emergjencave 112 dhe mirë administrimin e tij; monitorimin e veprimeve të policisë në linjë me parimet e policimit në komunitet, në mbrojtje dhe respektim të drejtave të njeriut, si objektiva të rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie të sigurt dhe të drejtë për të gjithë qytetarët.”

“Ndhima juridike falas për personat në nevojë”, për vlerësimin e politikave dhe efektivitetit të tyre në funksion të garantimit të aksesit të barabartë në gjykatë, duke u fokusuar kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë që Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka. Gjithashtu u synua një vlerësim i aktorëve të përfshirë në proces, në drejtim të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas dhe monitorimit të cilësisë së shërbimit të ofruar kah përfituesve të skemës.

Auditimi u ushtrua në Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.

Në kuadrin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përfshihet edhe e drejta për t’iu drejtuar gjykatës (aksesit në gjykatë).

Në vendin tonë, deri në vitin 2008, ndihma juridike parashikohej vetëm në legjislacionin penal, në kuadër të “mbrojtjes së detyruar”. Më pas, për herë të parë, në vitin 2008 u hartua një ligj specifik për ndihmën juridike nr. 10039/2008. Megjithatë, pavarësisht miratimit të një ligji specifik që sanksionon ndihmën juridike falas, aksesit në drejtësi nuk ishte efektiv, duke diktuar kështu nevojën për ndryshime dhe përmirësime të legjislacionit. Në këto kushte, një nga risitë që solli reforma në drejtësi ishte Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili parashikon format, kushtet, procedura dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike falas.

Ndhima juridike falas e garantuar nga shteti ofrohet në mënyrë taksative vetëm për personat që përmbushin kriteret për të qenë përfitues të kësaj skeme.¹⁶ Ky shërbim jepet në formën e ndihmës juridike parësore (konsulenca juridike) dhe dytësore (përfaqësimi në gjykatë), përjashtimit nga pagimi i tarifave gjyqësore & shpenzimeve gjyqësore dhe përjashtimit nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrat të ekzekutimit.

Duke marrë në konsideratë faktin se ofrimi i ndihmës juridike parësore dhe dytësore për personat në nevojë apo kategoritë përfituese është faktor i rëndësishëm për të garantuar drejtësinë dhe të drejtat e tyre me karakter personal, auditimi merr një rëndësi të veçantë.

Me gjithë punën e bërë nga institucionet përgjegjëse janë konstatuar, disa të meta e mangësi ku më kryesoret janë:

- nuk është kryer analizë, për përcaktimin e kriterit të pamjaftueshmërisë financiare dhe përfitimit të ndihmës juridike falas;

¹⁶ Personat në pamjaftueshmëri financiare dhe kategoritë e veçanta, të parashikuara specifikisht në nenin 10 dhe 11 të Ligjit nr. 111/2017 “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti”;

- struktura monitoruese për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të ndihmës juridike në Drejtoria e Ndihmës Juridike përbëhet vetëm nga 2 specialistë;
- Drejtoria e Ndihmës Juridike nuk ka strukturë apo person përgjegjës që trajton ankesat e qytetarëve si dhe një plan veprimi me synim rritjen e numrit të Organizatave Jo-Fitimprurëse të autorizuara që ofrojnë ndihmë juridike parësore;
- klinikat e ligjit nuk kanë ofruar shërbim gjatë vitit 2022.

Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrin institucionet përgjegjëse në garantimin nga sistemi i drejtësisë i ofrimit të ndihmës juridike falas të barabartë për të gjithë individët, në përmirësimin e organizimit të sistemit të ofrimit të ndihmës juridike falas në funksion të realizimit të të drejtave të qytetarëve, në përmirësimin e kushteve infrastrukturore, aksesit të barabartë në drejtësi për personat në nevojë, etj., si dhe në përfundim të auditimit doli me mesazhin e auditimit: “Garantimi i aksesit të barabartë në drejtësi për personat në nevojë sigurohet nëpërmjet ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtat e tyre dhe ofrimit të një shërbimi cilësor të asistencës ligjore. Për realizimin e këtij qëllimi, kërkohet një angazhim më i madh i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në kryerjen e monitorimeve efektive ndaj ofruesve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, i cili do të mundësonte nxitjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garantimin e kushteve infrastrukturore në përputhje me standardet e miratuara.”

“Shërbimi përmbartimor shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore” për vlerësimin e politikave dhe efektivitetin e tyre në funksion të sigurimit të shërbimeve përmbartimore për individët. Gjithashtu në rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse në realizimin e objektivave dhe ofrimit të shërbimeve përmbartimore me cilësinë e duhur dhe brenda një kohe të arsyeshme, me qëllim garantimin e të drejtave të qytetarëve.

Auditimi u ushtrua në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit Shtetëror.

Një parim i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor është “afati i arsyeshëm ligjor në procesin gjyqësor”, i cili sanksionohet në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Për rrjedhojë, vonesat e tepruara për vënien në vend të drejtësisë përbëjnë një rrezik të konsiderueshëm në respektimin e shtetit ligjor dhe garantimin e të drejtave të njeriut. Parimi i afatit të arsyeshëm ligjor shtrihet edhe mbi fazën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe nuk lidhet vetëm me fazën e shqyrtimit gjyqësor. Një vendimmarrje e drejtë dhe efektive nënkupton jo vetëm dhënien e një vendimi nga gjykata, por njëkohësisht edhe ekzekutimin e tij në respektim të plotë të afateve procedurale. Në këto kushte, pritshmëria e lartë e opinionit publik për një sistem drejtësie efektiv, cilësor dhe të aksesueshëm nga shtetasit në të gjitha nivelet kërkon një performancë të lartë edhe të shërbimit përmbartimor në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nëpërmjet urdhrave të ekzekutimit.

Në këto kushte, shërbimi i përmbartimit gjyqësor shtetëror duhet të garantoj ekzekutimin e titujve ekzekutivë, në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe objektivitetit brenda afateve procedurale të përcaktuara, si dhe në respektim të të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj subjekteve që marrin pjesë në ekzekutim.

Me gjithë punën e bërë nga institucionet përgjegjëse janë konstatuar, disa të meta e mangësi ku më kryesoret janë:

- mungesa e një dokumenti strategjik institucional si dhe e një baze ligjore e nënligjore të pa përditësuar;
- evidentohet mbingarkesa e përmbartuesve me çështje të mbartura, ka mangësi në kushtet infrastrukturore si dhe vështirësi në lajmërimin e debitorëve për shkak të pasaktësive të adresave;
- ka vakum ligjor sa i përket mbulimit të shpenzimeve të ekspertëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve për personat në pamjaftueshmëri financiare;

- evidentohet numër i madh debitorësh të cilët nuk paguajnë detyrimin ushqimor për shkak të emigrimit të cilëve nuk u rezulton pasuri e sekuestrueshme;
- pengesa në kuadër të ekzekutimit të detyrueshëm të vendimeve për shkak të mungesës së bashkëpunimit me institucionet shtetërore, si p.sh. ASHK, DPSHTRR, IKM etj.

Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrin institucionet përgjegjëse në garantimin e ofrimit të shërbimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore nga përmbarimi shtetëror, në mirë organizimin e sistemit të përmbarimit shtetëror dhe hartimin e kuadri rregullator të nevojshëm në respektim të afateve procedurale, me qëllim ofrimin e një shërbimi përmbarimor cilësor ndaj qytetarëve, etj., si dhe në përfundim të auditimit doli me mesazhin e auditimit: “Për të siguruar mirë funksionimin e sistemit të përmbarimit shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit duhet të krijojë një frymë të re bashkëpunimi me të gjitha institucionet e përfshira në ekzekutimin e vendimeve, në përputhje me ligjin e ri organik, në drejtim të rritjes së cilësisë së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, garantimit të të drejtave të qytetarëve dhe përmirësimit të shërbimit të ofruar.”

“Performanca e Shërbimit të Paraburgimit” për vlerësimin e politikave dhe efektivitetit të tyre në realizimin e objektivave në funksion të mbrojtjes dhe garantimit të shërbimeve ndaj personave të paraburgosur, të drejtave dhe ri integrimin e tyre në shoqëri.

Auditimi u ushtrua në Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, si dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë.

E drejta për liri dhe siguri, si edhe të drejtat e personave të ndaluar dhe të arrestuar, në pritje të një vendimi gjyqësor, parashikohen në një sërë aktesh ndërkombëtare, si: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të drejtat Civile dhe Politike, Rregullat Minimum Standarde për Trajtimin e të Burgosurve, Rregullat Minimum Standarde mbi Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (*Rregullat Beijing*), Konventa Evropiane për të Drejtat të Njeriut dhe Liritë Themelore etj..

Bazuar në të dhënat statistikore të përpunuara, konstatohet rritje e të paraburgosurve, krahasuar me të dënuarit me burgim, çka ka sjellë edhe trajtimin e tyre jo korrekt e degradues, në implementimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor për trajtim njerëzor të personave me liri të kufizuar, si rezultat i kushteve jo të përshtatshme infrastrukturore, kapaciteteve të kufizuara për akomodimin. Përdorimi i zgjeruar i masës së sigurisë “*arrest me burg*” shpesh është një simptomë e mosfunksionimit të sistemit të drejtësisë penale, e cila rrishton mbrojtjen e të drejtave të paraburgosurve.

Me gjithë punën e bërë nga institucionet përgjegjëse janë konstatuar, disa të meta e mangësi ku më kryesoret janë:

- evidentohet rritje e numrit të personave të paraburgosur;
- në mos hartimin dhe miratimin e skemës dhe standardeve për mbikëqyrjen e rregullt psikologjike për stafet e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale;
- nuk ka analizë dhe shpërndarje proporcionale të paraburgosurve, sipas kapaciteteve dhe infrastrukturës së ngritur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale;
- IEVP-të kanë numër të lartë të vendeve të punës të paplotësuar me staf policor;
- kushtet që ju ofrohen personave të paraburgosur në IEVP-të nuk përmbushin plotësisht standardet kombëtare e ndërkombëtare në respektim të dinjitetit njerëzor.

Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrin institucionet përgjegjëse në drejtim të hartimit të politikave dhe sigurimit të kushteve të përshtatshme për të paraburgosurit, në përputhje me standardet ndërkombëtare; hartimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të personave të paraburgosur; për sigurimin e kushteve infrastrukturore të nevojshme për

personat e paraburgosur; rritjen e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit në mënyrë integrale të institucioneve, në funksion të garantimit të të drejtave për personat e paraburgosur, etj., si dhe në përfundim të auditimit doli me mesazhin e auditimit: *“Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale duhet të luajnë një rol proaktiv në garantimin e të drejtave të shtetasve të paraburgosur, nëpërmjet krijimit të një qasje të re, me qëllim ruajtjen e shëndetit të tyre, vetë respektit dhe dinjitetit njerëzor. Sistemi penitenciar ka nevojë edhe për një bashkëveprim më dinamik ndërmjet institucioneve shtetërore përgjegjëse, veçanërisht midis Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.”*

6. Në fushën e ekonomisë dhe sigurisë. Auditimi i performancës në këtë fushë ka vlerësuar investimet në infrastrukturë dhe kapacitetet për menaxhimin e emergjencave, që ekonomia të sigurojë të jetë e aftë për të përballuar situata emergjente dhe garantuar disponueshmërinë e rezervave materiale për të gjithë qytetarët në momente të krizave, nga ku konstatojmë se:

“Rezervat e shtetit në shërbim të qytetarit”, për vlerësimin e politikave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse dhe efektivitetin e tyre në funksion të garantimit të rezervës materiale dhe miradministrimin e saj si dhe proceset administrative që garantojnë miradministrimin e rezervës materiale të shtetit si një garanci për qytetarin.

Auditim u zhvillua në Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe Drejtoritë Rajonale në varësi të saj.

Një qeverisje e mirë nëpërmjet institucioneve dhe instrumentave që përdor, garanton jetën, shëndetin dhe përmirëson cilësinë e jetës së qytetarëve të vet. Në situatat e emergjencës civile, rezervat materiale të shtetit janë një instrument që kontribuon në funksionimin e *“shtetit të mirë”*, i cili në kushte jo të zakonshme i siguron dhe garanton jetën dhe shëndetin qytetarit. Rezerva materiale e shtetit krijohet për të ndërhyrë në mënyrë operative, për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe mbrojtjen e vendit, në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, veprimeve terroriste, veprimeve ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin. Infrastruktura për rezervën materiale luan rol të rëndësishëm në ruajtjen e shpërndarjen në kohën e duhur të mallrave, në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme dhe emergjencës civile.

Misioni primar i rezervës materiale të shtetit është garantimi i listës së mallrave të përcaktuar dhe përgjigja e shpejtë ndaj qytetarit në situatat e parashikuara. Përfshirja e institucioneve që garantojnë rezervën materiale të shtetit në aktivitete dytësore, zhvendos fokusin drejt tyre dhe rrezikon përmbushjen e misionit për të cilin janë krijuar.

Me gjithë punën e bërë nga institucionet përgjegjëse janë konstatuar, disa të meta e mangësi ku më kryesoret janë:

- Ministria e Mbrojtjes nuk ka përfshirë në dokumentet politikë rezervën materiale të shtetit;
- kuadri ligjor dhe rregullator i rezervës materiale të shtetit nuk është i përditësuar;
- gjendja e mallrave rezervë materiale shtetërore është nën kufijtë e përcaktuara në VKM nr.1128 datë 05.08.2008 *“Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”*;
- nuk ka qartësi mbi mënyrën se si do të administrohen pasuritë e paluajtshme të rezervave materiale dhe regjistrimi i tyre;
- institucionet që administrojnë rezervën materiale shtetërore janë përqendruar kryesisht në kryerjen e aktivitetit dytësor për ruajtjen dhe shitjen e mallrave të sekuestruara dhe konfiskuara, duke krijuar hapësira në përmbushjen e qëllimit dhe misionit kryesor të krijimit të tyre;
- territori dhe ndërtesat e njësisë kryesore të rezervës materiale me vendndodhje në Lundër, Tiranë i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Fondit Shqiptar të Zhvillimit, pa zgjidhur garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit.

Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrin institucionet përgjegjës

në drejtim të garantimit të rezervës materiale të shtetit për qytetarët, përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullator, përcaktimit të roleve dhe përgjegjësi të qarta të institucioneve të përfshira, në përmirësimin e mekanizmi i ngritur në funksion të rezervës materiale të shtetit, etj., si dhe në përfundim të auditimit doli me mesazhin e auditimit: *Institucionet përgjegjëse duhet të përdorin gjithë instrumentet në dispozicion për të përmbushur pritshmërinë e qytetarit lidhur me sigurinë që ato duhet të ofrojnë për jetën dhe shëndetin e tyre.*

Rezerva materiale e shtetit si një garanci për qytetarin, duhet të përmbushë plotësisht misionin për të cilin është krijuar. Kalimi nën përgjegjësinë e Ministrisë së Mbrojtjes, duhet të sjellë zhvillime pozitive, të cilat ti shërbejnë forcimit të rolit të saj. Orientimi i veprimtarisë së strukturave përgjegjëse, burimet njerëzore dhe financiare duhet të fokusohet drejt aktivitetit parësor për përballimin e situatave të parashikuara. Asetet e trashëguara, pasuri kombëtare, duhet të administrohen për të qenë një vlerë e shtuar në rezervën materiale të shtetit. Parë nga perspektiva e zhvillimeve gjeopolitike, ndryshimeve klimaterike dhe demografike përmbushja e kufijve minimalë të përcaktuar të rezervës materiale e shtetit, duhet të jetë garanci për qytetarin.

7. Në fushën e teknologjisë dhe inovacionit. Në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, objektivat janë të përqendruara në përparimin dhe përdorimin e teknologjisë për të përmirësuar jetën e njerëzve, për të rritur konkurrueshmërinë ekonomike dhe për të zgjidhur sfidat komplekse shoqërore dhe mjedisore e në këtë fokus është realizuar një auditim performace, nga ku është konstatuar se:

“Performanca e ofrimit të shërbimeve on-line”, për vlerësimin e institucioneve përgjegjës në garantimin dhe ofrimin në kohë dhe me cilësi të marrjes së shërbimeve on line për qytetarin dhe bizneset nëpërmjet Portalit Unik Qeveritar E–Albania si dhe përmirësimit të zhvillimit të infrastrukturës, rritjes së sigurisë kibernetike dhe aftësive të përparuara digjitale etj.

Auditimi u ushtrua në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Qeverisja dixhitale është një tregues i rëndësishëm i mirëqenies së qytetarëve të një vendi. Vendi ynë është ndër vendet e para të rajonit që i ofron shërbimet me dokumente përmes platformës kombëtare digjitale. Çdo ditë janë me qindra qytetarë që kërkojnë të marrin shërbime nga strukturat përkatëse pranë institucioneve publike. Deri më 1 Maj 2022 shërbimet ofroheshin online nëpërmjet portalit e-Albania apo në qendrat one-stop-shop që funksiononin në pjesën më të madhe të bashkive. Nga data 1 Maj 2022 me vendim të qeverisë 95% e shërbimeve ndaj qytetarëve ofrohen vetëm online.

Portali Unik Qeveritar E-Albania vepron si një pikë e vetme për ofrimin e shërbimeve publike të institucioneve qeveritare, duke shërbyer kështu si një pikë e vetme hyrëse për qytetarët 24/7 dhe është e lidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit e cila lejon ndërveprimin midis 58 sistemeve elektronike të institucioneve publike.

Përmirësimi i këtij sistemi nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës, rritjes së sigurisë kibernetike dhe aftësive të përparuara digjitale, do të ndikojnë në rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Me gjithë punën e bërë nga institucionet përgjegjëse janë konstatuar, disa të meta e mangësi ku më kryesoret janë:

- në drejtim të procesit të hartimit të planeve të monitorimit nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit si dhe në plotësimin e vendeve të punës me ekspertë të fushës;
- nuk ka bashkëpunim ndërmjet institucioneve shtetërore në marrjen e informacionit të detajuar me përshtatjen e shërbimeve që ofrojnë ato për përmirësimin e sistemeve elektronike ekzistuese;
- u konstatua mos respektimi i afateve të ndryshimeve ligjore në sistemet elektronike të institucioneve;
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe 75 institucione të administratës shtetërore nuk kanë bashkëvepruar për transferimin e aseteve;
- në rritjen e investimeve nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së sistemeve digjitale të institucioneve.

Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrin institucionet përgjegjës

në drejtim të përmirësimit të procesit të digjitalizimit të ofrimit të shërbimeve publike on-line për qytetarët dhe bizneset, mirë përcaktimit të roleve dhe përgjegjësive të institucioneve publike, kryerjes së investimeve në drejtim të reduktimit të kohës dhe kostove të shërbimeve në mënyrë elektronike etj., si dhe në përfundim të auditimit doli me mesazhin e auditimit: *Agjenda Digjitale e Shqipërisë për të përmirësuar dhe zgjeruar përdorimin e teknologjisë informative dhe komunikuese në vend, është një sfidë për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe për institucionet shtetërore, të cilat nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës, rritjes së sigurisë kibernetike dhe aftësive të përparuara digjitale, do të ndikojnë në rritjen e mirëqenies së qytetarëve.*

Për të arritur këto objektiva Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe institucionet e tjera të përfshira në procesin e digjitalizimit duhet të sigurojnë zgjidhjet më të mira për qytetarët dhe bizneset, në përputhje me standardet teknologjike dhe protokollet e komunikimit të ndryshme, orientimit të drejtë të planifikimit dhe shpërndarjes së fondeve të buxhetit, investimeve si dhe transferimit të infrastrukturave të sistemit TIK.

8. Në fushën e kulturës. Kemi audituar në fushën e kulturës dhe mbrojtjes së drejtës së autorit në përmbushjen e nevojave të artistëve dhe krijuesve në mbrojtjen e të drejtave të krijimtarisë tyre artistike. Gjithashtu të promovojmë inovacionin dhe krijimtarinë në fushën e kulturës, të krijojnë një mjedis të favorshëm për krijuesit dhe artistët, duke i inkurajuar ata të vazhdojnë të krijojnë dhe të inovojnë në fushën e kulturës, ndërkohë të respektohen dhe të mbrohen të drejtat për krijimtarinë e tyre.

“Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit”, për vlerësimin e politikave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse në garantimin, miradministrimit dhe vazhdimësinë e procesit të mbrojtjes së interesave të krijuesve dhe artistëve në përputhje me ligjin. Auditimi u ushtrua në Ministrinë e Kulturës, Autoritetin e Mediave Audiovizive dhe Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.

E drejta e autorit një është një e drejtë thelbësore për krijimtarinë njerëzore dhe zhvillimin e shoqërisë demokratike. Garantimi i kësaj të drejte nxit veprimtarinë e krijuesve, jo vetëm nëpërmjet njohjes por dhe shpërblimit ekonomik të aktivitetit të tyre, si dhe garanton që veprat e tyre mund të shpërndahen pa frikën e kopjimit të paautorizuar dhe piraterisë. Analizimi i veprimtarisë së institucioneve shtetërore që garantojnë normat juridike të drejtës së autorit, është i domosdoshëm për të mbrojtur interesat morale dhe materiale që rrjedhin nga çdo krijimtari artistike, shkencore dhe letrare, autor i të cilave është ai vetë. Ndjeshmëria dhe ndërgjegjësimi qytetar për njohjen dhe respektimin e kësaj të drejte, rezulton me deficite, si në nivel shoqëror, ashtu dhe institucional.

Me gjithë punën e bërë nga institucionet përgjegjëse janë konstatuar, disa të meta e mangësi ku më kryesoret janë:

- nuk është përafruar plotësisht kuadri rregullator për të drejtën e autorit me direktivat e BE-së si dhe konstatohet mbivendosje kompetencash;
- nuk ka një marrëveshje midis shoqatave për rishikimin e metodologjisë dhe masës së shpërblimit të tarifave për mbajtësit e të drejtave të autorit;
- Sporteli Unik i Administrimit të të Drejtës së Autorit është larg objektivit të gjurmimit dhe denoncimit të shkelësve të së drejtës;
- ka paqartësi të kompetencave dhe koordinim të pamjaftueshëm të ndërveprimeve institucionale ndërmjet Drejtorisë për të Drejtën e Autorit, Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoritetit të Mediave Audiovizuale, të ngarkuara me mbrojtjen dhe garantimin e së të drejtës së autorit.

*Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrin institucionet përgjegjëse në drejtim të përmirësimit të kuadrit rregullator, procesit të administrimit, mbikëqyrjes së administrimit kolektiv, koordinimi dhe bashkëpunimit ndërinstitucional për mbrojtjen e të drejtës së autorit, etj., si dhe në përfundim të auditimit doli me mesazhin e auditimit: *Ministria e Kulturës, institucionet**

shtetërore dhe organizatat joqeveritare, duhet të rrisin më shumë bashkëveprimin për, mbrojtjen, promovimin dhe garantimin e të drejtës së autorit nëpërmjet, forcimit të legjislacionit, harmonizimit të praktikave më të mira ndërkombëtare dhe marrjen e masave ligjore, nëse vepra e tij kopjohet, përdoret pa leje, ose shkelet ndonjë aspekt tjetër.

E drejta e autorit në vendin tonë, vijon të ketë paqartësi ligjore në kuadrin rregullator ekzistues të cilat kanë sjellë objektiva pjesërisht të realizuara. Përafrimi i vonuar me direktivat e BE – së, mungesa e një strategjie të dedikuar, mungesa e marrëveshjeve dhe koordinimit ndërinstytucional, kanë shkaktuar mbivendosje kompetencash midis institucioneve përgjegjëse, lidhur me administrimin, monitorimin/inspektimin, tejkalimin e kostove të administrimit të Agjencive të Administrimit Kolektiv të Drejtave, në raport me nivelin e shpërndarjeve të shpërblimeve tek mbajtësit e të drejtave të autorit. Mosrespektimi i detyrimeve të licencave të Agjencive të Administrimit Kolektiv, mungesa e transparencës dhe besueshmërisë ndërmjet autorëve dhe agjencive, mungesa e gjurmimit dhe evidentimit të përdoruesve të veprave, nuk garantojnë administrim korrekt dhe mbrojtje efektive të së drejtës së autorit.

E. Auditime të Teknologjisë së Informacionit

Auditimet në fushën e teknologjisë së informacionit kanë pasur në fokus vlerësimin nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet TI, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të, kryesisht për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri më datë 30.09.2022.

1. Në Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a. Në përfundim të auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit është konstatuar se, mungojnë strategjia, politikat dhe aktet rregullativë që përcaktojnë drejtimin, përgjegjësitë dhe detyrimet mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit. Gjithashtu, ka munguar një planifikim dhe zhvillim në shërbime të reja informatike, që do të ndihmonin shoqërinë për arritjen e objektivave institucionale. Hapat e ndërmarrë në drejtim të rritjes së përdorimit, përmirësimit dhe sigurisë së shërbimeve që ofrohen nëpërmjet teknologjisë së informacionit janë të pamjaftueshëm, për të hyrë në procesin e sigurisë së të dhënave dhe vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve pa ndërprerje. Megjithëse nuk ka pasur problematika të mëdha në të dhënat elektronike, mundësia për humbjen e tyre, ndërprerjen apo tjetërsimin është e lartë.

2. Në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial. Në përfundim të auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit është konstatuar se, mungesa e strategjisë, akteve rregullative, pajisjeve kompjuterike dhe internetit në tabletat për inspektim, problematikat në funksionalitetet e sistemit “e-inspektimi”, janë disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar në cilësinë dhe saktësinë e të dhënave që gjeneron Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Sistemi e-inspektimi vazhdimisht punon me ndërprerje dhe ka probleme gjatë procesit të inspektimit duke ndikuar negativisht në veprimtarinë e punës së inspektorëve në ofrimin e shërbimeve kundrejt bizneseve dhe qytetareve.

Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në infrastrukturën network dhe atë kompjuterike është i pamjaftueshëm, si dhe shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në ISHTI mbështeten në një infrastrukturë TI jo të konsoliduar.

3. Në Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Në përfundim të auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit është konstatuar se, investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur problemet e sigurisë së informacionit, si dhe sigurimin e vazhdueshmërisë së biznesit. Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës nuk është mbështetur në praktikën më të mira.

Pajisjet fizike, programet softuerike të cilat ndërveprojnë në mënyrë që sistemet të operojnë, janë të pa përditësuara (në fund të jetës) e nuk ofrohet suport nga prodhuesi. Nga auditimi i sistemeve kryesore,

duke u bazuar në performancën e veprimeve me tregues si: koha e përgjigjes, koha e përpunimit, përdorimi i burimeve të sistemit, komentet e përdoruesve, rezultojnë se sistemet i përgjigjen me vonesë kërkesave të përdoruesve.

Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave, si dhe të vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet Teknologjisë së Informacionit është i pamjaftueshëm.

ISSH nuk ka marrë masa për kalimin e strukturave përgjegjëse TIK tek AKSHI, si dhe dorëzimin e Sistemeve dhe Infrastrukturës TIK ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosura në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

4. Në Rrjetin Akademik Shqiptar. Në përfundim të auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit është konstatuar se, Rrjeti Akademik Shqiptar është i vetmi institucion në vend që ka zhvilluar dhe ndërtuar disa sisteme informatike me programues të cilët janë punonjës të institucionit, duke ofruar zgjidhje në informatizimin e proceseve të administrimit të brendshëm dhe akademik të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe informatizime të rëndësishme për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Për Rrjetin Akademik Shqiptar nuk është financuar asnjë e ardhur nga buxheti i shtetit apo buxhetet e universiteteve, me qëllim mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve informatike që ka ndërtuar dhe ofron për Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Nga Ministria e Arsimit dhe Institucionet e Arsimit të Lartë Publik, megjithëse si institucione themeluese të RASH, nuk është zbatuar pika 5/c e VKM-së nr.88, datë 14.02.2018, në të cilën ato përcaktohen si burime të financimit të Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, duke vendosur institucionin në kushtet e riskut të ekzistencës së tij dhe të zhvillimeve e produkteve informatike të rëndësishme që ka ofruar deri tani.

5. Në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Në përfundim të auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit është konstatuar se, me gjithë përpjekjet dhe investimet e kryera në fushën e teknologjisë nga ana e FSDKSH-së, situata në këtë drejtim nuk është e konsoliduar. Nisur nga ky fakt, zhvillimi i sistemeve ndër vite nuk është zhvilluar sipas një planifikimi strategjik afatgjatë. Nga ana tjetër, si rezultat i investimeve në sistemet e reja, disa prej sistemeve ekzistuese nuk gjejnë përdorim pasi funksionalitetet e tyre janë zëvendësuar nga sistemet e reja. Megjithatë, edhe sistemet e reja kanë shfaqur një sërë problematikash të cilat vështirësojnë ndjeshëm punën e përdoruesve me sistemet duke ulur performancën e tyre e, si rrjedhojë, edhe nivelin e shërbimit ndaj qytetarit.

Pjesa më e madhe e infrastrukturës softëare dhe hardëare e FSDKSH-së është lënë nën administrimin e AKSHI-t dhe ofertuesve të shërbimeve. Në gjykimin tonë, është me rëndësi përcaktimi i nivelit të shërbimit që AKSHI i ofron FSDKSH-së, me qëllim rritjen e efektivitetit, kufizimin/monitorimin e risqeve teknike, ruajtjen e integritetit dhe vazhdueshmërinë e punës, etj.

Sistemi i regjistrimit të të siguruarve (AHIS) shfaq një sërë problematikash të cilat vështirësojnë ndjeshëm punën e përdoruesve me sistemin, duke ulur performancën e tyre në punë e si rrjedhojë edhe nivelin e shërbimit ndaj pacientit. Gjithashtu këto probleme riskojnë saktësinë dhe përmbajtjen e informacionit që regjistron e mban sistemi, aksesueshmërinë e tyre e si rrjedhojë, përdorueshmërinë e informacionit nga strukturat shëndetësore. Duke patur në konsideratë që ky është sistemi qendror me të cilin ndërveprojnë sistemet të tjera në FSDKSH dhe jashtë saj, por është edhe sistemi qendror që realizon menaxhimin dhe regjistrimin e popullsisë pranë çdo mjeku të qendrave shëndetësore, mosfunksionimi i tij do të sillte pasoja serioze dhe impaktonte negativisht ofrimin e shërbimeve pa ndërprerje.

Sistemi i recetës elektronike eRx, i cili ka rëndësi të veçantë për procesin e menaxhimin e recetave të rimbursueshme për pacientët e kategorive të ndryshme në të gjithë Republikën, shpeshherë ka punuar

me ndërprerje dhe ngadalësime serioze, duke kompromentuar vazhdimësinë e punës. Edhe pse kanë kaluar disa vite që nga implementimi dhe përdorimi i tij në shkallë të gjerë, edhe në këtë auditim u konstatuan disa mangësi, çka nënkupton që nuk janë marrë masat e nevojshme për minimizimin e problematikave apo përmirësimin e situatës.

Mungesa e strategjisë institucionale dhe strategjisë së teknologjisë së informacionit mbart riskun e keqadresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së FSDKSH-së. Rregulloret dhe përshkrimet e punës të papërditësuara kanë sjellë mospërcaktimin e saktë të detyrave specifike të punonjësve dhe kryerjen e tyre nga persona pa kompetencat e duhura teknike në fushën e TI.

6. Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve. Në përfundim të auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit është konstatuar se, pajisjet fizike ku hostohet sistemi e-Taxation i cili përmban të dhëna të rëndësishme për vendin dhe jetike për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, janë në ezaurim të hapësirës së tyre dhe funksionojnë në limitet e ciklit jetësor, si dhe me sisteme operimi jashtë suportit teknik çka do të thotë që operojnë në kushte jo optimale sigurie. Në aktet ligjore mbi infrastrukturën kritike, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, nuk e kanë vlerësuar me rëndësi kritike sistemin e-Taxation, duke mos krijuar kushtet për përmbushjen në kohë të detyrimeve për sigurinë kibernetike të kësaj infrastrukture.

Aksesimi në të dhëna nga struktura TIK e AKSHI-t atashuar pranë DPT, menaxhimi i pagjurmueshëm i ndryshimeve të funksionaliteteve të sistemeve si dhe monitorim jo i vazhdueshëm i aksesit të përdoruesve, mund të krijojnë hapësira për veprime në tejkalim të kompetencave të AKSHI-t.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si administrator i të dhënave, nevojitet të luajë rol interaktiv në lidhje me Teknologjinë e Informacionit, për sa kohë në sistemet informatike kryhen veprime nga përdorues të brendshëm dhe të jashtëm dhe të dhënat e sistemeve janë tregues i aktivitetit të institucionit.

7. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Në përfundim të auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit është konstatuar se, siguria e të dhënave është e cënuar në sistemet informatike ku ruhen të dhënat e kësaj Drejtorie dhe mundësia e institucionit për të marrë masa përmirësuese është e kufizuar për shkak të bashkëpërgjegjësisë që ka në drejtim të teknologjisë me AKSHI-n. Me rëndësi është situata e mungesës së strukturës së dedikuar nga AKSHI që i shërben sigurisë së informacionit si dhe mungesa e marrëveshjes në terma teknike ndërmjet institucioneve, e mbështetur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Megjithëse DPSHTRR është penalizuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për rrjedhjen e të dhënave të regjistrit të mjeteve, nuk është vepruar në marrjen e masave organizative dhe teknike që ka secili prej institucioneve DPSHTRR dhe AKSHI në procesin e sigurisë së të dhënave dhe sigurisë kibernetike.

2.4 VERIFIKIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE NGA AUDITIMET E MËPARSHME

Korniza e Deklaratave Profesionale të INTOSAI (IFPP), përcakton qartë rolet e përgjegjësitë e subjekteve të audituara dhe Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-eve), sipas të cilave është thelbësore që përgjegjësia për implementimin e rekomandimeve në kohë dhe me efektivitet është e subjekteve të audituara; por nga ana tjetër është

por nga ana tjetër është përgjegjësi e SAI-ve ndjekja e zbatimit të rekomandimeve, pra verifikimi nëse veprimet e ndërmarra i shërbejnë rezultateve të pritshme.

Konsolidimi i një mekanizmi efektiv të verifikimit sistematik dhe raportimit të zbatimit të rekomandimeve, bazuar në metodologji dhe procedura të standardizuara, të qarta dhe të mirë detajuara, i lejon jo vetëm Kontrollit të Lartë të Shtetit por dhe palëve të treta Kuvendit, Qeverisë etj., të sigurojnë në vijimësi, një informacion të plotë, lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e subjekteve të audituara për hartimin e dokumenteve strategjike në nivel institucional dhe kombëtar apo iniciativa për ndryshime ligjore, administrative dhe organizative.

Skemat dhe qasja e përdorur për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, synojnë të gjenerojnë indikatorë të konsoliduar institucional, sa i takon pranueshmërisë dhe zbatueshmërisë së rekomandimeve, duke mundësuar në këtë mënyrë

rritjen e mbikëqyrjes parlamentare nga ana e Kuvendit

ndaj ekzekutivit, me efekt rritjen e përgjegjshmërisë së menaxhimit të fondeve publike.

Gjatë vitit 2023, KLSH kreu verifikimin e zbatimit të rekomandimeve për 141 auditime të cilat kanë përfshirë ndjekjen dhe monitorimin e 4631 rekomandimeve.


Në zbatim të Vendimit të Kuvendit nr.49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, me qëllim ndjekjen dhe zbatimin në vazhdimësi, KLSH i ka përcjellë Kuvendit raport përmbledhës për rezultatet e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve me shkresat nr. 86 prot., datë 16.01.2024. dhe nr. 165 prot., datë 29.01.2024, si dhe ka përditësuar në vijimësi sistemin e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve që administrohet nga Kuvendi.

Rezultatet e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve i janë përcjellë Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, me shkresat nr. 86/1 prot., datë 16.01.2024 dhe nr.165/1 prot., datë 29.01.2024, me qëllim ndikimin në rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve nga institucionet e administratës shtetërore të dhëna nga KLSH.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezultoi se nga 4631 rekomandime të verifikuara që i përkasin auditimeve të vitit 2022, janë 4494 rekomandime të pranuar, ose rreth 97% e totalit të rekomandimeve dhe nuk janë pranuar 137 rekomandime, ose rreth 3% e tyre.




Nga totali i 4494 masave rekomanduese të pranuar, 1753 kanë rezultuar të jenë zbatuar plotësisht (ose rreth 40% e masave të pranuar), 471 masa zbatuar pjesërisht (ose rreth 10 % e masave të pranuar), 1132 në proces zbatimi (ose rreth 25 % e masave të pranuar) dhe 1138 masa janë ende pa zbatuar (ose rreth 25% e totalit të masave të pranuar).



Nga totali i 4494 masave të pranuar, 1753 masa rezultuan të jenë zbatuar plotësisht (ose rreth 40 % e total masave të pranuar), 471 masa zbatuar pjesërisht (ose rreth 10 % e total masave të pranuar), 1132 në proces zbatimi (ose rreth 25 % e total masave të pranuar) dhe 1138 masa janë ende pa zbatuar (ose rreth 25% e total masave të pranuar).

Diagrama nr.3: Niveli i zbatueshmërisë së rekomandimeve të pranuar



Përgatiti: KLSH

Në përfundim të auditimeve për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimet e mëparshme, sipas llojit, nivelit të pranimit dhe statusit të zbatimit ka rezultuar:

Nga 44 “Masa për përmirësime ligjore” të rekomanduara, janë pranuar 43 masa ose 98% dhe nuk është pranuar 1 masë ose 2%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar janë zbatuar 24 masa ose 56%, janë zbatuar pjesërisht 2 masa ose 5%, janë në proces zbatimi 12 masa ose 28% dhe nuk janë zbatuar 5 masa ose 11%.

Nga 3000 “Masa organizative” të rekomanduara, janë pranuar 2909 masa ose 97% e tyre dhe nuk janë pranuar 91 masa ose 3%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 1151 masa ose 40%, janë zbatuar pjesërisht 304 masa ose 10%, janë në proces zbatimi 755 ose 26% dhe nuk janë zbatuar 699 ose 24% e tyre.

Nga 901 masa të rekomanduara për eliminimin e efekteve financiare negative dhe masave për shpërblim dëmi:

- Rekomanduar 562 “Masa për eliminimin e efekteve negative” nga të cilat janë pranuar 548 masa ose 98% dhe nuk janë pranuar 14 masa ose 2%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar 92 masa ose 17%, janë zbatuar pjesërisht 78 masa ose 14%, janë në proces zbatimi 195 masa ose 36% dhe nuk janë zbatuar 183 masa ose 33%.
- Rekomanduar 339 “Masa për shpërblim dëmi”, nga të cilat janë pranuar 320 masa ose 94% dhe nuk janë pranuar 19 ose 6%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve në subjekte rezultoi se nga 339

rekomandimet e pranuar, janë zbatuar plotësisht 101 masa ose 32%, pjesërisht 49 masa ose 15%, janë në proces zbatimi 114 ose 36% dhe 56 masa (ose 17%) nuk janë zbatuar.

- Nga 589 “Masa disiplinore” të rekomanduara, janë pranuar 581 masa ose 99% dhe nuk janë pranuar 8 masa ose 1%. Nga verifikimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar 342 masa ose 59%, zbatuar pjesërisht 37 masa ose 6%, në proces zbatimi 54 ose 9% dhe nuk janë zbatuar 148 ose 26% e tyre.
- Nga 97 “Masa administrative”, të rekomanduara, janë pranuar 93 masa ose 96% e tyre dhe nuk janë pranuar 4 masa ose 4%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar 43 masa ose 46% e tyre, zbatuar pjesërisht 1 masë ose 1%, janë në proces zbatimi 2 masa ose 2% dhe nuk janë zbatuar 47 masa ose 51% e tyre.

KLSH, në shqyrtimin e zbatimit të rekomandimeve, ka ri kërkuar nga të gjitha subjektet zbatimin e masave të pazbatuara, si dhe ka inkurajuar zbatimin e masave që kanë rezultuar në proces ose të zbatuara pjesërisht.

3. MENAXHIMI INSTITUCIONAL DHE ZHVILLIMI STRATEGJIK

3.1 Korniza e Indikatorëve të Matjes së Performancës të KLSH-së

KLSH, gjatë vitit 2023, ka vijuar me procesin e vetëvlerësimit nëpërmjet Kornizës së Matjes së Performancës (KMP) si një mjet i zhvilluar nga Grupi i Punës së INTOSAI-t mbi Vlerat dhe Përfitimet e SAI (INTOSAI - P 12). Raporti i Vetëvlerësimit të Performancës sipas Kuadrit të INTOSAI-t synon të luajë një rol të rëndësishëm në përpjekjet e KLSH-së drejt përmirësimit të metodologjive të auditimit, qeverisjes së brendshme dhe etikës, zhvillimit të kapaciteteve, si dhe angazhimit të palëve të interesuara. Ky vlerësim vijon pas një pune të nisur, udhëhequr dhe mbikëqyruar nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t dhe SAI i Norvegjisë, e cila u finalizua me rezultate dhe vlerësime pozitive. Përgjatë këtij procesi, u siguruan mjetet e nevojshme metodologjike për kryerjen e procesit të vlerësimit të performancës së institucionit. Rezultatet e këtij procesi synojnë t’i shërbejnë në përmirësimit të punës menaxheriale, organizuese dhe veprimtarisë audituese të KLSH-së.

KLSH ka vijuar punën për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit metodologjik në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, siç është hartimi dhe zbatimi i udhëzuesit mbi shkrimin e raporteve, hartimi dhe implementimi i metodologjisë së planifikimit vjetor të auditimeve, rikonceptimi i të dhënave statistikore etj.

Përdorimi i kornizës së vetëvlerësimit është shumëdimensional, duke mos u kufizuar vetëm në përputhshmërinë dhe plotësimin e kërkesave që burojnë nga standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI), por duke ofruar një perspektivë më të gjerë në përdorimin e rezultateve të tij. Korniza, në formën e një matrice treguesish të detajuar, është e organizuar në gjashtë dimensione, të cilat zbërthehen në indikatorë të mirë përcaktuar, si nga pikëpamja e matjes ashtu edhe nga pikëpamja e pikëzimit, nga vlerësimi i të cilëve prodhohet një informacion i sintetizuar edhe analitik.

Monitorimi periodik vjetor, i treguesve të performancës i mundëson KLSH-së të ndjekë progresin në aspektet kryesore dhe të sigurojë informacion të rëndësishëm mbi të cilin mund të bazohen vendimet menaxheriale dhe organizative.

Matja e performancës nëpërmjet këtij instrumenti përbëhet prej 25 treguesish, të cilat vlerësojnë veprimtarinë e KLSH-së në gjashtë fushat kryesore: Pavarësia dhe Korniza ligjore, Qeverisja e Brendshme dhe Etika, Cilësia e Auditimit dhe Raportimi, Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Strukturat Mbështetëse, Burimet Njerëzore dhe Trajnimi, si dhe Komunikimi dhe Menaxhimi i Palëve të Interesit.

Secila prej fushave detajohet në dimensione dhe indikatorë, të cilat janë subjekt i një vlerësimi analitik. Në bazë të vlerësimit bëhet pikëzimi përkatës, ku për secilin dimension në veçanti dhe fushë në përgjithësi, niveli i pikëzimit varion nga 0 në 4 (ku 0 është vlerësimi minimal dhe 4 maksimal).

KLSH edhe në vitin 2023 paraqet qëndrueshmëri sa i takon pesë fushave të vlerësimit dhe një rritje nga 3 pikë në 4 të fushës E “Burimet Njerëzore dhe Trajnimi”, si dhe përmirësim në fushën C “Cilësia e Auditimit dhe Raportimi”.

Për përmirësimin e fushave të mësipërme KLSH ka punuar në drejtim të:

- forcimit të kapaciteteve audituese për auditimin e PPP-ve dhe kontratave koncesionare, ku gjatë vitit 2023, KLSH si pjesë e projektit “*Forcimi i mbikëqyrjes së kontratave të koncesionit dhe partneritetit publik privat në Shqipëri*”, financuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike të Zvicrës (SECO) “Mbi forcimin e kapaciteteve audituese për auditimin e koncesioneve / PPP-ve”: ka përfunduar auditimin e “*Kontratës së koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit*”, si dhe është në fazë përmbyllëse auditimi i kontratës së koncesionit për markimin e karburanteve; në bashkëpunim me ekspertë të jashtëm është konceptuar, hartuar dhe aplikuar Metodologjinë e Auditimit të Koncesioneve dhe PPP-ve (e cila pritet të kthehet në një Manual të mirëfilltë që do të udhëheq punën audituese në vijim); ekipet e auditimit përkatës janë trajnuar nga ekspertët në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve;
- trajnimit të vazhdueshëm të audituesve në lidhje me metodologjitë dhe teknikat audituese për audituesit e rinj dhe ata me më eksperiencë, duke realizuar edhe për vitin 2023 rreth 26 ditë trajnimi/vit/auditues;
- përmirësimit të dokumentimit të punës audituese në mbështetje të gjetjeve të auditimit, duke pasur parasysh gjithmonë përputhshmërinë e plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit, nëpërmjet rishikimit të plotë të Rregullores së Procedurave të Auditimit si dhe letrave të punës pjesë e kësaj rregulloreje (të cilat priten të finalizohen brenda muajit mars, 2024);
- përmirësimeve të nevojshme në procesin e planifikimit vjetor të auditimeve, duke hartuar dokumentin “Metodologjia e Planifikimit Vjetor të Auditimeve”, mbi të cilën u bazua i gjithë procesi i planit vjetor të auditimeve për vitin 2024;
- orientimit drejt përmirësimit të shkrimit të raporteve në mënyrë që gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e tyre të jenë të qarta dhe të kuptueshme për përdoruesit e tyre, duke hartuar dokumentin “Mbi shkrimin e Raporteve të Auditimit” i cili ka shërbyer si një guidë për audituesit gjatë shkrimit të raporteve;
- përmirësimit të procesit të ndjekjes së rekomandimeve, nëpërmjet rikonceptimit tërësor të Regjistrit të Rekomandimeve, dhe shndërrimin e kësaj statistike në një mjet që i shërben përmirësimit të procesit.

3.2 Implementimi i Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2023-2027 dhe Objektivat 2024

Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027, është dokumenti më i rëndësishëm strategjik i institucionit, në linjë me misionin e tij, i cili udhëheq Kontrollin e Lartë të Shtetit në aktivitetin e tij institucional duke u përshtatur dhe përgjigjur në kohë dhe me përgjegjshmëri dinamikave dhe zhvillimeve lokale dhe globale. Strategjia, orientohet drejt rritjes më tej të cilësisë së auditimeve, duke iu përgjigjur në mënyrë të vazhdueshme zhvillimeve të standardeve dhe rregulloreve të auditimit sipas ISSAI-ve, duke përditësuar metodologjitë, si dhe duke rritur përdorimin e vizualizimeve për të përmirësuar efikasitetin e përcjelljes së punës audituese. Kjo nënkupton optimizimin e aftësive profesionale dhe njohurive inovative mbi standardet ndërkombëtare të fushës, për të gjithë trupën audituese dhe personelin mbështetës nëpërmjet trajnimeve dhe punës së përbashkët, me qëllimin për të zhvilluar më tej kuptueshmërinë e njohurive audituese, që nxisin veprim dhe prodhojnë rezultat. Me qëllim përmbushjen e objektivave strategjike, është hartuar plani i veprimit për implementimin e strategjisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 144, datë 01.08.2023. Ky plan

monitorohet në vijimësi dhe në mënyrë sistematike për vlerësimin e nivelit të arritjes së objektivave kundrejt parashikimit.

Në përmbushje të misionit dhe vizionit të tij, KLSH ka përcaktuar tre qëllime strategjike që udhëheqin punën e institucionit, realizimi i të cilëve monitorohet periodikisht, nëpërmjet përmbushjes së nën-objektivave dhe treguesve të performancës, të cilët janë:

Qëllimi Strategjik I lidhet me rritjen dhe përmirësimin e rolit të KLSH-së si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike, qëllim ky i cili përmbushet nëpërmjet tre objektivave.

Qëllimi Strategjik II, lidhet me rritjen e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve, qëllim ky i cili përmbushet nëpërmjet pesë objektivave.

Qëllimi Strategjik III, lidhet me optimizimin e kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese, qëllim ky i cili përmbushet nëpërmjet tre objektivave.

Në funksion të përmbushjes së qëllimeve strategjike gjatë vitit 2023, KLSH ka hartuar "*Metodologjinë e Planifikimit Vjetor të Auditimeve*" miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 166, datë 26.09.2023. Ky dokument, unifikon procesin e planifikimit të auditimeve duke përcaktuar indikatorët më të rëndësishëm të cilët mbahen në konsideratë dhe vlerësohen për përzgjedhjen e temave.

Gjithashtu, në kuadër të hartimit të planit vjetor të auditimeve për vitin 2024, të gjitha departamentet e auditimit kanë zhvilluar workshope, ku audituesit kanë propozuar tema auditimi, dhe më pas vlerësimi e përzgjedhja e tyre është bërë duke përdorur metodologjinë e mësipërme. Departamenti i Auditimit të Performancës, vlerësimin dhe përzgjedhjen e temave të auditimit e ka kryer bazuar gjithashtu në Udhëzuesin e Fushave me Risk.

Në përmbushje të qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm sipas Axhendës 2030 (OZHQ), nëpërmjet punës audituese, në përputhje edhe me prioritetet strategjike të INTOSAI-t, gjatë vitit 2023 Departamenti i Performancës ka kryer tre auditime që mbulojnë tre nga fushat e OZHQ-ve, konkretisht: Fuqizimi ekonomik i gruas në vendin tonë; Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës) nga Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ndryshimet klimatike, i cili është duke u zhvilluar me mbështetjen e IDI-t.

Me qëllim sigurimin e vazhdimësisë, profesionalizmit, dhe cilësisë së zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, janë adoptuar dhe përditësuar vazhdimisht udhëzuesit dhe manualët duke iu përgjigjur në kohë ndryshimeve. Nisur nga praktikat e mira të INTOSAI-t, iniciativa e Komisionit Evropian "Mbi të shkruarin qartë për Evropën", si dhe nga nevoja për shkrimin e raporteve të auditimit me një gjuhë të thjeshtë e të qartë, Departamenti i Metodologjisë, gjatë vitit 2023 ka hartuar "Udhëzuesin mbi shkrimin e raporteve të auditimit" Gjithashtu, nisur nga rëndësia e planifikimit mbi bazë risku, është përditësuar dhe rikonceptuar "Metodologjinë e Planifikimit Vjetor të Auditimeve". Departamenti i Metodologjisë ka zhvilluar trajnime në mënyrë që gjithë audituesit të njihen me këto udhëzues.

Me qëllim zhvillimin e moduleve TI për përdorimin e elementeve të auditimeve të IT-së edhe në auditimet e përputhshmërisë, financiare dhe të performancës, përgjatë vitit 2023, Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit ka vijuar bashkëpunimin me ekspertët e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë (OANG) në drejtim të përmirësimit të cilësisë së auditimeve me anë të zhvillimit të workshop-eve online dhe onsite, si dhe webinar-ëve. Gjithashtu, është marrë pjesë në workshop-in e TI Workgroup EuroSAI në tetor 2023 dhe webinar-in ARABOSAI dhjetor 2023.

Gjatë vitit 2023, KLSH, duke ndjekur praktikat e mira, duke marrë në konsideratë ndryshimet makroekonomike të diktuar nga evoluimi i shpejtë i teknologjisë, bazuar edhe në rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, ka synuar orientimin drejt auditimeve të sistemeve me qëllim parandalimin e fenomeneve që kanë impakt negativ në financat publike. Janë kryer tre auditime mbi bazë sistemi, konkretisht: 1. Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme, zhvilluar në MFE dhe MIE; 2. Ecuria e detyrimeve shtetërore për vendime të formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi, zhvilluar në Avokaturën e Shtetit dhe MFE; dhe 3. Auditimi i përputhshmërisë në licencimin dhe monitorimin e subjekteve me veprimtari në fushën minerare për periudhën 2018-2022.

Sa i takon komunikimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm i KLSH-së me Kuvendin, KLSH ka vijuar të intensifikojë komunikimin dhe bashkëpunimin me Kuvendin, duke përcjellë gjithsej 160 raporte auditimi që i përkasin vitit 2023. Kuvendi është informuar periodikisht për rezultatet e punës audituese edhe nëpërmjet përcjelljes së buletineve statistikore periodike, raporteve periodike të zbatimit të rekomandimeve, raportit mbi zbatimin e buxhetit të shtetit dhe raportit vjetor mbi performancën e KLSH-së.

KLSH, gjatë vitit i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministrinë të Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin, dy raporte përmbledhëse: “Raportin përmbledhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të përfunduara për periudhën 01.01.2021-30.06.2021” dhe “Raportin përmbledhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të përfunduara për periudhën 01.07.2021-31.12.2021”

Në kuadër të riorganizimit të statistikave në funksion edhe të zbatimit të rekomandimeve, gjatë vitit 2023, KLSH rikonceptoi tërësisht formatin e statistikave të auditimeve duke përdorur formate më të avancuara, të cilat ofrojnë mundësinë e përpunimit të të dhënave sipas kërkesës. Gjithashtu, u rikonceptua në tërësi formati statistikor mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. Këto formate ofrojnë mundësinë e përdorimit të përlllogaritjeve të avancuara mbi të dhënat.

Sa i takon realizimit të qëllimit strategjik nr. 2, KLSH gjatë vitit 2023 ka paraqitur dhe komunikuar punën audituese deri tek përdoruesi më i fundit, qytetari. Në funksion të misionit që ka, KLSH synon t’u shërbejë qytetarëve dhe taksapaguesve, duke u ofruar mundësinë dhe aksesin e plotë në informacion për të kontribuar në realizimin e qëllimit të përbashkët, që është mirëqeverisja. Kështu, gjatë vitit 2023, KLSH ka publikuar në faqen web raportet e auditimit me qëllim promovimin e punës audituese dhe informimin e vazhdueshëm të palëve të interesit. Gjithashtu, për auditimet me ndjeshmëri të lartë, ka promovuar rezultatet e auditimit nëpërmjet përgatitjes së broshurave, ku gjatë vitit 2023 janë përgatitur si vijon: përgatitja e materialeve informuese mbi rolin dhe veprimtarinë e KLSH-së, në gjuhën shqipe dhe angleze; mbi aktivitetin e departamenteve të auditimit; mbi auditimet e performances “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit” dhe auditimin “Fuqizimi ekonomik i gruas në vendin tonë”, në bashkëpunim me zyrën UN Women në Shqipëri.

Në kuadër të promovimit të rolit të KLSH-së dhe punës audituese, nëpërmjet mjeteve të komunikimit, gjatë vitit 2023, rezultuan të publikuar në shtypin e shkruar 480 artikuj nga 300 që ishin në vitin 2022 (ose 180 më shumë), si dhe 1756 artikuj e kronika në median audio-vizive dhe online nga 1500 artikuj dhe kronika në vitin 2022 (ose 256 më shumë), të cilat i referohen veprimtarisë audituese të institucionit.

Me qëllim që faqja e web-it të jetë lehtësisht e përdorshme edhe nga partnerët ndërkombëtarë, ka filluar pasurimi i saj me informacione dhe materiale të pasura me infografikë, si dhe të përshtatura edhe në gjuhën angleze.

Gjatë vitit 2023, janë përdorur programe të dedikuara që lejojnë krijimin e infografikëve dhe vizualizimeve, nëpërmjet të cilave janë prodhuar dokumente cilësore dhe profesionale si: Udhëzuesi mbi shkrimin e raporteve të auditimit; Metodologjia e planifikimit vjetor të auditimeve; Buletinet statistikore; Raporti mbi zbatimin e rekomandimeve etj. Këto programe do të vijojnë të përdoren edhe për implementimin e infografikëve edhe në dokumente të rëndësishëm si Raporti i Performancës së KLSH-së, Raporti Vjetor i Implementimit të Strategjisë 2023-2027, si dhe në raste të veçanta sipas nevojës.

KLSH, gjatë vitit 2023 ka synuar rritjen e mëtejshme të këtij bashkëpunimit për shkëmbimin e informacionit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, me organet ligj-zbatuese në luftën kundër korrupsionit, duke marrë pjesë në aktivitete dhe tryeza të rrumbullakëta të organizuara nga OJF me qëllim luftën kundër korrupsionit.

KLSH, nëpërmjet programit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, ka bërë të mundur rritjen e njohurive dhe aftësive që ju nevojiten audituesve në realizimin e objektivave, për rrjedhojë përmirësimin ndjeshëm të cilësisë së punës audituese në funksion të rritjes së transparencës, mirëqeverisjes dhe përdorimit të parasë publike, si dhe rritjes së besimit të publikut dhe palëve të jashtme në institucion.

KLSH ka kryer në mënyrë periodike analizën e nevojave për trajnim (diktuar këto të fundit nga gjithë stafi auditues nëpërmjet pyetësorëve në google form, të cilët dërgohen në fund të vitit), duke zhvilluar trajnime të brendshme si dhe duke ndjekur zhvillimin e trajnimeve nga partnerë të tjerë, me qëllim përmirësimin e njohurive dhe aftësive të stafit të KLSH-së.

KLSH ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet homologe me qëllim shkëmbimin e njohurive, pasi “eksperienca e përbashkët na shërben të gjithëve”. Deklarata e Rios 2022, orienton nxitjen e një zëri global më efektiv dhe reagimin ndaj ndryshimit të mjedisit dhe risqeve, gjë që kërkon që SAI-t të përmirësojnë mënyrën se si punojnë së bashku dhe të angazhohen me palët e interesuara. Në këtë kuadër janë kryer disa auditime paralele dhe të përbashkëta.

Diagrama nr 4: Takime të organizuara në kuadër të luftës kundër korrupsionit

- 01 Më 11 korrik 2023, KLSH merr pjesë në tryezën e diskutimit me temë: “Fuqizimi i rolit mbikëqyrës të legjislacionit në vlerësimin e hapësirave për korrupsion”, organizuar nga Fondacioni eestminster për Demokraci në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Kërkime Ekonomike.
- 02 Më 15 shtator 2023, KLSH merr pjesë në prezantimin e raportit “Fuqizimi i rolit të Kuvendit të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit”, organizuar nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI).
- 03 Më 28 shtator 2023, KLSH merr pjesë në takimin “Nevoja për përmirësim në Legjislacionin e Prokurimit Publik (Kapitulli 5: Integrimi)”, organizuar nga Instituti Shqiptar i Shkencës/ Open Data Albania.
- 04 Më 4 dhjetor 2023, KLSH merr pjesë në workshop-in “Fuqizimi i rolit të shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit”.
- 05 Më 10-12 Dhjetor 2023, KLSH merr pjesë në takimin e organizuar nga ANAC në Romë.
- 06 Më 28 shtator 2023, KLSH merr pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Albanian Institute of Science mbi nevojën për përmirësimin e legjislacionit të prokurimeve publike për të minimizuar risqet e korrupsionit.
- 07 Më 13 dhjetor 2023, KLSH merr pjesë në forumin “Roli Parlamentar në procesin Demokratik në Shqipëri”, organizuar nga WFD Albania

Burimi: KLSH

Gjatë vitit 2023, është hartuar "Dokumenti i Politikave të Burimeve Njerëzore", ku implementimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i tij, do t'i sigurojë stafit të ketë një plan zhvillimi personal që mbështet prioritetet strategjike të KLSH-së dhe njëkohësisht nxit zhvillimin në karrierë për çdo auditues.

Gjatë vitit 2023 audituesit kanë marrë pjesë vazhdimisht, në aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare për forcimin e kapaciteteve audituese. Kështu, dy auditues kanë përfunduar me sukses programet e internship-t në Gjykatën Evropiane të Llogarive (ECA) dhe një auditues ka ndjekur programet e fellowship-it pranë Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA (GAO), si dhe të tjerë tashmë zotërojnë certifikata ndërkombëtare profesionale. Të tre audituesit që kanë ndjekur programet në ECA dhe GAO pasi janë kthyer në KLSH kanë zhvilluar trajnime me qëllim ndarjen e eksperiencës me kolegët.

Objektivat për vitin 2024

Edhe gjatë vitit 2024, puna e KLSH-së do të vijojë të udhëhiqet nga misioni, vizioni dhe qëllimet strategjike të Planit Strategjik të KLSH 2023-2027, ku:

Në përmbushje të Qëllimit Strategjik nr. 1¹⁷ do të vijojë puna për konsolidimin e mëtejshëm të metodologjisë për përzgjedhjen e auditimeve mbështetur mbi dokumentin e Metodologjisë së Planifikimit Vjetor të Auditimeve; në përputhje edhe me prioritetet strategjike të INTOSAI-t për periudhën 2023-2027, do të realizohen 3 auditime që mbulojnë fusha të reja, të rekomanduara nga Axhenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 (OZHQ); do të vijojë puna për azhurnimin e manualeve dhe udhëzuesve në koherencë me ndryshimet e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të rishikuara; do të vijojë bashkëpunimi me SAI-et homologe dhe me INTOSAI-n nëpërmjet kryerjes së projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta; si dhe në funksion të zbatimit të rekomandimeve, do të punohet për rishikimin e Manualit të Zbatimit të Rekomandimeve, si dhe riorganizimit të statistikave për këtë qëllim.

Në përmbushje të Qëllimit Strategjik nr. 2¹⁸, me qëllim promovimin e vazhdueshëm të rolit të KLSH-së dhe punës audituese, si garantues i mirëpërdorimit të fondeve publike, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit, gjatë vitit 2024 do të rritet numri i broshurave të përgatitura mbi rezultatet e auditimeve me ndjeshmeri të lartë; do të vijojë pasurimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare të KLSH-së dhe jo vetëm, për të rritur më tej aksesueshmërinë e palëve të interesuara; forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dhe koordinimit të punës audituese, me organet e linjës së parë në luftën kundër korrupsionit, në përputhje edhe me Deklaratën e Limës; gjithashtu, do të vjohet t'i jepet rëndësi e veçantë përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së raporteve, si dhe forcimit të mëtejshëm të komunikimit me subjektet e audituara dhe paraqitja e rekomandimeve, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.

Në përmbushje të Qëllimit Strategjik nr. 3¹⁹, edhe gjatë vitit 2024 do të synohet drejt optimizimit të kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese, nëpërmjet aktiviteteve për shkëmbim njohurish, siç janë: praktika të mira, seminare, workshop-e, internship-e; me organizma si INTOSAI, SAI-e homologe, ekspertë të fushës dhe personalitete në fushën akademike; si dhe monitorimi i vazhdueshëm i dokumentit të politikave për zhvillimin e burimeve

¹⁷ Qëllimi Strategjik 1: Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH-së si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike.

¹⁸ Qëllimi Strategjik 2: Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.

¹⁹ Qëllimi Strategjik 3: Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.

njerëzorë të KLSH-së, me qëllim që t’i sigurojë stafit të ketë një plan zhvillimi personal që mbështet prioritetet strategjike të KLSH-së dhe njëkohësisht në ambicie personale.

3.3 Organizimi institucional dhe zhvillimi e menaxhimi i burimeve njerëzore

Organizimi institucional. Në zbatim të Ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, organizimi strukturor bëhet në përputhje me këtë ligj dhe me rregulloren e miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit²⁰, i cili vendos për strukturën, organikën dhe emërtimin e funksioneve të këtij institucioni,²¹ si dhe për kompetencat dhe detyrat e njësive organizative brenda tij. Organizimi strukturor i Kontrollit të Lartë të Shtetit është i miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 19, datë 31.01.2022, “Për Strukturën e Renditjes së Punëve, Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Nivelin e Pagave në KLSH”, i ndryshuar.

KLSH, në vitin 2023 ka qenë i organizuar në 9 departamente, nga të cilët 7 departamente auditimi: për institucionet qendrore, për buxhetin e shtetit, për shoqëritë publike dhe investimet e huaja, për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për performancën, dhe për teknologjinë e informacionit, dhe Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit dhe Zhvillimit Strategjik, si dhe Departamenti Juridik.

Shërbimet mbështetëse kanë qenë të organizuar në 4 drejtori: burimet njerëzore, komunikimi dhe marrëdhëniet me jashtë, shërbimet IT dhe e shërbimeve, si dhe Sektori i Financës.


Me përjashtim të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore dhe Departamentit i Auditimit IT, departamentet e tjera dhe drejtoritë janë të ndarë me sektorë.

Departamentet e auditimit, Departamenti i metodologjisë, përfshirë dhe Drejtorinë e Kontrollit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve janë në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm, ndërsa drejtoritë në shërbimet mbështetëse janë në varësi të Sekretarit të Përgjithshëm.

Për vitin 2023 numri i punonjësve të miratuar ka qenë 243 duke pësuar një rritje me 10 punonjës krahasuar me vitin 2022, ndërsa numri faktik i punonjësve është 216, nga të cilët trupa audituese përbën 76% të numrit total faktik ose 165 auditues²².

Stafi drejtues, ku përfshihet Drejtor i Kabinetit, Sekretar i Përgjithshëm, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve e të Drejtorive, Këshilltarë, përbën rreth 7% të numrit total faktik të punonjësve ose 16 punonjës; Stafi auditues përbën 76% të numrit total faktik të punonjësve ose 165 punonjës; ndërsa Stafi mbështetës (përgjegjës sektori, zëdhënës, specialistë, juristë, punonjës shërbimi etj.) përbën rreth 16% të numrit total faktik të punonjësve, ose 35 punonjës.

Diagrama nr.5 Organigrama e KLSH-së në vitin 2023



Burimi: KLSH

²⁰ Ligji nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 35

²¹ Po aty, neni 25/ë

²² Trupa audituese përbëhet nga 16 Kryeauditues dhe 149 auditues.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore. Filozofia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka vijuar me zbatimin rigoroz të kuadrit ligjor për krijimin e një shërbimi civil profesional dhe të qëndrueshëm, zbatimin e kërkesave të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të BE-së, duke synuar konsolidimin e kapaciteteve dhe rritjen e profesionalizmit dhe integritetit të çdo punonjësi në KLSH. Besimi dhe kredibiliteti ndaj Institucionit të KLSH-së është e lidhur organikisht me menaxhimin e burimeve njerëzore, sikurse është sigurimi zhvillimit të vijueshëm profesional, pra profesionalizmi dhe integriteti i stafit.

Burimet njerëzore janë pjesë e rëndësishme e menaxhimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për të bërë të mundur që institucioni të sigurojë stafin e nevojshëm me aftësitë profesionale dhe eksperiencën e duhur për realizimin detyrimit kushtetues të veprimtarisë audituese, dhe në këtë kuadër të objektivave strategjike institucional.


Në këtë aspekt, KLSH, duke e konsideruar menaxhimin e burimeve njerëzore si parakusht për funksionimin e institucionit në mënyrë efektive dhe eficiente, referuar udhëzimeve dhe praktikave më të mira të komunitetit të INTOSAI-t për ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve audituese, ka vijuar të investojë në zhvillimin e burimeve njerëzore.

Në përmbushje të Qëllimit 3 të Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2023-2027, “Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese”, KLSH edhe gjatë vitit 2023 është përpjekur që të sigurojë një staf auditues i cili zotëron kompetencat e duhura profesionale për të kryer detyrat funksionale duke kontribuar në arritjen e objektivave të institucionit. Në funksion të mirëmenaxhimit të burimeve njerëzore, KLSH ka synuar rekrutimin e individëve me kualifikime të larta, që njohin gjuhë të huaja, ekspertë dhe specialistë me kontribute të shquara në fusha të ndryshme si të teknologjisë së informacionit etj.; zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe rritjen e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme; zbatimin e një sistemi objektiv të vlerësimit të stafit bazuar në performancë, në përmbushjen e objektivave individuale dhe kërkesave të kompetencave profesionale etj.

Gjatë vitit 2023 me Vendim nr. 123 datë 24.07.2023 të Kryetarit të KLSH-së u miratua Dokumenti i ri i Politikave të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në KLSH. Qëllimi i këtij dokumenti është të sigurojnë ekzistencën e politikave dhe procedurave që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e burimeve njerëzore të KLSH-së, si dhe të formalizohen disa hapa të punës së përditshme e të proceseve të ndryshme që ndjek DBNJ. Si pjesë e rëndësishme e këtij dokumenti është edhe klasifikimi i pozicioneve të punës në KLSH dhe kualifikimet themelore për secilin pozicion. Miratimi i këtij dokumenti ishte një ndër indikatorët matës për përmbushjen e qëllimit strategjik nr. 3 të Strategjisë së Zhvillimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit 2023-2027.

Mbi zhvillimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore. Stafit auditues (auditues dhe kryeauditues) ka pësuar rritje në periudhën 2021-2023, e lidhur ngushtë kjo me rritjen e vëllimit të veprimtarisë audituese, krahas përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit.


Grafiku nr.1 Trupa audituese 2021-2023



Burimi: KLSH

Klasifikuar sipas nivelit të arsimimit, në strukturën organizative për vitin 2023, rezultojnë 200 punonjës me arsim të lartë ose rreth 93% kundrejt numrit total faktik të punonjësve. Ndërsa, sipas profilit të diplomimit, stafi i KLSH-së përfshin kryesisht ekonomistë, financierë, kontabilistë, juristë, inxhinierë, arkitektë dhe profile të tjera. Në një linjë me objektivat e dokumentit të politikave të burimeve njerëzore, si dhe me qëllim aftësimin profesional dhe metodologjik në funksion të përmirësimit të performancës, një pjesë e punonjësve kanë përfunduar studimet universitare në degë të dyta apo janë trajnuar dhe certifikuar brenda dhe jashtë vendit në përgjigje të zhvillimeve të reja në fushën e auditimit publik.

Diagrama nr.6 Punonjësit e KLSH-së me arsim të lartë sipas profilit të diplomimit



Burimi: KLSH

Sipas profilit të diplomimit rezulton se, 42.5% janë Financierë, Kontabilistë dhe Ekonomistë; 29% Juristë; 12% Inxhinierë të profileve të ndryshme; si dhe 16.5% me diploma në fusha të tjera.


Procedurat e rekrutimit të punonjësve përgjatë vitit 2023 janë zhvilluar sipas kërkesave të kuadrit ligjor dhe nënligjor përkatës, në koherencë me Strategjinë e Zhvillimit të institucionit 2023-2027, si dhe politikave të miratuara të menaxhimit të burimeve njerëzore, me qëllim që KLSH të sigurojë stafin e duhur me kualifikimet, aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të plotësuar nevojat aktuale dhe të perspektivës. Si një proces shumë i rëndësishëm që ndikon drejtpërsëdrejti në përmirësimin e performancës së institucionit, gjatë vitit 2023 janë rekrutuar 26 punonjës në pozicione pjesë e shërbimit civil. Punonjësit e rekrutuar janë emëruar rast pas rasti në departamentet e auditimit apo në departamentet dhe drejtoritë mbështetëse në plotësim të nevojave që ka secila njësi për realizimin e planit vjetor të auditimeve apo përmbushjen e objektivave dhe detyrave funksionale. Në pozicionet që menaxhohen në zbatim të përcaktimeve të Kodit të Punës janë emëruar 5 punonjës gjatë vitit 2023.

Përgjatë vitit 2023, është treguar kujdes për zhvillimin e karrierës brenda institucionit, duke e vlerësuar si faktor të rëndësishëm që i shërben drejtimit më të mirë dhe sigurimit e rritjes së cilësisë së veprimtarisë audituese. Aktualisht, zhvillimi profesional dhe përparimi në karrierë realizohet nëpërmjet sistemit të vlerësimit periodik të performancës dhe aftësive individuale, testimi të njohurive nga formimi profesional dhe konkurrimit transparent për të gjitha pozicionet pjesë e shërbimit civil. Çdo punonjës ka të drejtën e ngritjes në detyrë dhe qëllimi i politikës së ngritjes në detyrë në KLSH është të sigurojë qëndrueshmërinë e potencialit të audituesve, në një linjë me kuadrin rregullator institucional dhe Standardet Ndërkombëtare ISSAI. Në referencë dhe zbatim të standardeve ndërkombëtare, ku një institucion suprem auditimi duhet të ruajë dhe të zhvillojë trupën profesionale në funksion të qëllimit të krijimit të mundësive për promovimin dhe për integrimin e stafit të ri, gjatë vitit 2023 janë ngritur në detyrë 2 auditues në zbatim të përcaktimeve të bëra në Dokumentin e Politikave të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ndërsa 2 vende të lira në pozicione drejtuese janë plotësuar nga konkurrimi i brendshëm.

KLSH, në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore i ka kushtuar vëmendjen e duhur respektimit të parimit të barazisë gjinore në të gjitha politikat, aspektet, veprimtaritë institucionale duke synuar eliminimin e fenomeneve të diskriminimit përshkak të gjinisë. Raporti i punonjësve femra/meshkuj,

është përmirësuar duke pësuar një rritje të lehtë prej 1.1% krahasuar me një vit më parë. Politika e KLSH-së në mbështetje të zhvillimit në karrierë të gjinisë femërore, reflektohet në numrin e konsiderueshëm që femrat zënë në nivele menaxheriale, duke përfaqësuar 9 pozicione drejtuese kundrejt 16 drejtues në total, si: Sekretare e Përgjithshme, Drejtore e Përgjithshme, Drejtore Departamenti, Drejtore Drejtorie dhe Kryeaudituese ose 56% numrit gjithsej të drejtuesve. Përfaqësimi gjinor për Nivelin e Lartë Drejtues për kategorinë Sekretar/Drejtor i Përgjithshëm, për vitin 2023 rezulton në pozicion drejtues femra në nivelin 100%.


Grafiku nr.2 Raporti femra-meshkuj i punonjësve 2021-2023



Burimi: KLSH

Një tregues mjaft i rëndësishëm i politikave të ndjekura në drejtim të garantimit të vijueshmërisë së punës dhe të gërshetimit të përvojës së audituesve të vjetër me stafin e ri janë dhe treguesit moshës dhe të vjetërsisë në punë. Ecuria në këto vite e këtyre treguesve ka njohur trendin e uljes së moshës mesatare të punonjësve. Mosha mesatare në KLSH në fund të vitit 2023 është 41.2 vjeç nga 41.4 vjeç në vitin 2022, duke ruajtur të njëjtin trend renës të viteve të fundit.

Grafiku nr.3 Moshë mesatare e punonjësve dhe eksperiencia në KLSH 2021-2023



Burimi: KLSH

Nëpërmjet programit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, KLSH ka bërë të mundur rritjen e njohurive dhe aftësive që ju nevojiten audituesve në realizimin e objektivave, për rrjedhojë përmirësimin ndjeshëm të cilësisë së punës audituese në funksion të rritjes së transparencës, mirëqeverisjes dhe përdorimit të parasë publike, si dhe rritjes së besimit të publikut dhe palëve të jashtme, tek KLSH.

Trajnimi dhe zhvillimi i audituesve, është një proces investimi strategjik i kohës, energjisë dhe burimeve, drejt përmirësimit të kapaciteteve audituese. KLSH i ka kushtuar një vëmendje të veçantë zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit të KLSH-së, si një prej prioriteteve kryesore në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve audituese, në bashkëpunim kjo me partnerë të brendshëm dhe të jashtëm

Edhe për vitin 2023, KLSH ka kryer në analizën e nevojave për trajnim (diktuar këto të fundit nga gjithë stafi auditues nëpërmjet pyetësorëve në google form, të cilët janë dërguar në muajin Dhjetor, 2022). Mbështetur në këto nevoja, në praktika të mira të institucioneve homologe, si dhe në referencë të qëllimeve strategjike të KLSH-së, është miratuar Programi i Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së, për vitin 2023, me Vendimin nr. 7, datë 13.01.2023, të Kryetarit të KLSH-së.

Referuar Plan -Veprimit mbi zbatimin e “Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së” për vitin 2023, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, janë zhvilluar trajnime me prezencë fizike dhe online nëpërmjet platformës Microsoft skype me stafin e KLSH-së, webinarë dhe kurse online pranë ASPA-s, si dhe trajnime, workshopë, konferenca etj, me organizata dhe partnerë ndërkombëtarë, duke bërë të mundur rritjen e njohurive dhe aftësive që ju nevojiten audituesve në realizimin e objektivave, për rrjedhojë përmirësimin ndjeshëm të cilësisë së punës audituese.

KLSH i ka kushtuar një vëmendje të veçantë zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit të KLSH-së, si prioritet kryesor për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve audituese, kjo në bashkëpunim dhe me

partnerë të brendshëm dhe të jashtëm si SAI-et homologe, INTOSAI, EUROSAI, SIGMA, ASPA, OSBE, ANAC.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2023, u realizuan gjithsej 207 tema trajnimesh, nga të cilat 99 të organizuara nga ASPA dhe 108 nga KLSH dhe partnerë ndërkombëtarë.

U trajnuan gjithsej 196 auditues, duke realizuar në total 4,854 ditë-njerëz trajnime, nga të cilat 4,465 ditë për 168 staf auditues dhe 389 për 28 staf jo-auditues; ose realizuar mesatarisht rreth 27 ditë trajnimi/auditues (nga 20-25 ditë trajnimi që është objektivi vjetor), dhe 14 ditë trajnimi për staf jo-auditues.

Ndër temat kryesore objekt trajnimi gjatë vitit 2023, rendisim: tema që prekin çështjet mjedisore, tema mbi auditimet e burimit të sistemeve, forcimi i kapaciteteve audituese për

auditimin e koncesioneve/PPP-ve, siguria e informacionit dhe krimi kibernetik, të shkruarit e raporteve, menaxhimi i cilësisë së auditimit, çështje që lidhen me disiplinën buxhetore, metodologji mbi auditimin e bashkive, risku i korrupsionit në fushën e prokurimit publik, çështje që lidhen me auditimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, apo me auditimin e prokurimeve publike etj.



4. KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI ME PALËT E INTERESIT

4.1 KLSH dhe Kuvendi

Ndërtimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve efektive të KLSH-së me Kuvendin është i bazuar në kuadrin kushtetues dhe ligjor, si dhe është i orientuar drejt zbatimit rigoroz të kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare, si dhe Parimeve e praktikave më të mira të rekomanduara nga Bashkimi Evropian. Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka kushtuar një vëmendje të veçantë marrëdhënieve me Kuvendin duke e vendosur këtë raport në shërbim të forcimit të llogaridhënies, transparencës dhe mirëqeverisjes.

Institucionet supreme të auditimit dhe parlamentet janë dy institucionet më të rëndësishme për të mbajtur qeveritë të përgjegjshme për mirëqeverisjen e fondeve dhe pronës publike, ashtu siç theksohet në ISSAI 120 *“Institucionet supreme të auditimit duhet të ruajnë marrëdhëniet me Parlamentin dhe komisionet përkatëse parlamentare për t'i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë raportet e auditimit, në mënyrë që ato të ndërmarrin veprimet e duhura, për të garantuar transparencën dhe llogaridhënien e ekzekutivit”*.

Kontrolli i Lartë të Shtetit, vijon të zhvillojë marrëdhënie efektive me Kuvendin, me qëllim rritjen e impaktit të punës audituese dhe mbështetjen e misionit të KLSH-së, si institucioni në shërbim të qytetarit shqiptar dhe Kuvendit, për të përmbushur në vijimësi rolin e vet kushtetues dhe për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie në përdorimin e fondeve publike nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përcjellë pranë Kuvendit të Shqipërisë:

- Raportin e Performancës për vitin 2022, në muajin mars 2023 duke vijuar më pas me paraqitjen e këtij raporti në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave. Raporti i Performancës së institucionit u raportua nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë më datë 20.07.2023 gjatë së cilës u miratua dhe Rezoluta *“Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2022”*.
- Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2022, në muajin tetor 2023. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit raportoi pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat mbi Raportin e Zbatimit të Buxhetit më datë 8.11.2023.
- KLSH përgjatë vitit 2023 e ka informuar Kuvendin në vijueshmëri nëpërmjet përcjelljes periodike të raporteve përfundimtare të auditimit, të cilat përmbajnë rezultatet konkrete mbi përdorimin e parasë publike nga institucionet në të gjitha nivelet e qeverisjes. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka dërguar në mënyrë periodike pranë Kuvendit të Shqipërisë 160 Raporte përfundimtare auditimi të evaduar gjatë vitit 2023.

Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi të Kuvendit nr. 134/2018 *“Për miratimin e Manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”*, KLSH edhe gjatë vitit 2023 ka informuar Kuvendin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna:

- KLSH i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministrin të Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin dy raporte përmbledhëse *“Raportin përmbledhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të përfunduara për periudhën 01.01.2021-30.06.2021”* (përcjellë nëpërmjet shkresave nr. 136 dhe 136/1 prot., datë 03.02.2023) dhe *“Raportin përmbledhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të përfunduara për periudhën 01.07.2021-31.12.2021”* (përcjellë nëpërmjet shkresave nr. 136/2 dhe 136/3 prot., datë 10.02.2023).

- Në kuadër të bashkëpunimit me Kuvendin, përfaqësues të KLSH-së më datë 17.01.2023 kanë marrë pjesë dhe kanë dhënë kontributin në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, për shqyrtimin e projektligjit “Për përgjegjësinë financiare të punonjësve publikë”.
- Përfaqësuesit e KLSH-së kanë marrë pjesë në tryezën e diskutimit të organizuar mbi rëndësinë e përmirësimit të ndërveprimit dhe bashkëpunimit mes Kuvendit të Shqipërisë dhe Institucioneve të Pavarura.

Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit.

Në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2022”, miratuar më datë 20.07.2023, vlerësohet veprimtaria e KLSH-së në angazhimin për kryerjen e auditimeve në pajtueshmëri me standardet dhe praktikat ndërkombëtare të auditimit, adresimin e rekomandimeve, vijimin e punës për rritjen e dobisë së rezultateve të auditimit, rritjen e besueshmërisë së publikut, modernizimin e aktivitetit auditues dhe trajnimin e audituesve, angazhimin në raportimin për procesin e integritetit në Komisionin Evropian në kuadër të Kapitullit 32, “Kontrolli Financiar”.

Gjithashtu, Kuvendi ka kërkuar që për vitin 2023 Kontrolli i Lartë i Shtetit të vazhdojë punën në disa drejtime. Për të gjitha rekomandimet e dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë, Kontrolli i Lartë të Shtetit ka hartuar plane konkrete pune për zbatimin tërësor të çdo pike të rezolutës. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka miratuar më datë 07.09.2023, Planin e Veprimit “Për zbatimin e rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2022”, e cila i është përcjellë Kuvendit të Shqipërisë me shkresën nr.757 prot., datë 07.09.2023, në të cilin janë përcaktuar masat, strukturat përgjegjëse, afatet dhe treguesit e rezultateve në zbatim të këtyre rekomandimeve. Me shkresën nr.1136/1 prot., datë 21.12.2023 i është dërguar Kuvendit raporti i monitorimit të planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të kësaj rezolute, me vëmendje të veçantë në:

Rekomandimi 1. Rritjen e ekspertizës profesionale në veprimtarinë audituese mbi fusha të tilla, si: Qëndrueshmëria e financave publike, efektiviteti dhe efienca e menaxhimit të programeve të qeverisjes, kryesisht në ato me partneritet publik-privat, zhvillimet dixhitale etj.

- Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer auditime të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare mbi “Kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”, ndërsa po vijon auditimi i dytë pilot, i kontratës koncesionare “Për Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve”.
- Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet prezencës së OSBE-së në Shqipëri, KLSH-së dhe Autoritetit Kombëtar Anti-Korrupsion të Italisë (ANAC), u zhvillua, moduli VI dhe i fundit i trajnimit të audituesve të KLSH-së mbi vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve të korrupsionit në fushën e prokurimit publik. Në këtë modul u trajtua monitorimi i kontratave publike dhe promovimi i mjeteve digjitale inovative për të përmirësuar auditimin e procedurave të prokurimit publik. Trajnimi u ofroi pjesëmarrësve mundësinë për të shkëmbyer informacion, për të kuptuar më mirë kuadrin rregullator dhe operacional, standardet ndërkombëtare dhe për të ndarë praktikat e mira me ekspertët e lartë të ANAC-ut.
- Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit ka vijuar bashkëpunimin me ekspertët e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë (OANG) në drejtim të përmirësimit të cilësisë së auditimeve me anë të zhvillimit të workshopeve online dhe onsite si dhe webinar-eve në lidhje me auditimin bazik të Network Security; Cisco ACL dhe mbi Cyber security dhe përgjigja ndaj rasteve kërcënuese.

Rekomandimi 2. Programimin periodik të auditimeve në të gjitha institucionet e pavarura që raportojnë në Kuvendin e Shqipërisë dhe gjetjet e këtyre auditimeve t’ua paraqesë komisioneve parlamentare bazuar edhe në analizën e risqeve të tyre.

- KLSH ka kryer auditime financiare/përputhshmërie në këto institucione kushtetuese ose të pavarura: Gjykata e Lartë, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Akademia e Shkencave dhe Autoriteti i Konkurrencës, si dhe janë parashikuar të auditohen Autoriteti i Konkurrencës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Avokatura e Shtetit etj.

Rekomandimi 3. Nxitjen e auditimeve të teknologjisë së informacionit dhe auditimeve të mjedisit për sa u takon fushave që lidhen me sulmet kibernetike, ndryshimet klimatike, menaxhimin e mbetjeve dhe financimin e mbrojtjes së mjedisit.

- KLSH ka kryer 10 auditime të Teknologjisë së Informacionit krahasuar me 5 auditime të realizuara një vit më parë me fokus auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, si dhe janë kryer 5 auditime përputhshmërie me fokus çështjet e mjedisit. Gjatë vitit 2023 kanë filluar edhe 3 auditime performance me fokus ndotjen e mjedisit.
- Me asistencën e ekspertëve norvegjezë është realizuar auditimi i performancës me temë “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit” dhe auditimi TI-së në subjektin “Ujësjellës-Kanalizime” Durrës.

Rekomandimi 4. Përmirësimin e cilësisë së auditimeve duke iu përgjigjur në mënyrë të vazhdueshme zhvillimeve të Standardeve Profesionale të Auditimit të Jashtëm Publik dhe rregulloreve të auditimit për të ndikuar në forcimin e sistemit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, si dhe në ndihmë të zhvillimit dhe forcimit të institucioneve publike.

- KLSH ka miratuar dokumentin “Rregullore e Procedurave të Auditimit”, për t’iu përgjigjur në mënyrë të vazhdueshme zhvillimeve të Standardeve Profesionale të Auditimit të Jashtëm Publik, si dhe gjatë vitit 2024 do të zhvillohen trajnime të stafit për njohjen dhe zbatimin e saj në punën audituese.
- Me qëllim planifikimin dhe përzgjedhjen e temave të auditimit mbi bazë risku, për të siguruar mbulueshmëri me auditime të fushave dhe subjekteve me risk të lartë, në funksion edhe të forcimit të sistemit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies publike, është hartuar “Metodologjia e Planifikimit Vjetor të Auditimeve”, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 166, datë 26.09.2023.
- Në kuadër të bashkëpunimit me SIGMA ka vijuar workshop-i për auditimin e pasqyrave të buxhetit të konsoliduar dhe atyre financiare të buxhetit të shtetit, me qëllim përmirësimin e auditimeve të kësaj fushe midis KLSH-së dhe SIGMA-s vijon bashkëpunimi me qëllim hartimin e Udhëzuesit për Auditimin e Zbatimit të Buxhetit.

Rekomandimi 5. Identifikimin e institucioneve që rezultojnë me nivelin më të ulët të treguesit të zbatimit të rekomandimeve, si dhe nxitjen e mekanizmave të koordinimit me Kuvendin dhe qeverinë, me qëllim përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të financave publike.

- Platforma e raportimit mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, është rikonceptuar në tërësi, duke u sjellë në formë të tillë që të mund të shërbejë edhe si regjistër rekomandimesh për t’u ndjekur në çdo kohë. Në këtë regjistër, janë ngarkuar të dhëna edhe për ato rekomandime, zbatimi i të cilave është parë si një drejtim i veçantë i programit të auditimit (p.sh në rastet e subjekteve të cilat auditohen çdo vit), duke na dhënë kështu mundësinë që të raportojmë mbi një numër më të lartë auditimesh. Po njëjloj si statistikatat e auditimeve, edhe ky format na ofron

mundësinë e përdorimit të teknikave të avancuara të përpunimit të të dhënave me qëllim plotësimin e raportit me indikatorë të ndryshëm, të rëndësishëm për raportimin. KLSH ka informuar Kuvendin nëpërmjet dërgimit periodik të raporteve të zbatimit të rekomandimeve dhe përditësimin e Regjistrit elektronik të Platformës së Kuvendit të hartuar për këtë qëllim nga Kuvendi i Shqipërisë. Regjistri elektronik i Platformës së Kuvendit mbi zbatimin rekomandimeve është plotësuar gjatë muajit mars 2023. Kjo platformë përditësohet periodikisht sapo hartohet dhe finalizohet raporti përmbledhës i zbatimit të rekomandimeve.

- Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm është një nga drejtimet e programit të auditimit, që nëpërmjet rekomandimeve të synohet përmirësimi i vazhdueshëm i këtij sistemi.

Rekomandimi 6. Ndjekjen me përparësi dhe realizimin e aktiviteteve në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike të institucionit, të parashikuara në Strategjinë e Zhvillimit Institucional të KLSH-së për periudhën 2023-2027, hartuar në bashkëpunim me Iniciativën për Zhvillim të INTOSAI (IDI) dhe ekspertizën e SAI-t të Norvegjisë.

- Në zbatim të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2023–2027 është hartuar Plani i Veprimit, miratuar me Urdhrin e Kryetarit nr. 144, datë 01.08.2023, i cili monitorohet çdo vit për të vlerësuar nivelin e arritjes së objektivave kundrejt parashikimit. KLSH ka verifikuar dhe ndjekur me përparësi ecurinë e zbatimit të planit të veprimit dhe hartimin e Raportit të Monitorimit të Strategjisë së KLSH-së për vitin 2023.

Rekomandimi 7. Orientimin e punës audituese në lidhje me programin buxhetor vjetor dhe afatmesëm, në funksion të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 dhe përdorimin efektiv dhe eficient të fondeve publike.

- KLSH ka kryer disa auditime me fokus Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm ndër të cilat: “Fuqizimi Ekonomik i Gruas në vendin tonë”; “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”; “Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e grave të dhunuara ose fëmijëve të dhunuar dhe realizimi i projekteve”; “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”. Plani i auditimeve për vitin 2024 është orientuar drejt përmbushjes së objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm sipas Agjendës 2030 sikur janë ato të barazisë gjinore, mjedisit, arsimit, shëndetësisë etj.

Rekomandimi 8. Përcaktimin e mënyrës dhe metodologjinë e përlogaritjes së dëmit ekonomik që i shkaktohet buxhetit të shtetit referuar praktikave më të mira dhe ta publikojë atë në faqen zyrtare të institucionit.

- KLSH për këtë rekomandim ka angazhuar strukturat përkatëse për të konsultuar praktikën më të mirë në komunitetin INTOSAI dhe legjislacionin e brendshëm mbi ekzistencën e ndonjë metodologjie mbi mënyrën e përlogaritjes së dëmit ekonomik.

Rezulton se në gjithë rastet e shqyrtuara (Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të SHBA-GAO, Zyra Kombëtare e Auditimit e Anglisë-NAO, Gjykata Evropiane e Audituesve- ECA, si dhe SAI-et kryesore të Evropës e rajonit etj.), nuk identifikohet ekzistenca dhe aplikimi i një metodologjie të tillë të standardizuar, pasi koncepti i shkeljeve financiare e të ligjshmërisë apo përcaktimi i mënyrës së llogaritjes së vlerës së dëmit ekonomik, nuk është qëllim kryesor dhe në vetvete i institucioneve të auditimit të jashtëm publik.

Parimi INTOSAI-P1 “Deklarata e Limës me udhëzimet mbi rregullat e auditimit” ka shprehur qartësisht në Nenin 1, se: “Auditimi është komponent i domosdoshëm i një sistemi rregullator, i cili ka për qëllim të zbulojë devijimet nga standardet e pranuar dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë, eficiencës, efektivitetit, ekonomikitetit dhe të menaxhimit financiar. Ky sistem do të bënte të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese në raste të veçanta, rritjen e përgjegjshmërisë, marrjen e kompensimit, si dhe parandalimin e shkeljeve të tilla.”

KLSH në lidhje me mënyrën e vlerësimit dhe përlllogaritjes së efekteve të mundshme të shkeljeve të disiplinës financiare, apo të vlerësimit të efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe në menaxhimin pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike, (njohur si koncepti i “3 E-ve”), apo për vlerësimin e të ardhurave të munguara, bazohet rast pas rasti, në Standardet Ndërkombëtare Profesionale të Auditimit të Jashtëm Publik, në Manualët e Auditimit të KLSH-së sipas fushave, si dhe në kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi që rregullon aktivitetin e subjekteve të audituara.

Lidhur me shpërblimin e dëmit ekonomik, INTOSAI P1- Deklarata e Limës për udhëzimet e Auditimit (2019, Seksioni 2, Paragrafi 3) përcakton: “Auditimi ex post (pas faktit) nga një Institucion Suprem i Auditimit nënvizon përgjegjësinë e atyre që janë përgjegjës; mund të çojë në kompensim për dëmin e shkaktuar dhe mund të parandalojë përsëritjen e shkeljeve.”

Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 7850, date 29.07.1994, i ndryshuar, Neni 420 i tij, shpreh kuptimin mbi lindjen e detyrimeve: “Detyrimet lindin nga kontratat ose nga ligji”. Natyra ekonomike e detyrimit pasqyrohet në Nenin 421 të këtij Kodi, i cili përcakton se “Objekt i detyrimit duhet të ketë një vlerësim ekonomik dhe t’i përgjigjet interesave qoftë dhe jo pasurore të kreditorit.”

Kodi i Punës, miratuar me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Neni 3 dhe 27/ 1, cilëson: “Punëmarrësi përgjigjet para punëdhënësit për dëmin që i shkakton kur shkel detyrimet kontraktuale, me dashje ose nga pakujdesia.”

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në nenin 4, pika 14 tij përcakton: “Parregullsi” është moszbatimi ose zbatimi i gabuar i ligjeve apo i rregulloreve të tjera, që e ka origjinën te veprimet a mosveprimet e përdoruesit të fondeve publike, të cilat kanë ose mund të kenë pasoja të dëmshme për fondet publike, pavarësisht nëse ajo prek të ardhurat/të hyrat, shpenzimet/të dalat, fondet e kthyer mbrapsht, aktivet apo detyrimet financiare.

Përkufizimi nga Këshilli i Evropës²³, në lidhje me dëmin: Duhet të përcaktohet një lidhje e qartë shkak-pasojë ndërmjet dëmit të shkaktuar dhe shkeljes së pretenduar. Për sa i përket dëmit material, barra e provës i takon kërkuesit, pra është kërkuesi ai që duhet të tregojë se dëmi material ka ardhur si rezultat i shkeljes ose shkeljeve të pretenduara. Kërkuesi duhet të parashtrojë sa më shumë dokumente të jetë e mundur për të provuar, për aq sa është e mundur, jo vetëm ekzistencën e dëmit por edhe shumën ose vlerën e dëmit të shkaktuar. “Normalisht, vendimi i Gjykatës reflekton shumën e plotë të llogaritur për dëmin, nëse dëmi aktual nuk mund të llogaritet saktësisht”.

Lidhur me masat për eliminimin e efekteve negative, të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhurat e munguara, (njohur si koncepti i “3 e-ve”), Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, në nenin 3 të tij përcakton: “Auditimi i performancës” ka të bëjë me auditimin e ekonomikitetit, efencës dhe efektivitetit. Përkufizimi i mësipërm është huazuar nga Standardet ISSAI dhe konkretisht ISSAI 3000 dhe GUID 3910, “Central Concepts for Performance Auditing” (INTOSAI 2019), dhe GUID 3920 “The Performance Auditing Process” kanë identifikuar Parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit të përkufizuara si më poshtë:

a) Parimi i ekonomizimit nënkupton minimizimin e kostove të burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë të disponueshme në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e përshtatshme, dhe me çmimin më të mirë.

²³ <https://www.coe.int/sq/web/execution/article-41>

b) Parimi i efikasitetit do të thotë të përfitosh maksimumin nga disponueshmëria e këtyre burimeve. Kjo ka të bëjë me marrëdhëniet midis burimeve të angazhuara dhe outputeve të ofruara, për sa i përket sasisë, cilësisë dhe kohës.

c) Parimi i efektivitetit ka të bëjë me përmbushjen e objektivave të vendosura dhe arritjen e rezultateve të synuara;

Në një shpjegim më të sintetizuar, ekonomiciteti nënkupton “të shpenzosh më pak”, eficienta “të shpenzosh më zgjuar” dhe efektiviteti “të shpenzosh më mirë” dhe gjen pasqyrim në Manualin e Auditimit të Performancës të KLSH-së, miratuar me Vendimin e nr. 196, datë 26.11.2021 të Kryetarit të KLSH-së.

Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, miratuar me Vendimin e nr. 07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH-së ka nënvizuar se: duhet të kemi parasysh Ekonomicitetin p.sh. si në rastin e hartimit të fondit limit i cili nuk është hartuar i saktë dhe referuar çmimeve të tregut etj. Eficencën: nëse fondet e përdorura janë eficiente, të mjaftueshme për investimin, blerjen, etj dhe Efektivitetin nëse fondet e realizuara janë efektive dhe investimi, blerja shpenzimi janë në punë, funksion, (investimi kryer, rruga, aktivi funksionon); për të ardhura të munguara në lidhje me detyrimet që tatimpaguesit kanë ndaj subjektit, të cilat nuk janë kontabilizuar si detyrime tatimore për periudhën nën auditim dhe gjithashtu nuk janë arkëtuar. Në rast se detyrimet e tatimpaguesve janë kontabilizuar duhet të konsiderohen si debitorë të pa arkëtuar dhe nuk kanë të bëjnë me të ardhurat e munguara etj.

Rekomandimi 9. Rritjen e transparencës nëpërmjet vijimit të publikimit në faqen zyrtare të institucionit të raporteve të auditimit, të raporteve të paraqitura nga KLSH në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe të buletinit përmbledhës të KLSH-së.

- Në kuadër të transparencës dhe informimit të publikut, KLSH ka vijuar në mënyrë periodike publikimin e raporteve përfundimtare të auditimit. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka publikuar 160 raporte përfundimtare auditimi të evaduar gjatë vitit 2023. Në faqen zyrtare të KLSH-së është publikuar “Raporti vjetor i performancës 2022”, “Raporti për zbatimin e buxhetit të shtetit 2022” (në gjuhën shqipe dhe atë angleze) si dhe buletinet periodikë statistikorë.

Rekomandimi 10. Promovimin e rolit të institucionit nëpërmjet shtimit të mjeteve të komunikimit me palët e interesit, organizatat e shoqërisë civile dhe botën akademike, me qëllim forcimin e besimit të publikut tek pavarësia e institucionit.

- Në kuadër të promovimit të punës audituese, KLSH ka organizuar takime të ndryshme dhe ka përgatitur broshura informuese për auditime me një ndjeshmëri të lartë publike me palët e interesit, organizatat e shoqërisë civile dhe botën akademike.

- Aktiviteti i KLSH-së, jo vetëm ai auditues është pasqyruar rast pas rasti në faqen zyrtare të internetit në të cilën ekziston edhe një dritare komunikimi, e cila përdoret nga qytetarët, si një mënyrë komunikimi për të dërguar ankesat, denoncimet apo pyetjet e tyre.

4.2 Bashkëpunimi ndërinstitucional

K Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka zhvilluar përgjatë vitit 2023, angazhimin e gjithanshëm me partnerët e jashtëm dhe të brendshëm, në ndjekje të praktikave më të mira, me qëllim rritjen e impaktit të punës audituese dhe optimizimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale, për t’iu përshtatur sa më mirë kontekstit në të cilin operon.

INTOSAI.

Viti 2023 shënon anëtarësimin e KLSH-së në Task Forcën e INTOSAI-t për “Pjesëmarrjen qytetare dhe angazhimin e shoqërisë civile” të kryesuar nga SAI i Perusë. Gjithashtu në kuadër të INTOSAI-t stafi i KLSH-së është angazhuar në një sërë aktiviteteve si:

- Takimi i VI i SG1 "Mbështetje ndaj auditimeve efektive, inovative dhe relevante nëpërmjet promovimit dhe bashkëpunimit profesional" organizuar online nga SAI-t e Gjermanisë/Lituanisë, zhvilluar më datë 25 janar 2023;
- "Side event- Më shumë impakt nga auditimet e SDG-ve" organizuar online në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara, zhvilluar më datë 13 korrik 2023;
- webinar i grupit të punës për auditimet IT "E ardhmja e auditimit" të zbulosh mjetet emergjente TECH, zhvilluar më datë 19 korrik 2023;
- Webinar mbi çështjet IT i organizuar në bashkëpunim me SAI-n e Indisë, zhvilluar më datë 30 gusht 2023;

Bashkëpunime me Inicativën për Zhvillim (IDI) të INTOSAI-t. Një ndër partnerët kryesorë të KLSH-së vijon të mbetet IDI²⁴. Gjatë vitit 2023, IDI ka vijuar të asistojë ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe njerëzore të audituesve në KLSH-së.

Kështu, për herë të parë u organizua në KLSH në datat 17-19 tetor 2023, takimi i "resource persons" të IDI-t për SPMR III me pjesëmarrjen e ekspertëve të IDI-t si dhe përfaqësuesve të SAI-ve nga vende të ndryshme të botës. Gjithashtu përmendim si vijon:

- Kursin e IDI-t për SPMR (raportimi dhe zbatimin) të zhvilluar në Stamboll në datat 6-10 shkurt 2023;
- Takimin II të Grupit të Referencës së IDI-t mbi "Mekanizmin pro-aktiv të mbrojtjes së pavarësisë së SAI-ve" i zhvilluar në Pragë në datat 24-28 prill 2023;
- Masterklasën mbi Liderhipin i zhvilluar në Stamboll në datat 19-21 shtator 2023;
- Akademinë mbi Qeverisjen e SAI-t të zhvilluar në Tbilisi në datat 27 nëntor – 1 dhjetor 2023.

Përgjatë vitit 2023 KLSH ka vijuar të jetë pjesë e programit "Kursi Profesional për Audituesit e SAI-t – Pilot" ose PESA-P i organizuar nga IDI, me dy auditues, të cilët kanë përmbushur me sukses programin detyrues të aktiviteteve dhe portofolin fillestar të zhvillimit profesional.

Në vitin 2023, KLSH është bërë pjesë gjithashtu e programit pilot mbi "Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë në Auditime" (SoAQM). Në këtë program pilot marrin pjesë 13 SAI të ndryshme të botës të ndarë në dy grupe dhe rezultatet përfundimtare të këtij pilotimi pritet të jenë të treguarit e një kulture që i jep prioritet cilësisë sipas tonit të liderhipit të SAI-t, sistemit të institucionit dhe njerëzve, ashtu si edhe hartimi i një sistemi të menaxhimit të cilësisë në bazë të nevojave.

EUROSAI

Viti 2023 shënon anëtarësimin e KLSH-së në Projekt Grupin e EUROSAI-t për "Përfitimet dhe Metodologjitë e auditimit në kohë reale" në kuadër të Qëllimit Strategjik 1 të EUROSAI-t, "Ngritja e kapaciteteve", takimi prezantues i të cilit u zhvillua në Gjykatën e Llogarive të Italisë në datën 11 maj 2023.

Takimi i Komitetit të Kontaktit nën drejtimin e SAI-t të Portugalisë, u zhvillua në datat 21-22 qershor 2023, në Lisbonë me pjesëmarrjen e Presidentëve të SAI-ve të vendeve anëtare të BE-së, Presidentëve dhe përfaqësuesve të SAI-ve të vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme për në BE, Gjykatës Evropiane të Llogarive, si dhe përfaqësuesve të lartë të Komisionit Evropian. Agjenda përgjatë dy ditëve trajtoi çështjen e Energjisë, se si SAI-t mund të kontribuojnë për një zbatim më të mirë, përmbushjen e SDG 2030, si dhe rimëkëmbjen e këtij sektori.

Takimi i Presidentëve të SAI-ve të Rrjetit të Vendeve Kandidate dhe Kandidate të mundshme për në BE nën moderimin SAI-t të Bosnje dhe Hercegovinës dhe me pjesëmarrjen e OECD/SIGMA-s dhe SNAO-s, u zhvillua online në datën 20 dhjetor 2023. Kryetarët dhe përfaqësuesit e SAI-ve të Shqipërisë, Kosovës, Turqisë, Malit të Zi, Bosnje dhe Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut dhe

²⁴ IDI – INTOSAI Development Initiative (Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t)

Serbisë, dakordësuan dhe miratuan kuadrin e ri të bashkëpunimit të këtij Rrjeti (të rishikuar). Gjithashtu gjatë takimit u rishikuan dhe u miratuan një sërë aktivitetesh në kuadër të Programit të Punës së këtij Rrjeti për periudhën 2023-2025.

Aktivitete në kuadër të grupeve të punës dhe Task Force



Grupi i Punës së EUROSAI-t për Auditimet e Mjedisit – WGEA²⁵: Përgjatë vitit 2023, janë zhvilluar dy takime të këtij grupi pune, respektivisht sesioni i pranverës që u ndoq në formatin online në datat 25-26 maj 2023 me temë "Ndryshimet klimatike; Progresi në përshtatjen e përpjekjeve", i cili u ndoq nga 2 auditues. Takimi vjetor dhe seminari "Green SAI-s" u zhvillua me prezencë fizike në datat 25-26 shtator 2023 në Pragë, ku morën pjesë 4 auditues nga KLSH.

Grupi i Punës së EUROSAI-t për Teknologjinë e Informacionit – ITWG²⁶:

Takimi i 16 i këtij grupi pune u zhvillua në datat 10-11 tetor 2023 në Varshavë, ku morën pjesë 2 përfaqësues nga KLSH. Temat kryesore të diskutuara përgjatë takimit trajtuan pavarësinë në përdorimin e zgjidhjeve Cloud, sigurinë dhe vazhdimësinë e sistemeve IT.



Pjesëmarrje aktive e KLSH-së u paraqit edhe në e-seminarin e zhvilluar nga grupi i punës me temë "Identifikimi elektronik dhe sfidat e tij", i zhvilluar më 19 prill, 2023 ku mori pjesë 1 auditues nga KLSH, si dhe në modulet profesionale të përgatitura nga ky grup pune për auditues që nuk kryejnë auditime IT me titull "IT for non IT auditors", të cilat janë në vazhdim dhe që po ndiqen nga 6 auditues të KLSH-së. Gjithashtu 2 përfaqësues të KLSH-së ndoqën online edhe simpoziumin e organizuar nga ARABOSAI në bashkëpunim me këtë grup pune mbi "Zhvillimin e konceptit të auditimit IT" i zhvilluar në datat 2-3 nëntor 2023.



Task-Force e EUROSAI-t për Auditimin e Bashkive – TFMA²⁷: Takimi i VII i Task Forcës së EUROSAI-t për Auditimin e Bashkive si dhe seminari me titull "Shpërndarja e transfertave dhe granteve", u zhvilluan në datat 19-20 tetor 2023 në Varshavë. Në këtë takim KLSH u përfaqësua me 3 auditues. Në fokus të diskutimeve ishin eksperiencat dhe sfidat e hasura gjatë auditimeve në lidhje me kontrollin e brendshëm të granteve, kriteret e shpërndarjes së transfertave buxhetore për njësitë e qeverisjes vendore, përmirësimi metodologjik i auditimit të tyre, auditimi i borxhit të njësitë të qeverisjes vendore, etj.

KLSH dhe bashkëpunimi bilateral me SAI-et homologe

Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të ndërsjellë të nënshkruar me **Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Norvegjisë** janë zhvilluar një sërë aktivitetesh të parashikuara në planin 2-vjeçar të miratuar me homologët, ku përmendim për vitin 2023:

- në fushën IT; workshop mbi ofrimin e njohurive për auditimet e network dhe firewalls dhe network security i zhvilluar në qytetin e Vlorës në datat 5-9 qershor 2023;
- në fushën e performancës; takimin mbi auditimin me temë "Ndikimi i transportit rrugor në cilësinë e ajrit" mbi piramidën e pyetjeve të auditimit zhvilluar në datat 21 dhe 22 shkurt 2023;

²⁵ WGEA – Working Group on Environmental Auditing

²⁶ ITWG – IT Working Group

²⁷ TFMA – Task Force on Municipality Audit

- trajnimin mbi dokumentimin e rezultateve nëpërmjet teknikave të auditimit dhe përdorimin e tyre për gjenerimin e gjetjeve të auditimit, intervistave, si dhe realizimin e pyetësorëve, vëzhgimeve etj., zhvilluar në datat 12-14 qershor 2023;
- vizitën studimore pranë OAGN nga grupi i KLSH-së zhvilluar në datat 22-26 prill 2023 me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave në auditimin e performancës me fokus aspektet mjedisore, mundësitë për zhvillimin e auditimit të performancës si dhe diskutimi nga afër i projekt-raportit të auditimit “Ndikimi i transportit rrugor në cilësinë e ajrit”;
- në fushën e auditimit të industrive nxjerrëse; ëorkshop mbi identifikimin e risqeve në sektorin e industrive nxjerrëse dhe përgatitja për dhënien e asistencës në auditim zhvilluar në datat 3-5 korrik 2023.

Më 3 mars 2023 u nënshkrua në Shkup, Marrëveshja e Bashkëpunimit tripalëshe, ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, e cila i hapi rrugën auditimit paralel të performancës me titull “Barazia gjinore dhe fuqizimi i gruas nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”, në bashkëpunim me organizatën UN Women.

Bashkëpunimi në auditime paralele. Me qëllim shkëmbimin e eksperiencave më të mira dhe praktikave audituese, KLSH përgjatë vitit 2023 ka vijuar angazhimin në auditimet ku janë përmbyllur:

- auditimi paralel me temë “Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e Bashkive për të siguruar shërbime cilësore për qytetarët gjatë pandemisë “. Në muajin korrik 2023 u publikua Raporti i përbashkët përfundimtar i auditimit ku KLSH dhe në muajin shtator 2023 u zhvillua në Shkup takimi përmbyllës i këtij auditimi ku KLSH mori pjesë së bashku me SAI-t e Polonisë, Rumanisë, Sllovakisë, Malit të Zi dhe Turqisë;
- auditimi paralel me temë “Sistemet e TI-së në Ujësjellës – Kanalizime Tiranë SH.A”. Ky auditim u zhvillua në bashkëpunim me ZKA-në e Kosovës dhe raporti përfundimtar i përbashkët u prezantua në takimin përmbyllës të zhvilluar në Tiranë në muajin dhjetor 2023.

Në muajin maj 2023, KLSH u bë pjesë gjithashtu e iniciativës së IDI-t në auditimin global të përbashkët organizuar në bashkëpunim edhe me Grupin e Punës së INTOSAI-t për auditimet e mjedisit, INTOSAI/WGEA për “Përshtatjen e aksionit të ndërmarrë në kuadër të ndryshimeve klimaterike”.

KLSH dhe shkëmbimi i praktikave dhe eksperiencave nëpërmjet pjesëmarrjes në takime, konferenca, seminare dhe trajnime. Përgjatë vitit 2023, u zhvilluan edhe një sërë aktivitetesh të tjera me prezencë fizike dhe në formatin online ku përfaqësues të KLSH-së kanë marrë pjesë respektivisht.

- 2 Simpoziumet e EUROSAT-t për "Çështjet Emergjente" duke trajtuar tematikat e auditimit në kohën e transformimeve digjitale zhvilluar në Londër në datat 30-31 janar 2023 dhe auditimet për rimëkëmbjen e shërbimeve publike zhvilluar në Lisbonë në datat 30-31 tetor 2023;
- Workshop-e DEA/SG2 (data envelopment analysis) të EUROSAT-t; në kuadër të Qëllimit Strategjik 2 “Standardet Profesionale” të zhvilluara në Madrid në datat 9-10 shkurt 2023 dhe Varshavë në datat 10-11 dhjetor 2023, si dhe mbi metodologjinë në auditime zhvilluar në Varshavë në datat 15-16 nëntor 2023;
- Takimi mbi “Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet SAI-ve dhe OJQ në luftën kundër korrupsionit” organizuar online nga Transparency International dhe IDI zhvilluar më datë 7 mars 2023;
- “Summer school of investigation” organizuar nga Gjykata Hollandeze e Auditimit në bashkëpunim me UKNAO dhe EUROSAT me në fokus konceptin e auditimeve investigative dhe eksplorimin e mënyrave të reja të me qëllim rritjen e impaktit dhe eficiencës zhvilluar në Hagë në datat 3-5 korrik 2023;

- Forumi “Të punojmë së bashku” organizuar nga EUROSAI - ECIIA mbi marrëdhëniet auditues i jashtëm dhe auditues i brendshëm me në fokus të kuptuarin e punës së ndërsjellë dhe promovimin e roleve të përbashkëta zhvilluar në Bruksel në datën 6 tetor 2023;
- Takimi i Bordit të audituesve të NATO-s zhvilluar më datë 7 qershor 2023;
- Workshopi rajonal organizuar nga UNODC “Rritja e bashkëpunimit mes SAI-ve dhe organeve anti-korrupsion” zhvilluar në Vjenë në datat 31 maj – 2 qershor 2023;
- Takimi mbi “Bashkëpunimin ndërmjet audituesve të brendshëm dhe të jashtëm” organizuar online nga SAI i Letonisë/EUROSAI/ECIIA zhvilluar më datë 16 mars 2023;
- Forumi Anti-korrupsion dhe Siguria Kombëtare organizuar online nga Qendra për Studimin e Demokracisë, Ministria e Drejtësisë e Bullgarisë dhe Instituti Bazel zhvilluar më datë 21 mars 2023;
- Masterklasi për metodologjinë e auditimit të bashkive organizuar online nga EUROSAI/TFMA zhvilluar më datë 30 mars 2023;
- Webinari post COVID-19 organizuar nga UKNAO zhvilluar më datë 24 prill 2024;
- Webinari "SAI PMF in the new era" organizuar nga IDI i zhvilluar më datë 27 prill 2023;
- Kursi e-ITEC iCISA organizuar online nga SAI i Indisë për Auditimet e Performancës dhe zhvilluar në datat 27 qershor – 11 korrik 2023;
- Kursi mbi Auditimin e Mjedisit në Sektorin Publik organizuar online nga SAI i Estonisë dhe Universiteti i Tartusë zhvilluar në datat 25 shtator – 22 tetor 2023;
- Kursi Politikat ndërkombëtare në luftën ndaj pastrimit të parave organizuar online nga Guardia di Finanza dhe zhvilluar më datë 25 tetor 2023.

Përgjatë vitit 2023, janë përmbyllur gjithashtu pjesëmarrjet në:

- Internshipin e Gjykatës Evropiane të Llogarive ECA për periudhën 1 mars - 31 korrik 2023 me dy auditues;
- Fellowshipin e Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, GAO për periudhën 3 maj – 28 korrik 2023 me 1 auditues.
- Gjithashtu, ka vijuar bashkëpunimi me Universitetin e Auditimit Nanjing të Kinës për programin Master që ky universitet ofron për audituesit e rinj.

Bashkëpunimi me partnerë të tjerë ndërkombëtarë

KLSH dhe SIGMA: KLSH ka vijuar komunikimet dhe takimet me ekspertët e SIGMA-s dhe grupit të punës të ngritur në KLSH për hartimin e Manualit praktik mbi Auditimin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit, si dhe ka marrë pjesë në disa prej aktivitetëve të organizuara nga SIGMA me prezencë fizike dhe online si vijon:

- Konferenca "Marrëdhënia efektive ndërmjet SAI-ve dhe palëve të interesit, mënyra se si SAI-t mund të bashkëpunojnë me ta, përfshirë shoqërinë civile me qëllim rritjen e impaktit” organizuar në bashkëpunim me SNAO dhe zhvilluar në Sarajevë në datat 5-6 qershor 2023;
- Seminari mbi Auditimet e Përputhshmërisë organizuar në kuadër të planit të punës së aktivitetëve të Rrjetit të vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme për në BE dhe zhvilluar në Prishtinë në datën 11 tetor 2023;
- Webinari për “Shqyrtimin e pritshmërive të standardeve ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë/menaxhimin efektiv në të gjitha aktivitetet e një SAI” organizuar në kuadër të planit të punës së aktivitetëve të Rrjetit të vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme për në BE dhe zhvilluar më datë 13 prill 2023.

KLSH dhe Prezenca e OSBE-së dhe Autoriteti Kombëtar Italian Anti Korrupsion - ANAC: Në kuadër të bashkëpunimit të filluar tashmë që në vitin 2021, OSBE në partneritet me ANAC kanë

përmbyllur në 5-6 qershor 2023 modulën VI dhe të fundit të trajnimit të audituesve të KLSH-së mbi vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve të korrupsionit në fushën e prokurimit publik. Ky modul shënoi përmbylljen e të gjithë ciklit dy-vjeçar të sesioneve të trajnimit në bashkëpunim me ekspertët e Autoritetit Antikorrupsion Italian. Gjithashtu, me mbështetjen e OSBE-së u zhvillua në Romë në datat 11-12 dhjetor një vizitë studimore e zyrtarëve të KLSH-së pranë këtij Autoriteti. Përfaqësuesit e KLSH-së u njohën më nga afër me aplikimin nga ANAC të platformave të të dhënave të hapura, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e përdorimit të fondeve publike apo eksplorimin e mjeteve inovatore në auditim.

KLSH dhe SECO: Në kuadër të Projektit “*Forcimi i mbikëqyrjes së kontratave të koncesionit dhe partneritetit publik privat në Shqipëri*” i financuar nga Sekretariati i Çështjeve Ekonomike të Zvicrës (SECO), u finalizua gjatë vitit 2023 auditimi pilot “Kontrata e koncesionit për ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenerëve dhe automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifën e skanimit” dhe ka përfunduar në terren auditimi i dytë pilot “Për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve”.

Ky projekt përfshin një sërë objektivash të pritshme, ku përmendim: (I) kryerjen e 3 auditimeve pilot në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve; (II) zhvillimin e kapaciteteve audituese në këtë fushë nëpërmjet trajnimeve nga ekspertët e jashtëm; si dhe (III) hartimin e një Manuali për auditimin e koncesioneve dhe PPP-ve. Së bashku me finalizimin e auditimit pilot të parë, të kryer tashmë, është konceptuar, hartuar dhe aplikuar Metodologjia e Auditimit të Koncesionave dhe PPP-ve (e cila pritet të kthehet në një Manual të mirëfilltë që do të udhëheq punën audituese).

KLSH dhe UN Women Albania: Në zbatim të memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet KLSH-së dhe UN Women Albania, me qëllim ofrimin e asistencës në drejtim të barazisë gjinore dhe monitorimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor u zhvillua më datë 8 maj 2023, takimi me përfaqësuesit e UN Women në Shqipëri, z. Michele Ribotta dhe përgjegjësen e Zyrës së Bashkëpunimit Suedez për Zhvillim në Shqipëri, znj. Petra Burcher, me rastin e prezantimit të auditimit të performancës me temë “Fuqizimi ekonomik i gruas në Shqipëri” 2016-2021, i kryer në kuadër të projektit “Financimi transformues për barazinë gjinore drejt një qeverisje më transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor” i financuar nga qeveria e Suedisë (SIDA). Me mbështetjen e UN Women është zhvilluar gjithashtu, auditimi paralel i performancës me titull “Barazia gjinore dhe fuqizimi i gruas nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës” në kuadër të marrëveshjes trilaterale me SAI-t e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut nënshkruar në Shkup, në muajin mars 2023.

Bashkëpunimi me Prokurorinë

Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe të Marrëveshjeve të Bashkëpunimit: nr. 948 prot., datë 24.09.2020 me Prokurorinë e Përgjithshme dhe nr. 1040 prot., datë 19.10.2020 me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, KLSH ka vijuar bashkëpunimin gjatë vitit 2023 me këto institucione për raportimin e rasteve të konsideruara si vepra penale.

KLSH gjatë vitit 2023 ka adresuar 67 materiale auditimi pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të cilat kanë shërbyer për nisjen apo vijimin e mëtejshëm të veprimeve hetimore që kryhen nga ana e këtij organi në kuadër të procedimeve penale. Janë kallëzuar penalisht 10 zyrtarë të administratës shtetërore për veprën penale shpërdorim i detyrës të parashikuar nga neni 248 i Kodit penal, si dhe shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, të kryera në bashkëpunim më shumë se njëherë.

KLSH, ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme edhe me Prokuroritë Pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, kundrejt të cilave, në kuadër të këtij bashkëpunimi, ka adresuar

24 materiale auditimi, të cilat kanë shërbyer për nisjen apo vijimin e veprimeve hetimore që kryhen nga ana e këtij organi në kuadër të procedimeve penale.

Gjatë vitit 2023 nëpërmjet përfaqësuesve të saj, KLSH është angazhuar në disa tryeza të rrumbullakëta apo grupe pune me qëllim luftën kundër korrupsionit.

Në këtë kuadër, strukturat përkatëse pranë KLSH-së, kanë përgatitur përgjigjet për pyetjet e Pyetësorit të BE duke mbajtur marrëdhënie intensive me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave. Përgjigjet e pyetësorit për kapitullin 23, janë plotësuar dhe dërguar, sipas metodologjisë së kërkuar në ministritë përkatëse, brenda afateve të kërkuara.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022-2023, KLSH është përfaqësuar edhe në grupin e punës për hartimin e draftit të koncept-dokumentit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) për vitet 2023-2030, si dhe në grupin e punës, “Për hartimin e Strategjisë Kombëtare kundër mashtrimit, për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian”, për periudhën 2025-2027”.

Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile dhe Botën Akademike

Strategjia e Komunikimit të KLSH-së nuk mund të realizohet pa ndërtuar një partneritet funksional me të gjithë palët e interesuara. Ky partneritet është shpallur si prioritet strategjik i punës së institucionit. Në përmbushje të objektivit strategjik, KLSH ka rritur komunikimin dhe bashkëpunimin me qytetarët, median, shoqërinë civile dhe botën akademike.

Nisur nga interesi publik për rritjen e transparencës, angazhimit në luftën kundër korrupsionit dhe nevojën për një qasje të gjithë shoqërisë për një qeverisje të mirë dhe efektive nga ana e institucioneve publike, KLSH më datë 11 dhjetor 2023, nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM).

Gjatë vitit 2023, KLSH ka marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta me shoqërinë civile, si: në prezantimin e raportit “Fuqizimi i rolit të Kuvendit të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit”, organizuar nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI).

në tryezat e diskutimit organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM):

- “Menaxhimi i pandemisë Covid-19, ndikimi i tij në demokracinë dhe prokurimet publike në Shqipëri”.
- “Angazhimi qytetar për Reformën në Administratën Publike (RAP); rezultatet e monitorimit 2021/2022 dhe përvojat nga monitorimi i qeverisjes vendore”.
- Prezantimi i sondazhit “Besimi në qeverisje 2022”.

në takimet e organizuara nga Instituti Shqiptar i Shkencës:

- “Kontrolli i integritetit të kontraktorëve publik, praktikat e Bashkimit Evropian dhe kontraktimi në kontekstin shqiptar”.
- “Kontrolli financiar i korporatave me financim publik”.
- “Nevoja për përmirësim në Legjislacionin e Prokurimit Publik (Kapitulli 5: Integrimi)”.

në aktivitetet e organizuar nga Qëndresa Qytetare mbi:

- Akademinë Zgjedhore, një iniciativë për rritjen e kapaciteteve të monitoruesve të rinj në zgjedhjet e 14 majit, me qëllim identifikimin dhe parandalimin e krimeve zgjedhore dhe keqpërdorimit të burimeve publike për qëllime elektorale.
- tryezën e diskutimit “Transparenca dhe menaxhimi financiar i universiteteve publike”, organizuar nga Qëndresa Qytetare dhe fondacioni “Friedrich Ebert”.

në tryezat e diskutimit organizuar nga Fondacioni Westminster:

- “Rëndësia e përmirësimit të ndërveprimit dhe bashkëpunimit mes Kuvendit të Shqipërisë dhe institucioneve të pavarura”.

- “Fuqizimi i rolit mbikëqyrës të legjislacionit në vlerësimin e hapësirave për korrupsion” (bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Kërkime Ekonomike).

në tryezën e diskutimit “Përqendrimi i pushtetit ekonomik dhe nevoja për të forcuar demokracinë në një ekonomi tranzitore: rasti i Shqipërisë”, organizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes.

në takimin e organizuar nga shoqata “Together for Life”, për prezantimin e raportit të monitorimit të shpenzimeve në sektorin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për vitin 2022.

prezantimi i gjetjeve të auditimit të performancës “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”, me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës dhe shoqërisë civile.

Në kuadër të bashkëpunimit me botën akademike, Departamentet e Auditimit kanë zhvilluar analizat vjetore dhe workshop-et “Mbi planifikimin e auditimeve për vitin 2024” në ambientet e Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Universitetit “Fan Noli” të qytetit të Korçës me pjesëmarrje të deputetëve, pedagogëve dhe studentëve të këtyre universiteteve.

Bashkëpunimi në nivel bilateral nëpërmjet vizitave zyrtare, paraqitet si vijon:

Vizita zyrtare e Kryetarit të KLSH-së e zhvilluar në datat 29-30 maj 2023 pranë Autoritetit të Llogaridhënies së Emirateve të Bashkuara Arabe, me ftesë të Presidentit z. Humaid Abushibs. Gjatë kësaj vizite të dy titullarët, shprehën angazhimin dhe vullnetin e plotë në thellimin e këtij partneriteti të suksesshëm që do të vijojë me ngritjen e një grupi pune të përbashkët për përcaktimin dhe identifikimin e fushave dhe hapave konkretë për bashkëpunim.

Vizita zyrtare e Kryetarit të KLSH-së e zhvilluar në datat 30 nëntor – 1 dhjetor 2023 pranë Gjykatës së Llogarive të Italisë, njëkohësisht në Komandën e Përgjithshme të Guardia di Finanza dhe Autoritetin Kombëtar Anti-Korrupsion të Italisë (ANAC). Gjatë kësaj vizite, Kryetari i KLSH-së dhe titullarët e institucioneve respektive e vunë theksin në thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë me qëllim materializimin në aktivitete konkrete të shkëmbimit profesional.

Vizita zyrtare e Kryetarit të KLSH-së e zhvilluar në datën 6 dhjetor 2023 pranë Gjykatës Turke të Llogarive me ftesë të Presidentit z. Metin Yener, me në fokus ngritjen dhe thellimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët, si në fushën e auditimit IT, burimeve natyrore, mjedisit, shëndetësisë, ndryshimeve klimaterike etj.

Roli dhe aktiviteti i KLSH-së kanë gjetur shprehje edhe në pjesëmarrjet dhe takimet e ndërsjella që Kryetari i KLSH-së z. Arben Shehu dhe përfaqësues të institucionit kanë zhvilluar në kuadrin e bashkëpunimit ndër-institucional ku veçojmë:

Takimin e drejtuesve të lartë të Institucioneve Supreme të Auditimit të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut mbi lidërsipin dhe bashkëpunimin rajonal, organizuar nga SAI i Suedisë.

Vizitën e zhvilluar në Podgoricë me rastin e 19- vjetorit të krijimit të SAI-t të Malit të Zi.

Vizitën e zhvilluar në Prishtinë me rastin e 20-vjetorit të krijimit të ZKA së Kosovës.

Takimin me përfaqësuesit e projektit të Bashkimit Evropian “EU For Good Governance” në kuadër të angazhimit të KLSH-së në strategjinë anti-korrupsion dhe kontributin e dhënë në këtë fushë.

Takimin me Ambasadorin e Republikës së Italisë, z. Fabrizio Bucci.

Takimin me Ambasadorin e Britanisë së Madhe, z. Alastair King-Smith;

Takimin me Ambasadoren e Izraelit, znj. Galit Peleg.

Takimin me Ambasadorin e Republikës së Turqisë, z. Tayyar Kağan Atay.

Takimin me Ambasadorin e Mbretërisë së Arabisë Saudite, z. Faisal Ghazi Hifzi.

Takimin me Ambasadoren e Delegacionit të BE-së, znj. Christiane Hohmann.

Takimin me Presidentin e Autoritetit Kombëtar Anti-Korrupsion të Italisë (ANAC), z. Giuseppe Busia.

Takimin me grupin vlerësues të NDI (Instituti Kombëtar Demokratik) mbi përgatitjen e raportit vlerësues që NDI do të hartojë në kuadër të forcimit dhe zhvillimit të rolit të Parlamentit në politikat dhe masat anti-korrupsion ku KLSH luan një rol thelbësor.

Takimi me përfaqësues të Agjencisë Franceze të Zhvillimit lidhur me mundësitë e bashkëpunimit të ndërsjellë me qëllim trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH-së. Të gjitha këto takime janë duke u finalizuar me marrëveshje konkrete bashkëpunimi.

4.3 KLSH dhe Media

Kontrolli i Lartë i Shtetit, krahas publikimit të rezultateve të punës, gjetjeve të auditimit, e vlerëson si shumë të rëndësishëm komunikimin me palët e interesit dhe veçanërisht me median, për të marrë në mënyrë aktive komentet dhe sugjerimet e tyre për kuptimin dhe promovimin e aktivitetit auditues, si dhe ka shërbyer në disa raste si burim informacioni për çështje të ndryshme me ndjeshmëri publike. Në këtë mënyrë, KLSH synon t'i përgjigjet më mirë publikut dhe sfidave si një institucion suprem i auditimit me fokus transparencën dhe përgjegjshmërinë, të cilat themelore në rritjen besimit të qytetarëve ndaj veprimtarisë së institucionit.

Duke pasur në vëmendje problematikat e ngritura nga mjetet e informimit publik për çështje që kanë në fokus përdorimin e fondeve publike, performancën e shërbimeve të ofruara për qytetarët në fushën e shëndetësisë, mbrojtjes sociale, arsim etj., KLSH monitoron raportimet e medias lidhur me denoncimet për abuzime në fusha të ndryshme, të cilat shërbejnë si indicie për t'u vlerësuar dhe përfshirë në aktivitetin auditues.

Rritja e transparencës përbën një nga objektivat kryesore të Strategjisë së Komunikimit të Institucionit, e cila synon rritjen e të kuptuarit mbi rolin dhe funksionet e KLSH-së jo vetëm nga institucionet, por edhe nga publiku, organizatat jo-qeveritare dhe media.

Nëpërmjet ekspertizës dhe auditimeve cilësore informon publikun dhe palët e interesit në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në menaxhimin burimeve publike, me qëllim llogaridhënien dhe transparencën në përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Veprimtaria e institucionit për vitin 2023, veçanërisht aktiviteti auditues i KLSH-së ka gjetur pasqyrim të gjerë në shtypin e shkruar nëpërmjet 480 artikujve, si dhe 1756 artikujve e kronikave në median audio-vizive dhe online, që pasqyrojnë gjetjet dhe rekomandimet e raporteve përfundimtare të auditimit të publikuara periodikisht në faqen zyrtare të institucionit.

Pasqyrim më të gjerë në media gjatë vitit 2023 kanë gjetur auditimet e ushtruara në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe institucioneve në varësi të saj, si drejtoritë e tatimeve, doganave etj., të cilat përfshihen në Raportin për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit etj. Për çështjet me ndikim social dhe me ndjeshmëri të lartë publike të audituara në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e varësisë, përfshirë Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), spitalet etj., si: trajtimi i sëmundjeve tumorale, shërbimet e check-up, dializa, sterilizimi i instrumenteve kirurgjikale etj.

Raporti i auditimit të performancës “Rezervat materiale të shtetit në shërbim të qytetarit” i është përcjellë në vëmendje opinionit publik përmes pasqyrimit mediatik. Me interes nga media janë vlerësuar edhe raporti i auditimit të ushtruar në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, raporti për auditimin në Albpetrol, Agjencinë e Trajtimit të Pronave etj.

4.4 Programi i Transparencës dhe e Drejta e Informimit

KLSH, në respekt të detyrimit ligjor për informimin e publikut, siguron natyrën publike të punës së tij nëpërmjet publikimit të raporteve përfundimtare të auditimit, të njoftimeve për shtyp dhe çdo informacioni tjetër që përcaktohet nga Kryetari i KLSH-së, me përjashtim të informacioneve dhe materialeve, të cilat përbëjnë sekret shtetëror, tregtar apo konsiderohen si konfidenciale.

E drejta e informimit, si një e drejtë kushtetuese, tanimë është e parashikuar qartazi në një legjislacion të veçantë si e drejtë elementare me në qendër qytetarin, shoqërinë civile, median e çdo aktor tjetër të

një shoqërie demokratike. Në zbatim të ligjit “Për të drejtën e informimit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka trajtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash për informacion nga viti në vit. Si një njësi dedikuar vetëm kërkesave për informacion, Koordinatorin për të drejtën e informimit ka trajtuar 28 kërkesa të cilat janë përcjellë tek kërkuuesi brenda afateve ligjore të përcaktuara, kërkesa këto të ardhura kryesisht nga deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, gazetarë dhe qytetarë të ndryshëm.

Kontrrolli i Lartë i Shtetit ka vijuar të trajtojë me korrektesë dhe profesionalizëm letrat dhe ankesat e qytetarëve. Rritja e personalitetit dhe imazhit të institucionit është reflektuar dhe në rritjen e kërkesave dhe të ankesave të qytetarëve të ndryshëm që vijnë në adresë të institucionit, gjë që dëshmon shtimin e besimit të publikut tek KLSH.

Për shkak të këtij vizioni është rritur besueshmëria e qytetarëve shqiptar tek institucioni si një mbrojtës i pa kompromis i interesit publik në luftën e vazhdueshme dhe të përditshme ndaj abuzimeve dhe korrupsionit në administratën shtetërore.

Gjatë vitit 2023, KLSH ka administruar 368 letra, ankesa/ kërkesa për informacion nga individë dhe subjekte të ndryshme. Numri më i madh i ankesave është administruar për çështje të Vetëqeverisjes Vendore me rreth 200 ankesa. Për të gjitha kërkesat ankesat që ka qenë e mundur, përgjigja është dhënë brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj. Një pjesë e tyre mbeten në proces verifikimi në auditime të radhës sipas tematikave përkatëse, në përfundim të të cilave KLSH informon menjëherë qytetarin ankimues.

5. VLERËSIMET NGA INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE

Vlerësimi i Progres-Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2023, për veprimtarinë e KLSH-së



Komisioni Evropian ka publikuar Progres-Raportin e vitit 2023 për Shqipërinë dhe në vlerësimet për Kapitullin 32 “Kontrolli financiar” nënvizon se: *“Në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), kuadri kushtetues dhe ligjor i Shqipërisë parashikon pavarësinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit.*

KLSH ka miratuar Planin e ri Strategjik të Zhvillimit institucional 2023-2027 dhe ka vijuar aktivitetin në përmirësimin e kapaciteteve të

veta institucionale.

Raporti në vijim cilëson se *“Cilësia e punës audituese ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe se objektivat kanë kaluar nga auditimet e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, në ato të performancës. Ndiqet një qasje e auditimit të jashtëm bazuar në risk.”*

Sa i takon zbatueshmërisë së rekomandimeve raporti citon se: *“Niveli i zbatimit të rekomandimeve është ende i pamjaftueshëm me gjithë një nivel të konsiderueshëm të pranimit të rekomandimeve nga institucionet (97%). KLSH raporton gjithashtu rregullisht mbi zbatimin e rekomandimeve. Shqyrtimi parlamentar është i kufizuar.”*

Ndërsa në lidhje me impaktin e punës audituese raporti vijon se *“ka disa progres dhe se KLSH vazhdon të hartojë raporte vjetore mbi aktivitetin, dhe i publikon ato në faqen zyrtare të internetit dhe ia raporton rregullisht Kuvendit. KLSH ka të drejtën të referojë pranë organeve të prokurorisë kurdoherë që gjetjet janë në kompetencat e tyre.”*

Në përfundim, në Progres Raport rekomandohet se, është e nevojshme të rritet shkalla e zbatimit të rekomandimeve si dhe të mundësohet zhvillimi i një shqyrtim parlamentar nëpërmjet dëgjësave më të shpeshta dhe krijimin e një kuadri parlamentar monitorues që të vlerësojë rregullisht veprimin nga ana e ekzekutivit, të ndjekjes së rekomandimeve të lëna nga KLSH.”

VLERËSIME NGA SIGMA/OECD



BE dhe OECD e konsiderojnë mirëqeverisjen publike një faktor vendimtar për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, rritjen ekonomike, konkurrencën dhe cilësisë më të mirë të jetës, si dhe për të adresuar sfidat kryesore në shoqëri si sot ashtu edhe në të ardhmen. Në Nëntor 2023, SIGMA ka publikuar Raportin mbi Parimet e Administratës Publike, i cili mund të përdoret si një mjet për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të administratës publike dhe si një udhëzues për të zhvilluar politika më të mira për jetë më të mirë,

për të ofruar shërbime me cilësi të lartë dhe në qendër të përdoruesit, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë efikase, për të nxitur transparencën dhe llogaridhënien dhe për të ndërtuar besimin e qytetarëve në institucionet publike.

Në këtë raport cilësohet, si një ndër aktorët kryesorë për të arritur objektivat e mësipërme edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit (Parimi 16 dhe 31) si një institucion, i cili ka kapacitete të mjaftueshme për të ushtruar mandatin e tij dhe gëzon besimin e publikut dhe që nëpërmjet rekomandimeve synon të korrigjojë mangësitë e identifikuara. Organizimi, menaxhimi dhe administrimi i burimeve njerëzore të Institucionit të Lartë të Auditimit (KLSH) si dhe planifikimi strategjik i auditimeve dhe aktiviteteve të tjera, i mundësojnë Institucionit të Lartë të Auditimit (KLSH) që ai të përmbushë mandatin e tij dhe të përmirësojë vazhdimisht kapacitetin e tij institucional dhe profesional. KLSH ruan procedurat e menaxhimit të cilësisë dhe etikës në nivel organizativ, sipas standardeve ndërkombëtare. Raportet e auditimit janë koncize dhe përmbajnë rekomandime të rëndësishme dhe të dobishme, dhe ekzistojnë procedura për përcjelljen e raporteve të auditimit. Institucioni i Lartë i Auditimit (KLSH) komunikon gjerësisht për aktivitetet dhe rezultatet e auditimit nëpërmjet mediave, faqeve të internetit dhe mjeteve të tjera dhe i publikon raportet e tij në kohën e duhur.

Vlerësimi i veprimtarisë së KLSH-së nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Sondazhi i opinionit publik i zhvilluar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) i publikuar në vitin 2023, vit i cili shënon vitin e dhjetë të publikimit të tij “Besimi në Qeverisje”, shqyrton perceptimin publik dhe qëndrimet e qytetarëve në çështje, si: besimi në institucionet publike, transparenca dhe llogaridhënia institucionale, korrupsioni, niveli i përfshirjes qytetare në politikë bërje dhe vendimmarrje, kënaqësia me ofrimin e shërbimeve publike, menaxhimi i fatkeqësive natyrore dhe zbatimi i ligjeve dhe politikave për mbrojtjen nga diskriminimi. Për Kontrollin e Lartë të Shtetit, perceptimi publik edhe në këtë edicion, është ai i institucionit me rolin më efikas lidhur me llogaridhënien e qeverisë, ku evidentohet sërish në vendin e parë, ndjekur nga Kuvendi dhe Avokati i Popullit.

6. TREGUESIT BUXHETORË DHE FINANCIARË TË KLSH DHE KONKLZIONI I AUDITIT TË BRENDSHËM

6.1 Treguesit buxhetorë dhe financiarë të KLSH-së për vitin 2023

Gjatë vitit 2023, KLSH ka zbatuar dhe monitoruar treguesit e buxhetit të miratuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në Deklaratën e Politikës së Programit, dhe nëpërmjet analizave e vlerësimeve të vazhdueshme e monitorimit të performancës së realizimit të fondeve buxhetore, i ka shërbyer përmirësimit të procesit të planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

Në mbështetje të Ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.07.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, performanca e treguesve buxhetorë të institucionit për vitin 2023, paraqitet si më poshtë:

Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve për vitin 2023. KLSH-së për vitin 2023 i është miratuar fondi në total në vlerën 509,100 mijë lekë, nga të cilat 486,100 mijë lekë për shpenzime korente dhe 23,000 mijë lekë për Shpenzime Kapitale. Ky buxhet, është shtuar në muajin qershor 2023 në vlerën për 150,000 mijë lekë (me burim nga Fondi Rezervë për përballimin efekteve financiare për shtesën e pagave të nëpunësve), dhe në muajin dhjetor nga Fondi i Veçante në vlerën për 1,100 mijë lekë, (me qëllim zbatimin e VKM nr. 795, datë 28.12.2023 “Për shpërbllimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të acquis (screening), në kuadër të procesit të negociatave me bashkimin evropian”). Me Aktin Normativ nr.6, datë 14.12.2023 buxheti i KLSH-së ka pësuar ndryshime, duke arritur në vlerën totale për 561,700 mijë lekë.

Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas zërave për vitin 2023, paraqiten si më poshtë.

Tabela nr. 4 Fondet e alokuara sipas zërave për vitin 2023

<i>Në mijë lekë</i>									
Artikulli	Përshkrimi	Fakti 2022	Ligji Buxhetit V.2023	VKM	Akti Normativ 2023	Fondi i Veçantë	Plan Buxheti 2023	Fakti 2023	%
				1	2	3	4=1+2+3		
600	Paga	290,957	351,300	120,000	283,300	1,100	404,400	402,587	100%
601	Sigurime Shoqërore	47,126	46,800	30,000	33,800		63,800	62,524	98%
600+601	Shpenzime për paga	338,083	398,100	150,000	317,100	1,100	468,200	465,111	99%
602	Mallra dhe Shërbime	72,158	87,850		75,850		75,850	71,424	94%
605	Transferta		150		150		150	116	77%
602-605	Shpenzime Korente	72,158	88,000	0	76,000		76,000	71,540	94%
231	Kapitale të Trupëzuara	13,032	15,000		9,500		9,500	6053	64%
230	Kapitale të Pa Trupëzuara	4,291	5,000		5,000		5,000	1,816	36%
230 +231	Financim i Brendshëm	17,323	20,000	0	14,500		14,500	7,869	54%
230	Financim i Huaj		3,000		3,000		3,000	7,317	
	Totali	427,564	509,100	150,000	410,600	1,100	561,700	551,837	98%

Burimi: KLSH

Për vitin 2023, fondet e vëna në dispozicion të KLSH-së, sipas të gjithë burimeve të financimit (të brendshëm dhe të jashtëm), janë realizuar në shumën gjithsej prej 552 milionë lekë, ose në nivelin 98 % ndaj planit të miratuar.

Analiza e realizimit të buxhetit të KLSH-së për vitin 2023.

Nga analiza faktoriale sipas kategorisë së shpenzimeve të realizuara në nivel artikulli rezulton:

- Fondi i pagave është realizuar në 100 % të shumës së planifikuar,
- Fondi i Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore është realizuar 98 %,

- Fondi i shpenzimeve korente për 94 %, nga ku, zëri i shpenzimeve për “mallra dhe shërbime “ rezulton në rreth 94 % të fondeve të planifikuara.
- Buxheti i investimeve të planifikuara për “aktive afatgjata materiale” në vlerën 6,5 milionë lekë është realizuar në nivelin 100 % të objekteve të planifikuara, duke reflektuar një kursim të fondeve prej rreth 3.4 milionë lekë, si rezultat i zbatimit të procedurave të prokurimit dhe konkurrencës në këto procedura.
- Fondet me financim të huaj janë realizuar në nivelin 240 % të shumës të planifikuar.

A-Financim i Brendshëm

- *Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore. Llogaria 600-601.* Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2023 sipas Ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, në zërin “Paga dhe Sigurime” është në vlerën për 398,100 mijë lekë dhe numri i miratuar i punonjësve është 243 punonjës. Për vitin 2023, buxheti i planifikuar i rishikuar, është realizuar në vlerën 465,111 mijë lekë ose realizuar në masën 99% dhe numri faktit i punonjësve është 218. Shuma e shpenzuar në zërin “Paga dhe Sigurime”, përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
- *Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602.* Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2023 në Ligjin nr.84/2022, për zërin shpenzime operative, është në vlerën për 88,000 mijë lekë, ose 17 % e planit buxhetor të vitit 2023. Buxheti i planifikuar dhe i rishikuar për këtë zë për vitin 2023 në vlerën për 76,000 mijë lekë është realizuar në vlerën për 71,540 mijë lekë, ose realizuar në masën 94%. Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar mbulimi i nevojave administrative për shërbimin e sigurisë, dhe shërbimet e tjera utilitare si ato për energjinë, karburantin, ujin, telefoninë, etj. Një pjesë të konsiderueshme në shpenzimet operative e zënë shpenzimet për udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit në funksion të veprimtarisë audituese në vlerën për 47,004 mijë lekë dhe që përfaqësojnë 65.2% të shpenzimeve faktike korente. Organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare është shoqëruar me kostot përkatëse, ku institucioni është fokusuar në menaxhimin sa më të kujdesshëm dhe efektiv të këtyre fondeve buxhetore. Gjatë vitit 2023, KLSH ka realizuar disa procedura prokurimi në funksion të garantimit të veprimtarisë audituese dhe funksionimin optimal të pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe rritjes së sigurisë së rrjetit dhe infrastrukturës teknologjike të KLSH-së, ku mund të përmendim prokurimet për: rinovimin e suportit të licencave të Firewall dhe E-Mail Security; shërbimin e interneti për institucionin, për sistem alarmi, mirëmbajtje ashensori, blerje karburanti për automjetet, shërbime për automjetet etj.
- *Transferta korrente dhe të huaja. Llogaria 605.* Për periudhën raportuese 2023, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare profesionale INTOSAI dhe EUROSAI, përkatësisht në shumën 126 mijë lekë, nga 150 mijë lekë të planifikuara.
- *Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606.* Gjatë periudhës ushtrimore 2023, fondi i veçantë i akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vlerën 1,600 mijë lekë, ka patur si destinacion shpenzimet me rastin e daljen në pension të punonjësve, apo pagesa për raste të fatkeqësive dhe sëmundjeve. Për vitin 2023, ky zë është realizuar në vlerën për 643 mijë lekë.
- *Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 230-231.* Për vitin 2023, buxheti i planifikuar në masën për 14,500 mijë lekë, për këto dy zëra është realizuar në vlerën për 7,870 mijë lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 5 Shpenzime për investime kapitale në vitin 2023

Në lekë

Artikulli	KOD	Përshkrimi	Plan Buxheti 2023	Fakti 2023	Diferenca	%
231	M240009	Pajisje informatike	3,400,000	2,228,863	1,171,137	66%
231	M240010	Pajisje zyre	5,400,000	3,190,999	2,209,001	59%
230	19AA402	Kosto Lokale	5,000,000	1,816,700	3,183,300	36%
231		Rikonstrukcion ndërtesa	700,000	633,600	66,400	91%
231		Totali	14,500,000	7,870,156	6,629,844	46%

Burimi: KLSH

Plani i buxhetit në zërin “Kosto lokale/ TVSH”, në vlerën për 5,000 mijë lekë i përket shpenzimeve për projektin e investimit “*Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikëqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri*”, zë i cili për vitin 2023, është realizuar në masën për 1,817 mijë lekë.

B-Financim i Huaj

Bazuar në Ligjin nr.84/2022, “*Për buxhetin e vitit 2023*”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale me Financim të Huaj (artikulli 230), është miratuar në vlerën 3,000 mijë lekë i parashikuar për zbatimin e projektit “*Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikëqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri*”. Për vitin 2023, ky projekt është realizuar në vlerën për 7,317 mijë lekë.

Qëllimi i projektit është që në kuadër të bashkëpunimit midis KLSH-së dhe Sekretariatit të Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) të Konfederatës së Zvicrës, të mbështetet ngritja dhe forcimi i kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH-së.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të nxisë mbikëqyrjen publike dhe të rrisë cilësinë, transparencën dhe frenimin e korrupsionit në ofertat publike, koncesionet dhe partneritetet publike-private (PPP). Projekti do të mundësojë auditime më cilësore dhe do të japë rekomandime me vlerë të shtuar në mirë menaxhimin e kontratave të PPP-ve, duke përmirësuar dhe kuadrin ligjor të realizimit të tenderave publike përkatës dhe të lidhjes dhe zbatimit të kontratave koncesionare. Ky projekt dy vjeçar do të ndihmojë në drejtim të auditimit më profesional të fondeve publike në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve në Shqipëri.

6.2. Konkluzioni i auditit të brendshëm mbi pasqyrat financiare 2023

Bazuar në Planin Vjetor të Angazhimeve, miratuar me shkresën nr. 867/1 prot., datë 11.10.2022, të Kryetarit të KLSH-së dhe në kuadër të veprimtarisë së saj, Njësia e Auditimit të Brendshëm, ka kryer misionin e auditimit “*Mbi auditimin e sistemeve dhe përputhshmërisë në fushën e menaxhimit financiar*” për periudhën 1 janar 2023 deri më 31 dhjetor 2023, raporti përfundimtar i të cilit, është protokolluar me nr. 1084/4, datë 11.03.2024, ku në përfundim të angazhimit është dhënë ky Opinion/ Konkluzion nga auditimi:

“Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare të institucionit për periudhën e mbyllur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2023, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e flukseve monetare, pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto, si dhe shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të KLSH-së paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të institucionit më datë 31 dhjetor 2023, dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të raportimit financiar.

Auditimi u krye në përputhje me Ligjin nr. 114/2015 “*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*” i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin Financiar e Kontrollin*” i ndryshuar, UMF nr.86, datë 10.12.2015 “*Për miratimin e Kodit të Etikës për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*”, UMF nr. 100, datë 25.10.2016 “*Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në*

Sektorin Publik”; UMF nr. 12, datë 5.06.2012 “*Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik*” etj.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të Udhëzimit të MFE nr. .8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në, njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 31, datë 3.12.2023 “*Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit të vitit 2023*”.

Qëllimi i auditimit është të ndihmojë institucionin e KLSH-së dhe të japë siguri, që të arrijë objektivat nëpërmjet një veprimtarie në përputhje me kërkesat ligjore, standardet dhe rregulloret në fuqi, duke identifikuar aktivitetet me risk dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit.”

Gjatë kryerjes së këtij auditimi është synuar vlerësimi i përgjithshëm mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe dhënia e një opinioni mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2023, nga ku rezulton se, menaxhimi financiar dhe kontrolli në përgjithësi dëshmon një proces funksional e efektiv, që ofron siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve tjera të kontrollit. Nga auditimi është konstatuar se të gjithë proceset dhe transaksionet janë kryer në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, siç trajtohet dhe në Raportin Final të Auditimit me nr. 1154/4 prot, datë 17.03.2023, “*Mbi auditimin e sistemeve dhe përputhshmërisë në fushën e menaxhimit financiar të Sektorit të Financës*”, janë dhënë gjithsej 2 rekomandime, të cilat janë pranuar dhe është përgatitur dhe dërguar në afat Plan i Veprimit për zbatimin e tyre (shkresa nr. 1154/5, datë 21.03.2023), statusi i të cilëve rezulton në proces zbatimi.

7. ANEKSE

ANEKSI 1: Institucionet e audituara nga KLSH, për periudhën Janar – Dhjetor 2023

Nr	Nr	Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit
1	1	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
2	2	Banka e Shqipërisë
3	3	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
4	4	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Pjesa II)
5	5	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
6	6	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj
7	7	Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës
8	8	Drejtorinë e Përgjithshme/Qendrore të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
9	9	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
10	10	Kontrata e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit
11	11	Licencimi dhe monitorimi I subjekteve me veprimtari ne fushën minerare ne Ministrinë e Infrastruktura dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Autoriteti Kombëtar për sigurinë dhe Emergjencat ne Miniera
12	12	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
13	13	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin I-rë të vitit 2022
14	14	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin I-rë të vitit 2022
Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore		
15	1	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
16	2	Autoriteti i Mediave Audio Vizive
17	3	Avokatura e Shtetit
18	4	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik
19	5	Gjykata e Lartë
20	6	Instituti i Gjeoshkencave
21	7	Këshilli i Lartë Gjyqësor
22	8	Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
23	9	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë
24	10	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
25	11	Ministria e Drejtësisë
26	12	Ministria e Kulturës projekti Parku i Artit
27	13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
28	14	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
29	15	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
30	16	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë
31	17	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shkodër
32	18	Sistemi i përgjithshëm i raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduar të Qeverisjes së Përgjithshme në subjektin MFE
33	19	Sistemi i përgjithshëm i raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduar të Qeverisjes së Përgjithshme në subjektin MIE
34	20	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin I-rë të vitit 2022
35	21	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin I-rë të vitit 2022
Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetqeverisjes Vendore		
36	1	Agjencia e Trajtimit të Pronave
37	2	Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Tirana Jug
38	3	Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Tirana Veri
39	4	Bashkia Belsh
40	5	Bashkia Belsh (II)
41	6	Bashkia Berat
42	7	Bashkia Bulqizë
43	8	Bashkia Cërrik
44	9	Bashkia Delvine
45	10	Bashkia Devoll
46	11	Bashkia Dibër
47	12	Bashkia Dimal
48	13	Bashkia Divjakë
49	14	Bashkia Dropull
50	15	Bashkia Elbasan
51	16	Bashkia Fier
52	17	Bashkia Finiq
53	18	Bashkia Fushë Arrëz
54	19	Bashkia Gjirokastrë
55	20	Bashkia Gramsh
56	21	Bashkia Has

57	22	Bashkia Himarë
58	23	Bashkia Kamëz
59	24	Bashkia Kavajë
60	25	Bashkia Këlcyrë
61	26	Bashkia Klos
62	27	Bashkia Kolonjë
63	28	Bashkia Konispol
64	29	Bashkia Krujë
65	30	Bashkia Kuçovë
66	31	Bashkia Kukës
67	32	Bashkia Kurbin
68	33	Bashkia Lezhë
69	34	Bashkia Libohovë
70	35	Bashkia Librazhd
71	36	Bashkia Lushnjë
72	37	Bashkia Malësi e Madhe
73	38	Bashkia Mallakastër
74	39	Bashkia Mat
75	40	Bashkia Memaliaj
76	41	Bashkia Mirditë
77	42	Bashkia Patos
78	43	Bashkia Peqin
79	44	Bashkia Përmet
80	45	Bashkia Pogradec
81	46	Bashkia Poliçan
82	47	Bashkia Prrenjas
83	48	Bashkia Pukë
84	49	Bashkia Pustec
85	50	Bashkia Roskovec
86	51	Bashkia Rrogozhinë
87	52	Bashkia Sarandë
88	53	Bashkia Selenice
89	54	Bashkia Shijak
90	55	Bashkia Tepelene
91	56	Bashkia Tropojë
92	57	Bashkia Vau Dejës
93	58	Bashkia Vlorë
94	59	Bashkia Vorë
95	60	Drejtoria e Përgjithshme e ASHK
96	61	Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë
97	62	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë
98	63	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamez-Vore
99	64	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë
100	65	Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë
101	66	Njësia Administrative Farkë Bashkia Tiranë
102	67	Njësia Administrative Kashar, Bashkia Tiranë
103	68	Njësia Administrative Petrelë, Bashkia Tiranë
104	69	Njësia Administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë
105	70	Njësia Administrative Zall-Here, Bashkia Tiranë
106	71	Njësia Administrative Zall-Bastar, Bashkia Tiranë
107	72	Auditim Performance: Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e bashkive për të siguruar shërbime cilësore për qytetarët gjatë pandemisë
108	73	Tirana Parking, Bashkia Tiranë
109	74	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin I-rë të vitit 2022
110	75	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin I-rë të vitit 2022
111	76	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në vitin 2022 në ASHK
		Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja
112	1	AlbPetrol sh.a. Patos
113	2	Autoriteti Rrugor Shqiptar
114	3	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
115	4	Hekurudha Shqiptare sh.a., Durrës
116	5	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare KESH sh.a.
117	6	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
118	7	Operatori i Sistemit të Transmetimit
119	8	Porti detar Sarandë sh.a.
120	9	Posta Shqiptare sh.a.

121	10	Projekti: Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate, në Autoritetin Rrugor Shqiptar
122	11	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
123	12	Spitali Universitar i Traumës
124	13	Ujësjiellës-Kanalizime Durrës sh.a.
125	14	Ujësjiellës-Kanalizime Tirane sh.a.
126	15	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
127	16	Universiteti i Sporteve të Tiranës
128	17	Projekti: Asistencës Sociale
129	18	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në vitin 2022”
Departamenti i Auditimit IT		
130	1	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transporti Rrugor
131	2	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial
132	3	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
133	4	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
134	5	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm i Kujdesit Shëndetësor
135	6	Radio Televizionin Shqiptar
136	7	Rrjetin Akademik Shqiptar
137	8	Ujësjiellës - Kanalizime Tiranë sh.a.
138	9	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin I-rë të vitit 2022
139	10	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin I-rë të vitit 2022
Departamenti i Auditimit të Performancës		
140	1	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
141	2	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
142	3	Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës
143	4	Auditim Performance me temë: “Efektiviteti i procesit të certifikimit të materialit mbjellës bimor (fara e fidanë), i përdorur nga fermerët”
144	5	Auditim Performance me temë: “Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus, gratë e dhunuara”
145	6	Auditim Performance me temë: “Fuqizimi ekonomik i gruas në vendin tonë”
146	7	Auditim Performance me temë: “Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit”
147	8	Auditim Performance me temë: “Kujdesi ndaj të moshuarve”
148	9	Auditim Performance me temë: “Ndhimja juridike falas për personat në nevojë”
149	10	Auditim Performance me temë: “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”
150	11	Auditim Performance me temë: “Performanca e ofrimit të shërbimeve on-line”
151	12	Auditim Performance me temë: “Performanca e Shërbimit të Paraburgimit”
152	13	Auditim Performance me temë: “Performanca e sistemit të shfrytëzimit minerar të mermerëve”
153	14	Auditim Performance me temë: “Rezervat e shtetit në shërbim të qytetarit
154	15	Auditim Performance me temë: “Shërbimi I policisë në përgjigje të qytetarëve”
155	16	Auditim Performance me temë: “Shërbimi në Terapinë Renale Zëvendësuese (hemodializa, dializë peritoneale, transplantit)”
156	17	Auditim Performance me temë: “Shërbimi përbarimor shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore”
157	18	Auditim Performance me temë: “Trajtimi i sëmundjeve tumorale”
158	19	Auditim Performance me temë: “Siguria Kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave gjatë përdorimit të shërbimeve”
159	20	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin I-rë të vitit 2022
160	21	Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin I-rë të vitit 2022

ANEKSI 2: Masat e rekomanduara për ndryshime apo përmirësime ligjore

Nr	Subjektet e audituara	Nr.
1	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara	1
2	Autoriteti i Mediave Audio Vizive	2
3	Drejtoria Vendore e Agjencise Shtetërore të Kadastrës Kamez-Vorë	1
4	Auditim Performance me temë: “Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus, gratë e dhunuara”	3
5	Auditim Performance me temë: “Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit”	3
6	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (IT)	1
7	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm i Kujdesit Shëndetësor (IT)	1
8	Auditim Performance me temë: “Kujdesi ndaj të moshuarve”	2
9	Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	2
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1
11	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	4
12	Auditim Performance me temë: “Ndhimja juridike falas për personat në nevojë”	3
13	Auditim Performance me temë: “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”	1
14	Auditim Performance me temë: “Performanca e Shërbimit të Paraburgimit”	3
15	Auditim Performance me temë: “Performanca e sistemit të shfrytëzimit minerar të mermerëve”	2
16	Auditim Performance me temë: “Rezervat e shtetit në shërbim të qytetarit	1
17	Auditim Performance me temë: “Shërbimi në Terapinë Renale Zëvendësuese (hemodializa, dializë peritoneale,	1

	transplanti)''	
18	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shkodër	4
19	Sistemi i përgjithshëm i raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduar të Qeverisjes së Përgjithshme në subjektin MFE	4
20	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	2
	Gjithsej	42

ANEKSI 3: Masat Organizative të rekomanduara

Nr	Subjektet e audituara	Nr.
1	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara	20
2	Agjencia e Trajtit të Pronave	22
3	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	15
4	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	22
5	Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës	23
6	Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Tirana Jug	29
7	Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Tirana Veri	21
8	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	24
9	AlbPetrol sh.a. Patos	44
10	Autoriteti i Mediave Audio Vizive	35
11	Autoriteti Rrugor Shqiptar	30
12	Avokatura e Shtetit	12
13	Banka e Shqipërisë	10
14	Bashkia Belsh	8
15	Bashkia Belsh II	14
16	Bashkia Berat	45
17	Bashkia Bulqizë	20
18	Bashkia Cërrik	14
19	Bashkia Delvinë	10
20	Bashkia Devoll	34
21	Bashkia Dibër	25
22	Bashkia Dimal	13
23	Bashkia Divjakë	26
24	Bashkia Dropull	22
25	Bashkia Elbasan	35
26	Bashkia Fier	51
27	Bashkia Finiq	26
28	Bashkia Fushë Arrëz	15
29	Bashkia Gjirokastrë	17
30	Bashkia Gramsh	20
31	Bashkia Has	26
32	Bashkia Himarë	17
33	Bashkia Kamëz	16
34	Bashkia Kavajë	16
35	Bashkia Këlcyrë	19
36	Bashkia Klos	18
37	Bashkia Kolonjë	29
38	Bashkia Konispol	12
39	Bashkia Krujë	28
40	Bashkia Kuçovë	37
41	Bashkia Kukës	18
42	Bashkia Kurbini	30
43	Bashkia Lezhë	11
44	Bashkia Libohovë	23
45	Bashkia Librazhd	22
46	Bashkia Lushnjë	16
47	Bashkia Malësi e Madhe	27
48	Bashkia Mallakastër	30
49	Bashkia Mat	18
50	Bashkia Memaliaj	22
51	Bashkia Mirdite	16
52	Bashkia Patos	38
53	Bashkia Peqin	29
54	Bashkia Përmet	14
55	Bashkia Pogradec	49
56	Bashkia Poliçan	18
57	Bashkia Prrenjas	24

Nr	Subjektet e audituara	Nr.
58	Bashkia Pukë	23
59	Bashkia Pustec	9
60	Bashkia Roskovec	15
61	Bashkia Rrogozhine	30
62	Bashkia Sarandë	41
63	Bashkia Selenice	28
64	Bashkia Shijak	34
65	Bashkia Tepelene	27
66	Bashkia Tropoje	23
67	Bashkia Vau Dejës	17
68	Bashkia Vlorë	74
69	Bashkia Vorë	28
70	Drejtoria e Përgjithshme e ASHK	35
71	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	28
72	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Pjesa II)	13
73	Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë	28
74	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë	26
75	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (IT)	28
76	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	20
77	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	29
78	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik	24
79	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj	41
80	Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës	5
81	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamez -Vorë	26
82	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë	20
83	Drejtorinë e Përgjithshme/Qendrore të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	26
84	Auditim Performance me temë: “Efektiviteti i procesit të certifikimit të materialit mbjellës bimor (fara e fidanë), i përdorur nga fermerët”	18
85	Auditim Performance me temë: “Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus, gratë e dhunuara”	21
86	Auditim Performance me temë: “Fuqizimi ekonomik i gruas në vendin tonë”	14
87	Auditim Performance me temë: “Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit”	13
88	Gjykata e Lartë	8
89	Hekurudha Shqiptare sh.a., Durrës	19
90	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (IT)	14
91	Instituti i Gjeoshkencave (IT)	6
92	Instituti i Sigurimeve Shoqërore (IT)	33
93	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (IT)	16
94	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm i Kujdesit Shëndetësor (IT)	35
95	Këshilli i Lartë Gjyqësor	14
96	Kontrata e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit	32
97	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.	27
98	Auditim Performance me temë: “Kujdesi ndaj të moshuarve”	17
99	Licencimi dhe monitorimi i subjekteve me veprimtari në fushën minerare në Ministrinë e Infrastruktura dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Autoriteti Kombëtar për sigurinë dhe Emergjencat në Miniera	11
100	Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	13
101	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë	9
102	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	31
103	Ministria e Drejtësisë	20
104	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	56
105	Ministria e Kulturës projekti Parku i Artit	1
106	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	36
107	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	45
108	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	47
109	Ndihma juridike falas për personat në nevojë	15
110	Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit	14
111	Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë	9
112	Njësia Administrative Farkë Bashkia Tiranë	11
113	Njësia Administrative Kashar, Bashkia Tiranë	10
114	Njësia Administrative Petrelë, Bashkia Tiranë	2
115	Njësia Administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë	9
116	Njësia Administrative Zall - Herë, Bashkia Tiranë	7
117	Njësia Administrative Zall - Bastar, Bashkia Tiranë	9
118	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	43

Nr	Subjektet e audituara	Nr.
119	Operatori i Sistemit të Transmetimit	14
120	Auditim Performance me temë: “Performanca e ofrimit të shërbimeve on-line”	9
121	Auditim Performance me temë: “Performanca e Shërbimit të Paraburgimit”	17
122	Auditim Performance me temë: “Performanca e sistemit të shfrytëzimit mineral të mermerëve”	8
123	Porti detar Sarandë sh.a.	9
124	Posta Shqiptare sh.a.	29
125	Projekti: Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate, në Autoritetin Rrugor Shqiptar	12
126	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	12
127	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë	85
128	Radio Televizionin Shqiptar (IT)	22
129	Rezervat e shtetit në shërbim të qytetarit	24
130	Rrjetin Akademik Shqiptar	10
131	Auditim Performance me temë: “Shërbimi i policisë në përgjigje të qytetarëve”	10
132	Auditim Performance me temë: “Shërbimi në Terapinë Renale Zëvendësuese (hemodializa, dializë peritoneale, transplantit)”	31
133	Auditim Performance me temë: “Shërbimi përmbartimor shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore”	11
134	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shkodër	25
135	Sistemi i përgjithshëm i raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduar të Qeverisjes së Përgjithshme në subjektin MFE	18
136	Sistemi i përgjithshëm i raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduar të Qeverisjes së Përgjithshme në subjektin MIE	24
137	Spitali Universitar i Traumës	54
138	Auditim Performance me temë: “Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e bashkive për të siguruar shërbime cilësore për qytetarët gjatë pandemisë”	18
139	Tirana Parking, Bashkia Tiranë	21
140	Trajtimi i sëmundjeve tumorale	12
141	Ujësjiellës - Kanalizime Durrës sh.a.	10
142	Ujësjiellës - Kanalizime Tiranë sh.a.	15
143	Ujësjiellës - Kanalizime Tirane sh.a.	43
144	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	35
145	Universiteti i Sporteve të Tiranës	7
	Gjithsej	3293

ANEKSI 4: Evidenca përmbledhëse e masave të rekomanduara për dëmin ekonomik të konstatuar

Në 000 lekë

Nr	Subjektet e audituara	Në shpenzime	Në të ardhura	Gjithsej
1	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara	11,207		11,207
2	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	18,442		18,442
3	AlbPetrol sh.a. Patos	4,590,146		4,590,146
4	Autoriteti i Mediave Audio Vizive	174		174
5	Autoriteti Rrugor Shqiptar	12,132		12,132
6	Bashkia Belsh 2	3,490		3,490
7	Bashkia Berat	869	204	1,073
8	Bashkia Bulqizë	1,416	689	2,105
9	Bashkia Cërrik	1,460		1,460
10	Bashkia Devoll	2,336		2,336
11	Bashkia Dimal	2,434	397	2,831
12	Bashkia Divjakë	6,990		6,990
13	Bashkia Dropull	939		939
14	Bashkia Elbasan	3,419		3,419
15	Bashkia Fier	15,258		15,258
16	Bashkia Finiq	849		849
17	Bashkia Gjirokastrë	7,875		7,875
18	Bashkia Gramsh	687	1,184	1,871
19	Bashkia Has		265	265
20	Bashkia Himare	3,564	4,643	8,207
21	Bashkia Kamëz	2,168		2,168
22	Bashkia Kavajë	8,607		8,607
23	Bashkia Këlcyrë	339		339
24	Bashkia Kolonjë	8,211		8,211
25	Bashkia Konispol	277		277
26	Bashkia Krujë	456		456
27	Bashkia Kuçovë	1,512		1,512
28	Bashkia Kukës	2,368		2,368

Nr	Subjektet e audituara	Në shpenzime	Në të ardhura	Gjithsej
29	Bashkia Libohove	313		313
30	Bashkia Librazhd	2,529		2,529
31	Bashkia Mallakastër	113		113
32	Bashkia Mat	43,257		43,257
33	Bashkia Mirdite	3,355		3,355
34	Bashkia Patos	2,082		2,082
35	Bashkia Peqin	18,921		18,921
36	Bashkia Përmet	136	360	495
37	Bashkia Pogradec	7,027		7,027
38	Bashkia Prrenjas	1,509		1,509
39	Bashkia Roskovec	1,042		1,042
40	Bashkia Rrogozhine	788		788
41	Bashkia Sarandë	321		321
42	Bashkia Selenicë	8,115		8,115
43	Bashkia Shijak	883		883
44	Bashkia Tropoje	7,667		7,667
45	Bashkia Vlorë	37,090		37,090
46	Bashkia Vorë	241		241
47	Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë	232		232
48	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë	4,172		4,172
49	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik	264		264
50	Drejtorinë e Përgjithshme/Qendrore të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	890		890
51	Hekurudha Shqiptare sh.a.	10,786		10,786
52	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare	21,981		21,981
53	Licencimi dhe monitorimi i subjekteve me veprimtari në fushën minerare në Ministrinë e Infrastruktura dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Autoriteti Kombëtar për sigurinë dhe Emergjencat në Miniera		49,999	49,999
54	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	7,591		7,591
55	Ministria e Drejtësisë	848		848
56	Ministria e Kulturës, projekti Parku i artit	5,663		5,663
57	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	996		996
58	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	264		264
59	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	756		756
60	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	9,832		9,832
61	Operatori I Sistemit të Transmetimit	1,040		1,040
62	Porti detar Sarandë sh.a.	1,153		1,153
63	Posta Shqiptare sh.a.	12,975		12,975
64	Projekti: Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate, në Autoritetin Rrugor Shqiptar	7,638		7,638
65	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	1,235		1,235
66	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë	112,289		112,289
67	Spitali Universitar i Traumës	1,877		1,877
68	Ujësjellës - Kanalizime Durrës sh.a.	791		791
69	Ujësjellës - Kanalizime Tirane sh.a.	64,405	1,545	65,950
70	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	513		513
	Gjithsej	5,111,204	59,285	5,170,489

ANEKSI 5: Evidenca e pasqyrim të parregullsive të dispozitave ligjore në fuqi, për të ardhura të munguara ose shpenzime jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, të cilat kanë sjell efekt negativ financiar në të ardhurat e subjekteve dhe buxhetin e shtetit

Në 000 lekë

Nr	Subjektet e audituara	Në shpenzime	Në të ardhura	Gjithsej
1	Agjencia e Trajtimit të Pronave	1,496		1,496
2	Agjencia Kombëtare e Mjedisit		8,522	8,522
3	Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Tirana Veri		84,746	84,746
4	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	161,516		161,516
5	AlbPetrol sh.a. Patos	362,789	6,456,116	6,818,905
6	Autoriteti i Mediave Audio Vizive	7,653	21,600	29,253
7	Autoriteti Rrugor Shqiptar	477,246		477,246
8	Bashkia Belsh		115,798	115,798
9	Bashkia Belsh II		124,191	124,191

Nr	Subjektet e audituara	Në shpenzime	Në të ardhura	Gjithsej
10	Bashkia Berat	21,208	230,322	251,530
11	Bashkia Bulqizë		48,198	48,198
12	Bashkia Cërrik	426	61,038	61,464
13	Bashkia Delvine		7,460	7,460
14	Bashkia Devoll	5,710	56,697	62,407
15	Bashkia Dibër	38,554	39,696	78,250
16	Bashkia Dimal	55,309	56,195	111,504
17	Bashkia Divjakë	146,962	193,653	340,615
18	Bashkia Dropull		11,003	11,003
19	Bashkia Elbasan	10,620	271,033	281,654
20	Bashkia Fier		215,370	215,370
21	Bashkia Finiq	26,456	108,853	135,309
22	Bashkia Fushë Arrëz	2,171	5,761	7,932
23	Bashkia Gjirokastrë		3,955	3,955
24	Bashkia Gramsh		27,087	27,087
25	Bashkia Has	51,745	13,156	64,901
26	Bashkia Himare	151,935	107,524	259,459
27	Bashkia Kamëz	526,921	631,061	1,157,982
28	Bashkia Kavajë	7,248	192,002	199,250
29	Bashkia Këlcyrë		20,013	20,013
30	Bashkia Klos		63,397	63,397
31	Bashkia Kolonjë	1,239	78,680	79,919
32	Bashkia Konispol		8,508	8,508
33	Bashkia Krujë		157,385	157,385
34	Bashkia Kuçovë		17,441	17,441
35	Bashkia Kukës		42,753	42,753
36	Bashkia Kurbin	1,773	91,701	93,474
37	Bashkia Lezhë		410,215	410,215
38	Bashkia Libohovë	5,962	3,662	9,624
39	Bashkia Librazhd		34,373	34,373
40	Bashkia Lushnjë		385,804	385,804
41	Bashkia Malësi e Madhe	1,183	59,634	60,817
42	Bashkia Mallakastër	847	56,212	57,059
43	Bashkia Mat		74,217	74,217
44	Bashkia Memaliaj	410,176	24,147	434,323
45	Bashkia Mirdite		29,186	29,186
46	Bashkia Patos		76,217	76,217
47	Bashkia Peqin	1,164	31,311	32,474
48	Bashkia Përmet		72,750	72,750
49	Bashkia Pogradec	2,265	89,517	91,782
50	Bashkia Poliçan	1,765	9,592	11,357
51	Bashkia Prrenjas		102,962	102,962
52	Bashkia Pukë	2,066	9,149	11,215
53	Bashkia Pustec		1,578	1,578
54	Bashkia Roskovec	23,256	36,889	60,145
55	Bashkia Rrogozhinë	627,332	95,462	722,794
56	Bashkia Sarandë	69,959	94,085	164,044
57	Bashkia Selenicë	198,694	180,862	379,557
58	Bashkia Shijak		87,731	87,731
59	Bashkia Tepelene		9,101	9,101
60	Bashkia Tropoje	129,181	5,385	134,567
61	Bashkia Vau Dejës	1,972	222,134	224,106
62	Bashkia Vlorë		444,681	444,681
63	Bashkia Vorë	0	77,972	77,972
64	Drejtoria e Përgjithshme e ASHK	12,549		12,549
65	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	8,210		8,210
66	Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë		102,116	102,116
67	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë	43,663		43,663
68	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)	15,259	28,926	44,185
69	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	77,667		77,667
70	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik	358	166,052	166,410
71	Drejtorinë e Përgjithshme/Qendrore të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	142,102		142,102

Nr	Subjektet e audituara	Në shpenzime	Në të ardhura	Gjithsej
72	DV ASHK Sarandë		19,466	19,466
73	DVASHK Kamez-Vorë		2,191	2,191
74	Hekurudha Shqiptare sh.a.	347,896		347,896
75	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare	611,615		611,615
76	Licencimi dhe monitorimi i subjekteve me veprimtari në fushën minerare në Ministrinë e Infrastruktura dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Autoriteti Kombëtar për sigurinë dhe Emergjencat në Miniera	33,020		33,020
77	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë	15,508		15,508
78	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	68,379	481,859	550,238
79	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	38,578,617	5,643,173	44,221,790
80	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	38,935		38,935
81	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	36,067		36,067
82	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	33,930		33,930
83	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	1,314,411		1,314,411
84	Operatori i Sistemit të Transmetimit	35,450		35,450
85	Porti detar Sarandë sh.a.	17,061		17,061
86	Posta Shqiptare sh.a.	262,467		262,467
87	Projekti: Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate, në Autoritetin Rrugor Shqiptar	86,837		86,837
88	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	65,125		65,125
89	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë	113,393		113,393
90	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë dhe Shkodër	1,891		1,891
91	Spitali Universitar i Traumës	574,642		574,642
92	Tirana Parking, Bashkia Tirane	12,815		12,815
93	Ujësjellës - Kanalizime Durrës sh.a.	30,790		30,790
94	Ujësjellës - Kanalizime Tirane sh.a.	5,414		5,414
95	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	34,230		34,230
	Gjithsej	46,153,101	18,739,529	64,892,630

ANEKSI 6: Evidenca e mangësive në aktivitetin kontrollues me ndikim negativ në të ardhurat tatimore dhe doganore

Në 000 lekë

Nr	Subjektet e audituara	Në të ardhura	Gjithsej
1	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	19,315	19,315
2	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Pjesa II)	146,119	146,119
3	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj	2,024,711	2,024,711
4	Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës	133,342	133,342
	Gjithsej	2,323,487	2,323,487

ANEKSI 7: Evidenca e Masave Disiplinore të rekomanduara

Nr	Subjektet e audituara	Ligji nr. 142/2013 dt.30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” Neni 58, shkronjat (a,b,c ç)	Me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës	Gjithsej
1	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara	1	10	11
2	Agjencia e Trajtimit të Pronave		12	12
3	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	38		38
4	Agjencia Kombëtare të Bregdetit	1		1
5	Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Tirana Jug		35	35
6	Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Tirana Veri		34	34
7	Agjencia Rajonale te Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës	1		1
8	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit		1	1
9	AlbPetrol sh.a. Patos		16	16
10	Autoriteti i Mediave Audio Vizive	1		1
11	Autoriteti Rrugor Shqiptar		1	1
12	Bashkia Belsh	16	1	17
13	Bashkia Berat	9	7	16
14	Bashkia Bulqizë	1		1
15	Bashkia Cërrik	6		6
16	Bashkia Delvine	3		3
17	Bashkia Devoll	19		19
18	Bashkia Dibër	8	2	10
19	Bashkia Dimal	9	1	10
20	Bashkia Divjakë	22		22
21	Bashkia Dropull	13		13
22	Bashkia Elbasan	23		23
23	Bashkia Fier	25	5	30
24	Bashkia Finiq	10		10
25	Bashkia Fushë Arrëz	6		6
26	Bashkia Gjirokastrë	1		1
27	Bashkia Gramsh	13	5	18
28	Bashkia Has	1		1
29	Bashkia Himarë	1		1
30	Bashkia Kamëz	18		18
31	Bashkia Kavajë	9	9	18
32	Bashkia Këlcyrë	8		8
33	Bashkia Klos	4		4
34	Bashkia Kolonjë	8		8
35	Bashkia Konispol	5		5
36	Bashkia Kuçovë	25		25
37	Bashkia Kukës	20		20
38	Bashkia Kurbini	20		20
39	Bashkia Libohovë	1	1	2
40	Bashkia Librazhd	1		1
41	Bashkia Lushnje	14		14
42	Bashkia Malësi e Madhe	11		11
43	Bashkia Mallakastër	23		23
44	Bashkia Mat	22		22
45	Bashkia Memaliaj	1		1
46	Bashkia Mirdite	17	1	18
47	Bashkia Patos	1		1
48	Bashkia Peqin	5	10	15
49	Bashkia Përmet	8		8
50	Bashkia Pogradec	16		16
51	Bashkia Poliçan	10		10
52	Bashkia Pukë	9		9
53	Bashkia Pustec	3		3
54	Bashkia Roskovec	15		15
55	Bashkia Rrogozhinë	19		19
56	Bashkia Sarandë	1		1
57	Bashkia Selenice	9		9
58	Bashkia Shijak	12		12

Nr	Subjektet e audituara	Ligji nr. 142/2013 dt.30.05.2013 "Për Nëpunësin Civil" Neni 58, shkronjat (a,b,c ç)	Me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës	Gjithsej
59	Bashkia Tepelene	6	7	13
60	Bashkia Tropojë	16	8	24
61	Bashkia Vau i Dejës	1		1
62	Bashkia Vlorë	35	23	58
63	Bashkia Vorë	27	1	28
64	Drejtoria e Përgjithshme e ASHK		1	1
65	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	11	24	35
66	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Pjesa II)	49		49
67	Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë		7	7
68	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë	31		31
69	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)		10	10
70	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1	1	2
71	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik		22	22
72	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj	1		1
73	Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës	18		18
74	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore te Kadastrës Kamez-Vorë		32	32
75	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë		22	22
76	Drejtorinë e Përgjithshme/Qendrore të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor		14	14
77	Hekurudha Shqiptare sh.a., Durrës		1	1
78	Këshilli i Lartë Gjyqësor	1		1
79	Kontrata e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit	1		1
80	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.		12	12
81	Licencimi dhe monitorimi i subjekteve me veprimtari ne fushën minerare ne Ministrinë e Infrastruktura dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Autoriteti Kombëtar për sigurinë dhe Emergjencat ne Miniera		1	1
82	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë		1	1
83	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	1		1
84	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	12		12
85	Ministria e Kulturës projekti Parku i Artit	7		7
86	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	14		14
87	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1		1
88	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	14		14
89	Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë	1		1
90	Njësia Administrative Farkë Bashkia Tiranë	1		1
91	Njësia Administrative Kashar, Bashkia Tiranë		1	1
92	Njësia Administrative Petrelë, Bashkia Tiranë	1		1
93	Njësia Administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë		1	1
94	Njësia Administrative Zall - Here, Bashkia Tiranë	1		1
95	Njësia Administrative Zall - Bastar, Bashkia Tiranë		1	1
96	Operatori i Shpërndarjes se Energjisë Elektrike		30	30
97	Operatori I Sistemit te Transmetimit		1	1
98	Porti detar Sarandë sh.a.		1	1
99	Posta Shqiptare sh.a.		72	72
100	Projekti: Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate, në Autoritetin Rrugor Shqiptar	1		1
101	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	1	14	15
102	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë		52	52
103	Shtëpia e të Moshuarve Shkodër		15	15
104	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë		14	14
105	Sistemi i përgjithshëm i raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduar të Qeverisjes së Përgjithshme ne subjektin MFE	1		1
106	Sistemi i përgjithshëm i raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduar të Qeverisjes së Përgjithshme ne	1		1

Nr	Subjektet e audituara	Ligji nr. 142/2013 dt.30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” Neni 58, shkronjat (a,b,c ç)	Me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës	Gjithsej
	subjektin MIE			
107	Spitali Universitar i Traumës		33	33
108	Tirana Parking, Bashkia Tiranë		1	1
109	Ujësjetllës-Kanalizime Durrës sh.a.		11	11
110	Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a.		1	1
111	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë		14	14
112	Universiteti i Sporteve të Tiranës		1	1
	Gjithsej	798	601	1399

ANEKSI 8: Evidenca e Masave Administrative të rekomanduara

Nr	Subjektet e audituara	Gjithsej
1	AlbPetrol sh.a. Patos	27
2	Autoriteti i Mediave Audio Vizive	1
3	Bashkia Kavajë	10
4	Bashkia Librazhd	1
5	Bashkia Mirditë	3
6	Bashkia Selenicë	18
7	Bashkia Vorë	1
8	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1
9	Ministria e Kulturës, Projekti: Parku i Artit	1
10	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	2
11	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	1
12	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë	3
	Gjithsej	69

ANEKSI 9: Mbi Pasqyrat Financiare të Vitit Ushtrimor 2023

Në lekë

Nr.	Llogaritë	EMERTIMI	Viti 2023	Viti 2022
1	A	A K T I V E T	707,724,849	738,231,145
2		I.Aktivët Afat shkurtër	65,203,342	51,572,890
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	5,952,922	2,264,314
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke	774,603	
6	520	Disponibilitete ne Thesar	5,178,319	2,264,314
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provizione zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	11,884,928	16,507,361
12	31	Materiale	11,884,928	16,507,361
13	32	Inventar I imet		
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provizione perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari te Arketushme	47,365,492	32,801,215
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohe nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetstore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		

32	468	Debitore te ndryshem	2,972,409	2,972,409
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	44,393,083	29,828,806
	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		0
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	0
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
42		II.Aktivitet Afat gjata	642,521,507	686,658,255
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	125,000,149	141,951,739
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	125,000,149	141,951,739
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	517,521,358	544,706,516
48	210	Toka, T,roje, Terene		
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndertesa e Konstruksione	462,941,804	486,673,546
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
52	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	36,924,735	36,924,735
53	215	Mjete Transporti	2,345,737	4,641,105
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	15,309,082	16,467,130
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		4.Investime		0
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale		
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	51,135,064	34,928,310
66		I.Pasivet Afat shkurtra	51,135,064	34,928,310
67		1. Llogari te Pagushme	51,135,064	34,928,310
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	1,772,713	0
69	42	Detyrime ndaj personelit	28,861,296	19,452,094
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	4,316,048	2,504,415
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	11,215,739	7,872,297
76	436	Sigurime Shendetsore		
77	437,438,	Organizma te tjere shtetere		
80	464	Det.per tu paguar per bl.etrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	1,996,859	2,127,095
82	467	Kreditore te ndryshem		
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	2,972,409	2,972,409
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
91		II.Pasivet Afat Gjata		0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	656,589,785	703,302,835
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	656,589,785	703,302,835
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	639,774,317	703,811,034
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Vepimtarise Ushtrimore		-775,654
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme		
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	16,815,468	267,455
105	107	Vlera e mjeeteve te caktuara ne perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	707,724,849	738,231,145

